

VLADIMIR DRAGOVIQ BISERKA ROVÇANIN NATASHA GAZIVODA

NË BOTËN E MATEMATIKËS

2

Matematika për klasën e dytë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2012



Dr. Vladimir Dragović, Biserka Rovčanin, Natasha Gazivoda

У СВИЈЕТУ МАТЕМАТИКЕ 2

Математика за други разред основне школе

Приручник за наставнике

NË BOTËN E MATEMATIKËS 2

Matematika për klasën e dytë të shkollës fillore

Libri i mësuesit

Botuesi	Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë
Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse	Nagja Durković
Redaktor	Llazo Leković
Redaktor i botimit në gjuhën shqipe	Dimitrov Popović
Recensentë	dr. Zhana Kovijaniq - Vukiqeviq dr. Svjetllana Terziq Svetllana Radojeviq Nagja Llutershek Radmilla Bajković
Përkthyes	Zarija Brajović
Ilustrues dhe disenjoja	Sërgja Radullovic
Përgatitja teknike	Nikolla Knezheviq
Redaktor teknik	Rajko Radullovic
Për botuesin	Nebojsa Dragović
Shtypur në	Studio MOUSE; Podgoricë
Tirazhi	50

CIP – Каталогизација у публикацији

Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-1661-6

COBISS.CG-ID 20349968

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin numër 16-3739 të datës 11.07.2011, e ka miratuar këtë komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollën fillore.



PËRMBAJTJA

Parathënia	4	33. Mbledhja me kalimin mbi dhjetëshe	112
Përcaktimi i programit të lëndës mësimore	7	34. Zbritja me kalimin mbi dhjetëshe	115
Programi i matematikës për klasën e 2 ^{-të}	9	35. Mbledhja me kalimin mbi dhjetëshe	119
1. Çfarë kemi mësuar në klasën e parë?	12	36. Zbritja me kalimin mbi dhjetëshe	122
2. Çfarë kemi mësuar në klasën e parë?	15	37. Mbledhja me kalimin mbi dhjetëshe	125
3. Pozicioni i sendeve	17	38. Zbritja me kalimin mbi dhjetëshe	128
4. Ku janë sendet dhe qeniet rreth meje?	20	39. Tabela e mbledhjes së numrave deri në 20	131
5. Në ç'drejtim lëvizim?	23	40. Mbledhja dhe zbritja e numrave	135
6. Karakteristikat e sendeve	27	41. Ushtrime me mbledhje dhe me zbritje	138
7. Bashkësitë e sendeve dhe të qenieve	31	42. Ushtrime me problema	141
8. Tabelat	34	43. Ditët e javës	145
9. Krahasimi i numrave	36	44. Trupat gjeometrikë	149
10. Krahasimi dhe klasifikimi	39	45. Trupat dhe figurat gjeometrike	151
11. Klasifikimi dhe paraqitja	43	46. Dhjetëshet dhe njëshet	154
12. Pika. Vijat e drejta dhe vijat e lakuara	46	47. Shkrimi dhe leximi i numrave deri në 100	158
13. Segmenti	50	48. Numrat deri në 100	162
14. Vijat e mbyllura dhe vijat e hapura	54	49. Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit me dy shifra	165
15. Vija e thyer	58	50. Krahasimi i numrave deri në 100	168
16. Matja e gjatësisë	61	51. Mbledhja dhe zbritja	171
17. Njehsimi me mbledhje dhe me zbritje	65	52. Mbledhja dhe zbritja	175
18. Mbledhësit dhe shuma	67	53. Mbledhja dhe zbritja e numrave	178
19. Ndërrimi i vendit të mbledhësve	70	54. Mbledhja dhe zbritja e numrave	182
20. I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshesa	72	55. Zbritja e numrave me dy shifra	185
21. Lidhja midis mbledhjes dhe zbritjes	75	56. Mbledhja dhe zbritja e numrave	188
22. Paraqitja e numrave	78	57. Monedhat: 50 dhe 100 euro	191
23. 0 dhe 1 tek mbledhja dhe zbritja	82	58. Ushtrime me mbledhje dhe me zbritje	194
24. Monedhat: 1, 2, 5, 10 dhe 20 euro	86	59. Ushtrime me problema	196
25. Mbledhja dhe zbritja	88	60. Ushtrime me problema	198
26. Numrat me një shifër dhe numrat me dy shifra deri në 20	92	61. Çfarë kemi mësuar në klasën e dytë?	200
27. Dhjetëshet e qindëshes së parë	96	62. Çfarë kemi mësuar në klasën e dytë?	203
28. Mbledhja dhe zbritja e dhjetësheve	99	Fletët mësimore	206
29. Decimetri dhe metri	101		
30. Mbledhja dhe zbritja e numrave	104		
31. Mbledhja dhe zbritja e numrave	106		
32. Mbledhja dhe zbritja e numrave	109		



Parathënia

MBI KOMPLETIN E TEKSTIT MËSIMOR

Në klasën e parë nxënësit kanë përvetësuar njohuritë elementare të matematikës, të cilat, tani, në klasën e dytë do të zgjerohen e plotësohen me njohuri të reja.

Teksti mësimor është material pune kushtuar nxënësve dhe është konceptuar në mënyrë të tillë, që të mund të sigurojë një bashkëveprim pedagogjik jo vetëm ndërmjet nxënësit e Tekstit mësimor, por edhe ndërmjet mësuesit e nxënësit. Përmbajtja mësimore e dhënë në Tekstin mësimor është trajtuar mbi bazën e Planit e të Programit mësimor dhe është në përputhje me qëllimet dhe me detyrat e caktuara për lëndën e matematikës në klasën e dytë. Lënda mësimore është ndarë në katër fusha: gjeometri, matje, aritmetikë dhe algjebër, paraqitja tabelore dhe grafike e të dhënave. Të gjitha temat janë të renditura në dy libra; pjesa e parë dhe pjesa e dytë, të parashikuara në mënyrë orientuese për semestrin e parë dhe për semestrin e dytë. Libri është ndërtuar si tekst mësimor pune që ka hapësirën e parashikuar të mjaftueshme për shënimin e përgjigjeve dhe për zgjidhjen e ushtrimeve. Në Tekstin mësimor është dhënë edhe materiali didaktik.

Temat mësimore në Tekstin mësimor janë ndarë në tema me tituj të ndryshëm. Çdo temë mësimi është paraqitur në një dyfaqësh dhe zhvillohet në dy orë mësimi: në orën e parë të mësimi është parashikuar zhvillimi i lëndës së re, kurse në të dytën është parashikuar përfundimi i saj. Temat e mësimi në Tekstin mësimor janë zhvilluar në mënyrë të tillë, që të jenë interesante dhe tërheqëse për nxënësit e kësaj moshe. Ato janë të pasuruara me ilustrime, të cilat do t'i bëjnë nxënësit edhe më të interesuar dhe më të motivuar. Ushtrimet në përputhje me kërkesat e tyre dhe do të futin ato gradualisht përmes figurave, shenjave e fjalëve në njohuritë bazë të matematikës. Çdo temë e re mësimi fillon me ilustrimin, me figurën ose me skemën që krijon tek nxënësit bazën pamore për hyrjen në lëndën e re dhe të cilat e zëvendësojnë materialin teorik.

Në librin e parë të Tekstit mësimor një pjesë e madhe e ushtrimeve dhe pjesa më e madhe e kërkesave janë paraqitur në mënyrë vizuale, sepse nxënësit e klasës së dytë nuk e zotërojnë akoma në semestrin e parë teknikën e leximit. Kërkesat janë hartuar në mënyrë të tillë, që t'u mundësojnë nxënësve që dinë të lexojnë për t'i zgjidhur vetë. Në librin e dytë të Tekstit mësimor karakteri i ushtrimeve ndryshon gradualisht; shtohet sasia e tekstit të shkruar në ushtrime dhe pakësohet sasia e ilustrimeve.

Në përputhje me Programin mësimor, pjesa më e madhe e materialit i kushtohet aritmetikës, e cila përfaqëson linjën themelore metodike. Megjithatë, edhe linjat e tjera (gjeometrike, algjebrike, kombinatorike), megjithëse të pakta në numër, zhvillohen e zbatohen paralelisht me aritmetikën. Jemi të mendimit, se vetëm kombinimi i temave dhe i linjave të ndryshme, si edhe lidhja horizontale e lëndës mësimore e mundësojnë përvetësimin e plotë të materialit mësimor dhe arritjen e standardit të njohurive të parashikuara me Programin mësimor.

Teksti mësimor është i pasur me një numër të madh kërkesash e ushtrimesh të ndryshme, të cilat janë të renditura nga ato më të thjeshtat, deri tek ato më të ndërlikuarat, por në një mënyrë të tillë, që për çdo nxënës të ekzistojë numri i mjaftueshëm i ushtrimeve. Kjo gjë mundëson organizimin më të lehtë të punës dhe individualizimin e saj të diferencuar gjatë mësimi.

Ushtrimet në Tekstin mësimor janë formuluar në mënyrë të tillë, që të mbështeten në përvojën e mëparshme të fëmijëve, përkatësisht në disa njohuri e shprehje të cilat ata është dashur t'i përvetësojnë në klasën e parë. Kërkesat janë parashtruar në mënyrën më të shkurtër e më të qartë të mundshme dhe kanë shpesh karakter motivues. Një Tekst mësimor i konceptuar në këtë mënyrë, jo vetëm që u mundëson nxënësve, që t'i fitojnë njohuritë e shkathtësitë bazë të matematikës, por edhe nxit e zhvillon tek ata kureshtjen, vëmendjen, këmbënguljen, saktësinë, të menduarit logjik dhe frymën krijuese.



Në Tekstin mësimor janë parashtruar edhe ushtrimet që kërkojnë nga nxënësit pjesëmarrjen krijuese (mendo, gjej, formo, zgjidh, vizato etj.), të cilat zhvillojnë jo vetëm intelektin, por edhe forcën e vullnetit e të ndjesisë; formojnë aftësinë për vendosjen e qëllimeve të jetës dhe për realizimin e tyre, zhvillojnë pavarësimin në kapërcimin e pengesave dhe aftësinë e vetëkontrollit e të vetëorientimit. Kjo gjë u mundëson nxënësve që, krahas zhvillimit të shkathtësive për të njehsuar e për të vizatuar, të përparojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e aftësive të veta mendore për të analizuar, krahasuar, përgjithësuar, sistemuar dhe kuptuar me anë të analogjisë.

Tekstet e para të matematikës luajnë një rol të madh në zhvillimin e interesimit të fëmijëve për matematikën dhe në qëndrimet e tyre pozitive ndaj saj. Për këtë arsye, ushtrimet bartin nganjëherë karakterin e lojërave, të cilat gjithsesi janë të mbushura me përmbajtje matematikore.

Puna me Tekstin mësimor nuk e shteron tërë përmbajtjen e orës së mësimt sepse, krahas tij, përdoren demonstrimet, puna praktike me mjetet ndihmëse didaktike, lojërat etj., kështu që mësuesi/mësuesja mund të krijojë gjithmonë situatën e duhur dhe atmosferën lidhur me temën e orës së mësimt.

LIBRI I MËSUESIT

Krahas Tekstit mësimor është dhënë edhe Libri i mësuesit, i cili ju kushtohet juve, arsimtarëve dhe duhet t'ju këshillojë dhe t'ju kujtojë, sesi t'i realizoni qëllimet operative të përcaktuara në Programin mësimor të lëndës së Matematikës për klasën e dytë. Libri i mësuesit, duke e përdorur patjetër Tekstin mësimor, mundëson planifikimin e duhur të temave të parashikuara të mësimt.

Me përmbajtjen e vet, Libri i mësuesit e ndjek plotësisht përmbajtjen e Tekstit mësimor. Janë dhënë propozimet për një spektër të gjerë të veprimtarive, duke përfshirë edhe lojërat, të cilat do ta lehtësojnë dhe do ta bëjnë edhe më interesant zhvillimin e temave të veçanta të mësimt. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve (shtatë vjeç), jemi përpjekur që të ofrojmë veprimtari që janë të afërta me përvojën e tyre, me njohuritë e tyre paraprake, si edhe me mënyrën sesi nxënësit e kësaj moshe i fitojnë njohuritë. Për këtë arsye, kemi planifikuar veprimtaritë përmes të cilave nxënësit i fitojnë njohuritë nga objektet konkrete të mjedisit përreth, nga ilustrimet e ndryshme dhe nga simbolet grafike. Mendimi i nxënësve të kësaj moshe është shpesh i mbizotëruar nga të dhënat e fituara me perceptim ose nga përvoja vetjake.

Në kuadër të çdo teme mësimi, tërheqim vëmendjen tek nocionet kyçe të fushës së matematikës brenda tyre. Libri i mësuesit do t'u ndihmojë arsimtarëve për planifikimin e mësimt, në ç'rast ata do t'i përshtatin orët e mësimt me kërkesat e punës në paralelen e vet. Ndërkohë, Libri i mësuesit nuk ju detyron që t'i përmbaheni atij në mënyrë rigorozë gjatë përdorimit të tij. Çdo arsimtar, në përputhje me përvojën e vet dhe me mënyrën sesi e sheh ai Programin, mund të hartojë realizimin vetjak të qëllimeve operative të Programit mësimor. Në këtë rast, Libri i mësuesit mund t'ju ndihmojë, që ju të arrini rezultatet optimale në punën me nxënësit tuaj.

Theksojmë se nxënësit nuk i fitojnë në mënyrë të gatshme njohuritë e reja matematikore, por përpiqen vetë që të arrijnë tek ato gjatë procesit të punës kërkimore. Ndryshon roli i mësuesit në orën e mësimt. Ai e organizon dhe e drejton veprimtarinë kërkimore të nxënësve gjatë orës së mësimt. Me anën e ushtrimeve më të lehta, nxënësi futet në problematikën e dhënë, ndërsa pastaj, në një nivel të caktuar, i ushtron dhe i verifikon njohuritë, kurse në fund, me një ngritje të lehtë të shkallës së kërkesave, konfirmon nëse nxënësi është i përgatitur për të bërë hapin në vazhdim.

Pjesa më e madhe e ushtrimeve të Tekstit mësimor janë të zhvilluara në Librin e mësuesit. Për disa prej ushtrimeve janë hartuar rrëfenjat, të cilat mund t'i nxitin nxënësit në punë. Ushtrimet e Tekstit mësimor janë bërë më të larmishme në Librin e mësuesit, gjë që krijon spektrin e mundësive për një zhvillim shtesë dhe për adaptimin me aftësitë individuale të nxënësve.

Në Librin e mësuesit janë propozuar zhvillimet e orëve të mësimt, që shërbejnë si material fillestar për krijimtarinë individuale të çdo arsimtari. Vëmendjen e veçantë e tërheqim tek çështja



e qëllimeve të orëve të mësimi. Qëllimet orientohen drejt nxënësve dhe janë të formuluar, para së gjithash, për nxënësit.

Qëllimet janë faktor i rëndësishëm i sistemit të mësimi. Si të jenë qëllimet, të tilla janë edhe procesi dhe rezultatet e edukimit. Rëndësi ka të tregohet kujdes për çështjet më poshtë: Çfarë mund të bëjë nxënësi pas kësaj ore mësimi? Si mund t'i përdorë ai njohuritë e veta në jetën e përditshme? Çfarë do të bëjë në orën e mësimi për ta përvetësuar materialin e dhënë?

Në mësimin e matematikës, përveç tekstit mësimor dhe shpjegimeve të mësuesit, rol të madh kanë materiali ndihmës didaktik, mjetet mësimore dhe lojërat matematikore. Lojërat fusin larminë e veprimtarive në klasë dhe e rrisin interesimin për lëndën e mësimi, zhvillojnë vëmendjen, kujtesën dhe të menduarit e nxënësve, sjellin sistematizimin e përvojës, zhvillojnë iniciativën e shkathtësinë, i ushtrojnë nxënësit për punë, saktësi, vërtetësi dhe durim në kapërcimin e pengesave. Gjatë lojës, nxënësit nuk ndjejnë se mësojnë, ndërsa njohuritë e fituara përmes lojës mbahen mend më gjatë sesa njohuritë e fituara në mënyra të tjera. Loja sjell kënaqësi tek nxënësit, kështu që gjendja shpirtërore pozitive transmetohet edhe në mësim. Lojërat mund shfrytëzohen në mënyra të ndryshme dhe në situata të ndryshme: gjatë përvetësimit të lëndës së re, gjatë ushtrimeve, gjatë përsëritjes së lëndës së mësuar. Rëndësi ka që mësuesit ta dinë, kur dhe pse e futin një lojë dhe çfarë dëshirojnë të arrijnë me të.

Çfarë i nxit nxënësit që të fillojnë të mendojnë për njërin apo për tjetrin ushtrim ose çështje matematikore? Si burim kryesor i motivimit të nxënësve mund të shërbejë interesimi fëmijëror. Për këtë arsye, mësuesi duhet të kërkojë e të gjejë mjetet dhe mënyrat për të zgjuar tek fëmijët interesimin për matematikën.

Të përmendim se ushtrimet logjike janë edhe një nga mënyrat e tjera për formimin e të menduarit të drejtë. Gjatë punës me ushtrimet logjike, fëmijët mësojnë t'i krahasojnë objektet matematikore, bëjnë llojet e thjeshta të analizës e të sintezës dhe zhvillojnë aparatin logjik.

Prania e humorit, proverbave, gjëgjëzave, lojërave me fjalë, e këngëve të shkurtra etj. krijon klimën e përshtatshme për të mësuar materialin e parashikuar. Prandaj edhe për to tregohet kujdes i veçantë në Librin e mësuesit. Përmes disa temave të mësimi realizohet edhe lidhja ndër-lëndore me disa lëndë të tjera mësimore.

Në fillim të Librit të mësuesit kemi sistemuar materialin për programin e lëndës së matematikës dhe për qëllimet e përgjithshme të kësaj lënde. Pastaj kemi dhënë programin e matematikës për klasën e 2-të, pasqyrën përmbledhëse të qëllimeve operative dhe katalogun e njohurive. Pjesën e fillimit të Librit të mësuesit e përmbyll projekti i Planit vjetor orientues të mësuesit.

Në fund të Librit të mësuesit janë propozuar fletët e punës, të cilat mund të shërbejnë për sistematizimin e disa temave të mësimi.



PËRCAKTIMI I PROGRAMIT TË LËNDËS MËSIMORE

Matematika është lëndë mësimi e rëndësishme e arsimimit të përgjithshëm, para së cilës qëndrojnë detyrat e shumta arsimore e edukative. Ajo ka lindur në kuadër të qytetërimeve të lashta, në pjesën më të madhe si pasojë dhe si nevojë për të zgjidhur disa detyra praktike. Zhvillimi i shoqërisë ka vënë para kësaj shkence detyra vazhdimisht të reja, kurse zgjidhja e tyre ka kërkuar një shkallë gjithnjë e më të madhe abstraksioni dhe krijimin e teorive të reja. Kështu ka lindur gjuha specifike e matematikës dhe formalizmi matematikor, është vendosur struktura matematikore, është caktuar koleksioni i nocioneve matematikore dhe janë përpunuar metodat matematikore. Matematika është zhvilluar pjesërisht në mënyrë të pavarur, ndërsa pjesërisht falë gërshetimit me shkencat natyrore (në vend të parë me fizikën). Rezultatet e saj janë shfrytëzuar mjaft, deri pak kohë më parë vetëm nga shkencat natyrore, kurse kohët e fundit edhe nga shkencat humane-shoqërore (gjuhësia, ekonomia). Matematika ka një karakter të theksuar të përgjithshëm civilizues, ndërsa rezultatet e matematikanëve janë më kohë fryt i përbashkët e të gjithë popujve e kulturave.

QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË MËSIMIT TË MATEMATIKËS

Mësimi i matematikës duhet:

- të nxitë e të zhvillojë aftësinë e vrojtimit e të mendimit logjik, kritik e abstrakt të nxënës-ve/eve;
- të nxitë e të zhvillojë arsyetimin e pavarur të nxënës-ve/eve;
- të kultivojë tek nxënës-it/set nevojën për të fituar njohuri të reja;
- t'i aftësojë nxënës-it/set për të zgjidhur e ushtrime të thjeshta matematikore;
- të zhvillojë tek nxënës-it/et aftësinë për t'i njohur situatat e jetës së përditshme, në të cilat mund të zbatohen njohuritë matematikore;
- t'u ndihmojë nxënës-ve/eve që më ndihmën e njohurive matematikore të kuptojnë disa dukuri në mjedisin jetësor përreth;
- t'u ofrojë nxënës-ve/eve njohuritë matematikore të nevojshme për vazhdimin e shkollimit.

Përveç qëllimeve të përgjithshme të përmendura, ekzistojnë edhe një varg detyrash të qëllimeve specifike të mësimi të matematikës.

Qëllimet; detyrat specifike të mësimi të matematikës janë:

- nxënës-i/ja të fitojë shkathtësinë e leximit e të shkrimit të numrave, të zotërojë veprimet aritmetike bazë të njehsimi dhe të aftësohet që të njehsojë lirshëm, lehtë dhe saktë;
- nxënës-i/ja të njohë nocionet bazë matematikore: bashkësi, njehsim, relacion, funksion dhe shënimin standard për këto nocione;
- nxënës-i/ja të njohë njësitë matëse bazë;
- nxënës-i/ja të njohë figurat e rrafshëta gjeometrike kryesore, trupat e format sipërfaqësore dhe relacionet e tyre reciproke;
- të zhvillohet tek nxënës-it/et shkathtësia e përdorimit të mjeteve ndihmëse të gjeometrisë dhe të aftësohen ata/ato që t'i masin saktë objektet gjeometrike;
- të kultivohet tek nxënës-it/et aftësia për t'i modeluar dhe për t'i ndërtuar figurat gjeometrike;
- nxënës-i/ja të përvetësojë pohimet matematikore që do të përmenden në Program;
- nxënës-i/ja të aftësohet për t'i mbledhur të dhënat nga mjedisi përreth dhe për t'i paraqitur ato me numra, me grafikë, me tabela ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe të aftësohet ai/ajo, që t'i lexojë dhe t'i shpjegojë vetë të dhënat e paraqitura në një nga mënyrat më sipër;



- të interpretohet matematika me shembuj nga mjedisi përreth i nxënës-it/ses si disiplinë jetësore, që ndihmon në zgjidhjen e një detyre konkrete dhe, përmes shembujve nga fizika, kimia, biologjia, gjeografia, të zhvillojë vetëdijen për praninë e matematikës në shkencat natyrore;
- të zhvillohet tek nxënës-it/et vetëdija për karakterin universal të gjuhës së matematikës si mjet komunikimi;
- të zhvillohen e të kultivohen tek nxënës-it/et dituritë matematikore;
- nxënës-i/ja të aftësohet në përdorimin e literaturës së matematikës;
- të zhvillohet e të kultivohet tek nxënës-it/et puna sistematike, këmbëngulja, konciziteti, fryma krijuese dhe logjika në shpjegimin me gojë e me shkrim të ushtrimeve, si edhe aftësia për të menduar në mënyrë abstrakte. Rëndësi të madhe ka që nxënës-i/ja të aftësohet për ta lexuar me kujdes ushtrimin; t'i kuptojë kushtet dhe ta ketë të qartë se çfarë kërkohet prej tij. Është mirë që, me një përzgjedhje të mirë të ushtrimeve, të krijohen situatat, në të cilat nxënës-it/et mund të manifestojnë frymën e vet krijuese. Duke këmbëngulur në analizën dhe në zgjidhjen e asaj që është dhënë, fëmija vihet në rolin e hulumtuesit të vogël; i jepet mundësia që ta shqyrtojë në mënyrë kritike zgjidhjen, që ta thotë mendimin e vet për atë që do të ndodhë me rezultatin, nëse ndryshohen të dhënat hyrëse, si edhe liria për të ndërtuar vetë ndonjë variant të ri në lidhje me ushtrimin e zgjidhur;
- të jetë matematika për nxënës-it/et një shtysë intelektuale, një fushë e vetëkonfirmimit të tyre. Ushtrimet për shkollën fillore janë të tilla, që shumica e tyre mund të zgjidhet nga të gjithë nxënës-it/et me më shumë apo me më pak përpjekje. Zgjidhja e çdo ushtrimi kërkon përpjekje mendore. Në momentin kur nxënës-i/ja e zgjidh ushtrimin, ai/ajo do ta konfirmojë aftësinë e vet mendore;
- t'ua bëjë të afërt nxënës-ve/eve anën estetike të matematikës. Kultivimi i ndjesisë për të bukurën matematikore duhet të jetë shqetësim i përhershëm i mësues-ve/eve. Natyrisht, me zhvillimin e kësaj ndjesie, zhvillohet edhe ndjesia e përgjithshme për të bukurën;
- të shfrytëzohen rrethanat që, në mësimin e matematikës, nxënës-it/et të punojnë në grupe dhe në grupet e formuara në mënyrë të tillë ata t'i zgjidhin ushtrimet. Kjo formë pune është frymëzuese për nxënës-it/et, i motivon ata/ato më shumë, ndërsa në grupe shfaqen edhe mjaft ide për zgjidhjen e ushtrimeve. Me punën më grupe, tek nxënës-it/et kultivohet nevoja për punën kolektive dhe zhvillohet ndjesia për një lloj pune të tillë;
- ta njohë nxënës-in/en me historiatin e matematikës dhe me karakterin e saj të përgjithshëm civilizues.



PROGRAMI I MATEMATIKËS PËR KLASËN E 2-të

Gjithsej 136 orë mësimi: 16 orë mësimi janë të papërcaktuara, 120 orë janë përcaktuar.

Fusha: GJEOMETRI (me orientim 25 orë mësimi)

Tema: Orientimi në hapësirë

- relacionet hapësinore dhe kahet e lëvizjes.

Tema: Format dhe relacionet hapësinore

- sendet e ndryshme në hapësirë;
- relacionet në hapësirë;
- trupat, figurat, vijat.

Fusha: MATJA (6 orë mësimi)

Tema: Matja

- njësitë matëse të gjatësisë (m, dm, cm);
- vlerat e monedhës;
- njësitë matëse të kohës (ditët e javës).

Fusha: ARITMETIKA DHE ALGJEBRA (me orientim 79 orë mësimi)

Tema: Numrat natyrorë deri në 100

- numrat natyrorë deri në 20;
- gjuha matematikore;
- mbledhja dhe zbritja në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 20 ($8 + 5$; $12 - 5$; $16 - 12$);
- ushtrimet e tipit: $8 + 5 + 6$, $13 - 5 + 6$, $8 + 5 - 6$, $18 - 5 - 6$;
- numrat natyrorë deri në 100 dhe numri 0;
- struktura e numrave (njëshet, dhjetëshet, qindëshet);
- krahasimi i numrave ($<$, $>$, $=$).

Tema: Njehsimet

- mbledhja dhe zbritja në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 100 (e numrit me dy shifra dhe e numrit me një shifër pa kalimin mbi dhjetëshe dhe e numrave me dy shifra prej të cilëve njëri duhet të përfundojë me zero (tek zbritja ky është zbritësi);
- ligji i ndërrimit të vendeve tek mbledhësit.

Fusha: PARAQITJA ME TABELA DHE ME GRAFIKË E TË DHËNAVE (me orientim 10 orë mësimi)

- bashkësitë;
- tabelat; leximi, sistemimi dhe paraqitja e të dhënave.

Qëllimet operative

Nxënës-it/et duhet:

- të përcaktojnë pozicionin e sendeve në relacion me sendet e tjera;
- të lëvizin në hapësirë (mjedis) duke ndjekur udhëzimet dhe të dinë t'i formulojnë ato;
- t'i krahasojnë sendet e të njëjtit lloj sipas gjatësisë, gjerësisë, trashësisë dhe lartësisë;
- ta kuptojnë rëndësinë e relacioneve (më i madh-më i vogël, më i trashë-më i hollë, më i gjatë-më i shkurtër, më i gjerë-më i ngushtë, i (e) barabartë;
- t'i renditin sendet e të njëjtit lloj sipas madhësisë: i vogël, mesatar, i madh (më i vogli, më i madhi);



- të dinë t'ï emërtojnë trupat që janë mësuar në klasën e parë (sferë, cilindër dhe kub), si edhe trupat kon e paralelepiped;
- të dallojnë dhe të emërtojnë figurat e thjeshta gjeometrike;
- të dallojnë, të emërtojnë dhe të vizatojnë vijat e drejta e të lakuara (vijat e hapura e vijat mbyllura);
- ta dallojnë vijën si kufirin midis asaj që është jashtë dhe asaj që është brenda (vija e mbyllur e lakuar dhe vija e mbyllur e thyer);
- ta dallojnë pjesën e jashtme e të brendshme tek shembujt konkretë;
- t'ï përdorin siç duhet mjetet e vizatimit (vizoren);
- ta dallojnë largësinë më të shkurtër midis dy pikave (segmenti);
- ta vizatojnë vijën e thyer;
- ta masin gjatësinë me njësinë matëse standarde e jostandarde të gjatësisë;
- të njohin mënyrat e ndryshme të matjes;
- t'ï njohin njësitë matëse të gjatësisë;
- t'ï shënojnë matjet me numrin dhe me njësinë matëse;
- t'ï mbledhin dhe t'ï zbresin njësitë e njëjta matëse;
- t'ï njohin vlerat e monedhave;
- t'ï dinë ditët e javës dhe renditjen e tyre;
- të masin kohën;
- të përdorin gjuhën e matematikës (mbledhësit, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshesa);
- të mbledhin e të zbresin në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 20 (kalimi mbi dhjetëshe);
- të përvetësojnë, të përsosin e të zbatojnë mbledhjen e zbritjen në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 20;
- të dinë të gjejnë mbledhësin e panjohur dhe zbritësin e panjohur;
- të numërojnë, të shkruajnë dhe të lexojnë numrat deri në 100;
- të njohin dhjetëshet e qindëshes së parë;
- të njohin strukturën e numrave me dy shifra;
- t'ï renditin sipas madhësisë numrat natyrorë deri në 100;
- të dallojnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrit të dhënë;
- të dinë vlerën e vendit të shifrës në numër;
- të shkruajnë relacionet midis numrave ($<$, $>$, $=$) në zgjidhjen e ushtrimeve;
- të zotërojnë mbledhjen me gojë të dhjetësheve brenda qindëshes së parë duke përdorur analogjinë;
- të mbledhin e të zbresin në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 100 (rastet e saktësuara në temën e mësimit);
- të dinë të gjejnë mbledhësin e panjohur dhe zbritësin e panjohur;
- të zbatojnë ligjin e ndërrimit të vendeve të mbledhësve;
- të dallojnë lidhjen reciproke midis mbledhjes e zbritjes;
- të kuptojnë rolin e 0 në mbledhje dhe në zbritje;
- të kuptojnë se 0 është ndryshesa midis dy numrave të barabartë;
- t'ï sistemojnë sendet; trupat, figurat dhe numrat sipas dy karakteristikave;
- të zbulojnë e të shpjegojnë me fjalë dy karakteristika, sipas të cilave janë të sistemuara sendet; trupat, figurat dhe numrat;
- t'ï paraqitin sendet e sistemuara;
- t'ï paraqitin të dhënat e thjeshta më ndihmën e diagrameve me shtylla dhe me anë të tabelave të përgatitura;
- të dinë t'ï lexojnë të dhënat e thjeshta.



KATALOGU I NJOHURIVE PËR KLASËN E DYTË

Nxënës-it/et duhet:

Kërkesat minimale:	Kërkesat bazë
<p>Nxënës-it/et duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojnë format e sendeve e të figurave; - të vënë re ndryshimet; shumë, pak, më shumë, më pak, më ulët, më lart, para, prapa; - t'i numërojnë elementet e bashkësisë; - t'i njohin shenjat matematikore dhe t'i përdorin ato siç duhet; - të dinë ta shkruajnë vargun numerik deri në 20; - të mbledhin e të zbresin deri në 20 (rastet $8+5$; $12-5$; $16-12$); - të masin me njësitë matëse jo standarde. 	<p>Nxënës-it/et duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohin, të dallojnë dhe t'i emërtojnë siç duhet format e sendeve, sipërfaqet dhe vijat; - të dallojnë e të vizatojnë pikën dhe segmentin; - të dinë të përdorin vizoren; - të vënë re relacionet e sendeve ndaj vetes dhe ato të sendeve ndaj sendeve; - t'i krahasojnë bashkësitë sipas përmbajtjes numerike; - të dinë t'i numërojnë, t'i lexojnë, t'i shkruajnë dhe t'i krahasojnë numrat deri në 100, si edhe t'i përdorin siç duhet shenjat e barazimit e mosbarazimit; - të njohin strukturën e numrave; - të zotërojnë mbledhjen dhe zbritjen deri në 100 (rastet e saktësuara në temën e mësimi); të kuptojnë radhën e njehsimeve mbi të cilat bazohen këto njehsime; të kuptojnë nocionin 0 dhe të dallojnë vetitë e saj në mbledhje dhe në zbritje; të njohin terminologjinë dhe shenjat e mbledhjes e të zbritjes; - të përdorin ligjin e ndërrimit të vendeve të mbledhësve; - të gjejnë mbledhësin e panjohur dhe zbritësin e panjohur; - të dinë t'i zgjidhin ushtrimet me problema (me një dhe me dy njehsime) në kuadër të mbledhjes e të zbritjes deri në 100, me ndihmën e formimit të njehsimeve dhe anasjelltas, mbi bazën e njehsimit të dhënë, të dinë ta hartojnë problemën përkatëse; - të njohin e të përdorin njësitë matëse bazë (metri, monedhat); - t'i paraqitin dhe t'i lexojnë të dhënat.



1. ÇFARË KEMI MËSUAR NË KLASËN E PARË?

QËLLIMET

Nxënësit:

- vënë re relacionet në mjedisin përreth mbi bazën e shembujve të thjeshtë e konkretë;
- përcaktojnë pozicionin në relacion me vetveten;
- dallojnë e emërtojnë në mjedisin përreth trupat bazë gjeometrikë (sfera, cilindri, kubi);
- dallojnë dhe emërtojnë figurat (trekëndëshi, katrori, rrethi, drejtkëndëshi);
- sistemojnë sendet sipas karakteristikës së dhënë;
- përsërisin barazinë dhe mosbarazinë e bashkësive.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria hyrëse:

Shënim: Nxënësit njihen me Tekstin e ri mësimor që sjell mjaft ushtrime interesante e të shumëllojshme, me ndihmën e të cilëve ata do të përforcojnë e do të zgjerojnë njohuritë e veta. Duke zgjidhur ushtrimet e Tekstit mësimor, nxënësit do të vazhdojnë të zbulojnë botën e mrekullueshme të matematikës. Nëse disa prej ushtrimeve do t'u duken të vështira, atëherë nxënësit duhet të përpiqen që t'i zgjidhin ato së bashku me shokët e vet të klasës ose me ndihmën e mësues-it/es.

Nxënësit e hapin Tekstin mësimor dhe në temën e parë të mësimimit njohin personazhet e reja të rrëfimit në figurën hyrëse në faqen 6. Nxënësit dëgjojnë rrëfimin:

Pushimet verore kanë përfunduar dhe me një shtator Markoja dhe Asimi, shokë të mirë shkolle, kanë shkuar të marrin shoqen e tyre Maja dhe janë nisur bashkë për në shkollë.

SHKOLLA

Në shkollë po shkojmë,
ku nxënësit e zellshëm janë,
ku ushtrimet një nga një zgjidhen,
ku dërrasa e zezë fshihet shpesh,
se shumë numra në të shkruhen.
Gjithçka që mësojmë e dimë,
njehsojmë e numërojmë,
nga numri një ka filluar!
Prandaj më shumë kujdes,
ndaj numrave tregoni,
ky rregull për çdo shkollë të vlej!

[Autori]

Markoja është rritur mjaft gjatë verës dhe tani është më i gjatë se Asimi.



Nxënësit përpiqen të gjejnë se kush është Markoja në figurën ilustruese. Pastaj u përgjigjen pyetjeve:

- Kush ecën para Majës? Kush ecën pas Majës? Në cilën dorë e mban çantën Markoja?
Cilën dorë tund Markoja?

Pas pushimeve verore, Markoja, Asimi dhe Maja kanë vështirësi në përsëritjen e lëndës mësimore të matematikës nga klasa e parë.

Nxënësve u propozohet që t'u ndihmojnë shokëve për ta rikujtuar atë që kanë mësuar ata në klasën e parë.

Veprimtaria 1: Loja "Trego me dorë"

Përmes kësaj veprimtarie që organizohet me të gjithë nxënësit e klasës, përsëriten relacionet: para-prapa, djathtas-majtas, lart-poshtë.

Nxënësit qëndrojnë para bankave të veta.

Me udhëzimin:

- "Djathtas" - nxënësit ngrenë dorën e djathtë dhe tregojnë djathtas;
- "Majtas" - nxënësit ngrenë dorën e majtë dhe tregojnë majtas;
- "Para" - nxënësit tregojnë me dorë para;
- "Prapa" - nxënësit tregojnë me dorë prapa;
- "Lart" - nxënësit tregojnë me dorë lart;
- "Poshtë" - nxënësit tregojnë me dorë poshtë.

Loja ka karakterin e garës. Udhëzimet jepen gjithnjë e më shpejt, ndërrohet radha e kërkesave, përkatësisht pozicioni i fëmijëve (lart, djathtas, prapa, majtas ...). Nxënësit që gabojnë dalin nga loja.

Veprimtaria 2: "Tregimi më i shkurtër", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Shënim: Me këtë veprimtari nxënësit përsëritin relacionet: më i madh-më i vogël, më i trashë-më i hollë, më i ulët-më i lartë.

Çdo nxënës ka para vetes fletën e fletores së vizatimit. Nxënësit i vizatojnë të gjitha "elementet" nga "Tregimi më i shkurtër", ndërsa pastaj, në po të njëjtën fletë vizatojnë "tregimin e anasjelltë" (për shembull: pranë godinës së banimit të lartë vizatojnë godinën e banimit të ulët ...).

Nxënësit e dëgjojnë dhe vizatojnë sipas tregimit, i cili u lexohet ngadalë e pjesë-pjesë.

"Godina ime e banimit është një godinë e lartë. Pranë saj janë dy drurë të hollë. Drurët i kanë gjethet e vogla."

Pas përfundimit të vizatimit, kontrollohet nëse nxënësit e kanë vizatuar siç duhet "tregimin e anasjelltë".

Nxënësit përsëritin relacionet; godinë banimi e lartë-e ulët; drurë të hollë-të trashë, gjethe të vogla-të mëdha.

Veprimtaria 3:

Nxënësit ndahen në tri kolona. Nxënësi më i lartë i kolonës është kapiteni. Detyra e kapitenit është që t'i sistemojë sendet e dhëna mbi tavolinën e veçantë (që gjendet prapa çdo kolone) në sende që janë në formë cilindri, kubi e sferë.

Në tavolinë duhet të jenë tri grupe sendesh. Kapiteni vendos se cilit grup i përket sendi që silllet. Ai ka të drejtë që, nëse nxënësi ka sjellë sendin që nuk është i formës së dhënë, ta vendosë atë aty ku duhet.



Para çdo kolone gjendet tavolina me sende të ndryshme në formë sferë, kubi e cilindri (për shembull: gota plastike, kanaçe, gogla, kuti ...). Kur dëgjojnë fjalën "cilindri", nxënësit e parë të kolonës shkojnë e kërkojnë sendin në formë cilindri, kthehen dhe ia japin atë kapitenit. Kjo gjë përsëritet për sferën dhe për kubin. Loja zgjat deri sa të kalojnë të gjithë nxënësit e kolonës. Fituese është kolona e nxënësve që bën më pak gabime në sistemin e sendeve.

Veprimtaria 4: Biçikleta matematikore


Shënim: Përmes kësaj veprimtarie, si edhe përmes veprimtarisë nr. 5, nxënësit përsëritin nocionet e figurave e të trupave gjeometrikë.

Në dërrasë të zezë është vizatuar biçikleta prej figurave gjeometrike (trekëndësh, katror, rreth, drejtkëndësh).

Nxënësit shohin vizatimin dhe emërtojnë se çfarë përfaqëson në biçikletë secila nga figurat (trekëndëshi përfaqëson timonin, rrethi përfaqëson rrotat etj.).

Pas kësaj veprimtarie, nxënësit në mënyrë të pavarur dhe me ndihmën e shablloneve vizatojnë shtëpinë duke shfrytëzuar figurat e ndryshme gjeometrike.

Çifti i nxënësve shpjegon se cila figurë përfaqëson secilën pjesë të shtëpisë.



Veprimtaria 5: "Gjej atë që s'i përket grupit"

Shënim: Me këtë lojë kontrollohet, nëse nxënësit i dallojnë trupat gjeometrikë prej figurave gjeometrike.

Mësues-i/ja thotë emërtimet e disa trupave gjeometrikë dhe të njërit që nuk i përket atyre, përkatësisht të një figure a trupi gjeometrik. Nxënësit gjejnë se cili prej tyre nuk i përket grupit. Ushtrimi përsëritet disa herë me kombinime të ndryshme.

Veprimtaria 6:

Kjo veprimtari zhvillohet përmes punës së katër grupeve të nxënësve. Grupet formohen në mënyrën si më poshtë. Çdo nxënës merr nga një figurë prej zarfit, në të cilën gjendet trekëndëshi, katrori, rrethi ose drejtkëndëshi. Nxënësi kërkon pastaj tavolinën, në të cilën gjendet figura që ka nxjerrë. Kur të formohen grupet, nxënësit marrin materialin e nevojshëm për punë.

Çdo grup merr kompletin prej dhjetë figurash: dy trekëndësha të verdhë e dy të kaltër, dy rrate të kuq, dy katrorë të gjelbër dhe dy katërkëndësha portokalli. Figurat me të njëjtin emërtim janë të puthitura.

Nxënësit që i përkasin të njëjtit grup, kanë për detyrë që prej figurave gjeometrike të formojnë dy grupe sendesh (të cilat i rrethojnë me spango), në mënyrë që midis tyre të mund të vihet shenja "=".

Teksti mësimor

Veprimtaria 7:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur **ushtrimet 1, 2, 3, 4 e 5.**



2. ÇFARË KEMI MËSUAR NË KLASËN E PARË?

QËLLIMET

Nxënësit:

- dinë t'i numërojnë, t'i lexojnë, t'i shkruajnë dhe t'i krahasojnë numrat deri në 20;
- mbledhin dhe zbesin brenda dhjetëshes së parë;
- gjejnë mbledhësin dhe zbritësin.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura muzikore

Nxënësit dëgjojnë këngën “Dhjetë piratët e tmerrshëm” dhe përsëritin numrat deri në 10. Pas dëgjimit të këngës, ata bëjnë “analizën matematikore” të saj përmes veprimtarive të ndryshme.

U përgjigjen pyetjeve:

- Sa piratë janë në këngë? (shkrimi i numrave)
- Cili pirat ka qenë para piratit të 8-të?
- Cili pirat ka qenë prapa piratit të 5-të? ...etj.

Numërojnë deri në 10 (nga 1 deri në 10 dhe anasjelltas).

Veprimtaria 2:

Shënim: Me veprimtaritë 2 e 3 nxënësit përsëritin mbledhjen dhe zbritjen deri në 10.

Në tavolinë janë tri sfera të kaltra dhe pesë sfera të verdha. Sferat janë të përziera. Nxënësit i shohin sferat, i përshkruajnë ato dhe i sistemojnë sipas ngjyrës. Pas kësaj i përgjigjen pyetjes: “Si mund të gjejmë, se sa sfera janë në tavolinë?” Nxënësit i përgjigjen kësaj pyetjeje duke shkruar dhe duke njehsuar se: $5 + 3 = 8$ dhe $3 + 5 = 8$.

Mbi bazën e rezultatit që kanë përfutuar me njehsimin me mbledhje, ata nxjerrin përfundimin, se kanë përfutuar të njëjtin rezultat, edhe pse është ndërruar vendi i mbledhësve. Pra, nxënësit e kuptojnë se shuma nuk ndryshon, nëse u ndërrohet vendi i mbledhësve. Pas kësaj vazhdon zgjidhja e shembujve të ngjashëm.

Veprimtaria 3:

Para dërrasës së zeze gjenden nëntë nxënës. Mësuesi ka në dorë shtatë “ftesa” për ekspozitën. Pra, nuk ka “ftesa” të mjaftueshme për të gjithë nxënësit. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Me ç’veprim njehsimi mund të gjejmë se sa nxënës nuk e kanë marrë “ftesën”?”

Ata nxjerrin përfundimin, se këtë mund ta gjejnë me anë të zbritjes dhe shkruajnë barazimin $9 - 7 = 2$.

Pason zhvillimi i ushtrimeve të ngjashme.

Veprimtaria 4:

Shënim: Me veprimtaritë 4 e 5, nxënësit përsëritin numrin e panjohur tek mbledhja dhe tek zbritja.

Para dërrasës së zeze është nxënësi që ka pesë bonbone. Meqë i pëlqejnë shumë bonbonet, ai dëshiron që të ketë nëntë bonbone. Nxënësit e zgjidhin ushtrimin për të ditur sesa bonbone i mungojnë atij për të pasur nëntë. Në dërrasë të zeze shkruajnë $5 + _ = 9$ dhe përgjigjen se i mungojnë edhe katër bonbone. Atëherë plotësojnë vendin bosh: $5 + 4 = 9$

Pason zhvillimi i shembujve të ngjashëm.



Veprimtaria 5: “Detyra e drurit të vjeshtës”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Në dërrasë të zeze është vizatuar “druri i vjeshtës”. Në të janë gjashtë gjethe. Nxënësit dëgjojnë rrëfimin e “drurit të vjeshtës”.

“Dikur kam qenë një dru i bukur. Kam qenë strehë e shumë kafshëve. Kam pasur shumë gjethe jeshile dhe fruta të kuqe. Aroma ime është përhapur deri larg dhe të gjithë janë mahnitur me mua. Por arriti vjeshta dhe pamja ime filloi të ndryshonte Frutat m’i volën, gjethet më ranë. Më kanë mbetur vetëm nëntë gjethe. Dje ka fryrë një erë e fortë dhe m’i ka marrë disa gjethe. Tani kam gjashtë gjethe. Detyrë për ju, o fëmijë! Sa gjethe me ka marrë era? Si do ta shkruani këtë gjë? Mendohuni!”

Nxënësit flasin, shkruajnë: $9 - \underline{\quad} = 6$ dhe përgjigjen, se era ka marrë 3 gjethe nga druri.

Pastaj e plotësojnë vendin bosh $9 - 3 = 6$. Pason zhvillimi i shembujve të ngjashëm me “drurin e vjeshtës”, por me numër tjetër gjethesh.

Veprimtaria 6:

Në dërrasë të zeze janë vizatuar tullumbace. Gjashtë janë të kuqe, kurse katër janë të kaltra. Nxënësit shohin figurën ilustruese në dërrasë të zeze dhe i përgjigjen pyetjes: “Prej cilave tullumbace ka më shumë?” Fëmijët përgjigjen, se më shumë ka tullumbace të kuqe sesa të kaltra dhe nxjerrin përfundimin se numri 6 është më i madh se numri 4, respektivisht se numri 4 është më i vogël se numri 6.

Detyra përsëritet me numër të ndryshëm balonash.

Veprimtaria 7: “Prezentohu dhe shkruaj”

Shënim: Me këtë veprimtari nxënësit përsëritin dhe krahasojnë numrat deri në 20.

Para dërrasës së zeze dalin 20 nxënës. Nxënësit marrin flamurët e vegjël me numrat nga 1 deri në 20. Renditja e nxënësve dhe, me këtë edhe e numrave, është e përzier. Nxënësit që kanë mbetur në bankat e veta fillojnë të numërojnë, d.m.th. i ftojnë numrat që të prezentohen, të gjejnë vendin e vet të duhur dhe ta shkruajnë numrin e vet. Këtë e bëjnë deri sa të prezantohen e të shkruhen të gjithë numrat deri në 20. Në fund, numërojnë së bashku nga një deri në 20 dhe anasjelltas.

Nga rreshti i formuar dalin numrat 13 dhe 17. Nxënësit përgjigjen, se cili prej këtyre numrave është më i vogël.

Shënim: Rëndësi ka që fëmijëve t’u tërhiqet vëmendja, se krahasimi i numrave mund të bëhet duke parë vendin e tyre në varg (ata shohin se është më i madh numri që është më larg nga fillimi i vargut), por se krahasimi mund të kthehet në krahasimin e numrave 3 dhe 7.

Pason përsëritja e kombinacioneve të ngjashme.

Teksti mësimor

Veprimtaria 8: Figura ilustruese hyrëse

Markoja është vendosur në hotel bashkë me prindërit. Nxënësit shohin figurën ilustruese të recepsionit të hotelit dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Cili është numri i dhomës së Markos?”
- Në cilat dhoma gjenden në këtë moment vizitorët? Si e keni nxjerrë këtë përfundim?
- Cili numër është mbuluar nga lulja? Mbi cilin numër ka rënë shalli?
- Prej abazhurit nuk e shohim numrin e një dhome. Cili numër është ky?

Veprimtaria 9: Ushtrimet nr. 1, 2, 3, 4 e 5

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna.



3. POZICIONI I SENDEVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përcaktojnë pozicionin e një sendi ndaj një sendi tjetër;
- njohin, përkatësisht përcaktojnë, relacionet midis sendeve: poshtë, sipër, para, prapa, midis, në mes, majtas, djathtas, në, mbi;
- shprehin relacionet hapësinore midis sendeve me anë të parafjalëve: poshtë, sipër, para, prapa, ndërmjet, në, mbi.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Shënim: Nxënësit shohin pozicionin e sendeve në mjedisin përreth dhe në figurat përkatëse për të ngulitur nocionet *mbi e nën*.

Në dërrasë të zezë dhe në fletore është vizatuar tavolina, ndërsa nxënësit vizatojnë nën tavolinë topin, kurse mbi tavolinë vizatojnë abazhurin.

Veprimtaria 2:

Shënim: Për të ngulitur nocionet para dhe prapa, nxënësit duhet t'u përgjigjen disa pyetjeve: Për shembull: "Kush rri para Milicës? Kush rri prapa Milloshit?" ...

Disa sende të ndryshme janë renditur në varg. Nxënësit shohin, se cili send gjendet para ose prapa sendit të dhënë. Pastaj një nxënës, sipas udhëzimeve, e zhvendos objektin e dhënë, në mënyrë që të jetë para ose prapa një objekti tjetër të dhënë.

Veprimtaria 3:


Shënim: Për përvetësimin e nocionit *ndërmjet* mund të shfrytëzohen sendet nga mjedisi përreth (në klasë ose në mjedisin përreth).

Nxënësit i përgjigjen pyetjes se çfarë gjendet ndërmjet drurit dhe stolit ose çfarë gjendet në klasë ndërmjet dërrasës së zezë dhe stendës.

Për këtë veprimtari mund të shfrytëzohen figurat, në të cilat janë tri sende ose disa sende, ndërsa nxënësit duhet të shohin, se cilat sende gjenden ndërmjet sendeve të tjera.

Veprimtaria 4: Loja "Molla"

Në dërrasën e zezë janë tri figura mollësh të drejtuara me pjesën e pa ngjyrosur drejt nxënësve.



Nxënësit zgjidhin detyrën: "Molla e kuqe është më e madhe se molla e verdhë, kurse molla e verdhë është më e madhe se molla jeshile. Cila prej mollëve është më e vogla?"



Nxënësit përgjigjen se molla më e vogël është molla jeshile. Pas kësaj, mësues-i/ja kthen anën e ngjyrosur të figurës, në mënyrë që nxënësit të binden se janë përgjigjur drejt. Më tej u përgjigjen pyetjeve:

- Cila mollë është në mes? (E verdha)
- Cila mollë është majtas së verdhës? Djathtas së kuqes? Djathtas së verdhës? Majtas jeshiles? Në mes të kuqes e mollës jeshile?

Në vazhdim të kësaj veprimtarie nxënësit punojnë me sende nga rrethina e vet, duke iu përgjigjur pyetjeve sipas figurave që propozon mësues-i/ja Çfarë është vizatuar në mes? Çfarë është majtas? Çfarë është djathtas?

Teksti mësimor

Veprimtaria 5: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse në të cilën është paraqitur dhoma e fëmijëve dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë gjendet djathtas raftit? Çfarë gjendet majtas raftit? Çfarë gjendet mbi raft? Çfarë shihet në raft? Çfarë është para raftit?
- Çfarë gjendet poshtë tavolinës? Çfarë gjendet në tavolinë?
- Çfarë shtrihet para shtratit të verdhë? Çfarë qëndron varur mbi shtrat?
- Çfarë shtrihet në shtratin e kaltër?
- Çfarë është hedhur në dysheme?

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit ngulitin nocionet: "poshtë", "mbi", "në", "majtas", "djathtas" duke zgjidhur ushtrimin e dhënë.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 2

Shënim: Relacionet mbi, poshtë, ndërmjet, djathtas, majtas kanë kuptimin e tyre të vërtetë, kur sendet që shohim janë të renditura në vijë njëri pranë tjetrit. Një renditje të tillë lineare edhe e ilustron figurat e katër goglave në ushtrim. Nëse renditja lineare është horizontale, përdorim nocionet majtas, djathtas, ndërmjet; ndërsa, nëse renditja lineare është vertikale, atëherë përdorim nocionet, mbi, poshtë, ndërmjet.

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke parë sesi është më trashë në njërin skaj të shkopit, gjë që tregon kahun në të cilin renditen goglat.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 4, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin më poshtë dhe vizatojnë figurën.

"Ishte ditë me re. Në çast nisi të frynte era dhe dielli u shfaq pas reve, tamam **mbi** bredhin e madh. Kafshët e egra dhe zogjtë iu gëzuan diellit. Lepurushi qëndroi **para** bredhit, që të ngrohej pak. Zogjtë u ulën **mbi** degët e rrapit, që prehet **majtas** bredhit. Lulja që rritet **djathtas** bredhit përkulet ngadalë në drejtim të diellit. Vetëm kërpudha që rritet **poshtë** bredhit mbeti nën hije duke i dëshiruar rrezet e rralla të diellit që depërtojnë përmes kurorës së dendur të drurit."




Veprimtaria 10: “Diktim vizual”, punimi i ornamentit

Nxënësit dëgjojnë udhëzimin verbal, sesi ta renditin materialin didaktik të përgatitur mbi fletën e letrës. Materiali didaktik përbëhet nga rrathët, trekëndëshat, katrorët dhe katërkëndëshat e ngjyrave dhe të madhësive të ndryshme. (Mësues-i/ja nuk tregon asgjë përveç udhëzimeve verbale.)

Për shembull: Vini katrorin e madh në mes fletës së letrës. Përreth vendosni 4 rrathë të vegjël. Ndërmjet trekëndëshave vini rrathët e vegjël.

Njëlloj kështu, nxënësit bëjnë në mënyrë të pavarur ornamente prej figurave gjeometrike, pastaj tregojnë sesa figura të ndryshme kanë marrë, ku dhe si i kanë vendosur ato.



Veprimtaria 11: “Mendo”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ.

Veprimtaria në vazhdim organizohet në grupe. Çdo grupi të nxënësve i jepet letra në të cilën është vizatuar ndonjë objekt, ndërsa nxënësit shënojnë pastaj me figura rrëfimin e mësuesit.

Për shembull: Në letër është vizatuar shtëpia. Majtas vizato drurin, djathtas stolin, në çati vizato oxhakun, mbi shtëpi diellin, kurse para shtëpisë vizato rrugën.

Grupi i dytë merr letrën, në të cilën është vizatuar druri, ndërsa detyrë e nxënësve është që në dru të vizatojnë folenë, majtas lulen, djathtas drurin e vogël etj.

Veprimtaria 12: “Vetëm deri tek figura”

Nxënësit ndahen në katër grupe. Para çdo grupi gjendet pllakati bosh dhe figurat në të cilat janë vizatuar: vogëlushi, vogëlushja, gota, topi, automobili dhe libri.

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e parë duke ndjekur udhëzimet: në mes të pllakatit vini figurën e vogëlushes; djathtas sipër vini figurën e gotës; majtas-poshtë vini topin; sipër - majtas vini librin; poshtë-djathtas vini figurën e automobilin.

Ushtrimin e dytë nxënësit e zgjidhin duke ndjekur udhëzimin më poshtë: në mes vini figurën e vogëlushit; djathtas-sipër vini librin; majtas-poshtë vini automobilin; sipër-majtas vini gotën; poshtë djathtas vini topin.

Pas çdo ushtrimi kontrollohet saktësia e punës dhe bëhet vlerësimi me pikë. Në fund shpallet fituesi.



4. KU JANË SENDET DHE QENIET RRETH MEJE?

QËLLIMET

Nxënësit:

- dinë të saktësojnë relacionet hapësinore;
- vërejnë relacionet midis sendeve në relacion me vetveten duke përdorur fjalët: para, prapa, midis, majtas, djathtas, sipër, poshtë në, mbi.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Shënim: Nxënësit shpesh nuk janë të sigurt në përcaktimin e anës së djathtë e të majtë të trupit, prandaj kjo gjë duhet të kontrollohet. Nxënësit mund të zgjidhin ushtrime të ndryshme, si edhe veprimtaritë me të cilat mund të kryhet një kontroll i tillë.

Shembuj:

Nxënësit duhet:

- të ngrenë dorën e majtë;
- të ngrenë dorën e djathtë;
- të kapin veshin e majtë;
- të kërcejnë në këmbën e djathtë;
- të tundin dorën e majtë;
- ta luajnë syrin e majtë;
- të prekin hundën me dorën e djathtë;
- të kapin dorën e djathtë me dorën e majtë;
- të kapin dorën e majtë, veshin e majtë, gjurin e djathtë dhe gjurin e majtë me dorën e djathtë;
- të qëndrojnë në këmbën e djathtë më dorën e majtë të ngritur lart;
- të përshëndeten më shokun e bankës me dorën e djathtë;
- të kryqëzojnë këmbën e majtë mbi këmbën e majtë;
- të emërtojnë shokët, që qëndrojnë majtas dhe djathtas;
- të thonë sendet në klasë që gjenden majtas, pastaj ato që gjenden djathtas;
- të përcaktojnë pozicionin e sendeve në klasë; çfarë ndodhet majtas dërrasës së zezë ose djathtas etazhesë ... etj.

Veprimtaria 2: "Ku gjendet çdonjëri"

Para dërrasës së zezë gjenden dhjetë nxënës, të cilët janë rreshtuar njëri pranë tjetrit. Me zgjedhje të rastësishme, disa prej nxënësve u përgjigjen pyetjeve që bëhen.

Shembuj:

- Cili nxënës është i treti majtas teje?
- Cili nxënës është i dyti djathtas teje?
- Cili nxënës është i pari majtas ...? etj.

**Veprimtaria 3:**

Nxënësit duhet të vënë re fillimisht, se mësuesi u ka kthyer atyre shpinën dhe se ka ngritur dorën e djathtë. Pasi që kthehet me fytyrë në drejtim të tyre, nxënësit nxjerrin përfundimin, se mësuesi është në pozicion tjetër në relacion me ta, në ndryshim me situatën e mëparshme kur ka ngritur dorën e djathtë dhe se ana e tij e djathtë nuk është e njëjtë si ajo e tyra. Nxënësve u thuhet, që ta mendojnë këtë pozicion.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme, që nxënësit të ushtrohen gjithnjë e më shumë në dallimin e anës së majtë e të djathtë në rastin e ndryshimit të pozicionit (kur dikush është i kthyer më shpinë, me fytyrë, anash). Që të ushtrohen me këtë relacion, duhet të nxirren para dërrasës së zezë tre-katër nxënës. Nxënësit duhet të arrijnë në përfundimin, se kush kujt i gjendet në anën e djathtë dhe pikërisht në të dyja pozicionet; kur ia ka kthyer shpinën klasës dhe kur është kthyer me fytyrë nga klasa.

Teksti mësimor**Veprimtaria 4: Ushtrimi hyrës**

Mbi bazën e figurës ilustruese në Tekstin mësimor, nxënësit dëgjojnë rrëfimin duke përdorur fjalët: para, prapa, ndërmjet, majtas, djathtas, sipër, poshtë, mbi, në. Për ta menduar më lehtë rrëfimin fëmijët, ata u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Çfarë gjendet majtas Markos? Çfarë gjendet djathtas Markos?
- Çfarë është para tij? Çfarë është prapa tij?
- Çfarë është poshtë tavolinës? Po, çfarë është mbi tavolinë?
- Ku gjendet etazheja?
- Çfarë është në etazhe? Çfarë është varur në raft?
- Çfarë është ndërmjet Markos e Majës? (Nxënësit nxjerrin përfundimin se ndërmjet tyre gjendet tavolina me lodra.)

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ngjashme duke imagjinuar, se gjenden në vendin e Majës. Nxënësit duhet të vënë re, se objektet që gjenden në të majtë të Markos, në relacion me Majën gjenden djathtas.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Në këtë ushtrim nxënësit i ngjyrosin rrathët mbi bazën e udhëzimit të dhënë. Në këta mënyrë, ata përsëritin dhe ngulitin nocionet "majtas" e "djathtas".

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin mbi bazën e udhëzimit të dhënë.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shohin figurën në Tekstin mësimor dhe përshkruajnë pozicionin e dritareve të godinës, duke iu përgjigjur pyetjeve më poshtë:

- Çfarë gjendet në katin e parë, në dritaren e dytë, majtas? (Shohin, se është fjala për vazon me lule.)
- Çfarë gjendet në katin e dytë në dritaren e tretë majtas, ndërsa çfarë në katin e tretë në dritaren e katërt majtas? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se në katin e dytë është banesa që shitet, ndërsa në katin e tretë në dritaren e katërt është Markoja që po përshëndet me dorë.)
- Në cilën dritare shihen perdet e bukura? (Nxënësit shohin se perdet janë në katin e tretë, në dritaren e tretë majtas.)
- Përmes cilës dritare shihet llamba elektrike e ndezur? (Nxënësit shohin figurën dhe nxjerrin përfundimin se llamba elektrike është e ndezur në katin e dytë, në dritaren e dytë majtas.)



- Në cilën dritare është lëshuar grila? Nxënësit shohin, se grila është lëshuar në katin e parë, në dritaren e katërt, majtas.)

Veprimtaria hyrëse për ushtrimin nr. 4

Tavolina e mësues-it/es është vendosur midis klasës. Pas saj gjendet mësuesja, ndërsa pas mësueses një vogëlush i klasës. Para tryezës së mësues-it/es gjendet një vogëlushe. Nxënësit duhet të vënë re, se nga pozicioni në të cilin gjendet, vogëlushi sheh fillimisht mësuesen, pastaj tavolinën e mësues-it/es, kurse vogëlushja sheh fillimisht tavolinën e mësues-it/es dhe vetëm pastaj mësuesen. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se të dy nxënësit shohin të njëjtën skenë, por secili prej pozicionit të vet sheh një pjesë të skenës.

Shënim: Nxënësit përcaktojnë në këtë mënyrë se ku gjenden sendet dhe qeniet në relacion me pozicionin e tyre.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4

Në Tekstin mësimor është dhënë figura e rrugës, të cilën fëmijët, Katerina dhe Petri, e shohin nga pika të ndryshme, të cilat në plan janë shënuar me K dhe P. Secili fëmijë e sheh në mënyrën e vet të njëjtën situatë në rrugë dhe kjo pamje është shënuar me vizatime. Nxënësit shohin figurat e paraqitura dhe zbulojnë, se cili vizatim është vizatuar prej secilës pikë K e P. Përgjigjet i shkruajnë në katrorët pranë figurave.

Zgjidhja: Figurën e parë e ka vizatuar Petri, ndërsa figurën e dytë e ka vizatuar Katerina.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit njihen me tekstin e ushtrimit duke e lexuar tekstin e shkruar në tërësi, ndërsa pastaj duke e lexuar me etapa (me fjali). Pas çdo fjalie të lexuar (udhëzimi për punë), nxënësit gjejnë zgjidhjen dhe i lidhin me shigjeta figurat dhe katet.

Udhëzim: Ka shumë rëndësi që të theksohet, se nxënësit, pas leximit të fjalisë së dytë, t'i ndajnë Markos dhe Asimit katet e tyre dhe t'i vizatojnë shigjetat. Pas leximit të fjalisë së tretë, nxënësit nxjerrin përfundimin, se Natasha dhe Maja jetojnë në katin e katërt ose të pestë, respektivisht se Natasha jeton në katin e katërt, ndërsa Maja jeton në katin e pestë.



5. NË Ç'DREJTIM LËVIZIM?

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsëritin relacionet hapësinore;
- përsëritin kahet dhe drejtimet e lëvizjes lart-poshtë, djathtas-majtas;
- ushtrohen në hartimin e planit të lëvizjes;
- ushtrohen në lëvizjen sipas planit të dhënë të lëvizjes;
- lexojnë planin e lëvizjes.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit lëvizin në kahun e dhënë: para, prapa, majtas, djathtas.

Shënim: Për këtë veprimtari është e nevojshme, që në klasë të ndërtohet poligoni, nëpër të cilin nxënësit do të lëviznin ndërmjet rreshtave e tavolinave, por pa u përplasur me njëri-tjetrin. Nxënësit lëvizin në kahe të ndryshme; para, prapa, majtas, djathtas, në varësi të udhëzimit që marrin.

Loja mund të jetë shumë zbavitëse për nxënësit, edhe pse do të shkaktojë pak rrëmujë në klasë. Si alternativë propozojmë lojën më poshtë, në të cilën nxënësit ushtrojnë kahet e lëvizjes duke qëndruar në vend.

“Loja e mollëkuqes”; materiali didaktik; tabela 3x3, zhetoni.

Para çdo nxënësi gjendet në tavolinë tabela dhe zhetoni (mollëkuqja). Nxënësit e zhvendosin zhetonin (mollëkuqen) nëpër katrorët e tabelës sipas udhëzimeve që jepen.

Për shembull: Mollëkuqja gjendet në këndin e majtë, poshtë. Më pas zhvendoset në katrorin sipër, kurse pastaj në katrorin djathtas etj.

●		

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Në hartë është paraqitur një pjesë e planit të terrenit. Vetura blu ecën drejt shtëpisë së verdhë dykatëshe. Nxënësit përshkruajnë lëvizjen e veturës: ku lëviz, ku ndalet, pranë (afër) kujt kalon.

Shënim: Mbi bazën e figurës ilustruese mund të diskutohen edhe situatat në vijim: rruget e nxënësve nga shtëpia deri në dyqanin e bukës, lëvizja e veturës së verdhë drejt shtëpisë së kuqe, lëvizja nga shtëpia portokalli deri tek farmacia etj.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimin dhe gjëgjëzën më poshtë:

Lara-lara është, gjarpër nuk është, me brirë është, dhi nuk është, barrën mban, por kalë nuk është?

Pasi që e zgjidhin gjëgjëzën dhe zbulojnë se fjala është për kërmillin, nxënësit njihen me mënyrën e shënimit të lëvizjes së tij (lëvizjen e kërmillit nga e majta në të djathtë e shënojmë me \rightarrow , prej poshtë lart me \uparrow , nga e djathta në të majtë me \leftarrow dhe nga lart poshtë me \downarrow).



Nxënësit shohin rrugën nëpër të cilën ka kaluar kërmilli Joco nga këndi majtas, poshtë, i tabelës deri në këndin djathtas, lart.

Detyrë e nxënësve është, që ta mendojnë e shënojnë lëvizjen e kërmillit në kah të kundërt.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Janë dhënë trajektorët e ndryshme të hartës së lëvizjes së kërmillit. Nxënësit e tregojnë në tabelë lëvizjen e Jocos. Duke pasur parasysh se janë dhënë tri trajektore të ndryshme të hartës së lëvizjes, është e nevojshme që çdo shembull në Tekstin mësimor të bëhet me ngjyrë tjetërsoj.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shohin ilustrimin në Tekstin mësimor dhe bëjnë planin e lëvizjes së milingonës.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 4

Duke parë labirintin, nxënësit e ndihmojnë Kësulëkuqen, që ta gjejë rrugën deri tek shtëpia e gjyshes, duke gjetur fillimisht (5-7 minuta) rrugën deri tek shtëpia, ndërsa nxënësit thonë pastaj një nga një kahun e lëvizjes së Kësulëkuqes.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5, Loja “Lëvizja e urithit”

Shënim: Kjo lojë mund të fillojë me gjëegjëzë: Lëron si bujk, i zi si kovaç, ose Gjurma e kujt njihet, ndërsa mbi tokë nuk ecën. Nxënësit duhet të zbulojnë se zgjidhja e gjëegjëzës është urithi.

Nxënësit udhëzohen, se urithi lëviz nën tokë dhe se “trajektorja e lëvizjes” së tij përshkruhet me katrorë dhe me rathë. Katrori tregon, se urithi lëviz nga e majta në të djathtë, ndërsa rrethi tregon lëvizjen nga poshtë lart. Sipër çdo terreni është dhënë kodi, i cili përbëhet nga katrorët dhe nga rathët dhe që jep lëvizjen e urithit nëpër atë terren. Nxënësit vizatojnë në mënyrë të pavarur në tri terrenet e tjera lëvizjet, të cilat u përgjigjen kodeve.

Shënim: Si detyrë shtëpie mund t’u propozohet nxënësve, që të bëjnë cilindo kombinim me tre katrorë e tre rathë dhe ta shënojnë një lëvizje të tillë të urithit.

Veprimtaria 8: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik

Shënim: Kjo veprimtari zhvillohet në oborrin e shkollës.

Nxënësit vihen në rresht duke qenë njëri pas tjetrit. Me dhënien e udhëzimeve, ata lëvizin majtas ose djathtas. Po kështu, në oborrin e shkollës mund të bëhet udhëkryqi, ndërsa nxënësit luajnë rolin e veturës, e cila lëviz në kah të caktuar me komandë të njërit prej nxënësve (polici rrugor).

Veprimtaria 9: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik


Shënim: Kjo orë mësimi zhvillohet në oborrin e shkollës me udhëzimet paraprakisht të përgatitura nga ana e mësuesit.

Nxënësit ndahen në tri grupe. Qëllimi i çdo grupi është të gjejë “arkën e shkollës”, d.m.th. çantën e fshehur të nxënësit. Çdo grup i ka udhëzimet e përgatitura paraprakisht. Udhëzimet përbëhen nga numrat dhe nga shigjetat pranë tyre. Numri shënon numrin e hapave, kurse shigjeta shënon kahun e lëvizjes.



Veprimtaria 10: Loja "Ku do të arrijë çiklisti?"

Para nxënësve është tabela me trajektoren e lëvizjes së çiklistit. Nxënësit e shënojnë lëvizjen me anë të shigjetave.




Veprimtaria 11: Diktim grafik

Nxënësit e zgjidhin diktimin grafik në fletore "në katrorë". Gjatë diktimit, ata lëvizin me laps nëpër vijat e anëve të katrorëve, duke filluar nga pika e dhënë pa e shkëputur dorën nga letra.

Shembull i diktimit nr. 1:


2 majtas, 2 lart, 2 djathtas, 2 lart, 1 djathtas, 5 poshtë, 5 djathtas, 1 lart, 1 majtas,
1 lart, 2 djathtas, 7 poshtë, 1 majtas, 2 lart, 5 majtas, 2 poshtë, 1 djathtas, 6 lart.



Pas përfundimit me sukses të ushtrimit, nxënësit vënë re se, duke e zhvilluar ushtrimin, ata kanë përfutur figurën e qenushit.

**Shembull i diktimit nr. 2:**

5 lart, 1 majtas, 4 lart, 1majtas, 2 lart, 2 djathtas, 1 lart, 1 djathtas, 2 lart, 1 majtas, 1 poshtë, 1 djathtas, 1 lart, 1 djathtas, 1 poshtë, 1 djathtas, 1 lart, 1djathtas, 2 poshtë, 4 majtas, 1 poshtë, 1 majtas, 3 poshtë, 1 djathtas, 1 poshtë, 8 djathtas, 2 poshtë, 1 majtas, 1 lart, 2 majtas, 6 poshtë, 1 majtas, 3 lart, 1 majtas, 1 lart, 3 majtas, 2 poshtë, 1 majtas, 2 poshtë, 1 majtas.



Pas përfundimit me sukses të ushtrimit, nxënësit vënë re se, duke e zhvilluar ushtrimin, ata kanë përfutur figurën e drerit.

Veprimtaria 12: Loja "Mos gabo"

Një nxënës qëndron para nxënësve të tjerë me shpinë të kthyer nga ata. Ky nxënës zbaton urdhrat e drejtuesit. Për shembull:

- dy hapa para,
- një hap majtas,
- tre hapa djathtas etj.

Nxënësit e tjerë përsëritin lëvizjet që nxënësi i zbaton siç duhet. Nëse nxënësi e zbaton urdhrin gabim, nxënësit e tjerë i përplasnin këmbët në dysheme.



6. KARAKTERISTIKAT E SENDEVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- vërejnë relacionet midis sendeve sipas ngjyrës, sipas formës dhe sipas madhësisë;
- përsëritin karakteristikat e ndryshme të sendeve: ngjyra, forma, madhësia, funksioni, materiali prej të cilit janë punuar sendet etj.;
- ndajnë sendet sipas një karakteristike;
- zbulojnë dhe shpjegojnë me fjalë dy karakteristika, sipas të cilave janë ndarë sendet, figurat dhe numrat.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria hyrëse:

Nxënësit tregojnë të gjitha objektet që shohin në rrugën nga shtëpia deri në shkollë. Bisedojnë për objektet e mjedisit përreth dhe për karakteristikat e tyre. Pastaj i krahasojnë e sistemojnë objektet e mjedisit përreth sipas lartësisë (kolonat, shumëkatëshat, shtyllat). Në të njëjtën mënyrë bëjnë edhe për gjatësinë e gjerësinë.

Veprimtaria 1:

Para dërrasës së zezë janë tri tavolina. Mbi çdo tavolinë janë sendet me gjatësi, gjerësi e lartësi të ndryshme. Kapitenët, nxënësit që do të përfaqësojnë rreshtat e vet, i zgjedh për nga lartësia trupore mësues-i/ja (i lartë, i shkurtër, më i shkurtër), Detyra e kapitenëve është, që t'i sistemojnë sendet nga kanistra, të cilat u sjellin nxënësit e veçantë nga rreshtat e tyre sipas udhëzimeve që kanë marrë. Nëse ndonjë nga nxënësit sjell sendin që nuk përputhet me udhëzimin e dhënë, kapiteni mund ta sistemojë këtë send, ashtu siç duhet. Fitues është rreshti, kapiteni i të cilit ka më pak gabime.

Veprimtaria 2: Puna në çifte

Nxënësit i renditin rrathët e madhësive e të ngjyrave të ndryshme të bërë prej kartoni: rrathë të kuq, të kaltër dhe të gjelbër. Pastaj i krahasojnë dy rrathët fqinjë në varg dhe i përgjigjen pyetjes: "Sipas cilave karakteristika dallohen rrathët?"

Veprimtaria 3: "Vazhdo lojën"

Para nxënësve janë figurat gjeometrike të madhësive e të ngjyrave të ndryshme (janë të dhëna tek materialet didaktike). Nxënësit veçojnë një figurë gjeometrike, e shohin dhe i përshkruajnë karakteristikat e saj (forma, madhësia, ngjyra). Pastaj veçojnë prej figurave të tjera gjeometrike një, e cila do të dallohet sipas një karakteristike prej figurës së zgjedhur më parë.

Loja vazhdon, deri sa të përftohet vargu prej 5 figurash gjeometrike.

Për shembull: rrethi i madh i kuq, rrethi i vogël i kuq, trekëndëshi i vogël i kuq, trekëndëshi i vogël blu, trekëndëshi i madh blu.

Veprimtaria 4:

Nxënësit shohin sendet e përgatitura ose grupin e sendeve të njëjta ose të ndryshme për nga forma, për nga ngjyra, për nga madhësia dhe për nga materiali. Për shembull, disa sende si sfera, kube etj., të njëjta për nga madhësia, por të ndryshme për nga ngjyra. Nxënësit i sistemojnë



sendet dhe u përgjigjen pyetjeve: “Ç’ngjyrë kanë sendet? Prej ç’materiali janë bërë? A janë sendet të së njëjtës madhësi?”

Teksti mësimor

Veprimtaria 5: Figura ilustruese hyrëse

Markoja dhe Maja kanë shkuar në dyqanin e lodrave për të zgjedhur dhuratën e ditëlindjes për shokun e tyre, Asimin.

Nxënësit e shohin figurën ilustruese dhe u përgjigjen pyetjeve:

- “Çfarë kanë parë Markoja dhe Maja në etazhenë sipër?” (Nxënësit përgjigjen, se kanë parë arushët prej pelushi).
- “A janë të njëjtë arushët? Në ç’gjë ngjasojnë dhe në ç’gjë ndryshojnë ata?” (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se materiali prej të cilit janë punuar arushët është i njëjtë dhe se ata ndryshojnë për nga ngjyra dhe për nga madhësia.)
- “Çfarë kanë parë ata në etazhenë poshtë? Nga se dallohen sendet në etazhe?”
- Aty është edhe rrjeta me topa të ndryshëm. “Nga se dallohen topat?” (Duke i parë topat, nxënësit nxjerrin përfundimin, se ato dallohen për nga madhësia, për nga ngjyra, për nga funksioni dhe për nga materiali prej të cilit janë punuar.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke zgjedhur nga valixhja e madhe figurat sipas karakteristikave të shënuara në etiketa dhe i vizatojnë ato në valixhet e vogla.

Zgjidhja: Në valixhen e parë duhet të vizatohen rrathët e mëdhenj, në valixhen e dytë duhet të vizatohen figurat blu, kurse në valixhen tretë duhet të vizatohen trekëndëshat e vegjël.

Nxënësit mund t’i sistemojnë më tej sipas ngjyrës rrathët, që janë vizatuar në valixhen e parë të vogël dhe shkruajnë $1 + 1$ gjë që i përgjigjet një rrethi të kuq të madh dhe një rrethi të kuq të vogël.

Nxënësit mund t’i sistemojnë gjithashtu sendet e valixhes së dytë të vogël sipas madhësisë. Kjo gjë shkruhet $3+1$ sepse janë 3 figura të vogla dhe 1 figurë e madhe. Sendet e valixhes nxënësit mund t’i sistemojnë më tej sipas formës. Këtë e shkruajnë $2 + 2$, sepse janë dy trekëndësha dhe dy rrathë.

Nxënësit mund t’i sistemojnë më tej sipas ngjyrës trekëndëshat e vegjël, që janë vizatuar në valixhen e tretë të vogël dhe të shkruajnë $2 + 1 + 1$, gjë që i përgjigjet një trekëndëshi të verdhë, një trekëndëshi të kuq dhe dy trekëndëshave blu.

Veprimtaria 7:

Nxënësit i krahasojnë figurat (trekëndëshi i madh i kuq dhe trekëndëshi i madh i vogël):

- Çfarë është e përbashkët tek këto figura? (Nxënësit shohin, se e përbashkët është forma e njëjtë e figurave).
- Sa ndryshime keni vënë re? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ka ndryshuar ngjyra (e kuqja → bluja) dhe madhësia (i madh → i vogël).

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit ndjekin ndryshimet që ndodhin dhe e thonë çdo ndryshim.

Udhëzim: Nxënësit u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- “Kemi pasur katrorin e madh të gjelbër. Ç’ndryshime kanë ndodhur në lëvizjen e parë?” (Nxënësit shohin, se ka ndodhur ndryshimi i formës dhe i madhësisë; trekëndëshi i vogël i gjelbër).
- “Çfarë ka ndodhur pastaj?” (Nxënësit shohin, se ka ndodhur ndryshimi i ngjyrës dhe i madhësisë; trekëndëshi i madh i verdhë).



- "Çfarë kemi përftuar në hapin në vazhdim?" (Nxënësit shohin, se figura në vazhdim është rrethi i madh i verdhë, ndryshimi është vetëm një dhe kjo është forma).
- "Çfarë kemi përftuar pas rrethit të madh të verdhë?" (Nxënësit shohin, se është fjala për rrethin e kuq të vogël). "Çfarë ka ndryshuar?" (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ka ndryshuar ngjyra dhe madhësia).
- "Ç'ndryshime kanë pasuar?" (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ka ndryshuar ngjyra dhe forma dhe se në figurën në vazhdim është katrori i vogël blu).
- "Çfarë ka ndodhur pastaj?" (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ka ndryshuar madhësia dhe forma; trekëndëshi i madh blu).
- "Në fund kemi përftuar katrorin tonë të madh të gjelbër? Cili është ndryshimi i fundit që ka ndodhur?" (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ndryshimi i fundit është në formë dhe në ngjyrë).

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit vizatojnë në mënyrë të pavarur figurat duke treguar kujdes që, në çdo hap të punës, të bëhet ndryshimi vetëm i dy karakteristikave.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit e shohin me vëmendje figurën ilustruese dhe studiojnë renditjen e flamurëve dhe pastaj i shtojnë duke vizatuar flamurët e vegjël që mungojnë.

Zgjidhja: Nga e majta në djathtë janë varg flamuri i vogël i kuq, flamuri i madh blu, flamuri i vogël i verdhë dhe flamuri i madh i kuq. Pak më tej ndeshim flamurin e vogël të kuq, flamurin e madh blu, flamurin e vogël të verdhë dhe vendin bosh. Pra, në këtë vend bosh duhet të jetë flamuri i madh i kuq. Pas këtij vendi, ku është vizatuar flamuri i madh i kuq, gjendet flamuri i vogël blu. Domethënë, flamuri i vogël blu duhet vizatuar në vendin e parë bosh, në të djathtë të flamurit të madh të kuq.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.

Zgjidhja: Kordelet e Majës dallohen për nga gjerësia dhe për nga gjatësia. Ato nuk ndryshojnë për nga ngjyra. Kordelja e parë është më e gjera dhe më shkurtra. Kordelja e dytë është më e ngushta dhe më e gjata. Kordelja e tretë është më e gjerë se e dyta, por më e ngushtë se e para. Kordelja e tretë është më e gjatë se e para, por më e shkurtër se e dyta.

Shënim: Kini kujdes se përveç renditjes sipas madhësisë: më e madhe – më e vogël, përdorni edhe krahasimet: më e gjatë – më e shkurtër, më e gjerë – më e ngushtë, më e ulët – më e lartë, më e trashë – më e hollë

Veprimtaria 12: Ushtrimi nr. 6

Udhëzim: Në ushtrimin numër 6 janë dhënë sendet që ndryshojnë për nga tri karakteristika: për nga forma, për nga ngjyra dhe për nga madhësia. Këto janë një rreth i madh i verdhë, një rreth i vogël i verdhë, dy trekëndësha të vegjël të verdhë, një rreth i vogël blu dhe një trekëndësh i vogël blu. Në tri figurat janë dhënë ndarjet e kësaj bashkësie sipas një karakteristike. Poshtë çdo veprimi është dhënë shprehja numerike, shuma e dy numrave, e cila tregon, se në sa sende ndahet bashkësia sipas karakteristikës së caktuar. Mbi bazën e kësaj shprehjeje numerike, që gjendet poshtë figurës, duhet caktuar edhe karakteristika sipas cilës bëhet ndarja.

Poshtë figurës së parë shkruan $1 + 5$. Kjo është ndarja sipas madhësisë, sepse në figurë është një send (rrethi i madh i verdhë) dhe pesë sende të mëdha (dy trekëndësha të vegjël të verdhë, një rreth i vogël i verdhë, një rreth i vogël blu dhe një trekëndësh i vogël blu).

Nxënësit e shënojnë këtë ndarje në Tekstin mësimor (duke vizatuar vijën që ndan rrethin e madh të verdhë nga figurat e tjera).



Poshtë figurës së dytë shkruan $2 + 4$. Kjo ndarje është bërë sipas ngjyrës, sepse është vizatuar një rreth i vogël blu dhe një trekëndësh i vogël blu.

Nxënësit e shënojnë këtë ndarje në Tekstin mësimor.

Poshtë figurës së tretë shkruan $3 + 3$. Kjo është ndarja sipas formës, sepse janë paraqitur tre trekëndësha dhe tre rrate.

Nxënësit e shënojnë këtë ndarje në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 13: Ushtrimi nr. 7

Shënim: Ky ushtrim është kombinim i detyrës logjike dhe lojës. Ai shërben për ushtrimin e vëmendjes, për vënien re të hollësive dhe për koncentrim. Në të njëjtën kohë ushtrohet pozicioni i sendeve në hapësirë dhe shfrytëzimi i propozimeve hapësinore.

Nxënësit shohin ndryshimet në figurë dhe i thonë ato.

Veprimtaria 14: Loja "Letrat logjike"

Për këtë lojë duhen 24 fletushka të së njëjtës madhësi dhe në formë drejtkëndëshi. Në çdo fletushkë janë figurat gjeometrike: rrethi, drejtkëndëshi dhe trekëndëshi, në dy madhësi: të mëdha dhe të vogla, ndërsa janë përdorur 4 ngjyra: ngjyra e verdhë, ngjyra e kuqe, ngjyra jeshile dhe ngjyra blu.

Nxënësit kanë para vetes 24 fletushka, në të cilat janë vizatuar figurat e ndryshme gjeometrike të ngjyrave e të madhësive të ndryshme. Çdo fletushkë ka karakteristikat e veta, për shembull, letra në të cilën është vizatuar rrethi i madh jeshil, i cili ka tri karakteristikat: "i madh", "jeshil", "rrumbullak".

Shënim: Loja me fletushkat logjike të kujton lojën me letrat e zakonshme të bixhozit. Atë mund ta luajnë nga dy deri në 4 nxënës.

Fletushkat janë të përziera dhe me pamjen poshtë. Një nga lojtarët i ndan nga 5 fletushka çdonjërit. Pas kësaj, një fletushkë kthehet së mbari, kurse të tjerat vendosen grumbull mënjanë. Lojtari i dytë duhet që prej fletushkave të veta të marrë një prej tyre dhe ta vendosë atë mbi fletushkën e hapur, në ç'rast duhet të zgjedhë një fletushkë të tillë, e cila do të ndryshojë prej fletushkës së kthyer me dy (një) karakteristikë. Nxënësi tjetër e vendos fletushkën e vet duke u përqendruar tek fletushka që ka vendosur tashmë lojtari i mëparshëm. Në rast se lojtari nuk e ka fletushkën që i duhet, ai e merr sipas radhës një prej fletushkave që kanë mbetur grumbull mënjanë, gjithnjë deri sa ta gjejë fletushkën që i duhet. Nëse në tavolinë nuk ka më fletushka, atëherë radha kalon tek lojtari pasues.

Fitues është lojtari që i harxhon më shpejt të gjitha fletushkat e veta. Ndërkohë, në rastin kur fletushkën e nxjerrë nuk mund ta mbyllë kurrkush me fletushkën e vet, atëherë shpallet fitues ai që ka në dorë më pak fletushka.



7. BASHKËSITË E SENDEVE E TË QENIEVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë idenë e grupimit të sendeve sipas karakteristikave të ngjashme, si edhe idenë e ndarjes nga grupi të sendeve të veçanta;
- përvetësojnë dhe kuptojnë nocionin bashkësi mbi bazën e sendeve që i rrethojnë, por nuk e përvetësojnë bashkësinë si nocion abstrakt;
- përvetësojnë nocionin bashkësi si koleksioni i objekteve të ndryshme, kurse elementet e bashkësisë si sendet që i përkasin këtij koleksioni.

Shënim: Bashkësia është nocioni bazë në matematikë, gjë që tregon se ajo nuk mund të përkufizohet. Bashkësitë mund t'i emërtojnë dhe t'i tregojmë, por jo edhe t'i përkufizojmë. Në nivelin fillestar të përvetësimit të bashkësisë, është më mirë të shfrytëzohen njohuritë paraprake të nxënësit, d.m.th. të bëhet lidhja me botën reale. Atëherë flasim për tufën e luleve, bashkësinë e nxënësve të një klase Çdo lule, çdo nxënës është element i bashkësisë përkatëse. Nxënësit duhet ta kuptojnë, se elementet e bashkësisë nuk duhet të jenë vetëm nocione të njëllota, por edhe të shumëllojta. Atyre duhet t'u tregohen shembujt e tjerë: mbathjet (elementet janë: këpucët, çizmet, papuçet, sandalet), enët (tenxheret, pjatat, gotat) etj.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit grupohen sipas një karakteristike. Ata vënë re, se sipas cilës karakteristikë janë grupuar dhe e emërtojnë këtë grup.

Shembuj:

- bashkësia e fëmijëve me të njëjtën lartësi trupi;
- bashkësia e fëmijëve me sy bojë qielli;
- bashkësia e fëmijëve me bluza të kuqe;
- bashkësia e vogëlushëve;
- bashkësia e vogëlusheve;
- bashkësia e fëmijëve me flokë të shkurtër.

Veprimtaria 2:

Nxënësve u ndahen paraprakisht fletët e përgatitura të punës, në të cilat janë vizatuar figurat e ndryshme (lulet, bojërat, veshmbathja). Pas kësaj, mbi bazën e udhëzimit të dhënë, nxënësit kërkojnë shokët që kanë marrë figurën, e cila ka të njëjtën karakteristikë sikurse ata. Fëmijët që kanë të njëjtën figurë (përkatësisht të njëjtin element të bashkësisë së dhënë) dalin para dërrasës së zezë. Në këtë mënyrë, nxënësit vënë re, se janë formuar katër bashkësi. Çdo grup emërton bashkësinë e vet. (Bashkësia e luleve, bashkësia e ngjyrave, bashkësia e veshmbathjeve.)



Veprimtaria 3: Loja “Kur ke lindur”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Nxënësit dalin para dërrasës së zezë, pasi të jetë thënë muaji në të cilin kanë lindur (me radhë: shtator, tetor, nëntor, dhjetor, janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht). Pas kësaj, nxënësit grupohen mbi bazën e pyetjeve:

- Kush janë fëmijët “e vjeshtës”?
- Kush janë fëmijët “e dimrit”?
- Kush janë fëmijët “e pranverës”?
- Kush janë fëmijët “e verës”.

Nxënësit shohin, se kanë formuar katër grupe. Çdo grup thotë, se cilës bashkësi i përket (e emërton atë).

Veprimtaria 4: Loja “Po të gënjej”, punë me çifte

Nxënësi merr fletoren nga shoku dhe vizaton në të bashkësinë prej pesë elementesh, ku një nga elementet nuk i përket bashkësisë. Nxënësi, fletorja e të cilit është, duhet ta emërtojë bashkësinë e dhënë, por edhe të shohë, ku e ka “gënjyer” shoku, përkatësisht të gjejë elementin që s’i përket bashkësisë dhe ta fshijë atë. Pastaj e bën këtë gjë nxënësi tjetër në fletoren e shokut të vet. “Gënjimi” përsëritet dy herë.

Shënim: Në këtë mënyrë, nxënësit shohin elementet që nuk i përkasin bashkësisë së dhënë.

Veprimtaria 5:

Shënim: Kjo veprimtari zhvillon vëmendjen e nxënësve.

Nxënësve u jepen udhëzimet më poshtë:

- Kur ta dëgjoni emërtimin e lules, atëherë ngrini lart dorën e djathtë, ndërsa kur ta dëgjoni emërtimin e kafshës, atëherë ngrini lart dorën e majtë (lepuri, tigri, trëndafili, elefanti, lulebora, ariu etj.).

Shënim: Pas kësaj, nxënësit mund të marrin udhëzimet e ndryshme në relacion me ndarjen e kafshëve në kafshë shtëpiake dhe në kafshë të egra, përkatësisht të luleve, në lule të lulishteve dhe në lule të fushave.

Veprimtaria 6: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Nxënësit kërkojnë emërtimin e përbashkët të sendeve në figurat ilustruese që përgatit mësues-i/ja (për shembull: tavolina, karriga, kolltuku, shtrati, janë mobilie. Pjata, gota, tasi etj., janë enë kuzhine). Nxënësit i emërtojnë sendet e tjera që i përkasin grupeve të përmendura (për shembull: rafti, divani, tryeza e shkrimi, janë gjithashtu mobilie, kurse broka e ujit, tenxherja, tigani, tepsia janë enë kuzhine).

Veprimtaria 7: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Shënim: Nxënësit mund ta kuptojnë vetë, se ç’është bashkësia mbi bazën e shumë shembujve.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Si quhet bashkësia e deleve?
- Si quhet bashkësia e zogjve dhe si quhet bashkësia e bletëve?
- Si e quajmë bashkësinë e ujqve dhe si e quajmë bashkësinë e elefantëve?
- Nëse në lukuninë e ujqve hyn gabimisht një dele, a do të bëhej ajo element i kësaj bashkësie?
- Si do ta quanim bashkësinë në të cilën do të gjendeshin një dele, një dhi, një lopë dhe një derr.

Kthehemi në klasë. Çfarë bashkësish kemi këtu? Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ata së bashku bëjnë një klasë; një bashkësi. Të gjithë nxënësit e paraleles sonë bëjnë bashkësinë e nxënësve të paraleles II/2. Elementë të kësaj bashkësie janë Markoja, Marija, Maja, Asimi; Milloshi, Hana etj. Nxënësit përgjigjen, sesa elemente ka kjo bashkësi dhe se cilat janë karakteristikat e përbashkëta



të elementeve të bashkësisë.

Nxënësit formojnë bashkësitë mbi bazën e udhëzimeve të dhëna.

Shembuj:

- bashkësia që bëjnë vetëm vogëlushet;
- bashkësia e vogëlushëve;
- bashkësia e fëmijëve që i kanë sytë e kaltër;
- bashkësia e fëmijëve që mbajnë bluzat e së njëjtës ngjyrë etj.

Nxënësit në një bashkësi kapen për dore, emërtojnë bashkësinë, elementet e bashkësisë dhe karakteristikat e përbashkëta të kësaj bashkësie. Në këtë mënyrë, nxënësit përvetësojnë gradualisht nocionin bashkësi dhe element (anëtar) i bashkësisë.

Teksti mësimor

Veprimtaria 8: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin bashkësitë e ndryshme të sendeve e të qenieve dhe i emërtojnë ato. Pastaj, caktojnë për çdo prej sendeve e të qenieve të dhëna bashkësinë përkatëse dhe i lidhin ato me shigjetë.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit ndeshen me problemin e anasjellë. Janë dhënë disa sende. Të gjitha sendet, përveç njërit, kanë një karakteristikë të përbashkët që i bashkon ato në bashkësi. Nxënësit duhet të dallojnë fillimisht këtë karakteristikë. Pastaj, duhet ta caktojnë atë send të vetëm që nuk e ka karakteristikën e vërejtur, kështu që nuk i përket bashkësisë.

Zgjidhja: Në figurën lart, majtas, lapsi, peneli, fletorja dhe stilolapsi janë mjete mësimore, kurse molla nuk është mjet mësimor. Domethënë, bashkësisë nuk i përket molla.

Në figurën lart, djathtas, të gjitha sendet do të mund të quheshin "instrumente". Ndërkohë, çekiçi, çelësi, mistria dhe kaçavida janë vegla pune artizanale, ndërsa kitara është instrument muzikor: Përfundimi: kitara nuk i përket bashkësisë.

Në figurën poshtë, majtas, janë paraqitur katër kafshë: pula e detit, rosa, delja dhe pula. Të gjitha ato janë kafshë shtëpiake. Ndërkohë, pula e detit, rosa dhe pula janë shpendë. Delja nuk është shpend. Domethënë, bashkësisë nuk i përket delja.

Në figurën poshtë djathtas janë paraqitur kësula, kapuçi, kapela dhe çizmjja. Të gjitha këto janë sende veshmbathjeje. Por, kësula, kapuçi dhe kapela janë sende për kokën. Çizmjja nuk është për kokën. Domethënë, bashkësisë nuk i përket çizmjja.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit dallojnë katër bashkësi: bashkësinë e lodrave, bashkësinë e mobilieve, bashkësinë e enëve dhe bashkësinë e mjeteve shkollore. Nxënësit i bashkojnë në bashkësi sendet në figurë, duke i qarkuar ato me vijë.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shohin figurat në çdo rresht dhe e emërtojnë bashkësinë. Pastaj vizatojnë në çdo rresht sendin, për të cilin mendojnë se i përket kësaj bashkësie. Në fund, verifikojnë, nëse e kanë zgjidhur drejt ushtrimin.

Veprimtaria 12: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.

Zgjidhja: Në etazhenë e parë janë lodrat, në etazhenë dytë janë enët, në etazhenë e tretë janë kasketat, kurse në etazhenë e katërt janë këpucët.



8. TABELAT

QËLLIMET

Nxënësit:

- njohin nocionin tabelë dhe elemente table;
- përshkruajnë rezultatet e vrojtimit të karakteristikave të sendeve: ngjyra, forma, madhësia, funksioni;
- fitojnë aftësinë e orientimit në tabelë.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin karakteristikat e sendeve, më saktë funksionin e tyre, mbi bazën e të cilëve Markoja do t'i sistemojë gjërat e hedhura nëpër sirtarë.

Nxënësit shkruajnë pranë çdo sendi numrin e sirtarit, në të cilin duhet të vendoset sendi.

Shënim: Pas kësaj veprimtarie, nxënësve u shpjegohet, se ç'është tabela dhe cilët janë elementet e saj. Nxënësit tregojnë pastaj në tabelën, të cilën mësuesi e ka vizatuar në dërrasën e zezë, se ç'janë rreshtat dhe kolonat e tabelës.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit shohin figurën dhe u përgjigjen pyetjeve, sesi janë vendosur sendet dhe qeniet në tabelë. Për shembull:

- Çfarë karakteristike të përbashkët kanë sendet në rreshtin e parë, në rreshtin e dytë dhe në rreshtin e tretë? (Nxënësit shohin, se në rreshtin e parë janë sendet me ngjyrë të kuqe, në rreshtin e dytë janë sendet me ngjyrë të gjelbër dhe në rreshtin e tretë janë sendet me ngjyrë të verdhë.)

topi	molla	çokollata
kubi	dardha	bomboni

- Sipas cilës karakteristike janë grupuar figurat në rreshta? (Sipas ngjyrës.)
- Sipas cilës karakteristike janë renditur figurat në kolona. (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se figurat në kolona janë renditur në varësi të funksionit që ato kanë: në kolonën e parë janë lodrat, në kolonën e dytë janë insektet, në kolonën e tretë janë veshjet, kurse në kolonën e katërt perimet.)
- Sa kolona janë në tabelë?
- Çfarë gjendet në pikën e prerjes të rreshtit të parë e të kolonës së dytë?

Nxënësit, në bazë të udhëzimit, përkatësisht të të dhënave që kanë marrë, i përgjigjen pyetjes, se cili është sendi i imagjinuar. Të dhënat duhet të përbëhen nga informatat, se në cilin rresht dhe në cilën kolonë gjendet sendi.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit duhet të shohin, se cila prej figurave mungon në tabelat e dhëna dhe t'i përgjigjen pyetjes: "Mbi ç'bazë e keni nxjerrë një përfundim të tillë?" dhe ta shpjegojnë përgjigjen që japin.

Shënim: Rëndësi ka, që nxënësit ta kuptojnë se figurat janë renditur sipas formës dhe sipas ngjyrës.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3**

Nxënësit i plotësojnë vendet bosh në tabelë me figurat që gjenden në rreshtin e parë dhe i ngjyrosin ato me ngjyrat që janë paraqitur në çdo rresht majtas.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit, mbi bazën e tabelës së dhënë, vizatojnë rrugën e fëmijëve deri në shkollë.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Mbi bazën e udhëzimit të dhënë, nxënësit duhet ta caktojnë në figurë vendin e figurave të dhëna, t'i vizatojnë dhe t'i ngjyrosin ato.

Udhëzim: djathtas çdo figure është dhënë numri dhe flamuri përkatës. Ata përcaktojnë vendin në tabelë: numri tregon kolonën, kurse flamuri tregon numrin e rreshtit. Vendi ku priten rreshti dhe kolona formon elementin (vendin) në tabelë, në të cilin duhet të vizatohet figura.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin më poshtë:

"Markoja dhe Asimi jetojnë në të njëjtën godinë banimi dhe shpesh kthehen bashkë nga shkolla. Atyre u pëlqen të flasin për ndodhitë në shkollë dhe të rikujtojnë se çfarë kanë mësuar atë ditë. Ndërsa sot, në orën e mësimi të matematikës, mësues-i/ja ka shpjeguar tabelën.

- Si mund ta shfrytëzojmë dijen e fituar? – pyeti Markoja.
- Duhet të mendojmë pak, - u përgjigj Asimi.

Shokët erdhën pranë godinës së tyre të banimit dhe atëherë u lindi ideja. Godina e banimit, me dritaret e veta, u kujtoi atyre tabelën, në të cilën të gjitha dritaret nëpër kate formojnë rreshtat. Njëlloj, vertikalisht, dritaret formojnë kolonat.

- Dritarja ime është e treta majtas në katin e dytë, tha Markoja. Tani, nëse i shënojmë kolonat me shkronja, mund të shkruajmë lehtë, se ku është dritarja ime: (B,2).
- Ndërsa dritarja ime është e para majtas në katin e parë, domethënë, (A,1), - tha Asimi.


Të nesërmen Markoja dhe Asimi ia treguan mësueses së tyre atë, që kishin vënë re. Mësuesja i lavdëroi dhe propozoi lojën."

Në dërrasë të zezë është vizatuar godina e banimit në formë tabele. Vendet në tabelë tregojnë dritaret e banesave, ku jetojnë disa vogëlushë dhe vogëlushe. Nxënësit caktojnë koordinatat. Pastaj, anasjelltas, mbi bazën e koordinatave të dhëna, ata dalin dhe shënojnë dritaret përkatëse.

Veprimtaritë përfundimtare**Veprimtaria 8: Puna me materialin didaktik**

Nxënësit, në një material të përgatitur, duhet të vendosin figurat në katrorët bosh të tabelës, në mënyrë që në çdo rresht dhe në çdo kolonë të mos ketë figura të njëjta.

Udhëzim: Rreshti i parë ose kolona e parë plotësohet lirshëm me figurat e frutave të ndryshme, ndërsa të tjerat vendosen në mënyrë, që të mos vijë tek përsëritja e renditjes nëpër rreshta dhe nëpër kolona. Në figurë shihni njërin prej varianteve të mundshme.

**Veprimtaria 9: Loja "Në treg."**

Udhëzim: Para nxënësve është "tezga fruta-perimeve" boshe në formë tabele. Në kanistrën anash gjenden lloje të ndryshme frutash e perimesh. "Tezga e fruta-perimeve" ka katër kolona dhe tre rreshta.

Nxënësit e plotësojnë "tezgën e fruta-perimeve" sipas udhëzimit të dhënë.

Për shembull: Në rreshti e 3^{-të} të kolonës së 2^{-të} gjenden mollët; në rreshtin e 2^{-të} të kolonës së 4^{-t} patatet etj. Nxënësit e zgjidhin këtë ushtrim, deri sa ta plotësojnë "tezgën e fruta-perimeve", d.m.th. tabelën.



9. KRAHASIMI I NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsërisin relacionet midis numrave: baras, më i madh, më i vogël;
- njohin shenjat dhe termat për relacionet midis numrave: $<$, $>$; "është më i vogël se", "është më i madh se";
- shënojnë rezultatet e krahasimit të grupit të sendeve me ndihmën e shenjave $<$, $>$.


Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Puna në grup

Nxënësit ndahen në katër grupe. Çdo grupi i jepen nga 10 blloqe logjike (10 drejtkëndësha dhe 10 trekëndësha. Nga ena me numrat 1 deri në 10 nxirret numri me zgjedhje të rastësishme (p.sh. 7). Nxënësit bëjnë vargun prej po aq drejtkëndëshash. Pastaj nxirret numri tjetër (p.sh. 9) dhe nxënësit bëjnë vargun prej po aq trekëndëshash. Nxënësit krahasojnë numrin e bashkësisë së drejtkëndëshave e të trekëndëshave dhe vënë re se drejtkëndësha ka më pak, ndërsa trekëndësha ka më shumë. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se numri 7 është më i vogël se numri 9, d.m.th. se numri 9 është më i madh se numri 7. Kjo gjë përsëritet disa herë me kombinime të ndryshme të numrave.

Veprimtaria 2:

Shënim: Me këtë veprimtari, nxënësit rikujtojnë se shenja \neq vetëm shënon mosbarazinë e numrave, por pa treguar, se cili numër është më i madh dhe cili është më i vogël. Shfaqen problemet, si të shënohet se numri 5 është më i madh se numri 3 ose se numri 3 është më i vogël se numri 5.



Nxënësit bëjnë propozimet e veta.

Shënim: Këtu ka rëndësi që nxënësit të shohin t'i ndajnë shiritat si "sqepi i zogut", i cili është gjithmonë i hapur në anën e numrit më të madh. Nxënësit informohen se një shenjë e tillë quhet "më i madh".

E njëjta gjë bëhet edhe për shenjën $<$ – "më i vogël".

Veprimtaria 3: Puna në grup

Para çdo çifti të nxënësve janë vendosur kubat prej druri dhe kartonët me shenjat ($>$, $<$, $=$). Ushtrimi konsiston si më poshtë: një nxënës ka për detyrë të bëjë dy shumëkatësha, ndërsa nxënësi tjetër ka për detyrë t'i numërojë katet në dy shumëkatëshat dhe t'i krahasojë ato duke vënë kartonin me shenjën e duhur. Pastaj ndërrohen rolet. Kjo gjë përsëritet disa herë.



Teksti mësimor

Veprimtaria 4: Figura ilustruese hyrëse

Markos i pëlqejnë shumë peshqit e vegjël dhe në dhomën e vet ka një akuarium të madh.

Nxënësit shohin me vëmendje figurën e akuariumit të Markos dhe u përgjigjen pyetjeve:

- A janë të njëjtë të gjithë peshqit?
- Prej cilëve peshq ka më shumë?
- Sa peshq notojnë majtas? Sa peshq notojnë djathtas?

Nxënësit numërojnë peshqit e llojeve të ndryshme dhe shkruajnë numrin e tyre në vendin e caktuar. Në fund shkruajnë shenjën: < ose >.

Veprimtaria 5:

Nxënësit plotësojnë në fletore nga një rresht të shenjave > dhe <.

Shënim: Nxënësit ndeshen për herë të parë me këto simbole dhe duhet të ushtrohen në shkrimin e tyre.

Veprimtaria 6: Ushtrimet nr. 1 e 2


Nxënësit i krahasojnë numrat duke përdorur shenjat e ndryshme.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shohin 15 kuti të vogla të njëjta (kuti ilaçesh ose kuti shkrepsësh), të cilat janë vendosur në mënyrë të tillë, që të qëndrojnë në tavolinë; një kuti, pranë saj dy kuti njëra mbi tjetrën dhe kështu me radhë deri tek pesë kutitë e vendosura njëra mbi tjetrën.

Nxënësit mund të vërejnë lehtë, se cili rresht është më i ulët dhe cili rresht është më i lartë, respektivisht cili rresht është më i vogël dhe cili rresht është më i madh. Ata mund të vërejnë edhe, se për sa një numër është më i madh ose më i vogël se një numër tjetër. Gjatë krahasimit, nxënësit do të përdorin fjalët më i madh dhe më i vogël.

Shënim: Nxënësit gabojnë shpesh në shkrimin e shenjave, prandaj është mirë që shenjat të paraqiten grafikisht.



Në **ushtrimin 3** nxënësit ngjyrosin katrorët e vegjël sipas numrave të paraqitur. Ashtu sikurse në rastin e kutive, edhe këtu pasqyrohet në mënyrë vizuale se cili numër është më i madh dhe për sa është më i madh. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të tipit: "Për sa është më i vogël numri 2 se numri 5?"

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4 e 5

Shënim: Shprehjet numerike nxënësit i krahasojnë në disa mënyra. Mënyra e parë dhe më e shpeshtë është krahasimi me ndihmën e njehsimit. Mënyrat e tjera bazohen në ndonjë varësi të dhënë.

Nxënësit i krahasojnë shprehjet numerike.

Udhëzim: Në dy figurat e para, tek ushtrimi numër 4, shohim se dominotë që renditim kanë pjesë të barabarta. Për këtë arsye, krahasimi i këtyre dominove mund të bëhet me krahasimin e atyre pjesëve që janë të ndryshme.

$$4+3 > 4+1 \text{ për arsye se } 3 > 1.$$

$$2+3 < 5+3 \text{ për arsye se } 2 < 5.$$



Në figurën e tretë nuk ka pjesë të barabarta. Prandaj shprehjet numerike i krahasojmë me anë të njehsimit:

$$3 + 4 = 6 + 1.$$

Ushtrimi numër 5 është i ngjashëm më dy ushtrimet e mëparshme dhe nxënësit e zgjidhin atë në mënyrë të pavarur.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.

Zgjidhja: Nëse është një mollë jeshile, atëherë mollë të kuqe janë $7 - 1 = 6$. Nëse janë dy mollë jeshile, atëherë mollë të kuqe janë $7 - 2 = 5$. Nëse, ndërkohë, janë tri mollë jeshile, atëherë mollë të kuqe janë $7 - 3 = 4$. Mollë jeshile nuk mund të ketë më shumë se 3, sepse mollë të kuqe ka më shumë sesa mollë jeshile.

Veprimtaria 10: Loja "Stafeta e matematikës"

Nxënësit ndahen në katër kolona, në ç'rast dy kolona bëjnë garë njëra me tjetrën për saktësinë dhe shpejtësinë e zgjidhjes së ushtrimeve që janë përgatitur paraprakisht në 4 pllakate. Në pllakate janë ushtrimet me krahasimin e numrave. Me dhënien e sinjalit të caktuar fillon zgjidhja stafetë e ushtrimeve. Nxënësi i parë vendos shenjën midis dy numrave ose shprehjeve dhe vrapon tek nxënësi tjetër, ia jep flomasterin dhe shkon në fund të kolonës. Loja e stafetës vazhdon deri sa të zgjidhen të gjitha ushtrimet. Në fund kontrollohen ushtrimet dhe shpallen fituesit.



10. KRAHASIMI DHE KLASIFIKIMI

QËLLIMET

Nxënësit:

- krahasojnë sendet e qeniet sipas madhësisë e lartësisë (më i madh-më i vogël, më i lartë-- më i ulët, më i trashë-më i hollë, më i gjatë-më i shkurtër, më i gjerë-më i ngushtë;
- njihen me relacionet: i vogël, mesatar, i madh; më i vogli, më i madhi (gjatë, më gjatë, shumë më gjatë; lart, më lart, shumë lart);
- fitojnë aftësinë e gjetjes e të krahasimit të karakteristikave të sendeve, e gjetjes së karakteristikave të përbashkëta të grupit të sendeve;
- formojnë përfytyrimin për karakteristikat, për ngjashmëritë dhe për dallimet midis sendeve;
- sistemojnë sendet sipas karakteristikës së përbashkët;
- përsëritin krahasimin e numrave deri në 10.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet në fletoret e veta sipas udhëzimeve të dhëna:

- Vizatojnë dy shtëpi, një të madhe e të ngushtë, tjetrën të gjerë e të ulët. Shtëpinë e madhe e të ngushtë e ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, kurse shtëpinë e gjerë e të ulët me ngjyrë të kaltër.
- Nxënësit vizatojnë dy drurë, një të lartë dhe një të ulët. Në drurin e lartë vizatojnë zogun, kurse në drurin e ulët vizatojnë dardhën.
- Nxënësit vizatojnë topin e basketbollit dhe topin e tenisit.

Veprimtaria 2: “Kanistra magjike”

Shënim: Me këtë veprimtari nxënësit dallojnë relacionet më i trashë-më i hollë.

Në “Kanistrën magjike” gjenden sendet e së njëjtës formë, të së njëjtës ngjyrë dhe të së njëjtës madhësi, por të trashësive të ndryshme. Me short me numër, caktohet nxënësi që fut dorën në kanistër dhe duke i prekur sendet gjen, se çfarë gjendet në kanistër. Pas kësaj, nxënësi e nxjerr sendin nga kanistra dhe e verifikon, nëse e ka ditur se ç’send është. Nxënësit e tjerë i emërtojnë sendet. Nxënësve u tregohen dy sende të së njëjtës formë, të së njëjtës ngjyrë dhe të së njëjtës madhësi, por të trashësive të ndryshme. Ata i shohin sendet dhe i përgjigjen pyetjes se nga dallohen sendet. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se ndryshimi qëndron tek trashësia e sendeve. Nxënësit i grupojnë sipas trashësisë të gjitha sendet nga kanistra dhe nxjerrin përfundimin, se ka sende më të trasha dhe sende më të holla.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Në figurën ilustruese është paraqitur vogëlushi Marko dhe vogëlushja Maja, të cilët kanë shkuar në parkun zbavitës dhe ku kanë parë “pasqyrat e shtrembra” në dhomën e qeshjes.



Nxënësit shohin figurën e paraqitur, vënë re ndryshimet që kanë ndodhur, kur fëmijët e kanë parë veten në “pasqyrën e shtrembër”. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

- Si ka ndryshuar lartësia e fëmijëve në pasqyrë?
- Si duket koka e vogëlushit dhe koka e vogëlushes në pasqyrë?
- Tek kush kanë ndryshuar flokët dhe si kanë ndryshuar ato?
- Çfarë ka ndodhur me trupin e vogëlushit dhe me trupin e vogëlushes në figurën në pasqyrë?
- Si duken në figurën në pasqyrë duart e vogëlushit?
- Çfarë ka mbetur e pandryshuar në figura? (Nxënësit nxjerrin përfundimin se e pandryshuar ka mbetur ngjyra e veshjeve.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe i ngjyrosin autobusët në përputhje me kërkesat e bëra.

Pasi ta përfundojnë këtë pjesë të ushtrimit, nxënësit i renditin autobusët sipas madhësisë, duke e shënuar me numrin 1 autobusin më të vogël, autobusin tjetër, sipas madhësisë, me numrin 2 etj. gjithnjë deri tek numri 5, me të cilin shënojnë autobusin më të madh.

Veprimtaria 5:

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin dhe u përgjigjen pyetjeve:

“Po zbriste milingona nga bjeshka dhe u takua me gomarin.

Pyet gomari milingonën:

- Të lutem më thuaj, si është bari në bjeshkë?
- Është shumë i lartë dhe i dendur, - iu përgjigj milingona.

U gëzua gomari dhe u ngjit në bjeshkë, por kurrsesi nuk mundi ta këpuste barin me gojë. Ishte shumë i shkurtër dhe shumë i rrallë.

- Më ka gënjyer milingona, - mendoi gomari.

Çfarë mendoni ju, a e ka gënjyer milingona gomarin?”

Veprimtaria 6: Ushtrimet nr. 2 e 3

Në vizatime janë paraqitur qeniet me të njëjtën madhësi edhe pse ato realisht janë të madhësive të ndryshme. Nxënësit duhet të dallojnë, se cila prej dy qenieve është realisht më e madhe, përkatësisht më e vogël.

Veprimtaria 7:

Shënim: Relacionet e gjatë-më e gjatë -shumë e gjatë dhe e lartë-më e lartë-shumë e lartë, nxënësit duhet t’i perceptojnë mbi bazën e modeleve konkrete dhe mbi bazën e sendeve nga mjedisi përreth tyre.

Shembuj: sendet mund të jenë lapsat, penjtë, shiritat dhe vizoret e gjatësive të ndryshme etj.

Nxënësit mund të ndahen në grupe në bazë të gjatësisë së mëngëve, të gjatësisë së fustaneve ose të gjatësisë së flokëve.

Nxënësit mund t’i renditin shiritat e gjatësive të ndryshme, të cilët do të vendosen në dërrasë të zezë njëri pranë tjetrit, por në mënyrë të tillë që fillimet e tyre të jenë të puthitur. Nxënësit duhet të vënë re relacionet i gjatë, më i gjatë, shumë i gjatë.

Me vrojtimin e sendeve të mjedisit përreth (drurëve, ndërtesave, rafteve etj.), nxënësit mund t’i krahasojnë qeniet e sendet sipas lartësisë.

Nxënësit mund të krahasohen sipas lartësisë së trupit (krahasohen disa nxënës në rresht, kurse të tjerët duhet të përcaktojnë kush prej kujt është më i lartë, si edhe kush është më i lartë në rresht).

**Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4**

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në Tekstin mësimor.

Shënim: gjatë krahasimit të gjatësive, sendet që krahasohen duhet të barazohen në njërin skaj.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit shohin figurën në Tekstin mësimor dhe i krahasojnë personazhet e paraqitura në relacion me lartësinë e trupit të tyre. Nxënësve mund t'u lehtësohet krahasimi, nëse ata u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Kush është më i larti?
- Kush është më e lartë: Maja apo Hana?
- A është Jovana më e lartë se Hana?
- Kush është më i lartë se Brankoja?
- Si quhet vogëlushja më e ulët?
- Sa fëmijë janë më të lartë se Maja?
- Kush prej të gjithë fëmijëve është më i ulët se Markoja?
- Kush është më i lartë se Maja, por më i ulët se Brankoja?
- Kush është në mes?

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 6

Mbi bazën e figurës së paraqitur në Tekstin mësimor, nxënësit shtojnë duke vizatuar "elementet" që mungojnë.

Shënim: Ky ushtrim ka si qëllim që të zhvillojë tek nxënësit mendjemprehtësinë dhe të shtojë interesimin për orët e mësimi të matematikës.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 7, Loja "Udhëtimi i numrave 3, 6, 7"

Nxënësit shohin në Tekstin mësimor figurën e paraqitur dhe dëgjojnë rrëfimin më poshtë:

"Numrat 3, 6 e 7 u nisën për udhë. Shpejt arrin dimri dhe çdo numër duhet ta zgjedhë shtëpinë për vete. Të nisemi për udhë së bashku me numrat. Arrijmë tek udhëkryqi i parë. Cilët numra mund të vendosen në shtëpinë e parë? Pse? A kemi ne numra të tillë? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se këto janë numra më të vegjël se 2, sepse qëndron shenja <2 dhe se numra të tillë nuk kemi."

Pasi që nxënësit u përgjigjen këtyre pyetjeve, ata dëgjojnë vazhdimin e rrëfimit.

"Vazhdojmë udhëtimin. Cilët numra mund të vendosen në shtëpinë e verdhë? Pse? A kemi ne numra të tillë? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se këto janë numra më të vegjël se 4, gjë që e tregon shenja <4 . dhe arrijnë në përfundimin se në këtë shtëpi mund të vendoset numri 3."

Pasi u përgjigjen këtyre pyetjeve, nxënësit shkruajnë numrin 3 në dritaren e vogël të parashikuar për këtë gjë.

"Vijmë tek shtëpia bojë kafe. Në shtëpinë bojë kafe duhet të vendosen numrat më të vegjël se 6, por më të mëdhenj se 4. A kemi ne numra të tillë? (Nxënësit shohin, se numra të tillë nuk ka dhe se shtëpia bojë kafe do të mbetet bosh.)

Vazhdojmë udhëtimin dhe arrijmë tek shtëpia portokalli. Cilët numra mund të vendosen në këtë shtëpi? A kemi ne numra të tillë? (Nxënësit shohin, se në shtëpinë portokalli mund të vendosen numrat më të mëdhenj se numri 6 dhe ky është numri 7.)

Numri 6 vendoset në shtëpinë e kaltër në përputhje me shenjën „ >5 ”.

Veprimtaria 12: Ushtrimi nr. 8

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin e dhënë me ndihmën e mësues-it/es.



Veprimtaria 13: Diktim matematikor

Nxënësit e zhvillojnë diktimin matematikor në fletë veçanta.

1. Vizato tre drurë me trungje me trashësi të ndryshme. Mbi drurin me trungun më të trashë vizato diellin, kurse poshtë drurit me trungun më të hollë, vizato qenin.
2. Vizato shallin jeshil, i cili është më i gjerë se shalli i kuq.
3. Vizato një godinë të lartë dhe një godinë të ulët. Ngjyrosi.
4. Vizato dy rrugë, në mënyrë të tillë që rruga e ngushtë të jetë ngjyrë kafe, kurse rruga e gjerë të jetë ngjyrë gri.
5. Vizato një kodër të lartë dhe një kodër të ulët. Ngjyrosi.
6. Vizato dy gota me lëng frutash dhe pastaj në njëren prej tyre vizato thithësin e ngushtë, kurse në të dytë thithësin e gjerë.
7. Vizato dy zorrë uji për vaditjen e kopshtit, për afërsisht të së njëjtës gjatësi, por në mënyrë të tillë që njëra zorrë uji të jetë e trashë, kurse zorra tjetër e ujit të jetë e hollë. Zorrën e trashë të ujit ngjyrose me ngjyrë të kuqe, kurse zeron e hollë të ujit ngjyrose me ngjyrë jeshile.
8. Vizato një dorezë të ngushtë dhe një dorezë të gjerë. Ngjyrosi sipas dëshirës.
9. Vizato dy xhirafa, pastaj ngjyrose xhirafën më të ulët.
10. Vizato një flamur të gjerë dhe një flamur të ngushtë. Flamurin e gjerë ngjyrose me larime sipas dëshirës.



11. KLASIFIKIMI DHE PARAQITJA

QËLLIMET

Nxënësit:

- dinë t'i ndajnë sendet sipas një karakteristike;
- lexojnë të dhënat në tabelë;
- paraqitin të dhënat e thjeshta me ndihmën e diagrameve;
- sistemojnë dhe lexojnë të dhënat e diagramit.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Para nxënësve është pjetanca me rruaza të madhësive e të ngjyrave të ndryshme. Në dërrasë të zezë është vizatuar tabela.

Nxënësit marrin nga një rruazë prej pjatancës. E krahasojnë atë me rruazën e shokut pranë dhe vënë re ndryshimet midis tyre (për nga ngjyra dhe për nga madhësia). Në tabelë shkruajnë shenjën (X) për rruazën që kanë nxjerrë. Kur e përfundojnë shkrimin, i numërojnë rruazat dhe pastaj komentojnë, se prej cilave rruaza ka më pak, prej cilave ka më shumë dhe ekzistojnë tipat e rruazave që janë baras.

	Të verdha	Të bardha
Të mëdha		
Të vogla		

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse, lidhja ndërlëndore me lëndët mësimore Gjuha shqipe e letërsia dhe Natyra dhe shoqëria

Nxënësit dëgjojnë fabulën popullore "Gjeli dhe dhelpira".

Pasi lexohet fabula, nxënësit bisedojnë për të. Biseda vazhdon me rrëfimin për kafshët shtëpiake dhe për kafshët e egra.

Në figurën ilustruese hyrëse janë paraqitur kafshët shtëpiake dhe kafshët e egra.

Nxënësit i analizojnë figurat e kafshëve dhe i ndajnë ato në lloje: me shigjeta lidhin figurën e kafshës më shkrimin përkatës.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit lexojnë rrëfimin: "Markoja ka bërë tabelën, në të cilën ka shkruar në rreshtin parë emrat e shokëve të vet, kurse në kolonën e parë ka vizatuar disa prej artikujve ushqimorë. Ai donte të dinte, se çfarë u pëlqen shokëve e shoqeve të tij: Petrit, Anës, Sashës, Mashës dhe Majës. Bëri përzgjedhjen më poshtë të gjellëve: rosto, çokollatë, mollë, qumësht, mish pule dhe akullore. Pyeti çdonjërin prej tyre me radhë dhe përgjigjet i shkroi në tabelë. Pranë gjellëve që u pëlqenin vinte zogun e vogël, ndërsa pranë atyre që nuk u pëlqenin vinte "kryqin e vogël".



Pas dëgjimit të rrëfimit, nxënësit shohin tabelën e Markos në Tekstin mësimor dhe u përgjigjen pyetjeve më poshtë?

- Çfarë i pëlqen Anës për të ngrënë?
- Sa fëmijë e pëlqejnë akulloren?
- A i pëlqen Petrit të pijë qumësht?
- Cila gjellë u pëlqen më shumë fëmijëve? Cila gjellë u pëlqen më pak? A mund t'u përgjigjeni menjëherë këtyre pyetjeve?

Nxënësit nxjerrin përfundimin, se për të dhënë këtë përgjigje, atyre u duhet fillimisht të numërojnë sesa gjellë që u pëlqejnë fëmijëve ka në çdo rresht dhe pastaj t'i krahasojnë numrat sipas rreshtave.

Shënim: Nxënësit informohen, se për krahasimin e të dhënave numerike përdoret shpesh diagrami, i cili shërben si paraqitje grafike e informacioneve. Diagramet i përdorim për krahasimin e madhësive. Sipas diagramit mund t'i krahasojmë dhe t'i analizojmë të dhënat e përgjithshme, por s'është e mundur, të themi, t'i përgjigjemi pyetjes, se çfarë i pëlqen konkretisht një fëmijë të veçantë: këtë gjë mund ta shohim nga tabela.

Pas kësaj, nxënësit i futin të dhënat e caktuara në diagramin që gjendet pranë tabelës. Ata numërojnë fillimisht nga tabela fëmijët, të cilëve u pëlqen rastoja dhe ngjyrosin po aq rrathë të vegjël në kolonën e parë. Një ecuri të tillë, nxënësit e përsëritin edhe me artikujt e tjerë ushqimorë. Kur ta përfundojnë këtë ushtrim, duke iu përgjigjur pyetjes se çfarë u pëlqen më shumë fëmijëve për të ngrënë, nxënësit i plotësojnë katrorët e vegjël poshtë diagramit dhe i përgjigjen pyetjes.

Vepërtaria 4: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit i ngjyrosin raketat mbi bazën e udhëzimit të dhënë.


Pasi që i ngjyrosin raketat, nxënësit plotësojnë diagramin me shtylla (ngjyrosin numrin e duhur të drejtkëndëshave mbi figurat e raketave që tregojnë kahun e lëvizjes) dhe u përgjigjen pyetjeve për kahun e fluturimit të raketave.

- Në cilin kah fluturojnë me shumë raketa?
- Në cilin kah fluturojnë me pak raketa?
- Sa raketa janë gjithsej?
- Sa raketa fluturojnë lart?
- Sa raketa fluturojnë poshtë?
- Sa raketa fluturojnë majtas?
- Sa raketa fluturojnë djathtas?

Vepërtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit përsëritin relacionet hapësinore dhe fillojnë formimin e nocioneve bazë të kombinimeve.

Nxënësit i ngjyrosin gjethet e vizatuara në mënyra të ndryshme.



Shënim: Para se të fillojnë ngjyrosjen në Tekstin mësimor, nxënësit mund të sistemojnë në bankat e veta, për shembull tre flomastera (lapsa me ngjyra) të ngjyrave të ndryshme.



Ka shumë rëndësi që nxënësit të nxjerrin përfundimin se ka vetëm 6 mundësi për sistemimin e tri ngjyrave në rresht me renditje të ndryshme. Rëndësi ka që ata të nxjerrin përfundimin se, për shembull, flomasteri i verdhë mund të jetë dy herë në vendin e parë. Nëse ai është në vend të parë, atëherë dy flomasterat e tjerë (i kuqi dhe i gjelbri) mund t'i ndërrojnë vendet. Kjo gjë vlen edhe për ngjyrat e tjera.







Shënim: Formimi i nocioneve të kombinimit është proces i gjatë dhe i ndërlikuar. Nuk duhet pritur që ai të zhvillohet lehtë dhe në mënyrë të njëtrajtshme tek të gjithë nxënësit. Për t'u përforcuar njohuritë fillestare të kombinimit, duhen rreshtuar tre nxënës (për shembull: Markoja, Nikolla dhe Ana) në lloj, në mënyra të ndryshme me zëvendësime të drejtpërdrejta. Renditjet e përfutuara duhet të shkruhen si më poshtë: MNA, MAN, NMA, NAM, AMN, ANM.

Veprimtaria 6:

Nxënësit e ndarë në grupe plotësojnë diagramin që gjendet në fletën e përgatitur të punës. Çdo nxënës i grupit vizaton veçmas një drejtkëndësh në kolonën mbi artikullin ushqimor që nuk i pëlqen. Pas plotësimit të diagramit, çdo grup prezenton rezultatet e veta.

Shembull: një grup ka si qëllim të hetojë në kuadër të grupit, se cili fryt pëlqehet më shumë. Nxënësit zgjedhin midis mollës, dardhës, pjeshkës, kumbullës, bananes dhe qershisë.

😊 Fleta e punës 😊

Shënim: Mund të propozohet edhe ushtrimi për artikullin ushqimor që u pëlqen më shumë nxënësve për ngrënie, por edhe ushtrimi për lëngjet që u pëlqejnë më shumë nxënësve për pirje si çaj, lëngje, qumësht, jogurt, ujë, pije e gazuar.



12. PIKA. VIJAT E DREJTA DHE VIJAT E LAKUARA

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë nocionin e vijës së thyer e të vijës së lakuar si trajektorja e pikës lëvizëse;
- vizatojnë vijat e lakuara me dorë të lirë dhe bëjnë vijat e drejta me ndihmën e mjeteve të vizatimit;
- dallojnë, emërtojnë dhe shënojnë pikën si prerja e vijave dhe shenjen e pozicionit të sendeve;
- bashkojnë pikat me vija të drejta e me vija të lakuara;
- vizatojnë me ndihmën e vizoresh drejtëzën që përmban dy pika të dhëna dhe gjejnë pikën e prerjes së dy drejtëzave;
- ushtrohen në përdorimin e mjeteve të vizatimit.

Shënim: Tema e mësimin në fjalë është shumë e rëndësishme për formimin e drejtë të koncepteve bazë gjeometrike tek nxënësit. Pika dhe segmenti janë nocionet bazë të gjeometrisë dhe nuk përkufizohen. Ato përfaqësojnë abstraksionin, idealizimin matematikor të objekteve reale të botës përreth nesh. Karakteri delikat i metodës didaktike në vijim qëndron në gjetjen e ekuilibrit midis pamundësisë parimore të ofrimit të përkufizimit në formë nga njëra anë, si edhe të nevojës për krijimin e bazës së formuar nga përvoja dhe të bazës empirike tek nxënësit përmes studimit të modeleve konkrete që do të mundësonin kuptimin e drejtë të nocioneve dhe përvetësimin e relacioneve më të rëndësishme midis tyre nga ana tjetër.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: “Përfundoni figurat”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore **Kultura e artit figurativ**


Shënim: Kur vrojtojmë trupat e imët ose ato që janë larg, të cilat mezi i shohim, atëherë themi se i shohim në një pikë. Domethënë, kur e shohim një objekt, të cilit nuk mund t’ia përshkruajmë as formën, as çfarëdo lloj shtrirje, atëherë do të themi se ky objekt shihet si një pikë. Shembull tipik i këtij lloji është gjurma që lë maja e lapsit, kur me të preket fleta e letrës, maja e shkumësit kur me të preket dërrasa e zezë. Pikërisht gjurmët e tilla na shërbejnë si shenja e pikës.

Nxënësit shohin dy figurat e përgatitura.

Në një figurë është vizatuar zog.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë hanë zogjtë?
- Si do t’i vizatojmë kokrrat dhe thërrimet, përkatësisht ushqimin që hanë zogjtë? (Nxënësit propozojnë mënyrën sesi mund ta bëjnë këtë gjë: Ata nxjerrin përfundimin, se duhet vetëm ta prekin me majën e lapsit fletën e letrës dhe kështu do të përftojnë pikën.)





Pasi u përgjigjen këtyre pyetjeve, nxënësit vizatojnë në fletoret e veta pikat ngjyrë kafe.

Në figurën tjetër është vizatuar hëna.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Përveç Hënës, çfarë tjetër mund shohim në qiellin e natës?
Ç'gjë ju kujtojnë yjet?

Pasi u përgjigjen këtyre pyetjeve, nxënësit duhet të vizatojnë në fletoret e veta pikat e verdha; yjet

- Ç'gjë tjetër ju kujton pikat?



Shënim: Nxënësit duhet të kujtojnë për shembull pikat dhe vijat në mjedisin përreth, por edhe modelet e afërta për ta nga përvoja e fituar duke mësuar.

Shembull: yjet në qiell janë pika, kurse gjurma që lë ylli që bie është vija; gjatë kohës së fishekzjarrëve fillimisht shohim vijat e ndritshme, ndërsa pastaj ndizen pikat shumëngjyrëshe etj.

Pika është shenjë pikësimi e rëndësishme në çdo gjuhë. Ajo përdoret për të shënuar fundin e fjalisë.

Veprimtaria 2:

Shënim: Pika është nocion mjaft abstrakt për fëmijët e kësaj moshe, prandaj ajo mund të paraqitet si vend prerja e dy vijave.

Çdo çift nxënësish ka dy penj të ngjyrave të ndryshme dhe dy zhetona me ngjyrë të verdhë. Me to formojnë dy vija që kryqëzohen dhe dallojnë vendin ku priten këto dy vija. Ku vend është pika dhe aty vendosin zhetonin me ngjyrë. Të njëjtën situatë nxënësit e vizatojnë me laps me ngjyrë në fletoret e veta: me ngjyrë të kuqe dhe blu shënojnë vijat, kurse me ngjyrë të gjelbër shënojnë pikën.

Udhëzim: Vendet ku priten vijat duhet të shënohen me pikë dhe me shkronja të mëdha shtypi.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit vënë re:

- se shkopinjët e peshkimit të Majës, Markos dhe Natashës që po peshkojnë në Lim janë pjesë të vijave të drejta;
- se fijet e najlonit përdridhen në formën e vijave të lakuara;
- se valët e vogla janë paraqitur gjithashtu në formën e vijave të lakuara;
- se flluskat e ajrit përfaqësojnë pikat.

Nxënësit përcaktojnë pastaj, se cilin peshk ka zënë secili.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Shënim: Nxënësit përsëritin lëndën mësimore nga klasa e parë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë shihni në figurën e parë?

Pasi që përgjigjen, nxënësit vizatojnë pikat e reja.

- Çfarë është në figurën e dytë?

Nxënësit vizatojnë pastaj vijën e re të lakuar.

- Çfarë është në figurën e tretë? Çfarë i ka ndihmuar lapsit, që të bëjë një vijë të tillë të drejtë?

Pas kësaj veprimtarie, nxënësit bëjnë me penj në bankat e veta modele të vijave të drejta e të vijave të lakuara.

**Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2**

Shënim: Përmes kësaj detyre, nxënësit ushtrohen në bërjen e vijave të drejta nga njëra anë me ndihmën e vizores. Përveç kësaj, ata ndeshen për herë parë me hulumtimin e thjeshtë gjeometrik.

Çdo nxënës vizaton në mënyrën e vet drejtëzën që përmban pikën e kuqe dhe arrin në përfundimin, se ekzistojnë shumë vija të drejta që përmbajnë pikën e dhënë. Drejtëza të tilla ka në të vërtetë pafundësisht shumë. Pastaj vizatojnë vijat e lakuara që përmbajnë pikën blu.

Si veprimtari shtesë, në hapësirën e dytë të paraparë në Tekstin mësimor, nxënësit vizatojnë vijën e lakuar, në mënyrë që ajo ta presë vijën e drejtë dhe shënojnë pikën e prerjes së vijave.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit saktësojnë, sesi ta heqin vijën e drejtë që përmban dy pika të dhëna. Situata problemore ka lidhje me përgjigjen ndaj pyetjes për numrin e vijave të tilla. Kur ta përfundojnë vizatimin, nxënësit vënë re zakonisht, se ekziston një drejtëz e tillë.

Bashkojnë pikat me vijën e drejtë dhe vënë re, se dy pikat mund të bashkohen vetëm me një vijë të drejtë.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit kanë vënë re në ushtrimin e mëparshëm, se ekziston vetëm një drejtëz që përmban dy pikat e dhëna. Shtrohet pyetja, sesa vija të lakuara ekzistojnë që përmbajnë dy pikat e dhëna. Në figurë janë paraqitur tashmë tri vija të tilla të lakuara. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: "A ekzistojnë edhe vijat e tjera të lakuara që përmbajnë këto dy pika?" Pastaj vizatojnë katër-pesë vija të tilla të lakuara.

Zgjidhja: Vija të tilla të lakuara ka pafundësisht shumë.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 5

Shënim: Ekzistojnë pafundësisht shumë drejtëza që përmbajnë një pikë të dhënë. Nxënësit duhet të fitojnë ndjesinë se prej tyre ka shumë, më shumë se dy, tri, katër ...

Nxënësit analizojnë vizatimin, në të cilin janë dhënë tri pika që nuk i përkasin një drejtëze dhe vënë re, se ekzistojnë tri drejtëza, prej të cilave secila përmban nga dy prej këtyre tri pikave.

Nxënësit analizojnë pastaj vizatimin, në të cilin janë dhënë katër pika, në mënyrë të tillë që asnjëra prej tri pikave nuk i përket të njëjtës drejtëz dhe vënë re, se ekzistojnë gjashtë drejtëza prej të cilave secila përmban nga dy prej katër këtyre pikave.

Në kuadër të këtij ushtrimi, nxënësit vizatojnë në fund drejtëzën që përmban dy pika. Ata konfirmojnë parimin, se ekziston vetëm një drejtëz që përmban dy pika të ndryshme.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 6

Shënim: Ky ushtrim përfaqëson një ushtrim psikologjik: "iluzion optik". Nxënësit duhet të mësojnë, se vrojtimi nuk është e thënë të jetë gjithmonë një bazë e saktë për konfirmimin e një fakti gjeometrik.

Udhëzim: Në figurë janë dhënë dy çifte drejtëzash paralele. Pjesët e rrafshëta janë të vijëzuara në mënyra të ndryshme, duke krijuar iluzionin, se në rastin e parë janë paraqitur vijat e lakuara që i "afrohen mesit". Në rastin e dytë duket sikur para nxënësve janë vijat e lakuara që i "largojnë mesit". Faktin se në të vërtetë është fjala për vijat e drejta, nxënësit e konfirmojnë duke i krahasuar vijat me vizore.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit ushtrojnë motorikën, koncentrimin dhe relacionet hapësinore sipër-poshtë duke rregulluar kujdes gjatë ngjyrosjes, se cili prej penjve kalon sipër dhe cili prej tyre kalon poshtë.



Veprimtaria 11:

Nxënësit zhvillojnë diktimin matematikor.

- Shëno pikën, vizato dy vija të drejta që priten në pikën e shënuar.
- Vizato dy vija të drejta që priten. Në sa pika priten këto dy vija të drejta?
- Vizato një vijë të drejtë dhe një vijë të lakuar që priten dhe shëno pikën e prerjes.
- Vizato dy vija të lakuara që priten në pikën M.
- Shëno dy pika, bashkoi ato me vijë të drejtë, pastaj bashkoi po ato me vijë të lakuar.
- Shëno pesë pika dhe emërtoji ato, pastaj lidhi ato me vija sipas dëshirës.



13. SEGMENTI

QËLLIMET

Nxënësit:

- formojnë nocionin e segmentit si pjesë e drejtëzës dhe si largësia më e shkurtër midis dy pikave;
- përvetësojnë shënimin e pikave skajore të segmentit me shkronja të mëdha shtypi;
- mësojnë të përdorin siç duhet vizoren dhe të fitojnë shkathtësi gjatë vizatimit.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Tregimi mbi krijimin e segmentit “Loja e xhaxhi Glishës”

Nxënësit dëgjojnë tregimin për “krijimin e segmentit”:

“Xhaxhi Glisha u nis për udhë. Eci mbi drejtëz. Eci gjatë, u lodh tmerrësisht dhe pyeti: “Edhe sa duhet të eci? A do të shfaqet ndonjëherë fundi i drejtëzës?”




Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Si do t’i përgjigjeshit ju xhaxhi Glishës?”

Shënim: Me ndihmën e modelit të drejtëzës që është bërë prej lëmsheve prej peri, nxënësit binden se drejtëza është pa fillim dhe pa fund dhe këtë përgjigje ia japin Glishës.

“U mërzit xhaxhi Glisha.

- Çfarë të bëj tani? Domethënë, tani duhet të eci shumë gjatë, të mos arrij deri në fund.

Menjëherë u shfaqën gërrshërët. Morën vesh për pikëllimin dhe prenë drejtëzën nga njëra dhe nga tjetra anë.



- Sa mirë. Tani jam në një pjesë të drejtëzës që ka fillimin dhe fundin.”

Nxënësit i përgjigjen pastaj pyetjes: Çfarë kemi fituar në këtë mënyrë? Ata nxjerrin përfundimi se kanë përfutur segmentin: një pjesë të vijës së drejtë. Vënë re se segmenti është i kufizuar në dy anë.

Pas kësaj i përgjigjen pyetjes: Ç’gjë në klasë ju kujton segmentin?

Në fund të kësaj veprimtarie hyrëse, nxënësve u tregohet vija e lakuar dhe u bëhet pyetja: A mund të themi se kjo vijë është segment? Pse?





Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Markoja dhe Maja kanë shkuar më shokët që të lëshojnë balonat.

Nxënësit shohin dhe tregojnë në figurën ilustruese hyrëse vijat e lakuara dhe segmentet.

Shënim: Është e nevojshme që nxënësit të mësojnë të gjejnë në mjedisin përreth sendet (ose pjesët e tyre) që u kujtojnë segmentet. Këtë mund të jenë anët e vizores, cepat e fletës së letrës, cepat raftit, cepat e dërrasës së zezë, cepat bankës etj.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit përshkruajnë përsëri krijimin e segmentit, vizatojnë segmentin dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Sa skaje ka segmenti?
- A ndryshojnë segmenti dhe drejtëza? Në ç'gjë ndryshojnë?

Shënim: Kryesore është që nxënësit ta kenë të qartë dallimin në vizatim të drejtëzës dhe të segmentit. Nxënësit përvetësojnë plotësisht se skajet e segmentit në figura janë të shënuara me pika ose me viza, ndërsa në vizatimin e drejtëzave kjo gjë nuk ekziston.

Përmes vrojtimit dhe ushtrimeve të ndryshme, nxënësit orientohen drejt përfundimit, se disa segmente mund t'i zërë fleta e letrës. Në anën tjetër, drejtëza nuk mund të realizohet në letër, sado të madhe që ta marrim fletën e letrës.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 2

Shënim: Me këtë ushtrim nxënësit ngulitin nocionin segment si distanca më e shkurtër midis dy pikave.

Nxënësit shohin figurën dhe i përgjigjen pyetjes:

- Nëpër cilën rrugë duhet të shkojë lepurushi që të arrijë më shpejt tek karota? (Ata vënë re, se lepurushi duhet të ecë nëpër rrugën e drejtë për të arritur më shpejt deri tek karota.)

Detyrë e nxënësve është t'i bashkojnë pikat me vijë të drejtë dhe të kujtojnë se dy pika mund të bashkohen me disa vija të lakuara, por vetëm me një vijë të drejtë.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit i ngjyrosin sendet sipas madhësisë dhe në përputhje me udhëzimin e dhënë.

Veprimtaria 6: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik: Loja "Ne jemi segment"

Nxënësit e klasës zënë pozicionet e ndryshme në terrenin sportiv. Vetëm nga një nxënës i bankës ka spangon pranë vetes, sepse ai duhet ta gjejë shokun e bankës dhe të formojë me të segmentin. Me fjalët "Ne jemi segment", nxënësit nisen nga pozicionet e ndryshme në kërkim të shokut të bankës dhe formojnë segmentin. Lojën mund ta shoqërojë këndimi prej tyre së bashku i këngës "O Paniq Kollariq, nise vallen, këmbët hiq, hidhe, hidhe vallen-o, dridhe, dridhe bukur-o."


Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Shënim: Me këtë ushtrim nxënësit ushtrojnë motorikën dhe përdorimin e mjeteve të vizatimit.

Nxënësit numërojnë segmentet në figura.

Veprimtaria 8: Ushtrimet nr. 5 e 6

Shënim: Krahas ushtrimit të motorikës dhe të përdorimit të mjeteve të vizatimit, nxënësit ushtrojnë në këto dy ushtrime shënimin e skajeve të segmentit me pika, të cilat shënohen me shkronjë të madhe dhe kështu e emërtojnë segmentin. Gjithashtu, nxënësit ushtrojnë relacionet "pika i përket segmentit", "pika është jashtë segmentit, si edhe relacionin "ndërmjet" për tri pika në segment. .



Rëndësi kanë ushtrimet që kërkojnë gjetjen e të gjitha segmenteve në vizatim, emërtimin e segmenteve dhe vizatimin e segmenteve që përmbajnë dy pika të dhëna. Në varësi të përbërjes së klasës, ato mund t'u dedikohen nxënësve që kanë më shumë talent.

Në **ushtrimin nr. 5** emërtojnë tre segmente AM, AO dhe MO.

Në **ushtrimin nr. 6** emërtojnë gjashtë segmente AO, AE, AM, OE, OM dhe EM.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit i bashkojnë pikat me radhë dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është përfutur në figurë?
- Sa segmente keni vizatuar?
- Sa rrrathë shihen në figurë?

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 8




Shënim: Ushtrimi numër 8 përfaqëson edhe një ushtrim tjetër psikologjik, i cili tregon sesi mund të na "gënjejë" syri, d.m.th. se shikimi nuk është e thënë të jetë gjithmonë baza për konfirmimin e një fakti gjeometrik.

Nxënësit duhet t'i përgjigjen pyetjes së bërë në Tekstin mësimor duke u shpjeguar, se në figurë janë vizatuar segmentet e mbuluara me shirit, kështu që duket sikur pas këtij shiriti janë tri segmente. Nxënësit duhet që me anë të rrafshimit me vizore, të nxjerrin përfundimin se është fjala për dy segmente.

Veprimtaria 11: Veprimtari për nxënësit e talentuar

Ushtrim. Vizatojmë vija të lakuara me ndihmën e vijave të drejta.

Shkruani vija mbi segmentet në fletën me katrore.



Shënim: Shohim se me shtimin e shtuar të segmenteve vizatohet gjithnjë e më shumë një vijë e lakuar.

Veprimtaria 12: Loja "Shkronjat"

Në dërrasë të zezë janë shkruar disa shkronja të mëdha, për shembull: A, B, V, G, Z, N, O, P, S, F etj. Detyrë e nxënësve është t'i ndajnë këto shkronja në tri bashkësi. Bashkësisë së parë i përkasin ato shkronja që shkruhen vetëm me segmente, për shembull A, V, N, Z. Bashkësisë së dytë i përkasin ato shkronja që shkruhen vetëm me vija të lakuara, për shembull C, O, S. Bashkësisë së tretë i përkasin ato shkronja që shkruhen me ndihmën e segmenteve dhe me ndihmën e vijave të lakuara, për shembull B, P, G.



Veprimtaria 13:

Nxënësit zhvillojnë diktimin matematikor:

- Vizato vijën e drejtë dhe shëno në të dy pika me shkronja të mëdha.
- Vizato drejtëzën dhe shëno në të tri pika. Sa segmente sheh?
- Shëno katër pika dhe shih sesa segmente mund të përftohesh me bashkimin e këtyre pikave.
- Vizato me vizore rrethimin e oborrit me parrakë. Prej sa segmentesh përbëhet ai?



14. VIJAT E MBYLLURA DHE VIJAT E HAPURA

QËLLIMET


Nxënësit:

- formojnë përfytyrimin për vijat e mbyllura dhe për vijat e hapura;
- dallojnë, emërtojnë dhe vizatojnë vijat e mbyllura dhe vijat e hapura;
- dallojnë vijën si kufirin midis pjesës brenda dhe pjesës jashtë;
- dallojnë pjesën brenda dhe pjesën jashtë tek objektet konkrete;
- saktësojnë relacionet “jashtë”, “brenda” dhe “në”.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria hyrëse: Loja “Udhëtimi i xhaxhi Glishës”

Nxënësit shohin figurën e vizatuar dhe dëgjojnë tregimin:




“Udhëtari ynë, xhaxhi Glisha, u nis përsëri për udhë, arriti në vendin e mrekullive dhe u gjend para një labirinti të mbyllur. Për të mos humbur në këtë labirint, ai mori lëmshin e perit. Njërin skaj të perit e lidhi në hyrje të labirintit dhe u nis para. U end gjatë nëpër rrugët e mpleksura (duke zgjidhur lëmshin e perit) dhe më në fund arriti në dhomën e thesarit. E mori xhaxhi Glisha thesarin dhe u nis prapa.”

Pas leximit të kësaj pjesë të tregimit, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë e ndihmoi xhaxhi Glishën, që të gjente rrugën e vërtetë dhe të mos humbiste?
- Sa skaje ka peri? Ku është njëri skaj i perit? Ku është skaji tjetër i perit?

Vazhdoi xhaxhi Glisha më tej dhe ndeshi në një pyll të dendur në bregun e një liqeni të mrekullueshëm. Kaq bukur ishte përreth liqenit, sa që xhaxhi Glisha e la arkën e thesarit dhe u nis përgjatë bregut të liqenit.”

Nxënësit tregojnë në figurë rrugën e xhaxhi Glishës.



“Xhaxhi Glisha shëtit për një kohë të gjatë, u lodh dhe vendosi të kthehej. Por, atëherë mendoi se ndoshta ishte më mirë të vazhdonte të ecte para. Pyeste, deri ku duhej të vazhdonte të ecte kështu?”

Nxënësit i përgjigjen pyetjeve?

- Si mund t’i ndihmojmë xhaxhi Glishës? (Duhet të gjejë arkën e thesarit që ka lënë në breg, përndryshe ai do të ecë gjatë në rrugën e mbyllur.)
- Ç’gjë është e përbashkët tek rrugët e labirintit dhe rrugët e pyllit? (Nxënësit shohin, se rrugët janë vija të lakuara.)
- Në ç’gjë ndryshojnë rrugët e labirintit dhe rrugët e pyllit? (Nxënësit shohin, se njëra rrugë ka dy skaje, kurse rruga e dytë nuk ka fund.)



Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Udhëzim: Markoja udhëton përqark liqenit dhe pas një farë kohe kthehet në pikën fillestare. Rruga e bërë prej tij është paraqitur me vijë të ndërprerë.

Nxënësit e bëjnë më të trashë këtë vijë duke filluar nga pika e kuqe. Pastaj konstatojnë, se kanë arritur deri tek pika fillestare dhe nxjerrin përfundimin, se vija më e trashë është vijë e mbyllur.

Nxënësit vënë re se edhe vija e liqenit përfaqëson një vijë të mbyllur. Bregu është vija që ndan dy zona; zonën e ujit që përfaqëson pjesën brenda dhe zonën tokësore që përfaqëson pjesën jashtë. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: Çfarë vini re në pjesën brenda? Çfarë gjendet në kufirin midis dy zonave? Çfarë gjendet në pjesën brenda? Maja po kthehet nga shkolla në shtëpi. Rruga e saj është paraqitur me vijë të ndërprerë. Nxënësit e bëjnë më të trashë vijën dhe konstatojnë se bëhet fjalë për vijën e lakuar të hapur. Kjo vijë ka dy skaje. Në njërin skaj gjendet shkolla, kurse në skajin tjetër gjendet shtëpia.


Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Shënim: Me këtë ushtrim nxënësit ngulitin nocionet vijë e mbyllur dhe vijë e hapur. Përmes këtij ushtrimi ata duhet të kuptojnë se, nëse nisen nga pika A duke ecur mbi vijën në figurë, atëherë do të kthehen prapë në pikën A dhe se kjo vijë është vijë e mbyllur. Tek vijat e mbyllura nuk ka as fillim, as fund.

Nxënësit kalojnë me lapsin e kuq mbi vijën në figurën në Tekstin mësimor dhe vizatojnë vijën e mbyllur që përmban pikat A dhe B. Pastaj vendosin një pikë blu në pjesën brenda çdo vije të mbyllur, kurse pikën jeshile e vendosin në pjesën jashtë.

Në figurën e dytë, në të cilën janë paraqitur vijat e hapura, përkatësisht vijat në cilat ka dy skaje, nxënësit e bëjnë më të trashë vijën me laps blu me skajet A e B dhe V e G, si edhe bëjnë vijën e vet të mbyllur me skajet M e K. Pas kësaj, nxënësit shënojnë pikat që shtrihen mbi këto vija dhe pikat që nuk shtrihen mbi këto vija.

Shënim: Për ngulitjen e nocioneve vijë e mbyllur dhe vijë e hapur mund të përdoret skema më poshtë:



Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit gjejnë vijat e hapura dhe i bëjnë ato më të trasha me laps me ngjyrë jeshile. Ata i përgjigjen pyetjes: "Sa skaje kanë vijat e hapura?"

Nxënësit gjejnë vijat e mbyllura dhe i bëjnë ato më të trasha me laps me ngjyrë të kuqe. Ata i përgjigjen pyetjes: "Sa skaje kanë vijat e mbyllura?"

Pas kësaj, nxënësit e ngjyrosin pjesën brenda të vijave të mbyllura me laps me ngjyrë blu.

Shënim: Gjatë zhvillimit të ushtrimit, nxënësit duhet të tregojnë kujdes, se jo të gjitha vijat janë të lakuara dhe se këtu ka vija, të cilat për ne janë akoma të panjohura (vijat e thyera). Për këto vija do të bëhet fjalë më vonë.

Veprimtaria 4: "Loja gjej dhe formo"

Nxënësit marrin me zgjedhje të rastësishme fletushkat dhe pikërisht 10 me ngjyrë blu, në të cilat janë vizatuar vijat e hapura dhe 10 fletushka me ngjyrë të kuqe, në të cilat janë vizatuar vijat e mbyllura.




Me thënien e fjalëve “Gjej dhe formo”, nxënësit gjejnë fëmijët e grupit të vet, grupohen sipas të të njëjtave kriterë, që janë ngjyra dhe vija. Detyra e nxënësve është të demonstrojnë vijën e mbyllur dhe vijën e hapur duke u mbajtur për dore.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 6: Detyrë krijuese, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Shënim: Për zhvillimin e mendjemprehtësisë gjeometrike të fëmijëve dhe të imagjinatës e të fantazisë të tyre, është me dobi të propozohen detyrat krijuese për “gjetje” tek vizatimet me skema.



Nxënësit vrojtojnë figurën e vizatuar në dërrasë të zezë (peizazhi, elementet e të cilit janë vijat e hapura dhe vijat e mbyllura) dhe i përgjigjen pyetjes:

- Çfarë u kujtojnë këto vija?

Veprimtaria 7:


Shënim: Kjo është veprimtari hyrëse për zgjidhjen e ushtrimit nr. 4, me të cilin formohen tek nxënësit nocionet dhe relacionet; “pjesa brenda”, “pjesa jashtë”, “jashtë”, “brenda” dhe “në”.

Shënim: Studimi i relacioneve “jashtë”, “brenda” dhe “në” bëhet duke shfrytëzuar grupet e ndryshme të sendeve, të figurave dhe të veprimeve praktike.

Për shembull, disa nxënës vihen në valle duke u mbajtur për dore. Një prej nxënësve qëndron brenda valles, kurse një tjetër jashtë valles. Nxënësit u përgjigjen pastaj pyetjeve më poshtë:

- Kush e formon vallen?
- Me ç’figurë ngjason vallja? (Nxënësit shohin, se vallja ngjason me rrethin, që vizatohet në dërrasë të zezë.)
- Kush qëndron brenda valles?

Në rrethin që është vizatuar në dërrasë të zezë, shënohet pika dhe pranë saj shkruhet shkronja fillestare e emrit të nxënësit që qëndron brenda valles. (Për shembull: Nxënësi quhet Vuko dhe shkruhet shkronja V).



Zona në të cilën gjendet ky nxënës është pjesa brenda valles.

- Kush është jashtë valles? (Nxënësit thonë emrin e nxënësës që gjendet jashtë valles. Emri i nxënësës është, për shembull, Ana) A ○

Në dërrasë të zezë shënohet pika jashtë valles, ndërsa pranë saj shkronja e madhe A.


- Ç’mendoni, pse janë zgjedhur pikërisht këto shkronja?

Shënim: Zona në të cilën gjendet Ana, quhet pjesa jashtë valles.

- Emërtoni pikën brenda (jashtë valles).

Shënim: Vija rrethore është kufiri midis pjesës brenda dhe pjesës jashtë.

- Si do t’i emërtonit nxënësit që formojnë vallen? (Nxënësit propozojnë vetë sesi t’i shënojnë pikat në rrethin që i përfaqësojnë ato.)
- Cilat shkronja do të zgjedhim për pikat e dhëna?
- Kush qëndron ndërmjet Borisit dhe Llanës, ndërsa kush ndërmjet Svetllanës dhe Katarinës?



Nxënësit shënojnë në dërrasë të zezë pikat në rreth. Për shembull: S, B, K, LL, N.



- Sa pika kemi shënuar në rreth?
- Cila pikë gjendet midis B e LI dhe cila midis K e N?

Shënim: Kjo është përvoja e parë për ndërtimin e modeleve gjeometrike të një situatë jetësore reale. Këto njohuri do të përfordohen dhe do të përdoren më tej përmes punës me vizatime dhe gjatë zhvillimit të ushtrimeve me problema.

Veprimtaria 8:

Në këtë veprimtari nxënësit i vendosin sendet në kuti, jashtë kutsisë dhe mbi kuti (ose i vendosin fletoret në çantë, stilolapsat mbi tavolinë, ndonjë send jashtë klasës etj.).

Gjatë vendosjes së sendeve në pozicionin e caktuar, nxënësit tregojnë se çfarë kanë bërë duke përdorur nocionet *në*, *mbi*, *jashtë*. Veprimtaria duhet zhvilluar gjithnjë deri sa të vërtetohet, se nxënësit e kanë kuptuar kuptimin e nocioneve.

Shembull:

- Vizato vijën e lakuar të mbyllur. Në vijë vizato lulen, jashtë saj tullumbacen, kurse brenda saj zemrën. Pjesën brenda vijëzoje me ngjyrë të verdhë.

Veprimtaria 9:

Në vijën e mbyllur të bërë prej dy lakimeve, në pjesën brenda qëndrojnë tri vogëlushe, kurse në pjesën jashtë qëndrojnë dy vogëlushë. Në vijën (lakimin) e parë vendosin çantën e nxënësit. Nxënësit shohin, se çfarë është në, çfarë është mbi dhe çfarë është jashtë. Shembulli përsëritet disa herë me sende e grupe të ndryshme të fëmijëve.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit shohin pozicionet e ndryshme të figurave, përkatësisht të vijës së mbyllur. Në vizatimet në rreshtin e parë, nxënësit saktësojnë nocionet: në vijë, brenda vijës dhe jashtë vijës, përkatësisht nocionet kufiri, pjesa brenda dhe pjesa jashtë. Për emërtimet pjesa brenda dhe pjesa jashtë përdoret edhe emërtimi zonë e brendshme dhe zonë e jashtme. Nxënësit thonë pozicionet e rrethit të vogël të kuq, blu dhe të verdhë. Në pjesën poshtë të tabelës, nxënësit i vizatojnë vijat duke e ruajtur pozicionin e tyre, përkatësisht pozicionin e vijave ndaj modelit të dhënë.

Veprimtaria 11: Puna e pavarur e nxënësve


Para çdo nxënësi është peri, teli dhe zhetonët me ngjyrë. Në bazë të udhëzimit, nxënësit në mënyrë të pavarur:

- formojnë vijën e lakuar të mbyllur;
- vendosin zhetonin blu në zonën e brendshme;
- vendosin zhetonin jeshil në zonën e jashtme;
- vendosin zhetonin blu në vijë;

Pason kontrolli i saktësisë.

Veprimtaria 12: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Nxënësit shohin hartën e Malit të Zi, në të cilën qytetet janë shënuar me pika. Ata vënë re se kufiri i Malit të Zi është vija e lakuar e mbyllur dhe, nëse ka mundësi, e bëjnë atë më të trashë. Nxënësit e kuptojnë se pjesa brenda është zona e brendshme; është në të vërtetë territori i Malit të Zi. Pjesa jashtë ose zona e jashtme është territor i huaj. Pikat përfaqësojnë qytetet që gjenden brenda Malit të Zi. Disa qytete janë të shënuara me shkronjën e tyre fillestare. (Kryeqendra është shënuar me pikë të kuqe.) Nxënësit gjejnë, se cila pikë shënon çdo qytet veçmas.





15. VIJA E THYER

QËLLIMET

Nxënësit:

- formojnë nocionin vijë e thyer;
- formojnë aftësinë e njohjes dhe të paraqitjes së vijës së thyer;
- vizatojnë vijën e thyer.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria hyrëse:




Nxënësit vizatojnë figurën e rrufesë dhe pas kësaj zgjidhet ajo që i përgjigjet më mirë detyrës së përfshirjes së nocionit të ri.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: “Si vizatohet më shpesh rrufeja? Sa segmente janë përdorur në paraqitjen e rrufesë?”

Shënim: Si ilustrim i qartë i nocionit vijë e thyer, nxënësve mund t’u tregohet dega e drejtë që thyhet në disa vende, por në mënyrë të tillë që pjesët e saj të mos ndahen. Nocioni i vijës së thyer mund të formohet në mënyrë të qartë edhe me ndihmën e metrit që paloset në mënyrën si më poshtë:



Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Ç’vijë u kujton ky send?” Ata nxjerrin përfundimin, se është fjala për segmentin.



Nxënësit shohin, sesi “thyhet” ky segment dhe i përgjigjen pyetjes: “Ç’vijë kemi përftuar tani?” Ata nxjerrin përfundimin, se është fjala për vijën e thyer.


Veprimtaria 1: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuha shqipe dhe letërsia, “Udhëtimet e Gulivierit”.

Nxënësit shohin figurën, në cilën është Gulivieri i famshëm. Ai është paraqitur duke thyer drurin e drejtë.

Nxënësit vënë re, se duke e thyer drurin e drejtë, Guliveri ka përftuar vijën e thyer. Pas kësaj nxënësit zhvillojnë veprimtarinë më poshtë: të gjithë nxënësit kanë para vetes disa fije plastike dhe i përgjigjen pyetjes: “Ç’vija përfaqësonjë fjetet plastike?” Ata vënë re se këto janë vija të drejta. Nxënësit i theyejnë pastaj fjetet plastike dhe nxjerrin përfundimin, se tani kanë përftuar vijat e thyera.

Veprimtaria 2:

Nxënësit shohin vijat e thyera dhe u përgjigjen pyetjeve: “Ç’gjë është e përbashkët tek vijat e dhëna? Në ç’gjë dallohen ato?” Nxënësit nxjerrin përfundimin, se të gjitha janë vija të hapura, por vija e parë është drejtëz, vija e dytë është vijë lakuar dhe vija e tretë është vijë e thyer.



Pas kësaj, nxënësit vizatojnë drejtëzën, vijën e lakuar dhe vijën e thyer dhe i përgjigjen pyetjes: “Prej sa segmentesh përbëhet vija juaj e thyer?”

Nxënësit i krahasojnë vijat e thyera në vazhdim dhe i përgjigjen pyetjes: “Si mund t’i quajmë këto vija?” Sharra dhe bredhi: vijë e thyer e hapur dhe vijë e thyer e mbyllur.



Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit kërkojnë llojet e njohura të vijave në figurën ilustruese dhe në mjedisin përreth.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1, 2 e 3

Në **ushtrimin nr. 1**, nxënësit i lidhin pikat dhe përftojnë vijën që përbëhet prej segmenteve. Mësues-i/ja u thotë se një vijë e tillë, quhet vijë e thyer. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Prej sa segmentesh përbëhet vija e thyer e vizatuar?”

Shënim: Nxënësit duhet të kuptojnë, se vijë e thyer është ajo vijë që përbëhet nga disa segmente. Skaji i segmentit të parë të vijës së thyer është fillimi i segmentit të dytë, kurse skaji i segmentit të dytë, është fillimi i segmentit të tretë e kështu më tej. Segmentet fqinjë nuk mund t’i përkasin një drejtëze.

Në **ushtrimin nr. 2**, nxënësit ngulitin nocionin vijë e thyer. Më ndihmën e vizesës i bëjnë vijat e thyera më të trasha.

Shpjegim: Në figurë janë dhënë tri vija që nuk janë të thyera, njëra vijë është e lakuar, vija e dyta përbëhet prej segmenteve, por segmentet janë të ndara, kështu që fundi i segmentit të parë nuk është fillim i segmentit të dytë e kështu më tej. Tek vija e tretë, pjesa e mesme nuk është segment.

Në **ushtrimin nr. 3**, nxënësit shohin figurat dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Ku janë fshehur segmentet?
- Ku janë fshehur vijat e thyera dhe ku janë fshehur vijat e lakuara?

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Shënim: Përmes këtij ushtrimi nxënësit njihen me faktin që vija e thyer, ashtu sikurse edhe vija lakuar, mund të jetë vijë e mbyllur dhe vijë e thyer.

Nxënësit shohin vijat e hapura dhe vijat e mbyllura, njohin mënyrën sesi shënohet vija e thyer dhe shkruajnë se prej sa segmentesh përbëhen vijat e thyera.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit, me ndihmën e vizesës, vizatojnë vijat e thyera të mbyllura dhe vijat e thyera të hapura.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit shohin figurën dhe zgjidhin ushtrimin. Ata vënë re, se në kolonën e parë të tabelës janë grumbulluar vijat e mbyllura, kurse në kolonën e dytë janë vizatuar vijat e hapura. Në rreshtin e parë gjenden vijat e lakuara, kurse në rreshtin e dytë gjenden vijat e thyera.

**Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7**

Shënim: Po i vjen fundi bllok orëve të mësimit kushtuar temave mësimore të gjeometrisë. Kemi mësuar tipat e ndryshëm të vijave. Në ushtrimin e fundit përmbledhim dhe përsërisim lëndën e mësuar. Nxënësit rikujtojnë se vijat grupohen në tre tipa: të drejta, të lakuara dhe të thyera.

Nxënësit i grupojnë vijat në Tekstin mësimor sipas karakteristikës së tyre të përbashkët.

Zgjidhja: Vijat 2, 5 dhe 8 janë vija të drejta; vijat 1,3, 6 janë vija të lakuara, vijat 4, 7, 9 janë vija të thyera. Asnjë prej vijave në figurë nuk është vijë e mbyllur.

Veprimtaria 9:

Nxënësit marrin fletën e punës, në të cilën janë vizatuar shembuj të vijave të hapura, të mbyllura dhe të thyera. Nxënësit gjejnë vijat e thyera dhe i qarkojnë ato me ngjyrë të kuqe.

Veprimtaria 10: “Dita me diell e thyer”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit duhet të vizatojnë vizatimin, kurse tema është “Ditë me diell e thyer”.

Nxënësit vizatojnë diellin e thyer, barin e thyer, lulen e thyer, zogjtë e thyer, retë e thyera Gjatë punës përdorin vizoren.

Veprimtaria 11:

Nxënësit punojnë në mënyrë pavarur në fletën e punës.

1. Vizato një vijë të thyer të hapur.
2. Vizato një vijë të thyer të mbyllur, e cila përbëhet prej 5 segmentesh.
3. Vizato 7 pika. Bashkoi ato, në mënyrë që të përftoh vijën e thyer.
4. Vizato një send duke përdorur vijën e thyer (p.sh. kurorën.)



16. MATJA E GJATËSISË

QËLLIMET

Nxënësit:

- masin gjatësinë me njësinë matëse standarde e jostandarde të gjatësisë;
- njohin mënyrat e ndryshme të matjes;
- njohin njësinë matëse të gjatësisë - centimetri;
- përvetësojnë nocionet njësi matëse dhe numër matës;
- përvetësojnë vartësinë e gjatësisë së segmentit nga njësia matëse;
- shkruajnë njësitë matëse me numër dhe me njësinë matëse.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Shënim: Nxënësit njihen përmes kësaj veprimtarie me mënyrat e krahasimit të segmenteve sipas gjatësisë. Ata ndeshen me krahasimin e gjatësive të segmenteve që janë matur me ndihmën e njësisë matëse jostandarde.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- "Cilat karakteristika të sendeve njihni?" Shënim: nxënësit duhet të veçojnë ngjyrën, formën, madhësinë, materialin, funksionin etj.)

Shënim: Pas përgjigjeve të nxënësve, atyre u duhet theksuar se disa prej karakteristikave të sendeve që kanë përmendur mund të krahasohen. Relacionet e karakteristikave të tilla tek sendet e ndryshme mund të tregohen me ndihmën: më i madh, më i vogël, baras. Karakteristikat e tilla të sendeve quhen madhësi.

- A mund të përcaktojmë, se cila ngjyrë është më e madhe; ngjyra rozë apo e kaltër, e kuqe apo portokallia?
- Mendoni shembujt e karakteristikave të tilla të sendeve, të cilat janë madhësi. (Nxënësit mund të thonë "gjatësia", "lartësia", "gjerësia", "temperatura", "masa" etj.)

Në tavolinë janë shiritat e ngjyrave të ndryshme (jeshile, blu dhe e kuqe). Dy shirita janë të së njëjtës gjatësi, ndërsa shiriti i tretë është paksa më e gjatë (i kuq dhe blu janë 1×15 cm, kurse jeshili është 1×18 cm).

Nxënësit i shohin shiritat dhe u përgjigjen pyetjeve:

- "Cili shirit është më i gjatë? Cili shirit është më i shkurtër? A është madhësi gjatësia e shiritave? A mund t'i krahasojmë shiritat sipas gjatësisë. Cili prej shiritave është më i madh (më i gjatë) dhe cili prej tyre është më i vogël (më i shkurtër)?"
- "Si mund ta tregojmë këtë gjë?" (Nxënësit duhet të shohin, se shiritat i vendosim njërin mbi tjetrin ose njërin pranë tjetrit, por në të dy rastet duhet ta puthitim njërin prej skajeve, për shembull, të majtin.)


Një nxënës, i kthyer nga klasa, i krahason shiritat, kurse të tjerët punojnë në vendet e veta. Nxënësit pohojnë, se shiriti i kuq dhe blu kanë gjatësi të barabarta, ndërsa shiriti jeshil është më i gjatë sesa dy shiritat e tjerë. Nxënësit shkruajnë:

$$J > K \quad B < J \quad K = B$$

Shënim: Nxënësit duhet të kuptojnë, se relacioni i shiritave mund të shkruhet me ndihmën e shenjave $<$, $>$ dhe $=$, dhe se gjatësia është madhësi.

**Veprimtaria 2:**

Nxënësit shohin në dërrasë të zeze dy segmente të vizatuara AB dhe VG. Ato duhet të jenë të vizatuara në mënyrë të tillë, që të mos dallohet fare qartë, se cili prej tyre është më i gjatë (gjatësia e segmentit të parë është 75 cm, kurse gjatësia e segmentit të dytë është 90 cm). Nxënësit i krahasojnë segmentet fillimisht me të parë. Përgjigjet (relacionet) e veta i shkruajnë me anë të $>$, $<$ dhe $=$.



Nxënësit ndeshen pastaj me mendimin e pazakontë:

- Por, mua më duket se segmentet janë të barabartë.

Tani nxënësit ndeshen me problemin, se nuk mund t'i vendosin segmentet njërin mbi tjetrin dhe shfaqet nevoja e shpikjes së një mënyre të re për krahasimin e gjatësive të segmenteve.

Pas diskutimit të mënyrave të ndryshme të krahasimit që propozojnë, nxënësit konstatojnë nevojën e përdorimit të njësisë matëse. Për këtë arsye, ata i përgjigjen pyetjes:

- "A mund të na ndihmojë për këtë shiriti ynë i kuq?"


Udhëzim: Nxënësit duhet të kuptojnë, se është e nevojshme të përcaktohet, sesa herë mund ta përmbajë ky shirit për nga gjatësia secilin prej segmenteve dhe pastaj t'i krahasojnë numrat e përfutur. Rëndësi ka që nxënësit ta zbatojnë me kujdes këtë procedurë tek të dy segmentet. Fillimisht punojnë me shiritin e kuq. Nga njëri skaj i segmentit AB, të themi A, vendosin shiritin, pastaj atje ku ka përfunduar shiriti vendosin shenjën, nga shenja vendosin edhe një herë shiritin dhe gjithnjë kështu deri sa ta përfundojnë matjen e segmenteve. Del se segmenti AB përmban 5 c gjatësi të shiritit të kuq ($AB = 5c$). Po kështu, segmenti VG përmban 6 herë shiritin e kuq ($VG = 6c$). Meqë $5 < 6$, përftohet $AB < VG$. Pra, me ndihmën e matjes, krahasimi i gjatësisë së segmenteve thjeshtohet në krahasimin e numrave.

Nxënësit informohen se mënyra e propozuar e krahasimit, quhet matja e segmenteve AB dhe VG me anë të shiritit të kuq.

Nxënësit ngulitin mënyrën e matjes së segmenteve:

- Zgjedhim njësinë e segmentit, në rastin e këtushëm ky është shiriti i kuq.
- Përcaktojmë se sa herë e përmban atë segment për nga gjatësia e vet.

Përfundimin e dhënë mund ta shkruajmë në mënyrën më poshtë:

**Veprimtaria 3:**

Shënim: Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të vënë re domosdoshmërinë e përdorimit të së njëjtës njësi matëse gjatë matjes së gjatësisë së segmenteve të ndryshme.

Nxënësit masin sendet e ndryshme me ndihmën e shiritave të vet: gjatësinë dhe gjerësinë e bankës, të librit, të fletores etj.

Pastaj masin me ndihmën e shiritit jeshil segmentin VG, i cili është vizatuar në dërrasë të zeze. Përftojnë se segmenti $VG = 5j$. Shkruajnë dy barazimet që kanë përfutur gjatë orës së mësimi:

$$VG = 5j \text{ dhe } AB = 5k$$

Prej këtyre barazimeve nxënësit nxjerrin përfundimin, se segmentet AB dhe VG janë të barabartë dhe i përgjigjen pyetjes: "Ku kemi gabuar kur kemi nxjerrë përfundimin se $AB < VG$?"



Nxënësit mendojnë për problemin e vet; ata duhet të gjejnë shkakun e këtij keqkuptimi: segmentet AB dhe VG janë matur tani me njësi të ndryshme matëse (me shirita të ndryshëm).

Teksti mësimor

Veprimtaria 4: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Nxënësit njohin njësitë e vjetra matëse për gjatësinë, të cilat njerëzit i kanë përdorur qysh në lashtësi. Popujt e vjetër kanë marrë si njësi matëse për gjatësinë atë që kanë pasur më afër dhe këto janë pjesët e trupit vetjak dhe mjetet e punës të dorës: gishti i madh, pëllëmba, përçiku, bërryli (kuti), këmba, hapi.

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse dhe u përgjigjen pyetjeve:

Markoja dhe Natasha kanë vendosur ta masin traun. Ata e kanë matur me këmbë, me bërryla (kute) dhe me hapa.

- A kanë përfutur ata rezultate të njëjta? Pse?
- A duhet të kenë dy njerëz të njëjtën gjatësi këmbë, bërryli (kuti) ose hapi?
- A është gjatësia e bërrylave dhe e këmbëve tuaja e barabartë apo më e madhe, sesa kanë qenë ato vitin e kaluar?

Në vazhdim të kësaj veprimtarie, disa nxënës masin gjatësinë e klasës me hapa dhe rezultatet e matjes i shkruajnë në dërrasë të zezë. Pastaj disa nxënës masin gjerësinë e klasës me këmbë. Rezultatet e matjes i shkruajnë përsëri në dërrasë të zezë.

Pas këtyre matjeve, nxënësit i përgjigjen pyetjes:

- Pse me matjen me hapa dhe me këmbë janë përfutur rezultate të ndryshme?

Nxënësit e masin bankën me bërryl dhe me pëllëmbë a përçik dhe i krahasojnë rezultatet e përfutura të matjes.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit studiojnë varësinë e rezultateve të matjes së gjatësisë nga zgjedhja e njësisë matëse. Nxënësit vënë re, sesa më e madhe që të jetë për nga gjatësia njësia matëse, aq më shumë zvogëlohet numri i herëve të gjatësisë që ajo përmban në segmentin e dhënë.

Nxënësit e kuptojnë se krahas çdo matjeje, përveç numrit; rezultatit të matjes, gjithmonë duhet të qëndrojë edhe emërtimi i segmentit matës, të cilin ata e kanë përdorur për matjen e madhësisë. Nxënësit njohin nocionin e numrit matës që tregon sesa njësi matëse bëjnë gjatësinë e segmentit të dhënë.

Në vazhdim të kësaj veprimtarie nxënësit bëjnë matje të ndryshme me ndihmën e shkopinjve të ngjyrosur.

Nxënësit masin:

- gjatësinë e cepave të tavolinës;
- gjerësinë e tavolinës;
- gjatësinë dhe gjerësinë e cepit të fletores.

Ata vënë re, se për matjen e gjatësisë më të shkurtër nevojitet njësi matëse më e vogël dhe anasjelltas. Pas kësaj, vijon matja e së njëjtës gjatësi me njësi matëse të ndryshme (shkopinj të gjatësive dhe të ngjyrave të ndryshme), ndërsa pastaj edhe matja e segmenteve të ndryshme me njësi matëse të ndryshme.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Shënim: Nxënësit njihen me njësinë matëse "katrori".

Nxënësit krahasojnë gjatësinë e sendeve në letër me katrorë; numërojnë katrorët, krahasojnë numrat që kanë përfutur dhe krahasojnë kështu gjatësinë e sendeve.



Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4

Shënim: Veprimtaritë e mëparshme u kujtojnë nxënësve nevojën e përfshirjes së njësisë matëse të përbashkët për gjatësinë, e cila do të jetë e njëjtë për të gjithë. Nxënësit njohin një njësi të tillë matëse për gjatësinë të pranuar prej të gjithëve: *centimetrin*. Centimetri krahasohet përafërsisht me gjerësinë e gishtit tregues dhe me gjatësinë e segmentit të dy katrorëve në fletore e punës. Nxënësit aftësohen që të masin me vizore gjatësinë e segmenteve dhe i lexojnë rezultatet në shkallën e vizores. Nxënësve u tërhiqet vëmendja, se matja siç duhet me vizore fillon nga zeroja. Është vënë re, se nxënësit masin shpesh nga njësia, nëse nuk u tregohet në kohën e duhur mënyra e rregullt e matjes.

Nxënësit bëjnë matjen e segmenteve me vizore.

Udhëzim:

- Afroni vizoren pranë segmentit.
- Përputheni njërin cep të segmentit me zeron në vizore.
- Gjeni në vizore numrin që i përgjigjet cepit tjetër të vizores.
- Thoni dhe shkruani përgjigjen.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit ushtrohen në matjen praktike të gjatësive të segmenteve të ndryshme me ndihmën e vizores.

Gjithashtu, nxënësit mund të masin me ndihmën e vizores gjatësinë dhe gjerësinë e fletores, të librit, të lapsit, të gishtit etj.

Veprimtaria 10: Puna e pavarur e nxënësve në fletore

Nxënësit, duke përdorur vizoren, vizatojnë në fletore "tabelën matematike të kërcimit" prej pesë segmentesh të përmasave të ndryshme: segmenti 3 cm, segmenti 4 cm, segmenti 5 cm, segmenti 6 cm, segmenti 7 cm.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 6

Shënim: Ky ushtrim psikologjik tregon përsëri, sesi mund të na mashtrorë shikimi, d.m.th. që shikimi dhe matja me sy nuk është e thënë të jenë gjithmonë bazë e saktë për vërtetimin e një fakti gjeometrik. Duke kontrolluar me vizore zbulojmë, se dy distancat janë të së njëjtës gjatësi.

Nxënësit zgjidhin detyrën e dhënë.

Veprimtaria përfundimtare:

Shënim: Nxënësit duhet të përsërisin:

- Madhësia është një karakteristikë e sendit që mund të krahasohet. Gjatësia është madhësi. Sendet e ndryshme mund të krahasohen për nga gjatësia, d.m.th. mund të jenë më të mëdha, më të vogla ose të barabarta.
- Për të matur gjatësinë e një segmenti, duhet të zgjedhim segmentin matës, përkatësisht njësinë matëse dhe të përcaktojmë sa herë përfshihet segmenti matës në segmentin që masim.
- Gjatësinë e dy segmenteve mund ta krahasojmë vetëm, nëse të dy segmentet i masim me të njëjtin segment matës.
- Njësitë matëse të vjetra, të lashta janë varur nga madhësia e trupit të njeriut që bën matjen, prandaj rezultatet e matjeve të tilla nuk mund të krahasoheshin. Tani përdoren njësitë matëse universale për gjatësinë, të pranuar prej të gjithëve. Një prej tyre është centimetri.
- Për të matur gjatësinë e segmentit në centimetra duhet të përdorim vizoren.

Gabimi më i madh tek nxënësit është se nuk kuptojnë dallimin midis nocioneve "madhësi" dhe "njësi matëse e madhësisë". Prandaj ka shumë rëndësi, që të tregohet që në fillim kujdes për dallimin midis këtyre dy nocioneve. Gjatësia është karakteristika që karakterizon shtrirjen e sendeve, ndërsa centimetri është segmentin matës me të cilin matet gjatësia. Gjatësia e segmenteve shprehet me numrin me njësinë matëse të shënuar (për shembull, 5 cm).



17. VEPRIMI I MBLEDHJES DHE I ZBRITJES

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsëritin dhe përforcojnë njehsimet: mbledhja si bashkim i një grupi sendesh dhe zbritja si veçim i pjesës nga grupi i sendeve;
- përsëritin shenjat matematikore; shenjat e njehsimit të mbledhjes dhe të zbritjes (+, -) dhe shenjat e relacioneve (<, >, =);
- formojnë përfytyrimin për shprehjen numerike si nocion matematikor;
- formojnë përfytyrimin për barazimin dhe jo barazimin si nocione matematikore;
- formojnë, lexojnë dhe shkruajnë shprehjet numerike të barazimit dhe të mosbarazimit;
- mbledhin dhe zbresin të njëjtat njësi matëse;
- përdorin në mënyrë aktive gjuhën e matematikës.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Në këtë veprimtari organizohet puna praktike e nxënësve, të cilët i bashkojnë sendet në grupe dhe veçojnë një pjesë të sendeve nga grupet e formuara në këtë mënyrë. Nxënësit caktojnë numrin e sendeve në grup dhe emërtojnë veprimin që kanë përdorur.

Shkruajnë matematikisht veprimin e caktuar. Nxënësit nxjerrin përfundimin se, kur duan t'i bashkojnë sendet në grup, përdorin shenjën "+". Për shembull, $5 + 3$. Atëherë përftohet shkrimi që në gjuhën e matematikës quhet "shprehje numerike".

Shënim: Nëse vihet shenja "=" dhe njehsohet shprehja numerike $5 + 3 = 8$, atëherë përftohet vlera e shprehjes numerike dhe ajo zgjerohet deri tek barazimi.

Veprimtaria 2:

Në dërrasë të zezë shkruhet një veprim aritmetik, ndërsa nxënësit me ndihmën e materialit didaktik (shkopinjë, aplikimet etj.) e ilustronë këtë shprehje numerike.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Nxënësit përsërisin mënyrat e shkrimit të shprehjeve në formën e shumës e të ndryshesës që ilustronë proceset rreth tyre. Këtu bëhet fjalë për ndërtimin dhe zgjidhjen e ushtrimeve në formë probleme. Nxënësit bëjnë shumat dhe ndryshesat sipas figurave duke u mbështetur në përvojën e tyre vetjake dhe në kuptimin e veprimit të mbledhjes e të zbritjes.

Ecuria për ndërtimin e shprehjes numerike që përshkruan një proces është:

1. së pari shkruajmë numrin e sendeve që kanë qenë në fillim;
2. pastaj shtohen ose hiqen disa sende. Kështu përftohet shuma ose ndryshesa.

Nxënësit i analizojnë figurat dhe gjejnë shprehjet numerike që i përgjigjen çdo ilustrimi. Ata e komentojnë përzgjedhjen e vet.



Për shembull, veprimi aritmetik $3 + 1...$ i përgjigjet figurës, në të cilën janë paraqitur tre zogj që çukitin thërrimet dhe një që po zbret të bashkohet me ta. Gjithsej do të jenë 4 zogj. Në bazë të kësaj figure, nxënësit mund të ndërtojnë problemën si vijon: “Tre zogj po çukitin thërrime. Ka ardhur edhe një zog. Sa zogj po çukitin tani thërrime?”

Veprimtaria 4: Veprimtaria hyrëse 3a Ushtrimi nr. 1

Në dërrasë të zezë janë shkruar disa numra. Nxënësit qarkojnë numrin që përfaqëson shumën e dy numrave të tjerë:

2	3	5	10	1	9	2	10	8
1	3	4	7	2	5	9	2	7
2	6	4	5	1	4	2	8	6

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit shkruajnë në katrorët e vegjël shenjën e mbledhjes dhe shenjën e zbritjes.

Shënim: Në kolonën e parë dhe në kolonën e dytë, çdo shembull është vetëm me nga një veprim aritmetik. Në kolonën e tretë janë ushtrimet më të vështira, sepse përmbajnë dy veprime aritmetike dhe ato mund t’u propozohen nxënësve të talentuar.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit plotësojnë zinxhirin, në të cilin njehsojnë me radhë vlerën e shprehjeve numerike.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Shënim: Shkrimi me shenjën = quhet barazim, kurse shkrimi me shenjën < ose > quhet mosbarazim.

Nxënësit i krahasojnë numrat dhe shprehjet numerike, duke vënë shenjën e duhur dhe komentojnë atë që kanë përfutur; barazimin apo mosbarazimin. Pas zhvillimit të ushtrimit nxënësit, punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e përgatitura parapraakisht.

Shembuj:

Ushtrimi A: Shkruaj disa barazime e mosbarazime të sakta duke përdorur numrat 5, 8, 7, 3, 9, 4, 6.

Ushtrimi B: Shkruaj disa barazime e mosbarazime të sakta duke përdorur numrat 7, 2, 3, 4, 5. (Për shembull: $7 - 4 = 3$, $7 - 4 > 2$, $4 + 2 > 5...$)

A) për nxënësit e talentuar, B) për të gjithë nxënësit.

Veprimtaria 8:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet e dhëna.

Udhëzim: Të gjithë nxënësit kanë flamurët e vegjël të përgatitur me shenjat >, < dhe =. Atyre u caktohet detyra, kurse ata ngrenë atë flamur, që i përgjigjet zgjidhjes së saktë.

Shembuj njehsimi:

$9 _ 7$	$5 - 3 _ 7$	$6 - 4 _ 8 - 6$
$5 _ 6$	$6 + 2 _ 6$	$4 + 2 _ 4 - 2$

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit masin gjatësinë e segmentit dhe shkruajnë rezultatet e matjes. Me ndihmën e vizesës e bëjnë më të trashë një pjesë të segmentit me ngjyrë të kaltër, kurse pjesën tjetër me ngjyrë të gjelbër. Masin gjatësinë e çdo pjese dhe gjatësinë e të gjithë segmentit dhe shkruajnë rezultatet. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Cilat barazime mund të shkruhen me këta tre numra?” Nxënësit i thonë të katër barazimet dhe vënë re, se gjatësia e të gjithë segmentit është e barabartë me shumën e gjatësisë së dy pjesëve.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.



18. MBLEDHËSIT DHE SHUMA

QËLLIMET

Nxënësit:


- përvetësojnë gjuhën e matematikës;
- mbajnë mend termat: **mbledhësi i parë, mbledhësi i dytë, shuma;**
- përdorin terminologjinë matematikore në të folur;
- gjejnë mbledhësin e panjohur me lojë didaktike të orientuar;
- hartojnë problema me mbledhje sipas figurave;
- përsëritin dhe përforcojnë mbledhjen deri në 10.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Duke e shkruar shprehjen, nxënësit i përdorin siç duhet termat,



Shuma e numrave 4 dhe 3 është numri 7 ose 7 është shuma e numrave 4 dhe 3.

Rëndësi ka që nxënësit të kuptojnë se shprehja numerike $4+3$ është shuma, ashtu sikurse edhe për rezultatin e mbledhjes, numrin 7, thuhet se është shuma.

Nxënësi shohin figurën ilustruese hyrëse në Tekstin mësimor, në të cilën Markoja dhe Maja mbledhin kubet. Mbi bazën e ilustrimit shkruajnë se është $3 + 2$.

Shënim: Është dhënë hollësisht në mënyrë të figurshme shpjegimi i të gjitha nocioneve. Me zhvillimin e mëtejshëm të ushtrimeve përcaktohet, nëse nxënësit e kanë përvetësuar terminologjinë.

Veprimtaria 2:

Në dërrasë të zezë janë shkruar disa barazime:

$$3+5=8 \quad 5+2=7 \quad 6+4=10 \quad 7+2=9.$$

Nxënësit emërtojnë tek barazimet e dhëna, mbledhësi i parë, mbledhësi i dytë dhe shuma.

Shembull: $3 + 5 = 8$ mbledhësi i parë është 3, mbledhësi i dytë është 5, kurse shuma është 8. Shprehja numerike $3 + 5 = 8$ është gjithashtu shuma.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit plotësojnë tabelën dhe emërtojnë mbledhësin e parë, mbledhësin e dytë dhe shumën. I nënvizojnë ata me laps me ngjyrë dhe me gjetje kërkojnë mbledhësin e panjohur.



Nxënësit i thonë shprehjet numerike dhe barazimet në mënyra të ndryshme. Nxënëset, në përputhje me të dhënat në tabelë, u shpjegohen mënyrat e ndryshme të shprehjes së shumës.

Mbledhja
Mbledhësi i parë është <input type="text"/> , mbledhësi i dytë është <input type="text"/> . Shuma është <input type="text"/> .
Numri <input type="text"/> të zmadhohet për <input type="text"/> .
<input type="text"/> plus <input type="text"/>
Të gjendet shuma e numrave <input type="text"/> dhe <input type="text"/> .
Numrit <input type="text"/> t'i shtohet numri <input type="text"/> .

Veprimtaria 4:

Nxënësit i përgjigjen pyetjes së mësuesit: "Sa rruaza kam në dorën e djathtë, nëse në dorën e majtë kam 3 rruaza, ndërsa gjithsej kam 8 rruaza?"

Ata vënë re, se ç'është numri i panjohur dhe propozojnë, sesi mund të paraqitet ai (*me vijë, me rreth, me katrorë*).

Shkruajnë barazimin në tabelë dhe numrin e panjohur tek mbledhja e tregojnë me anë të treguesit të vendit, d.m.th. të katrorit, në të cilin duhet të shkruhet numri që barazimi të jetë i saktë. Meqë nxënësit e kanë përvetësuar mbledhjen deri në dhjetë, ata nuk do ta kenë të vështirë të vënë re numrin që mungon.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit i plotësojnë tri tabelat me ndihmën e mësuesit.

Udhëzim: Në tabelën e parë janë dhënë të dy mbledhësit dhe duhet të gjendet shuma që shkruhet në pikën e prerjes të llojit dhe të kolonës, në të cilën janë mbledhësit.

Në tabelën e dytë është dhënë lloji i mbledhësve të dytë dhe është dhënë një kolonë e shumave. Mbi bazën e kësaj nxënësit përcaktojnë kolonën e mbledhësve të parë, ndërsa pastaj edhe kolonën e dytë të shumave.

Në tabelën e tretë është dhënë kolona e mbledhësve të parë dhe dy shuma. Mbi bazën e kësaj nxënësit përcaktojnë llojin e mbledhësve të dytë, ndërsa pastaj edhe shumatat e tjera.

Veprimtaria 6: Ushtrimet nr. 3, 4 e 5

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 7: Kontroll i kuptimit të përmbajtjes

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

- Shkruani numrat që mungojnë.

$$2 + _ = 7, \quad _ + 4 = 9, \quad _ + 6 = 10.$$

- Mbledhësi i dytë është numri dy. Sa është mbledhësi parë, nëse shuma është 8?
- Në një etazhe janë tre libra: Sa libra janë në etazhenë tjetër, nëse janë gjithsej 9 libra?


Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit formulojnë me gojë problemën mbi bazën e figurës. Pastaj shkruajnë veprimin matematik dhe gjejnë vlerën e tij.

Për shembull, mbi bazën e figurës së parë, mund të ndërtojmë një problemë të tillë?

Katër zogj pule po çukitin ushqimin. Vijnë edhe dy zogj pule që të hanë.

Sa zogj pule hanë gjithsej?

**Veprimtaria 9: "Në livadh", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ**

Nxënësit vizatojnë livadhin në mënyrë të tillë që fluturat, mollëkuqet, lulet dhe bletët (sipas përzgjedhjes) të përfaqësojnë veprimin aritmetik të mbledhjes, shkruajnë veprimin aritmetik dhe njehsojnë vlerën e tij. Pas kësaj nxënësit i përgjigjen pyetjes: "Në barazimin, që e keni paraqitur edhe në mënyrë figurative, çfarë është mbledhësi i parë e mbledhësi i dytë dhe çfarë është shuma?"

Veprimtaria 10: Loja "Kush do ta fitojë i pari numrin 10?"

Nxënësit luajnë në çifte. Njeri thotë çfarëdo numri nga 1 deri në 5. Tjetri i shton këtij numri 1 ose 2. Më tej, të dy vazhdojnë t'i shtojnë me radhë 1 ose 2 rezultatit të përfutur. Fiton ai që përfuton i pari numrin 10.

Për shembull: luajnë Markoja dhe Maja

Markoja thotë numrin 2.

Maja: $2 + 2 = 4$

Markoja: $4 + 2 = 6$

Maja: $6 + 1 = 7$

Markoja: $7 + 2 = 9$

Maja: $9 + 1 = 10$

Maja është fituese.

Tani Maja thotë numrin 3.

Markoja: $3 + 2 = 5$

Maja: $5 + 2 = 7$

Markoja: $7 + 1 = 8$

Maja: $8 + 2 = 10$

Maja është përsëri fituese.



19. NDËRRIMI I VENDIT TË MBLEDHËSVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë dhe kuptojnë se dy numra mund të mbliidhen me çfarëdo renditje;
- zbatojnë ligjin e ndërrimit të vendit të mbledhësve;
- dallojnë lehtësinë në njehsim: është më lehtë t'i shtohet numri i vogël numrit të madh, sesa numri i madh numrit të vogël.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Kush është ulur në bankën e parë? Sa nxënës janë ulur në bankë?

Nxënësit që janë të ulur në bankën e parë i ndërrojnë vendet, ndërsa nxënësit e tjerë i përgjigjen pyetjes:

- Sa nxënës janë të ulur tani në bankë?

Nxënësit arrijnë në përfundimin, se nxënësit që janë të ulur në bankën e parë, i kanë ndërruar vendet dhe se numri i nxënësve në bankë ka mbetur i njëjtë.

Veprimtaria 2:

Nxënësit janë ulur në çifte. Punojnë me ndihmën e materialit didaktik. Një nxënës i të çiftit i jepet detyrë të mbledhë katër zhetona blu dhe tre zhetona të kuq, kurse nxënës tjetër të mbledhë tre zhetona blu dhe katër zhetona të kuq. Nxënësi i parë shkruan $4+3$. Nxënësi i dytë shkruan $3+4$. Pastaj të gjithë nxënësit duhet t'i shkruajnë në fletoret e veta këto shprehje numerike dhe të gjejnë vlerën e tyre. Kur ta bëjnë këtë gjë, ata krahasojnë shumat e përfutuara dhe në tabelë shkruhet barazimi që ka përfutuar nxënësi i parë dhe barazimi që ka përfutuar nxënësi i dytë:

$$4+3=7 \quad 3+4=7.$$

Nxënësit nxjerrin përfundimin pse shumat e këtyre dy shembujve janë të barabarta.

Shënim: Nëse nxënësit nuk e nxjerrin vetë përfundimin, atyre duhet t'u shpjegohet se mbledhësit vetëm i kanë ndërruar vendet, ndërsa shuma në këtë rast ka mbetur e njëjtë.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit bisedojnë për figurën ilustruese hyrëse.

Veprimtaria 4:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet që janë të shkruara në tabelë:

$$3+2= _ \quad 4+3= _ \quad 5+ _ = 8 \quad _ + 1 = 4 \quad 2+ _ = 8$$

$$2+3= _ \quad 3+4= _ \quad 3+ _ = 8 \quad _ + 3 = 4 \quad 6+ _ = 8$$

**Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1**

Nxënësit shkruajnë në mënyra të ndryshme përbërjen e numrit 10.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Mbi bazën e shembullit të dhënë, nxënësit nxjerrin përfundimin, se është më e lehtë t'i shtohet numri i vogël numrit të madh sesa numri i madh numrit të vogël, kështu pra ndërrimi i vendit të mbledhësve e lehtëson nganjëherë mbledhjen.

Markoja duhet të sistemojë gjashtë kuba jeshil dhe një kub të kuq. Herën e parë një kubi të kuq i ka shtuar 6 kuba jeshil. Herën e dytë gjashtë kubave jeshil u ka shtuar një kub të kuq.

Nxënësit i përgjigjen pyetje se çfarë kanë më të lehtë mbledhin:

$$6+4 \text{ ose } 4+6; \quad 8+1 \text{ ose } 1+8$$

Закључак: Rregulla e ndërrimit të vendit të mbledhësve shërben edhe si lehtësi në njehsim.

Veprimtaria 7: "Unë e kam më lehtë"

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin më poshtë:

Numrat e shkruar mblidhi si të jetë më lehtë:

$$1 \text{ dhe } 7 \quad _ + _ = _$$

$$1 \text{ dhe } 8 \quad _ + _ = _$$

$$1 \text{ dhe } 9 \quad _ + _ = _$$

$$2 \text{ dhe } 8 \quad _ + _ = _$$

$$2 \text{ dhe } 7 \quad _ + _ = _$$

$$1 \text{ dhe } 6 \quad _ + _ = _$$

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit përsëritin përbërjen e numrave nga 1 deri në 9 duke i plotësuar kolonat, në mënyrë që shuma e numrave të jetë e barabartë me numrin e "kamionëve". Nxënësit vënë re se në rreshtin e parë numrat zmadhohen njëri pas tjetrit, kurse në rreshtin e dytë zvogëlohen. Ata arrijnë në përfundimin, se në rastin e shumës së qëndrueshme me zmadhimin e një mbledhësi për disa njësi, mbledhësi i dytë zvogëlohet për po kaq njësi.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 4 e 5

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit zgjidhin ushtrimet.

Shpjegim: Nxënësit e rreshtit të parë nxjerrin përfundimin, se pas trekëndëshit gjendet numri 5. Numri 2 gjendet ose pas rrethit, ose pas katrorit.

Të shqyrtojmë mundësinë e parë: pas rrethit gjendet numri 2. Atëherë në rreshtin e dytë do të ishte:

$$5+3=2+2+1, \text{ gjë që nuk është e saktë, sepse } 8 \neq 5.$$

Të shqyrtojmë mundësinë e dytë: pas katrorit gjendet numri 2, ndërsa pas rrethit numër 3. Atëherë rreshti i dytë jep: $5+2=3+3+1$, gjë që është e saktë.

Veprimtaria 11:

Në dërrasë të zezë janë shkruar barazimet. Nxënësit i shkruajnë numrat në barazime pa bërë njehsime duke shfrytëzuar vetinë e ndërrimit

$$2+4=\square+2 \quad 1+9=9+\square$$

$$6+\square=4+6 \quad \square+3=3+5$$



20. I ZBRITSHMI, ZBRITËSI DHE NDRYSHESA

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë gjuhën e matematikës;
- mbajnë mend termat: ***i zbritshmi, zbritësi, ndryshesa***;
- përdorin terminologjinë matematikore në të folur;
- gjejnë mbledhësin e panjohur me lojë didaktike të orientuar;
- zgjidhin shembuj me dy veprime njehsimi;
- përforcojnë zbritjen e numrave deri në 10.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Nxënësit duhet të përvetësojnë dhe të mbajnë mend termat: i zbritshmi, zbritësi, ndryshesa.

Nxënësit zgjidhin problemën: “Maja ka pasur në lulishten e vet 9 lule. Dy lule u vyshkën. Sa lule kanë mbetur në lulishten e Majës?”

Nxënësit shkruajnë veprimin e njehsimit dhe njehsojnë:

$$9 - 2 = 7 \text{ ose } 7 = 9 - 2$$

Nxënësit njihen me nocionet:

- *i zbritshmi*; numri prej të cilit zbritet;
- *zbritësi*; numri që zbritet;
- *ndryshesa*; rezultati që përftohet me zbritje.

Me zbritje përftohet numri i luleve që ka mbetur në lulishten e Majës.

Nxënësit lexojnë:

Ndryshesa e numrave 9 dhe 2 është numri 7 ose 7 është ndryshesa e numrave 9 dhe 2.

Shënim: Gjatë zhvillimit duhet të këmbëngulet në përdorimin dhe në leximin siç duhet të termave matematikore. Rëndësi ka që nxënësit të kuptojnë, se zbritja e numrave 9 dhe 2 është ndryshesa dhe rezultati i zbritjes, sepse numri 7 përftohet me zbritjen e numrave 9 dhe 2.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit plotësojnë tabelën, thonë të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshesën, i nënvizojnë ata me laps me ngjyrë, kërkojnë me gjetje zbritësin e panjohur.

Nxënësit i thonë shprehjet numerike dhe barazimet në mënyra të ndryshme. Në përputhje me atë që është paraqitur në tabelë, nxënësit kuptojnë mënyrat e ndryshme të shprehjes së ndryshesës.



Zbritja
I zbritshmi është <input type="checkbox"/> , zbritësi është <input type="checkbox"/> . Ndryshesa është <input type="checkbox"/> .
Numri <input type="checkbox"/> të zvogëlohet për <input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/> minus <input type="checkbox"/>
Të gjendet ndryshesa e numrave <input type="checkbox"/> dhe <input type="checkbox"/> .
Numrit <input type="checkbox"/> t'i zbritet numri <input type="checkbox"/> .

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Bretkosa u ngjitet shkallëve pa kapërcyer asnjë prej tyre. Nxënësit vënë re, se në shkallën e parë gjenden ndryshesat, të cilat janë të barabarta me 1. Njehsojnë ndryshesat dhe shkruajnë ndryshesat që mungojnë. Më tej, kalojnë në shkallën e dytë dhe vënë re, se ndryshesat janë të barabarta me 2. Njehsojnë dhe shkruajnë ndryshesat që mungojnë. Ecuria vazhdon gjithnjë, deri sa bretkosa të arrijë në shkallën e fundit.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Shënim: Trajtimi i temës së numrit të panjohur tek zbritja duhet filluar me analizën e figurës në Tekstin mësimor. Nxënësit analizojnë ushtrimin e paraqitur grafikisht dhe shkruajnë veprimin e njehsimit.

Përcaktojnë “me gjetje” zbritësin e panjohur.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit plotësojnë tri tabelat me ndihmën e mësuesit.

Udhëzim: Në tabelën e parë është dhënë i zbritshmi në kolonën e parë dhe zbritësi në llojin e parë. Nxënësit gjejnë ndryshesat, të cilat i shkruajnë në vendin ku priten kolona dhe lloji, në të cilën gjendet i zbritshmi dhe zbritësi përkatës.

Në tabelën e dytë janë dhënë zbritësit në llojin e parë dhe janë dhënë disa prej ndryshesave. Mbi bazën e kësaj, nxënësit duhet të gjejnë të zbritshmin e panjohur, ndërsa pastaj t'i njehsojnë ndryshesat e tjera.

Në tabelën e tretë është dhënë kolona e parë dhe janë dhënë disa ndryshesa. Mbi bazën e kësaj, nxënësit gjejnë zbritësin e panjohur dhe plotësojnë llojin e parë të tabelës, ndërsa pastaj i njehsojnë edhe ndryshesat e tjera.

Veprimtaria 6: Kontrolli i kuptimit

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

- Shkruaj numrin që mungon: $8 - _ = 2$, $10 - _ = 5$, $9 - _ = 9$, $7 - _ = 1$
- Nëse numrin 9 e zvogëlon me një numër të panjohur, do të përftohesh 6. Gjej numrin e panjohur.
- Kam pasur 8 bonbone. Kur kam ngrënë disa, më mbetën 5 bonbone. Sa bonbone kam ngrënë?

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit, mbi bazën e figurave, formulojnë me gojë problemat. Pastaj shkruajnë veprimin e njehsimit dhe gjejnë vlerën e tij.

Për shembull: Mbi bazën e figurës së parë mund të ndërtojmë një problemë të tillë:

Kanë qenë 8 mollë. Dy mollë janë ngrënë. Sa mollë kanë mbetur?

**Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 6**

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë.

Shënim: Në këtë ushtrim shfaqet veprimi i njehsimit me dy veprime njehsimi me zbritje. Punohet gradualisht: fillimisht nga i zbritshmi zbritet zbritësi i parë dhe pastaj nga ndryshesa e përfutur zbritet zbritësi i dytë.

Veprimtaria 9: Puna me grupe

Në fletët e përgatitura janë shkruar fjalët: i zbritshmi, zbritësi, ndryshesa dhe zbritja. Nxënësit marrin nga një fletë dhe mbi bazën e tij formojnë katër grupe.

Nxënësit hartojnë në bazë grupi problemën e duhur sipas veprimit të dhënë të njehsimit dhe gjejnë vlerën e këtyre shprehjeve numerike.

Shembuj ushtrimesh sipas grupeve:

Grupi i parë	Grupi i dytë	Grupi i tretë	Grupi i katërt
$6 - 4$	$9 - 6$	$8 - 6$	$4 - 2$
$7 - 3$	$4 - 2$	$5 - 3$	$6 - 5$
$3 - 2$	$10 - 8$	$7 - 5$	$9 - 4$

Veprimtaria 10:

Nxënësit kërkojnë në mënyrë të pavarur treshet e numrave **të ndryshëm**, në mënyrë që vlera e ndryshesës që përftohet, kur nga numri më i madh i treshes zbriten dy numrat e tjerë, është e barabartë me 6. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe shkruajnë pas kësaj veprimet e dhëna të njehsimit në tabelë duke i kontrolluar ata.

Shembuj:

$$10 - 1 - 3 = 6; 9 - 1 - 2 = 6 \text{ etj.}$$

Shembull: $8 - 1 - 1 = 6$ nuk i përgjigjet për shkak të përdorimit të numrit 1 dy herë.



21. LIDHJA MIDIS MBLEDHJES DHE ZBRITJES

QËLLIMET

Nxënësit:

- dallojnë lidhjen reciproke midis mbledhjes e zbritjes;
- përforcojnë mbledhjen dhe zbritjen në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 10.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Udhëzim: Para dërrasës së zezë duhen nxjerrë pesë vogëlushë dhe tri vogëlushe.

Nxënësit vënë re, se nga grupi janë veçuar pesë vogëlushë dhe tri vogëlushe. Ata nxjerrin përfundimin, se janë gjithsej tetë dhe shkruajnë:

$$5 + 3 = 8$$

Nxënësit i përgjigjen pyetjes: "A mund të shkruhet shuma në një mënyrë tjetër?"

Me këtë pyetje, nxënësit rikujtojnë ndërrimin e vendit të mbledhësve.

Tri vogëlushtet e veçuara shkojnë në vendet e veta. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se kanë mbetur pesë vogëlushë dhe shkruajnë veprimin e njehsimit:

$$8 - 3 = 5$$

Pas kësaj pjese të veprimtarisë, tri vogëlushtet kthehen në grupin e vogël, ndërsa pesë vogëlushët shkojnë në bankë. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se kanë mbetur tri vogëlushe dhe shkruajnë veprimin e njehsimit:

$$8 - 5 = 3$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse dhe vënë re, se me numra të njëjtë dhe me shenjat përkatëse mund të shkruhen dy mbledhje dhe dy zbritje. Ata nxjerrin përfundimin se, ekziston lidhja midis mbledhjes dhe zbritjes, si edhe se, kur dikush di të mbledhë, ai mundet lehtë edhe të zbresë.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Shënim: Mbi bazën e katër shembujve, nxënësit duhet të vënë re lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes, si edhe se me numrat e njëjtë janë shkruar tri barazime; një barazim me mbledhje dhe dy barazime me zbritje.

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin dhe i përgjigjen pyetjes: "Cilin barazim mund ta rishkruajmë në çdo kolonë, nëse shfrytëzojmë ndërrimin e vendit të mbledhësve."

Veprimtaria 4: Plotëso

Në fletët e përgatitura është dhënë ushtrimi që zgjidhet nga nxënësit.



Plotëso, në mënyrë që të përftohen barazimet e sakta:

$$_ + 1 = 5 \quad 6 + 2 = _$$

$$_ + 4 = 5 \quad 2 + 6 = _$$

$$5 - 1 = _ \quad _ - 6 = 2$$


$$5 - 4 = _ \quad _ - 2 = 6$$

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit i njehsojnë shprehjet numerike duke shfrytëzuar lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes.


Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3

Udhëzim: Me shigjeta me ngjyra janë dhënë veprimet: shigjeta jeshile tregon shtimin e numrit 1, shigjeta blu shtimin e numrit 2 ndërsa e kuqja shtimin e numrit 3.




Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Numrit 2 i shtojmë numrin 1. Çfarë kemi përftuar?
- Cilit numër i duhet shtuar numri 1, që shuma të jetë e barabartë me 5?
- Cilit numër i duhet shtuar numri 2, që shuma të jetë e barabartë me 6?



Shënim: Nxënësit mund ta thonë në mënyra të ndryshme secilin njehsim: numrit 2 i shtojmë numrin 1 dhe përftojme shumën 3; shuma e numrave 3 dhe 2 është e barabartë me 5; 5 plus 3 është e barabartë me 8.



Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit shohin figurën e paraqitur dhe nxjerrin përfundimin, se asaj i përgjigjen katër shprehje numerike. Nxënësit shpjegojnë kuptimin e tyre.

Udhëzim: Të gjitha mollët në figurë mund t'i ndajmë në dy grupe: "rriten në pemë" dhe "kanë rënë nga pema". Shprehjet numerike $3 + 4$ dhe $4 + 3$ tregojnë numrin e përgjithshëm të mollëve. Shprehja numerike $7 - 3$ tregon numrin e mollëve që kanë mbetur në pemë. Shprehja numerike $7 - 4$ tregon numrin e mollëve që kanë rënë nga pema.

Për këto shprehje mund të hartohen gjithashtu problemat:

- $3 + 4$ - Nga pema kanë rënë 3 mollë, por kanë mbetur varur edhe 4 mollë. Sa mollë janë gjithsej në pemë?
- $4 + 3$ - Në pemë janë 4 mollë, kurse poshtë pemës janë 3. Sa mollë janë gjithsej?
- $7 - 3$ - Në pemë janë rritur 7 mollë. 3 mollë kanë rënë. Sa mollë kanë mbetur në pemë?
- $7 - 4$ - Në pemë janë rritur 7 mollë, ndërsa kanë mbetur 4 mollë. Sa mollë kanë rënë?

Veprimtaria 8: Diktim matematikor

Nxënësit zgjidhin ushtrimet:

Shkruaj me shenja matematikore:

- shumën e numrave 8 dhe 2;
- ndryshesën e numrave 9 dhe 2;
- numrit 5 shtoji numrin 3;
- numrin 6 zmadhoje me 4;
- prej numrit 7 zbrit numrin 3;



- numrin 10 zvogëloje me numrin 3;
- numri 4 është më i madhe se numri 2;
- numri 8 është më i vogël se numri 10;
- shuma e numrave 4 dhe 2 është më e vogël se 8.

Gjej vlerën e shprehjeve numerike:

1. Mblidh numrat 8 dhe 2.
2. Zbrit numrin 4 nga numri 9.
3. Gjej shumën e numrave 5 dhe 3.
4. Sa është ndryshesa e numrave 7 dhe 2?

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Shënim: Tek disa shembuj, shenjat +, - dhe = mund të vihen në dy mënyra duke u përfutur barazimet e sakta. Për shembull:

$$9 \square 3 \square 6 \text{ mund të vihet } 9 - 3 = 6 \text{ ose } 9 = 3 + 6.$$

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike, kërkojnë shprehjet numerike, vlera e të cilave është 7 dhe i ngjyrosin ato. Në figurë është treguar rruga që përftohet kështu.

10 - 5	10 - 0	9 - 2	7 + 0	10 - 3	8 - 1	1 + 6	10 - 4
8 + 2	1 + 4	2 + 5	3 + 2	1 + 5	9 - 4	3 + 2	9 - 2
10 - 3	5 + 5	9 + 1	0 + 7	3 + 4	2 + 8	10 - 2	5 + 4
6 - 1	9 - 2	7 - 1	10 - 1	9 - 2	10 - 2	10 - 6	9 - 0
9 + 1	10 - 3	3 + 4	8 - 3	4 + 3	3 + 6	9 - 3	0 + 6
	8 + 1		5 + 2		9 - 1		5 + 3



22. PARAQITJA E NUMRAVE

Paraqitja e numrave zhvillohet në kuadër të kapitullit “Paraqitja dhe përpunimi i të dhënave. Formohet nocioni “segment numerik, gjë që është një hap drejt përvetësimit të nocionit “gjysmëdrejtëz numerike” që do të zhvillohet në klasën e tretë, në përputhje me Programin e lëndës mësimore të matematikës.

Paraqitja e numrave me ndihmën e segmentit numerik krijon bazën konceptuese për paraqitjen e të dhënave konkrete në situata të ndryshme jetësore. Segmenti numerik është edhe nyja lidhëse midis përmbajtjes algjebriko-aritmetike dhe asaj gjeometrike që zhvillohet në klasën e dytë. Kështu, segmenti numerik mundëson vizualizimin dhe gjeometrizimin e veprimeve të njehsimit të mbledhjes dhe të zbritjes, si edhe të relacioneve më i vogël dhe më i madh. Ai luan një rol të rëndësishëm në konceptimin e drejtë të bashkësisë së numrave natyrorë, konkretisht të nënbashkësive të tij të numrave natyrorë deri në 10, deri në 20 dhe deri në 100.

QËLLIMET

Nxënësit:

- formojnë nocionin segment numerik;
- njohin mënyrën e paraqitjes së numrave në segmentin numerik me shembuj të shtimit e të zbritjes së elementeve me anë të segmentit numerik;
- krahasojnë numrat me ndihmën e segmentit numerik;
- paraqitin numrat me dy shifra me pika në segmentin numerik;
- krahasojnë numrat deri në 20 duke përdorur shenjat $<$, $>$ ose $=$.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Nxënësit kanë ngulitur mbledhjen dhe zbritjen deri në dhjetë, kurse tani ndeshen për herë të parë me segmentin numerik. Vizatimi i segmentit numerik mund të lidhet me rrëfimin interesant për udhëtimin e ndonjë personazhi të përrallave, të ndonjë kafshe, të ndonjë treni a të ndonjë automobili etj.

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin më poshtë:

“Në një pyll jetonte një lepurush. Lepurushi jetonte i lumtur në shtëpi dhe të gjithë e donin. Ekzistonte vetëm një problem: ai nuk dinte të numëronte, nuk dinte të mblidhte dhe të zbriste. Atëherë, lepurushi plak me përvojë e këshilloi, që të numëronte çdo kërcim që bënte.

- Ti do të bësh një segment të mrekullueshëm, i cili quhet segmenti numerik. Ai do të jetë shoku yt besnik dhe do të mësojë t’i zgjidhësh edhe ushtrimet më të vështira.”

Nxënësit imagjinojnë, sesi e ndihmon segmenti numerik lepurushin për të numëruar. Ata duhet të vënë re, se kur shtojmë 1, atëherë në segmentin numerik zhvendosemi nga numri i dhënë një njësi djathtas, kurse për zbritje zhvendosemi nga numri i dhënë një njësi majtas.



Shënim: Gjatë vizatimit të segmentit numerik, nxënësit duhet të arrijnë në përfundimin:

1. Në segmentin numerik janë shënuar segmentet e barabarta.
2. Çdo numër tregon, sesa segmente të tilla të barabarta janë vënë.
3. Gjatë lëvizjes djathtas, numrat shtohen për 1, ndërsa gjatë lëvizjes majtas, numrat pakësohen për 1.



Numri 1 në segmentin numerik nuk është pika pranë cilës qëndron shifra 1, por është largësia midis dy pikave. Nxënësit duhet të kuptojnë, se në segmentin numerik mund të paraqiten të gjithë numrat, që ata kanë mësuar deri tani (paraqiten vetëm numrat nga një deri në dhjetë).

Segmenti numerik paraqitet si një pjesë e vijës së drejtë, në të cilën largësia midis çdo dy pikave është e barabartë. Numrat i bashkëngjiten pikave; poshtë çdo pike shkruhet numri përkatës. Në segmentin numerik, nxënësit caktojnë kush është paraardhësi dhe kush është pasardhësi i një numri. Pas kësaj, nxënësit i krahasojnë numrat në të njëjtin segment numerik.

Shënim: Në segmentin numerik mund të dallohen lehtë paraardhësit dhe pasardhësit e numrave, relacionet *më i vogël se* dhe *më i madh se*.

Është pranuar që lëvizja në segmentin numerik të tregohet me shigjetën të harkuar. Nëse ajo është e drejtuar djathtas, atëherë numrit i shtojnë njëshin dhe shkruajnë sipër saj "+1". Nëse shigjeta është e drejtuar majtas, atëherë është e kundërta, nga numri heqin njëshin.


Nxënësit studiojnë skemën që është vizatuar në dërrasë të zezë:



Për t'u treguar nxënësve favorin e përdorimit të segmentit numerik për kërkimin e shumave dhe të ndryshesave, rekomandojmë që të përdoret vizorja. Vizorja përfaqëson gjithashtu segmentin numerik, por të veçantë, me segmentin njësi të barabartë me 1 cm. Me ndihmën e vizores mund të zhvillohen me nxënësit disa shembuj, të cilët ata nuk i kanë zhvilluar deri tani, për shembull: $12 + 3$, $11 - 2$ etj.

Veprimtaria 2:

Shënim: Nocionet e reja do të përvetësohen më lehtë, nëse ndërtohet me nxënësit segmenti "i gjallë" numerik:



Nxënësit ftohen, që të udhëtojnë në segmentin "e gjallë" numerik. Me ndihmën e tij zgjidhin disa shembuj me mbledhje dhe zbritje: $6 - 3$, $7 + 2$, $8 - 6$ etj. Më dhënien e sinjalit, nxënësi që merr biletën me shprehjen numerike, për shembull $5 + 3$, duhet të gjejë fillimisht stacionin e duhur (stacioni i pestë), ndërsa pastaj të kalojë prej saj në stacionin pasardhës (+ tregon, se duhet të lëvizë nga e majta në të djathtë, kurse 3 tregon, sesa kalime duhet të bëjë). Nxënësi ka arritur kështu në stacionin e 8-të dhe ka gjetur vlerën e shprehjes numerike $5 + 3$.

Shënim: Këtë veprimtari e zhvillojnë nxënësit, të cilët akoma nuk e kanë kuptuar mirë mënyrën e mbledhjes e të zbritjes me ndihmën e segmentit numerik.



Veprimtaria 3: Puna në grupe

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Çdo grup ka detyrë që të bëjë flamurë të vegjël prej kartoni për numrin që kanë marrë (1 dhe 6, 2 e 7, 3 e 8, 4 dhe 5, 9 e 10).

Në spango është varur tashmë flamuri që është shënuar me zero dhe kapëset në largësi të barabarta që përfaqësojnë numrat në segmentin numerik. Kur grupet ta përfundojnë punimin e flamurëve, nxënësit gjejnë pikën, ku duhet të jenë numrat e tyre dhe i varin ato. Pas kësaj pjese të veprimtarisë, kontrollohet ajo që është bërë, respektivisht a i ka vendosur mirë flamurët çdo grup.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Shënim: Nxënësit njohin mënyrat e mbledhjes dhe të zbritjes me ndihmën e segmentit numerik. Në rastin e mbledhjes lëvizet nga e majta në të djathtë, kurse në rastin e zbritjes lëvizet nga e djathta në të majtë.

Nxënësit i studiojnë skemat dhe i plotësojnë barazimet.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Udhëzim: Nxënësit i shkruajnë barazimet mbi bazën e skemave. Ata vënë re, se në skemën e parë numrit 6 i është shtuar numri 4, gjë që e tregon shigjeta, e cila shkon nga e majta në të djathtë. Pastaj nga shuma e përfutur zbrisim numrin 2, gjë që e tregon shigjeta, e cila shkon nga numri 10 deri tek numri 8 nga e djathta në të majtë. Nxënësit shkruajnë në vendin e duhur barazimin: $6 + 4 - 2 = 8$.

Në skemën e dytë, nga numri 10 zbritet fillimisht numri, gjë që e tregon shigjeta, e cila shkon nga e djathta në të majtë, ndërsa pastaj mbledhim me numrin, gjë që e tregon shigjeta, e cila shkon nga e majta në të djathtë. Nxënësit numërojnë, se sa segmente të barabarta kanë zbritur fillimisht, ndërsa pastaj se sa kanë shtuar dhe shkruajnë barazimin: $10 - 7 + 3 = 6$.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3 e 4

Në **detyrën nr. 3**, nxënësit lidhin numrin me vendin e duhur në segmentin numerik.

Shënim: Gjatë zhvillimit të detyrës, nxënësit duhet të vënë re rregullën më poshtë:

nga dy numra në segmentin numerik, më i vogli gjendet majtas, kurse më i madhi gjendet djathtas. Kjo gjë është në përputhje me lëvizjen në segmentin numerik: në të djathtë numrat zmadhohen, ndërsa gjatë lëvizjes në të majtë zvogëlohen. Në bazë të këtij konkluzioni, është më dobi të shihen disa veti të mosbarazimeve. Për këtë gjë mund të shfrytëzoni lojën "Gjeni fjalën që duhet".

Nxënësit dëgjojnë fjalinë dhe pas kësaj gjejnë fjalën që mungon:

Shembuj:

1. Nëse numri i parë është më i vogël se i dyti, atëherë numri i dyti është _____ se numri i parë. (më i madh)
2. Nëse numri i parë është më i vogël se i dyti, ndërsa numri i dytë është më i vogël se numri i tretë, atëherë numri parë është _____ se numri i tretë. (më i vogël)

Shënim: Këto veti të mosbarazimeve mund të shpjegohen me shembuj konkret duke shfrytëzuar segmentin numerik. Për shembull: $5 > 3$, ndërsa $3 < 5$; $4 < 6$, $6 < 9$ atëherë $4 < 9$.

Më tej nxënësit shohin segmentin numerik dhe i krahasojnë numrat gojarisht (numri 14 është më i vogël se numri 18, numri 19 është më i madh se 17 etj.).

Në **detyrën nr. 4**, nxënësit luajnë lojën "Ta ndihmojmë korbin" për t'i vënë siç duhet shenjat "<" dhe ">"

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin shembujt me dy veprime njehsimi me ndihmën e segmentit numerik dhe i lidhin shprehjet numerike me numrin përkatës, i cili përfaqëson vlerën e kësaj shprehje numerike.



Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit shohin figurën e dhënë, dëgjojnë rrëfimin dhe u përgjigjen pyetjeve:

Në qytetin e "Numrave me një shifër" ndajnë shtëpizat. Janë vetëm 7 shtëpiza.

- Sa numra me një shifër janë? (dhjetë)
- Sa numra do të mbeten pa shtëpi? (tre)

Qyteti ka rrugët dhe rregullat e veta. Nuk mund të shkojë çdo numër, ku t'ia do qejfi.

Të gjithë janë nisur së bashku drejt shtëpive dhe kanë ndeshur udhëkryqin e parë.

- Të shohim tani, kush do të kthehet në rrugën blu? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se këto janë numrat më të vegjël se 1.) Ato nuk janë shumë. (Vetëm numri 0).
- Domethënë, shtëpinë blu do ta zërë numri 0. (Nxënësit shkruajnë numrin 0 në shtëpinë përkatëse.)

Numrat e tjerë e vazhduan më tej rrugën, deri sa arritën tek udhëkryqi tjetër.

- Cilët numra mund të nisen në rrugën e kuqe? (Nxënësit vënë re shenjën <6 dhe nxjerrin përfundimin, se këto janë numrat 1, 2, 3, 4, 5.)
- Cilët numra mund të nisen në rrugën jeshile? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se këto janë numrat më të mëdhenj se 6. Domethënë 7, 8, 9.)
- Kush do të mbesë me siguri pa shtëpi? (Nxënësit arrijnë në përfundimin, se është fjala për numrin 6.)

Tani grupi është ndarë në numrat më të vegjël se 6 (1, 2, 3, 4, 5) dhe në numrat më të mëdhenj se (7, 8, 9). Numri 6 ka mbetur vetëm.)

Grupi i parë e vazhdon më tej rrugën dhe ndesh përsëri në udhëkryq. Rruga e majtë është për numrat më të mëdhenj se 3, kurse rruga e djathtë është për numrat më të vegjël se 3. U trishtua numri 3. Edhe ai mbeti pa shtëpi.

- Cilët numra janë më të vegjël se 3? (Nxënësit përgjigjen, se këto janë numrat 1 dhe 2.) Domethënë, numrat 1 dhe 2 i kanë gjetur shtëpitë e veta. (Nxënësit i shkruajnë numrat në shtëpi.)
- Cilët numra janë më të mëdhenj se 3 dhe më të vegjël se 6? Këto janë numrat 4 dhe 5.) Edhe ato i kanë gjetur shtëpitë e veta. (Nxënësit i shkruajnë numrat në shtëpi.)

Grupi i dytë u nis gjithashtu në rrugën e vet jeshile. Të kujtojmë, këto janë numrat 7, 8, 9. Edhe ndeshin përsëri në udhëkryq. Njëra rrugë është e hapur për numrat më të vegjël se 8, ndërsa rruga tjetër është e hapur për numrat më të mëdhenj se 8. Kështu numri 8 ka mbetur pa shtëpizë.

- Cili numër është më i vogël se 8 dhe më i madh se 6? (shtata) Ai do të fitojë shtëpinë e parë jeshile. (Nxënësit shkruajnë numrin 7 në shtëpi.)
- Cili numër me një shifër është më i madh se 8? (nënta) Edhe shtëpia e fundit është plotësuar. (Nxënësit shkruajnë numrin 9 në shtëpi.)

Të gjithë numrat që kanë mundur janë vendosur. Numrat 3, 6 dhe 8 kanë mbetur pa shtëpiza.

Nxënësit ngjyrosin me ngjyrë të verdhë katrorët në rreshtin poshtë, tek të cilët ndodhen numrat 3, 6 dhe 8.



23. 0 DHE 1 TEK MBLEDHJA DHE ZBRITJA

QËLLIMET

Nxënësit:

- kuptojnë rolin e numrit 0 në mbledhje dhe në zbritje;
- kuptojnë se 0 është ndryshesa e dy numrave të barabartë;
- dallojnë me shembuj konkret neutralitetin e zeros si mbledhës dhe si zbritës;
- gjejnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrit të dhënë.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin interesant për grindjen midis shifrave.

“Një herë shifrat u grindën me zeron dhe i thanë asaj:

- Ti je shifër sikurse edhe ne, por të themi të vërtetën, ti s’ke kurrfarë rëndësie!
- Ja, për shembull, u krekos dyshi. Nëse nxënësi zgjedh shifrën dy, ai mund të hajë dy akullore. Po të mori ty, ai nuk mund të hajë asgjë.
- E saktë, ti je asgjë! – tha pesa.
- Asgjë, asgjë! – morën zjarr shifrat e tjera.
- Ju jeni budallaqe dhe asgjë nuk kuptoni, - tha zeroja. Ja, për shembull, ti o njësh. Po vendosem në anën tënde të djathtë. Çfarë je bërë tani? Përgjigju!”

Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Çfarë ka ndodhur me njëshin, kur shifra zero është vendosur pranë tij?”

- Ku qëndron veçantia e numrit 0?

Shënim: Ky është i vetmi numër që në segmentin numerik paraqitet me pikë dhe jo me segment.

Veprimtaria 2:

Shënim: Nxënësit njihen me numrin zero përmes numrit të elementeve të bashkësisë boshe.

Në kanistër janë pesë mollë. Nga kanistra nxirret një mollë, ndërsa nxënësit nxjerrin përfundimin, se në kanistër kanë mbetur katër mollë dhe kështu me rrallë, deri sa kanistra të zbrazet. Nxënësit konstatojnë, se në kanistër nuk ka asnjë mollë, ose se në kanistër nuk ka asgjë.

Shënim: Nxënësit njihen me nocionin bashkësi boshe, numri i elementeve të së cilës shënohet me shifrën 0. Domethënë, në këtë bashkësi ka 0 elemente. Numrin 0 nxënësit nuk duhet ta kuptojnë si “asgjë”, sepse zeroja është shifër e rëndësishme për shkrimin e numrave të tjerë dhe numër i rëndësishëm në njehsim.

Veprimtaria 3:

Shënim: Me këtë veprimtari, nxënësit e vënë re dhe e kuptojnë zeron si ndryshimin midis dy numrave të barabartë.



Për veprimtarinë në vazhdim mund të përdoret shembulli i ngjashëm me të mëparshmin. Në kanistër gjenden tri mollë. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Çfarë do të ndodhë, nëse të tri mollët i nxjerrim nga kanistra?

$$3 - 3 = 0.$$

Në dërrasë të zeze janë vizatuar pesë lule dhe pastaj janë fshirë. Pas kësaj nxënësit shkruajnë shprehjen numerike:

$$5 - 5 = 0.$$

Nxënësit duhet të kuptojnë, se zeroja është rezultati i zbritjes së dy numrave të barabartë.

Veprimtaria 4:

Nxënësit zgjidhin me ndihmën e mësues-it/es ushtrimet e dhëna.

Në dërrasë të zeze shkruhen ushtrimet, në të cilat duhet të plotësohen vendet boshe.

Shembuj:

$$5 - 5 = 4 - \square$$

$$3 + 4 = 7 + \square$$

$$8 + 0 = 8 - \square$$

$$4 + 0 = 2 + \square$$

$$2 + 4 = 0 + \square$$

$$6 - 0 = 0 + \square$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 5: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurat ilustruese hyrëse dhe ndërtojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin për papagajtë dhe shkruajnë barazimin.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 1 dhe 2

Shënim: Me këto ushtrime, nxënësve u tregohet se me shtimin e zeros një numri, rezultati nuk ndryshon: $4 + 0 = 4$. E njëjta gjë do të ndodhë, nëse zeroja zbritet nga një numër, gjë që do të thotë, se rezultati do të jetë i barabartë me numrin prej të cilit është zbritur: $2 - 0 = 2$

Në ushtrimin nr. 1, nxënësit shkruajnë shenjën + ose -, në mënyrë që të përftojnë barazime të sakta. Tek shembujt në të cilët numri 0 gjendet në vendin e dytë, janë të mundshme dy zgjidhje, për arsye se me shtimin dhe me zbritjen e zeros, rezultati nuk ndryshon.

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet duke i shkruar barazimet në fletore:

1. Cili numër i duhet shtuar numrit dy, që të përftohet numri dy?

2. Cili numër i duhet zbritur numrit dy, që të mbetet numri dy?

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin nr. 2.

Veprimtaria 7: "Krahaso"

Nxënësit kanë kartonët me shenja: më i madh, më i vogël, baras. Për çdo ushtrim që u jepet, nxënësit ngrenë lart shenjën përkatëse.

$$6 _ 0$$

$$6 - 3 _ 3 + 0$$

$$7 - 6 _ 7 - 7$$

$$0 - 0 _ 9 - 1$$

$$0 + 0 _ 6 + 1$$

$$0 _ 9 - 9$$

Veprimtaria 8: Loja "Ne jemi fqinj"

Para dërrasës së zeze gjenden 20 nxënës. Çdo nxënës ka kartonin me numrin që përfaqëson. Me thënien e një numri, nxënësit që janë "fqinjë", d.m.th. paraardhësi dhe pasardhësi i këtij numri, ngrenë lart kartonin dhe thonë "ne jemi fqinjët". Pason thënia e këtyre numrave. Loja përsëritet disa herë.



Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 3 e 4

Shënim: Në këto ushtrime nxënësit gjejnë vendet e numrave në vargun nga zero deri në njëzet. Për përvetësimin e nocioneve paraardhës dhe pasardhës mund të shfrytëzohen kutitë e vogla të sistemuara në dhjetë rreshta, në mënyrë që në rreshtin e parë të jetë një kuti, në të dytin dy kuti etj. deri tek rreshti i dhjetë, në të cilin janë dhjetë kuti. Nxënësit mund të vënë re lehtë, se çdo numër pasardhës është për një më i madh se numri paraardhës. Përmendet nocioni pasardhës, si numri që vjen pas numrit të dhënë. Në të njëjtën mënyrë, nxënësit mund të vënë re, se çdo numër ka paraardhësin; ky është numri që për një është më i vogël se vetë ky numër. Duhet të nxirret përfundimi, se çdo numër ka pasardhësin e vet dhe paraardhësin e vet.

Nxënësit i përgjigjen pyetjes: "A ka numri zero paraardhësin e vet?"

Shënim: Përveç nocioneve pasardhës dhe paraardhës, mund të përdoret edhe relacioni **është ndërmjet:** numri a është ndërmjet numrave b dhe c , nëse $b < a < c$. Kështu, për shembull, numri 5 është ndërmjet numrave 4 dhe 6; numri 7 është ndërmjet numrave 4 dhe 9.

Nxënësit zgjidhin në mënyrë pavarur **ushtrimet nr. 3 dhe nr. 4** në Tekstin mësimor.

Pas pjesës përfundimtare të kësaj veprimtarie, mund të propozohet loja. Me thënien e numrit, nxënësja e caktuar duhet të thotë, se cili është paraardhësi i këtij numri, ndërsa nxënësi i caktuar duhet të thotë, se cili është paraardhësi i tij. Në rrethin e dytë ndërrohen rolet. Loja mund të organizohet në mënyrë të tillë, që një nxënës të përmendë numrin dhe thërret shokun ose shoqen, i cili ose e cila duhet të thotë, se kush është pasardhësi i numrit të përmendur. Nëse përgjigjet saktë, ai thotë numrin dhe thërret nxënësin në vazhdim. Loja mund të përsëritet me gjetjen e paraardhësit.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 5, Loja "Roboti mbledhës"

Nxënësit mësojnë sesi funksionon roboti mbledhës. Në fillim të makinës llogaritëse është rrethi i kaltër, ku arrijnë numrat nga tabela, ndërsa pas "kalimit" nëpër makinë, në dalje, përftohet numri në rrethin e kuq, të cilin nxënësit e shkruajnë në tabelë.

Për shembull: Numri i parë në tabelë është 4. Numri 4 arrin deri tek kushti i krahasimit me numrin 5. Meqë $4 < 5$, zbatohet përgjigja "po" dhe në këtë rast roboti mbledhës i shton numrit 4 numrin 1. Roboti mbledhës e shkruan numrin 5 në rrethin e kuq. Nxënësit e shkruajnë përgjigjen në tabelë.

Nxënësit e përshkruajnë me fjalë procesin që kryen "makina e llogaritjes": për numrat më të vegjël se 5, roboti mbledhës cakton pasardhësin, ndërsa për numrat që nuk janë më të vegjël se 5, cakton paraardhësin.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 6 e 7

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 12: "Përralla për zeron"

Shënim: Përrallat u pëlqejnë të gjithëve, ndërsa veçmas fëmijëve. Ato mund të shfrytëzohen në orën e mësimin të matematikës për përsëritjen ose për përforcimin e një kapitulli mësimi. Pikërisht për këtë gjë shërben "Përralla për zeron".

Udhëzim: Puna me përrallën mund të jetë e ndryshme:

- pas leximit të përrallës, nxënësit u përgjigjen pyetjeve që bëhen;
- në faza të ndryshme nxënësit e vazhdojnë rrëfimin.

Po përmendim disa pyetje, të cilat mund t'u bëhen nxënësve gjatë kohës që u rrëfëhet përralla.

Përralla për zeron

"Larg, shumë larg, përtej deteve e maleve, ka qenë vendi i quajtur Shifrari. Në të jetonin numra shumë të singertë. Vetëm Zeroja dallohej prej të tjerëve me përtacinë dhe me mos sinqeritetin e vet."



- Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: Pse ky vend quhej Shifrari? Sa banorë ka ky vend?

“Një herë mësuan të gjithë, se tutje, larg shkretëtirës, jetonte mbretëreshë Aritmetika, e cila i ftonte banorët e Shifrarisë të vinin me shërbim tek ajo. T’i shërbenin mbretëreshës dëshironin të gjithë. Midis Shifrarisë dhe Mbretërisë së Aritmetikës shtrihej shkretëtira, e cila përshkohej nga dy lumenj: nga lumi Mbledhja dhe nga lumi Zbritja. Si të arrihej deri tek Mbretëria e Aritmetikës? Shifrat vendosën të bashkohen dhe të përpiqen ta kalojnë së bashku shkretëtirën.”

Pas kësaj pjese të përrallës, nxënësit u përgjigjen pyetjeve më poshtë: Me çfarë merret mbretëreshë Aritmetika në matematikë?

Zgjidhja: Aritmetika merret me numrat dhe me veprimet e njehsimit lidhur me to.

Cilët lumenj e ndajnë vendin Shifrari dhe Mbretërinë e Aritmetikës? Me ç’emër të përbashkët mund t’i quani këta dy lumenj?

Zgjidhja: Fjala është për veprimet.

Kush përgatitet të kalojë nëpër shkretëtirë:

Zgjidhja: shifrat

“Herët në mëngjes, shifrat u nisën për udhë. Udhëtuan gjatë nën një diell përvëlues dhe më në fund arritën tek lumi Mbledhja. Shifrat nxituan drejt lumit që të pinin, por lumi u tha: “Ndahuni në çifte dhe gjeni shumën, atëherë do t’u jap pijen”. Të gjitha shifrat e dëgjuan lumin. Dëshirën e lumit e plotësoi edhe zeroja përtace, por numri me të cilin formoi shumën mbeti i pakënaqur; në të vërtetë lumi jepte aq ujë sa njëshe kishte në shumë. Ndërsa shuma me zeron nuk dallohet nga numri që mblidhet me zeron.”

Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Pse ka mbetur i pakënaqur numri që u vendos me zeron?

“Dielli djeg edhe më shumë: Arritën tek lumi Zbritja. Ai kërkoi gjithashtu që ta paguanin ujin: “Ndahuni në çifte dhe gjeni ndryshesën midis numrit më të madh dhe numrit më të vogël. Tek kush të jetë përgjigja më e vogël, ai do të marrë më shumë ujë.” Përsëri, numri që qëndronte së bashku me zeron, doli me humbje dhe ishte i shqetësuar.

Nxënësit thonë dy shembuj që ilustrojnë fjalët e përrallës: “Ndahuni në çifte dhe gjeni ndryshesën midis numrit më të madh dhe numrit më të vogël. Tek kush të jetë përgjigja më e vogël, ai do të marrë më shumë ujë.”

Ata u përgjigjen pyetjeve: Pse doli me humbje numri që qëndronte me zeron? A mund të formojnë numrat çiftet e tilla që çdo çift të ketë vlerë të barabartë?

$$(9-4=8-3=7-2=6-1=5-0)$$

“Është e vërtetë se mbretëreshë Aritmetika i pajtoi të gjitha shifrat me zeron. Ajo thjeshtë filloi ta shkruante zeron pas numrit, i cili në këtë mënyrë zmadhohej shumë. Që atëherë numrat jetojnë të lumtur e të gëzuar.”



24. MONEDHAT: 1, 2, 5, 10 DHE 20 EURO

QËLLIMET

Nxënësit:

- njohin monedhat metalike dhe kartëmonedhat (1, 2, 5, 10 dhe 20 euro);
- njohin vlerat e monedhave dhe relacionet midis tyre;
- dallojnë vlerat e monedhave;
- dinë të paguajnë me të holla.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit dëgjojnë gjëegjëzën dhe përipiqen t'i përgjigjen pyetjes: Kush jam unë?

"Letër jam që shumë vlen,
Gjithkush mua më kursen." (Kartëmonedha)

Nxënësit njihen me monedhat metalike prej 1 dhe 2 euro dhe me kartëmonedhat prej 5, 10 dhe 20 euro. Nxënësit bisedojnë për blerjen dhe për vlerën e monedhave.

Shënim: Nxënësit do ta kuptojnë lehtë vlerën e monedhave, por duhet të këmbëngulet në njehsimin e numrit të përgjithshëm të eurove në bazë të figurave dhe të materialit konkret.

Veprimtaria 2: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore **Kultura e artit figurativ.**

Shënim: Nxënësit, para njohjes me këtë temë mësimi, në orën e mësimin të Kulturës së artit figurativ ose të veprimtarive të lira, bëjnë modele kartëmonedhash e monedhash metalike që do t'i përdorin si material didaktik.

Mësues-i/ja luan rolin e shitës-it/es dhe shet mjetet mësimore. Në banak janë librat. Çmimi i një libri është 20 euro. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Me ç'kartëmonedha e monedha metalike mund ta paguani librin? Ata i kanë aplikimet e monedhave dhe përgjigjen

Me 1 kartëmonedhë prej ___ eurosh.

Me 1 kartëmonedhë prej ___ eurosh dhe me 2 kartëmonedha prej ___ eurosh.

Me 10 monedha metalike prej ___ eurosh.

Me 2 kartëmonedha prej ___ eurosh.

Me 4 kartëmonedha prej ___ eurosh.

Me 20 monedha metalike prej ___ eurosh.

Veprimtaria 3: Loja "Në dyqan"

Udhëzim: Para nxënësve janë sende të ndryshme: lapsa, goma, stilolapsa etj. me kartonë të vegjël në të cilët janë shkruar çmimet.

Loja zhvillohet në çifte. Nxënësit kanë aplikimet në monedha metalike dhe në kartëmonedha. Një nxënës është blerësi, kurse tjetri është shitësi. Nxënësi i parë duhet t'i ndajë siç duhet monedhat për sendin që blen (ndarja siç duhet e monedhave nënkupton që nxënësi blerës të ofrojë sa duhet ose më shumë se ç'i duhen monedha për ta blerë sendin), kurse shitësi duhet t'i kthejë kusurin e duhur. Më pas, nxënësit i ndërrojnë rolet.



Teksti mësimor

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1 e 2

Nxënësit zgjidhin ushtrimin nr. 1 e 2, në të cilët shumat e përcaktuara të të hollave përfaqësojnë në disa mënyra ndihmën me monedha të ndryshme. Ushtrimin nr. 1 nxënësit e zgjidhin në fletoret e veta. Në ushtrimet me monedha ushtrohen njëkohësisht mbledhja dhe zbritja.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit njihen me artikujt ushqimorë që shiten në dyqane dhe me çmimet e tyre: biskotat kushtojnë 1 euro, gjevreku 1 euro, copa e tortës 2 euro, copa e pastës 2 euro, çokollata 1 euro, jogurti 1 euro, rostoja 2 euro dhe mishi i pulës 4 euro.

Shitësja ka dashur të dijë, se çfarë blejnë më shumë fëmijët dhe ka shënuar në tabelë çdo produkt të shitur. Nxënësve u rikujtohet se ndaj pyetjeve: "Çfarë kanë shitur më shumë? Çfarë kanë shitur më pak? është më e lehtë të përgjigjen, nëse të dhënat janë paraqitur në mënyrë grafike. Nxënësit njihen me mënyrën e re të paraqitjes së të dhënave: me ndihmën e figurave (i ashtuquajtur diagrami figurativ). Kjo gjë ndihmon në trajtimin më të qartë të të dhënave dhe në krahasimin e tyre.

Nxënësit studiojnë diagramin figurativ dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra.

Ushtrimi vazhdon me bërjen e veprimit të njehsimit.

Nxënësit shkruajnë çmimet e produkteve në vendin e caktuar dhe llogaritin, sesa duhet paguar gjithsej sipas çdo veprimi të njehsimit. Në fund të ushtrimit duhet të llogaritet edhe kusuri për çdo veprim njehsimi.

Veprimtaria 6: Kontroll i kuptimit të përmbajtjes

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet:

- Kam kartëmonedhën prej 5 eurosh dhe monedhën metalike prej 2 eurosh. Sa euro janë gjithsej?
- Kam 10 euro. Torta kushton 7 euro. Nëse e blej tortën, sa të holla më mbeten?
- Kam pasur 9 euro. Sa ka qenë kusuri, nëse çamçakëzët kanë kushtuar 3 euro?
- Kam blerë albumin për 6 euro dhe kam dhënë 4 monedha metalike. Ç'monedha metalike kam dhënë?



25. MBLEDHJA DHE ZBRITJA

QËLLIMET

Nxënësit:

- përdorin tabelën e mbledhjes për gjetjen e rezultatit të mbledhjes dhe të zbritjes;
- dallojnë lidhjen midis komponentëve e rezultateve të mbledhjes dhe të zbritjes.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit plotësojnë tabelën e mbledhjes së numrave nga 0 deri në 10. Duke plotësuar rreshtin e parë të tabelës, nxënësit njehsojnë shumat, tek të cilat mbledhësi i parë është zeroja.

Shënim: Dimë se shuma e 0 me cilindo numër është ky numri i dytë.

Në rreshtin e dytë, nxënësit njehsojnë shumat: $1 + 0 = 1$, $1 + 1 = 2$, $1 + 2 = 3$, $1 + 3 = 4$ etj. Kështu njehsojnë gjithnjë, deri sa vënë re, se shumat zmadhohen gradualisht për 1. Kjo gjë mundëson, që nxënësit të shkruajnë menjëherë vlerat e shumave të tjera në këtë rresht: 5, 6, 7, 8, 9, 10. Meqë gjatë ndërrimit të vendeve të mbledhësve shuma nuk ndryshon, plotësimi i rreshtit të parë jep edhe kolonën e parë.

Më tej, $2 + 0 = 2$, $2 + 1 = 3$, $2 + 2 = 4$ etj. Edhe në rreshtin e tretë numrat zmadhohen gjithashtu për 1. Kështu nxënësit plotësojnë gradualisht rresht pas rreshti, duke plotësuar njëkohësisht edhe kolonën përkatëse.

Udhëzim: Në figurë është paraqitur me ngjyrë blu, sesi, me ndihmën e tabelës, mund të përcaktohet shuma $4 + 2 = 6$. Duhet të gjendet numri që ndodhet në pikën e prerjes së rreshtit e të kolonës përkatëse. Nga rezultatet e përfuara pason se $4 + 2 = 6$, $6 - 2 = 4$, $6 - 4 = 2$. Domethënë, me ndihmën e tabelës së mbledhjes mund të kërkojmë jo vetëm shumat, por edhe ndryshesat.

Duke parë tabelën, nxënësit mund të vënë re rregullsitë interesante. Për shembull, nëse njëri nga mbledhësit nuk ndryshon, kurse tjetri zmadhohet për 1, atëherë shuma zmadhohet për 1. Domethënë, nëse një mbledhës zmadhohet për disa njësi, atëherë shuma zmadhohet për po aq njësi. Shumat e njëjta gjenden në "diagonale", sepse, nëse njërin mbledhës e zmadhojmë për disa njësi, ndërsa tjetrin e pakësojmë për të njëjtin numër të njëjësive, atëherë shuma nuk do të ndryshojë. Numrat 0, 2, 4, 6, 8, 10, që gjenden në "diagonalen" e dytë, përfaqësojnë shumat, tek të cilat dy mbledhësit kanë vlera të njëjta.

Shënim: Ligjësitë e dhëna nuk duhet t'u bëhen të ditura nxënësve në formë të gatshme. Mbajtja mend e rregullave formale nuk sjell rezultate të kapshme. Ka shumë më tepër rëndësi që nxënësit t'i zbulojnë vetë vetitë ekzistuese. Prandaj është më i mirë kufizimi në dy-tri veti, por edhe të organizohet puna në mënyrë të tillë, që këto veti të vihen re dhe t'u shfaqen vetë nxënësve.



Veprimtaria 2: Garë njehsimi

Në letra të përgatitura paraprakisht me shembuj me mbledhje dhe me zbritje (për çdo rresht veçmas), nxënësit e bankave të para të rreshtit, me dhënien e sinjalit, zgjidhin nga një shembull dhe ia përcjellin letrën nxënësit tjetër të rreshtit të vet. Fiton ai rresht, i cili i zgjidh saktë, më shpejt të gjithë shembujt.

Shembuj:

$5 + 2 = _ \quad 3 + 4 = _ \quad 2 + 7 = _$

$10 - 7 = _ \quad 10 - 4 = _ \quad 7 - 4 = _$

$8 - 5 = _ \quad 6 - 3 = _ \quad 6 + 4 = _$

$4 - 4 = _ \quad 8 - 0 = _ \quad 3 - 3 = _$

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit, duke u ndihmuar, e zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Gjatë zgjidhjes së shembujve, nxënësve duhet t'u tërhiqet vëmendja tek ligjësitë me të cilat janë të lidhura numrat në çdo kolonë.

Në kolonën e parë zbritësi zmadhohet gradualisht, ndërsa pastaj, po për kaq, zvogëlohet edhe mbledhësi. Kështu, në fillim përgjigjja zvogëlohet për 1, ndërsa pastaj zmadhohet për 1. Domethënë, tek të gjitha përgjigjet përftohen përgjigjet e barabarta.

Në kolonën e dytë përgjigjet zmadhohen për 1, për arsye se mbledhësi i parë zmadhohet për 1, kurse numrat e tjerë nuk ndryshojnë.

Në kolonën e tretë përgjigjet zvogëlohen për 1, për arsye se zbritësi zmadhohet gradualisht për 1.

Duke shfrytëzuar ligjësitë e vëna re, nxënësit mund t'i shkruajnë përgjigjet për shembujt në rreshtin e dytë dhe në rreshtin e tretë pa i bërë njehsimet. Kjo gjë demonstroi rëndësinë e përgjithësimeve matematike për zgjidhjen e ushtrimeve praktike: falë tyre zgjidhjet bëhen më të lehta dhe më të thjeshta.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit, mbi bazën e figurave, i ndërtojnë dhe i zgjidhin gojarisht problemat. Mësues-i/ja u ndihmon nxënësve që ta kuptojnë mënyrën e ndërtimit e të zgjidhjes së problemave me ndihmën e modeleve:

- Çfarë është vizatuar në figurë?
- Çfarë mund të gjejmë?
- Ç'veprim duhet të përdorim për zgjidhjen e problemës?
- Ndërto dhe shkruaj shprehjen numerike.
- Njehso dhe jep përgjigjen.

Për shembull: për figurën e parë problema mund të jetë e tillë: "Në liqen notonin 7 rosakë. Dy rosakë u lodhën dhe dolën të çlodhen pak. Sa rosakë vazhduan të notonin?"

Nxënësit e kuptojnë, se në fillim kanë notuar 7 rosakë, kurse pastaj janë larguar dy rosakë. Veçimi nga bashkësia e një pjese, shënohet me veprimin e zbritjes. Nxënësit ndërtojnë dhe shkruajnë shprehjen numerike $7 - 2$, njehsojnë dhe i japin përgjigje pyetjes: 5 rosakë vazhduan të notonin në liqen.

Shembulli i dytë me mbledhje. Ai mund të jetë i formuluar kështu: "Në telin telefonik po pushonin 8 dallëndyshe. Atyre iu bashkuan edhe dy dallëndyshe. Sa dallëndyshe janë ulur gjithsej në telin telefonik?"



Pasi që ta ndërtojnë problemën, nxënësit shkruajnë shprehjen numerike dhe njehsojnë vlerën e saj dhe japin përgjigjen. Rikujtohen se, kur është fjala për bashkimin e grupit të sendeve dhe të qenieve, atëherë në këtë rast përdorim veprimin e njehsimit të mbledhjes.

Vepimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit e plotësojnë tabelën duke u ndihmuar.

Shënim: Nxënësit janë ndeshur tashmë me një tabelë të ngjashme, por në këtë rast duhet të përcaktohet fillimisht veprimi i njehsimit, ndërsa pas kësaj ta plotësojnë tabelën.

Udhëzim: Në tabelën e parë nxënësit shohin numrat e dhënë në rreshtin e parë, në kolonën e parë, numrat që gjenden në vendin e prerjes së kolonës së parë dhe të rreshtit të tretë dhe arrijnë në përfundimin se $4 + 5 = 9$. Domethënë, fjala është për veprimin e njehsimit të mbledhjes dhe shkruajnë në drejtkëndëshin sipër, majtas, shenjën $+$. Tani në kolonën e parë dhe në rreshtin e parë gjenden mbledhësit, kurse në vendin e prerjes së rreshtit e të kolonës përkatëse gjenden shumat. Mbi bazën e shumave të njohura, nxënësit gjejnë fillimisht mbledhësit e panjohur dhe plotësojnë rreshtin e parë dhe kolonën e parë, ndërsa pastaj kërkojnë edhe shumat e tjera.

Në tabelën e dytë, nxënësit shohin numrat e kolonës së parë dhe të rreshtit e parë, duke vënë re, se në vendin e prerjes të kolonës së dytë dhe të rreshtit të dytë qëndron numri 4, gjë që tregon, se fjala është për veprimin e njehsimit të zbritjes: $6 - 2 = 4$. Kontrolli i të dhënave të tjera konfirmon përfundimin e nxjerrë nga nxënësit. Nxënësit shkruajnë në drejtkëndëshin sipër majtas shenjën e veprimit të njehsimit të zbritjes $-$. Domethënë, në kolonën e parë gjendet i zbritshmi, kurse në rreshtin e parë gjendet zbritësi. Mbi bazën e ndryshimeve të dhëna, nxënësit gjejnë fillimisht zbritësin e panjohur dhe plotësojnë rreshtin e parë. Në fund, gjejnë ndryshesën që shkruhet në vendin e prerjes të rreshtit dhe të kolonës, në të cilën gjenden numrat përkatës.

Vepimtaria 6: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit krahasojnë gjatësitë dhe vërejnë, se mjafton t'i krahasojnë numrat përkatës dhe shprehjet numerike, duke pasur kujdes se gjatësitë janë të shprehura me të njëjtat njësi matëse.

Vepimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit masin me ndihmën e vizes gjatësitë e të gjitha segmenteve dhe gjejnë gjatësinë e rrugës.

I $3 \text{ cm} + 3 \text{ cm} + 2 \text{ cm} = 8 \text{ cm}$

II 7 cm

III $2 \text{ cm} + 1 \text{ cm} + 4 \text{ cm} + 2 \text{ cm} = 9 \text{ cm}$

Nxënësit vënë re, se gjatësia e segmentit është më e vogël se gjatësia e çdo lloj vije tjetër që lidh skajet e tij.

Vepimtaria 8: Ushtrimi nr. 6

Shënim: Në këtë ushtrim, nxënësit ndeshen përsëri me ushtrimin me kombinim me ndërrim. Fillimisht, nxënësit rikujtojnë dhe përsëritin vetë procesin e zhvendosjes (ndërrimit): një element fiksohet, kurse dy të tjerët zhvendosen. Në fund duhet të jenë 6 mënyra të ndryshme ngjyrosjeje.

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Vepimtaria 9: Puna në stacione

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna.

Udhëzim: Nxënësit ndahen në katër grupe. Në 4 tavolina janë 4 fletët me ushtrime, të cilat duhet të kalojnë dhe të zgjidhen nga të gjitha grupet.



Shembuj

Stacioni i parë	Stacioni i dytë	Stacioni i tretë	Stacioni i katërt
$6 + 2 = \underline{\quad}$	$4 + 2 = \underline{\quad}$	$1 + 6 = \underline{\quad}$	$9 - 6 = \underline{\quad}$
$9 - 5 = \underline{\quad}$	$10 - 7 = \underline{\quad}$	$5 - 2 = \underline{\quad}$	$10 - 9 = \underline{\quad}$
$7 - 4 = \underline{\quad}$	$8 - 4 = \underline{\quad}$	$10 - 6 = \underline{\quad}$	$6 + 3 = \underline{\quad}$
$3 - 3 = \underline{\quad}$	$5 - 0 = \underline{\quad}$	$3 - 0 = \underline{\quad}$	$7 - 7 = \underline{\quad}$

Shënim: Të gjitha grupet duhet të kalojnë nëpër të gjitha stacionet.



26. NUMRAT ME NJË SHIFËR DHE NUMRAT ME DY SHIFRA DERI NË 20

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë nocionin e numrit me një shifër dhe të numrit me dy shifra të dhjetëshes së parë e të dhjetëshes së dytë;
- dallojnë vlerën e vendit të shifrës pa bërë përkufizimin;
- dallojnë numrat çift e numrat tek deri në 20;
- dinë të numërojnë në bashkësinë e numrave çift (tek) nga 0 deri në 20.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuha shqipe dhe letërsia

Në dërrasë të zezë janë shkruar dy numra, për shembull: 8 dhe 15. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: “Në ç’gjë ndryshon shkrimi i numrit 8 nga shkrimi i numrit 15?”

Bëhet analogjia me shkrimin e fjalëve.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë përdorim për shkrimin e fjalëve? (Nxënësve u rikujtohet, se për shkrimin e fjalëve përdoren shkronjat dhe se shkronjat në gjuhë janë shenjat për shkrimin e tingujve).
- Çfarë përdorim për shkrimin e numrave? (Nxënësve u rikujtohet, se për shkrimin e numrave përdoren shifrat dhe se numrat shkruhen me shifra: Shembull: numri 8 shkruhet me shifrën 8, kurse numri 15 shkruhet me ndihmën e dy shifrave: 1 dhe 5.
- Sa shifra janë gjithsej?

Nxënësit nxjerrin përfundimin, se me ndihmën e këtyre shifrave mund të shkruajmë çdo numër.

Nxënësit njihen me faktin, se numrat që shkruhen me një shifër, quhen edhe *numra njëshifrorë*, ndërsa numrat që shkruhen me dy shifra, quhen edhe *numra dyshifrorë*.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: figura ilustruese hyrëse, Loja “Goglat”

Në një pe janë përshkuar goglat. Nxënësit shkruajnë numrat e duhur në rrathët bosh.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Në ç’gjë ndryshojnë numrat e shkruar në goglat jeshile nga numrat e shkruar në goglat e kaltra?
- Emërtoni numrin më të madh me një shifër?
- Si e përftojmë numrin në vazhdim. Cili është ky numër?
- Pse quhet ai numër me dy shifra ose numër dyshifror?
- Cili është numri më i vogël me një shifër?
- Kam menduar numrin me një shifër për një më të vogël, sesa numri më i vogël me dy shifra. Cili është ky numër?
- Cili është pasardhësi i numrit në të madh me një shifër?
- Cili është paraardhësi i numrit më të vogël me dy shifra?

**Veprimtaria 3:**

Nxënësit i sistemojnë numrat deri në njëzet të dhjetëshes së parë e të dhjetëshes së dytë. Fillimisht emërtojnë numrat e dhjetëshes së parë dhe i shkruajnë ato (1, 2, ..., 10), pastaj emërtojnë numrat e dhjetëshes së dytë dhe i shkruajnë ato (11, 12, ..., 20).

Shënim: Nxënësit gabojnë shpesh në përcaktimin e numrit të parë e të fundit të një dhjetëshe, prandaj, për këtë arsye, ka rëndësi që të përvetësojnë e të mbajnë mend mirë numrat e dhjetëshes së parë dhe numrat e dhjetëshes së dytë. Më vonë, gjatë punës, atyre u duhet kujtuar herë pas here kjo gjë dhe duhet t'u jepen ushtrimet, tek të cilat do të përmenden numri më i vogël dhe numri më i madh i dhjetëshes së parë ose i dhjetëshes së dytë.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit shohin paraqitjen grafike të numrave. Dhjetë kube janë grumbulluar së bashku dhe përfaqësojnë dhjetëshen. Kubet e veçanta janë njëshet.

Mbi bazën e figurave, nxënësit i shkruajnë numrat që janë të paraqitur në tabelë.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit njihen me numëratoren me gogla, mjetin që kanë përdorur më parë njerëzit për njehsim. Numërorja jonë ka dy shufra, në të cilat mund të vihen dhjetë gogla. Shufra e parë përfaqëson dhjetëshet, kurse e dyta përfaqëson njëshet. Në çdo shufër mund të vihen vetëm 9 gogla. Nëse do të mund të vihej edhe një rruazë, prej tyre do të ishin 10. Ndërkohë, dhjetë në numëratoren me gogla paraqitet si 1 dhjetëshe dhe 0 njëshe = 10, d.m.th. një rruazë në shufrën e parë përfaqëson numrin 10. Me ndihmën e numëratores me gogla, nxënësit njihen me idenë e sistemit dhjetor pozicional dhe vërejnë se po e njëjta shifër përfaqëson vlera të ndryshme në varësi të pozicionit (vendit) të vet në kuadër të shkrimit të numrit. Këtë gjë e demonstroi shumë mirë numërorja, për shembull, 1 gogël në shufrën e parë shënon numrin 10, kurse 1 në shufrën e parë shënon numrin 1.

Nxënësit shkruajnë numrat që janë paraqitur në numëratoren me gogla ose që tregojnë numrat e ndryshëm me anë të numëratores me gogla.

Veprimtaria 6: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik

Si përgatitje për përvetësimin e nocionit numër çift dhe numër tek mund të shërbejnë orët e mësimi të lëndës mësimore të Edukimit fizik, për shembull: "Gjej çiftin" (nxënësit qëndrojnë në grup dhe me dhënien e sinjalit nisin të vrapojnë, ndërsa me sinjalin për të cilin kanë rënë dakord gjejnë çiftin; numërohen çiftet dhe sa nxënës janë në një, në dy apo në tri çifte).

Nxënësit thonë situatat, kur përdoren fjalët çift e tek (çift janë një palë çorape, një palë këpucë sportive etj.).

Veprimtaria 7:

Kjo veprimtari mund të organizohet në çifte. Çiftit të parë i jepen 2 zhetonë, çiftit të dytë i jepen 3 zhetonë, çiftit të tretë i jepen 4 zhetonë, çiftit të katërt i jepen 5 zhetonë e kështu me radhë. Nxënësit në çifte duhet t'i ndajnë zhetonët, në mënyrë që çdo nxënës në çift t'i jepet numri i barabartë i zhetonëve.

Pas përfundimit të veprimtarisë, nxënësit nxjerrin përfundimin, se disa çifte kanë arritur t'i ndajnë zhetonët në mënyrë proporcionale, kurse disa nuk kanë mundur ta bëjnë këtë gjë. Ata shkruajnë shprehjet numerike vetëm të atyre çifteve, që kanë arritur t'i ndajnë zhetonët në formën e shumës së numrave të barabartë:

$$2 = 1 + 1, \quad 4 = 2 + 2, \quad 6 = 3 + 3, \quad 8 = 4 + 4,$$

$$10 = 5 + 5, \quad 12 = 6 + 6, \quad 14 = 7 + 7, \quad 16 = 8 + 8$$

Shënim: Në fund, duhet të nxirret përfundimi, se numrat që kemi shkruar si shuma të mbledhësve të barabartë, quhen numra çift, ndërsa numrat e tjerë quhen numra tek.

**Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 3 e 4**

Në **ushtrimin nr. 3**, nxënësit vënë re vendin e numrave çift dhe i shkruajnë numrat përkatës në rrathët bosh. Ata mund t'u përgjigjen pyetjeve më poshtë, ndërsa lidhur me këtë ushtrim:

- Kam menduar një numër çift. Numri është më i vogël se numri 18 dhe më i madh se numri 14. Cili është ky numër?
- Sa këmbë kanë dy elefantë? Po katër pula? Sa veshë kanë pesë lepuj?

Në **ushtrimin nr. 4**, nxënësit shohin lepurin, i cili, për të ikur më shpejt nga ujku, ka vendosur t'i kapërcejë katrorët e bardhë. Nxënësit shënojnë kërcimet e lepurit, shkruajnë numrat në katrorët e verdhë dhe plotësojnë tabelën e numrave çift dhe të numrave tek deri në 20.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet në mënyrë të pavarur.

Veprimtaria 10: "Gara e numrave me një shifër dhe e numrave me dy shifra"

Nxënësit janë ndarë në dy kolona. Para çdo kolone është tavolina, ku gjenden kanistrat, në të cilat janë përzier numrat me një shifër dhe numrat me dy shifra deri në 20. Në fund të çdo kolone janë vendosur tavolinat, ku janë dy kuti boshe. Një kuti është për numrat me një shifër, kurse kutia tjetër është për numrat me dy shifra. Në kanistrat me numra, nxënësit duke vrapuar tërheqin me radhë numrin dhe gjejnë kutinë përkatëse, respektivisht kutinë së cilës i përket ky numër. Fitues është grupi që kryen më shpejt ushtrimin.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit studiojnë pesë bashkësi numrash dhe kërkojnë në bashkësi elementin që nuk i përket grupit.

Zgjidhja: Në bashkësinë e parë janë dy numra me një shifër dhe tre numra me dy shifra, prej të cilëve pesë numra janë tek dhe një numër është çift. Domethënë, grupit nuk i përket numri 14, i cili është i vetmi numër çift në bashkësinë e parë.

Në bashkësinë e dytë janë tre numra me një shifër dhe dy numra me dy shifra, prej të cilëve katër numra janë çift dhe një numër është tek. Domethënë, grupit nuk i përket numri 7, i cili është i vetmi numër tek në bashkësinë e dytë.

Në bashkësinë e tretë janë katër numra me një shifër dhe një numër me dy shifra, prej të cilëve tre numra janë çift dhe dy numra janë tek. Domethënë, grupit nuk i përket numri 6, i cili është i vetmi numër me një shifër në bashkësinë e tretë.

Në bashkësinë e katërt janë katër numra me një shifër dhe një numër me dy shifra, prej të cilëve dy numra janë çift dhe tre numra janë tek. Domethënë, grupit nuk i përket numri 11, i cili është i vetmi numër me dy shifra në bashkësinë e katërt.

Në bashkësinë e pestë janë tre numra me dy shifra dhe dy numra me një shifër, prej të cilëve dy numra janë çift dhe tre numra janë tek. Domethënë, grupit nuk i përket numri 9, i cili është i vetmi numër tek.

Veprimtaria 12:

Në kartonët e përgatitur janë shkruar numrat deri në 20; në çdo karton nga një numër. Nxënësve u jepet nga një karton.

Nxënësit:

- renditin numrat në drejtimin mbarë dhe mbrapsht;
- formojnë dy grupe nxënësish; njërin grup e bëjnë nxënësit që kanë numra me një shifër, kurse tjetrin e bëjnë nxënësit që kanë numra me dy shifra;
- formojnë dy grupe nxënësish; njërin grup e bëjnë nxënësit që kanë numra çift, kurse tjetrin e bëjnë nxënësit që kanë numra tek;



- formojnë dy grupe nxënësish; njërin grup e bëjnë nxënësit që kanë numra të dhjetëshes së parë, kurse grupin tjetër e bëjnë nxënësit që kanë numrat e dhjetëshes së dytë;
- nxënësi që ka numrin 15 del para dërrasës së zezë, ndërsa pastaj dalin nxënësit në kartonët e të cilëve është paraardhësi dhe pasardhësi u numrit 15.

Veprimtaria 13:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet:

1. Në vargun e dhënë, qarko numrin më të vogël të dhjetëshes së dytë:
10, 11, 16, 5, 18, 15, 19
2. Në vargun e dhënë, qarko numrin më të madh të dhjetëshes së dytë:
13, 9, 17, 12, 14, 20, 19
3. Qarko numrat që nuk i përkasin dhjetëshes së dytë:
8, 19, 11, 6, 10, 17, 13, 15.
4. Vazhdoje vargun e numrave:
12, 14, __, __, __
19, 17, __, __, __

Veprimtaria 14: Loja "Gjej numrin"

Nxënësi tërheq kartonin me numër dhe thotë disa të dhëna për këtë numër; për shembull:

- Ky është numër çift i dhjetëshes së dytë, që është paraardhësi i numrit 13.

Nxënësit e tjerë e gjejnë, se cili është ky numër.



27. DHJETËSHET E QINDËSHES SË PARË

QËLLIMET

Nxënësit:

- vënë re nevojën e futjes së njësisë më të madhe të numërimit;
- formojnë përfytyrimin për njësinë më të madhe të numërimit - dhjetëshen;
- njohin njësinë e re të numërimit;
- lexojnë dhe shkruajnë dhjetëshet e qindëshes së parë;
- aftësohen për numërimin e dhjetësheve deri në 100;
- zotërojnë mbledhjen me gojë brenda qindëshes së parë duke përdorur analogjinë;
- krahasojnë dhjetëshet e qindëshes së parë; përdorin shenjat $<$, $>$, $=$.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria hyrëse:

Nxënësit punojnë në grupe. Për çdo grup janë përgatitur prej 4 deri në 6 kuti me numër të njëjtë lapsash me ngjyrë (për shembull, me nga 10, 12 lapsa me ngjyrë). Lapsat me ngjyrë janë të nxjerrë nga kutitë (kutitë mbeten në tavolinë). Grupeve u jepet detyrë që, brenda një kohe të shkurtër, (për shembull, një minutë) të gjejnë, sesa lapsa me ngjyrë janë. Nxënësit ndeshen me problemin: janë shumë sende që duhen numëruar shpejt. Lidhur me këtë shtrohet pyetja: të mendohet mënyra e numërimit të shpejtë të një numri të madh sendesh.

Shënim: Këtë detyrë do ta zgjidhin me sukses nxënësit që ndërmarrin strategjinë më poshtë: i kthejnë lapsat me ngjyrë në kuti dhe numërojnë kutitë.

Nëse askush nga nxënësit nuk kujtohet t'i mbushë kutitë dhe të numërojë me kuti, mësues-i/ja ua sugjeron këtë ide dhe i vizaton kutitë në dërrasë të zezë.



Në vazhdim, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Sa kuti me lapsa me ngjyrë ka grupi i 1^{-të}? Sa kuti me lapsa me ngjyrë ka grupi i 2^{-të}? Sa kuti me lapsa me ngjyrë ka grupi i 3^{-të}?
- Si do ta shkruajmë rezultatin e numërimit tonë? (5 kuti. Shënim: Përveç rezultatit të numërimit, duhet të shënohet gjithmonë edhe emërtimi i njësisë matëse që kemi përdorur gjatë numërimit të sendeve; numrat e emërtuar.)
- Cili është kuptimi i njësisë më të madhe të numërimit? (Shënim: Disa sende të veçanta bashkohen në grupe të barabarta për nga madhësia dhe, falë kësaj, ato mund të numërohen më lehtë.)




- A dini disa shembuj nga jeta, tek të cilët përdoren njësitë më të mëdha të numërimit? (Për shembull: për njëzet vezë thuhet nganjëherë duzinë vezësh. Dhe përgjithësisht, 12 njësi të ndryshme quhen duzinë.

Veprimtaria 1:

Shënim: Nxënësit njohin njësinë e re matëse; dhjetëshen.

Nxënësit janë bindur për domosdoshmërinë e futjes në përdorim të njësisë së përbashkët të numërimit për të gjithë. Është e natyrshme, që masën ta lidhim me numrin 10, sepse njerëzit kanë përdorur gishtërinjtë e të dyja duarve si mjet numërimi.

Nxënësit numërojnë 10 shkopinj dhe i lidhin në tufë.



Ata u përgjigjen pyetjeve:

- Sa shkopinj janë në tufa? (Shënim: dhjetë shkopinj ose 1 dhjetëshe).

Pastaj shtohet edhe një tufë; 2 dhjetëshe; pastaj edhe një tufë; 3 dhjetëshe, 4 dhjetëshe, ..., dhjetëshe, ..., 10 dhjetëshe dhe nxënësit thonë së bashku njëzëri: "Një dhjetëshe, dy dhjetëshe, tri dhjetëshe ...".

Pastaj hiqen tufat një nga një, ndërsa nxënësit ushtrohen për numërimin në drejtim të kundërt duke filluar nga 10 dhjetëshe.

Shënim: Zotërimi i nocioneve dhjetëshe dhe njëshe mund të paraqesë vështirësi të caktuara për fillestarët, sepse dhjetë tregon njëkohësisht 10 njëshe dhe 1 dhjetëshe. Me fjalë të tjera, nocioni "një" që kishte të bënte më parë me sendet nga një, tani mund të ketë të bëjë edhe me grupin e sendeve; një dhjetëshe.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit lexojnë dhe shkruajnë dhjetëshet e qindëshes së parë.

Udhëzim: Ndërtimi i modeleve grafike tregon analogjinë midis numrave me një shifër dhe dhjetëshëve. Mësimi i nocionit të ri kthehet kështu në një material tashmë të njohur.

Nxënësit shohin paraqitjen e dhjetëshëve të qindëshes së parë në Tekstin mësimor. Ata shkruajnë në fletore dhjetëshet e qindëshes së parë me numra dhe me fjalë.

Në **dy** vende nga 10: dy-dhjetë = **njëzet**; 2 dh = 20.

Në **tri** vende nga 10: tri-dhjetë = **tridhjetë**; 3 dh = 30.

Në **katër** vende nga 10: katër-dhjetë = **dyzet**; 4 dh = 40.

Në **pesë** vende nga 10: pesë-dhjetë = **pesëdhjetë**; 5 dh = 50.

Në **gjashtë** vende nga 10: gjashtë-dhjetë = **gjashtëdhjetë**; 6 dh = 60.

Në **shtatë** vende nga 10: shtatë-dhjetë = **shtatëdhjetë**; 7 dh = 70.

Në **tetë** vende nga 10: tetë-dhjetë = **tetëdhjetë**; 8 dh = 80.

Në **nëntë** vende nga 10: nëntë-dhjetë = **nëntëdhjetë**; 9 dh = 90.

Në **dhjetë** vende nga 10: dhjetë-dhjetëshe = **njëqind**; 10 dh = 100.

Nxënësit i numërojnë dhjetëshet e qindëshes së parë në drejtimin mbarë: 10, 20, ... dhe në drejtimin mbrapsht: 100, 90, ...

**Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1, 2 e 3**

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet e Tekstit mësimor

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4 dhe 5

Tek **ushtrimi nr. 4**, nxënësit plotësojnë rrathët dhe njohin radhën e dhjetësheve të qindëshes së parë në segmentin numerik. Pas kësaj, ata zgjidhin ushtrimet në dërrasë të zezë:

1. Shkruaj dhjetëshet që i paraprijnë ose që e pasojnë dhjetëshen e dhënë:

___, 40, ___; ___, 70, ___; ___, 20, ___; ___, 90, ___

2. Shkruaj dhjetëshet që mungojnë:

___, 20, ___, ___, 50, ___, ___, 80, ___, 100.

3. Shkruaj dhjetëshet e qindëshes së parë që janë më të mëdha se 30, por më të vogla se 80.
4. Shkruaj të gjitha dhjetëshet që gjenden midis 20 dhe 60.

Tek **ushtrimi nr. 5**, nxënësit i renditin dhjetëshet nga më e madhja deri tek më e vogla.

Veprimtaria 5: Loja “Dhjetëshet”

Nxënësve u ndahen kartonët, në të cilët janë shkruar dhjetëshet e qindëshes së parë.

Çdo nxënësi i jepet nga një dhjetëshe.

Në dërrasë të zezë shkruhet, për shembull, numri 70. Me dhënien e sinjalit, nxënësit që kanë:

1. dhjetëshen paraprijëse;
2. dhjetëshen më të vogël;
3. dhjetëshen në vazhdim;
4. dhjetëshen më të madhe;
5. dhjetëshen që gjendet midis 30 dhe 70;

duhet të vijnë shpejt tek dërrasa e zezë.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6 e 7

Në dërrasë të zezë janë shkruar numrat:

$$3 + 6 = \quad \quad \quad 8 - 3 =$$

$$3dh + 6 dh = \quad \quad \quad 8dh - 3 dh =$$

$$30 + 60 = \quad \quad \quad 80 - 30 =$$

Nxënësit i zgjidhin shembujt dhe arrijnë në përfundimin, se dhjetëshet mbliidhen dhe zbriten në të njëjtën mënyrë sikurse mbliidhen edhe njëshet.

Pas kësaj, ata zgjidhin në mënyrë të pavarur **ushtrimin nr. 6 e 7** në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 7: Kontroll i kuptimit të përmbajtjes

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet më fletën e përgatitur të punës:

1. Shkruaj me fjalë dhjetëshet: 30, 60, 90.
2. Shkruaj dhjetëshet që mungojnë:
10, ___, ___, ___, 50, ___, ___, ___, ___, ___.
3. Shkruaj numrat që kanë: 6 Dh = ___, 8 Dh = ___, 40 Nj = ___.
4. Shkruaj shenjat <, >, =:

$$30 _ 20, 40 _ 80, \quad 5Dh _ 50,$$

$$90 _ 100, \quad 7 _ 70, \quad 6Dh _ 6 Nj$$



28. Mbledhja dhe zbritja e dhjetësheve

QËLLIMET

Nxënësit:

- zotërojnë veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes me gojë të dhjetësheve brenda qindëseshes së parë duke përdorur analogjinë;
- dallojnë lidhjen midis mbledhjes dhe zbritjes.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Shumëkatëshi"

Nxënësit ndahen në 4 grupe. Çdo grup ka 10 aplikime që përfaqësojnë dhjetëshet e qindëseshes së parë. Çdo dhjetëshe përfaqëson një kat. Detyrë e çdo grupi është që ta ndërtojë sa më shpejt shumëkatëshin prej 10 katesh, duke i ngjitur aplikimet me dhjetëshe deri në 100.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Bonbonet janë grupuar me nga 10 në një pako të madhe. Nxënësit bëjnë mbledhjen e pakove të mëdha dhe shkruajnë:

$$3 + 2 = 5, \quad 3 \text{ dh} + 2 \text{ dh} = 5 \text{ dh}, \quad 30 + 20 = 50,$$

duke u bindur kështu, se mënyra e mbledhjes së dhjetësheve është analoge me mbledhjen e njësheve.

Pas kësaj veprimtarie, nxënësit, fillimisht gojarisht dhe pastaj me shkrim, zgjidhin disa ushtrime:

Shembull:

$$\begin{array}{ll} 5 + 2 = & 9 - 6 = \\ 5 \text{ dh} + 2 \text{ dh} = & 9 \text{ dh} - 6 \text{ dh} = \\ 50 + 20 = & 90 - 60 = \end{array}$$

Veprimtaria 3:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet me figura ilustruese.

Udhëzim: Në ushtrimin e parë, nxënësit shohin figurën, në të cilën janë vizatuar dy tavolina me pasta. Në tavolinën e parë janë 40 pasta, kurse në tavolinën e dytë janë 30 pasta. Ata i përgjigjen pyetjes:

"Si do ta gjejmë, se sa pasta janë gjithsej në të dyja tavolinat?" Nxënësit e zgjidhin ushtrimin e dhënë. Ata mbledhin $40 + 30$.

Nxënësve u shpjegohet se, nëse $4 \text{ nj} + 3 \text{ nj} = 7 \text{ nj}$, atëherë $4 \text{ dh} + 3 \text{ dh} = 7 \text{ dh}$, përkatësisht $40 + 30 = 70$

Nxënësit shohin figurën, në të cilën janë 70 pasta në tavolinë. Ata i përgjigjen pyetjes:

"Si do ta gjejmë, se sa pasta mbeten në tavolinë, nëse fëmijët kanë ngrënë 50 pasta.

Nxënësit nxjerrin përfundimin, se nga 70 duhet të zbritet 50.

Nxënësve u shpjegohet se, nëse $7 \text{ nj} - 5 \text{ nj} = 2 \text{ nj}$, atëherë $7 \text{ dh} - 5 \text{ dh} = 2 \text{ dh}$, përkatësisht $70 - 50 = 20$.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1, 2, 3 e 4**

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 5:

Para nxënësve janë kanistrat me numrat: 10, 20, 30, 40, 50, 60, 70, 80 dhe 90. Nxënësit i nxjerrin nga kanistra e parë numrat, përkatësisht skedat me numra dhe gjejnë të gjitha kombinimet e numrave, shuma e të cilave është 100.

Në kanistrën e dytë janë numrat më poshtë: 30, 40, 50, 60, 70 dhe 80. Në të njëjtën mënyrë, domethënë duke i nxjerrë numrat nga kanistra, nxënësit duhet të gjejnë të gjitha kombinimet e numrave, ndryshesa e të cilave është numri 20.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit, duke u ndihmuar, e zgjidhin ushtrimin më poshtë:

Në rrethin e qitësve, nxënësit kanë qëlluar në objektiv me pushkë sportive. Çdo nxënës ka qëlluar tri herë dhe asnjëri nuk ka gabuar.


Udhëzim: Duhet paraqitur numri 70 si shuma e tre mbledhësve, të cilët duhen kërkuar midis numrave 20, 30 dhe 50. Kjo gjë mund të bëhet në mënyrën si më poshtë: $70 = 20 + 20 + 30$. Nxënësit vizatojnë pikat në vendet e caktuara. Njësoj, $80 = 20 + 30 + 30$, $60 = 20 + 20 + 20$.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit plotësojnë tabelën e parë, duke gjetur shumën e panjohur dhe duke kërkuar mbledhësit që mungojnë me plotësim. Nxënësit plotësojnë tabelën e dytë, duke gjetur ndryshesën e panjohur dhe duke kërkuar zbritësit (përkatësisht të zbritshmit) me gjetje.

Veprimtaria 8:

Nxënësit plotësojnë skemat, të cilat janë vizatuar në dërrasë të zezë:





29. DECIMETRI DHE METRI

QËLLIMET

Nxënësit:

- njohin njësitë e reja të matjes; **decimetri** dhe **metri**;
- mbledhin dhe zbresin të njëjtat njësi matëse;
- masin, shkruajnë rezultatet e matjes, krahasojnë, njehsojnë;
- zgjidhin problemat me njësitë matëse.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit kanë në bankat e veta dy shirita me gjatësi të ndryshme: i shkurtri (1 cm) dhe i gjati (10 cm). Ata masin gjatësinë e bankës së vet me anë të shiritave dhe u përgjigjen pyetjeve: “Cilin shirit do të zgjidhni për matje? (Udhëzim: Nxënësve u duhet treguar, se për matje duhet të zgjedhin shiritin e gjatë.) Pse do të përdorni shiritin e gjatë?”

Më tej, nxënësit e masin çdo shirit me ndihmën e vizores dhe shkruajnë në secilin gjatësinë e tij: 1 cm dhe 10 cm. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Sa shirita të vegjël me nga 1 cm përmban shiriti i gjatë?”

Nxënësit nxjerrin përfundimin, se s’është e përshtatshme t’i matim gjatësitë e mëdha në centimetra. Nëse gjatësitë janë të mëdha, atëherë është më e përshtatshme, që edhe njësi matëse të jetë më e madhe.

Nxënësve u bëhet e ditur, se krahas njësisë matëse të gjatësisë; centimetrit, ekzistojnë edhe njësitë e tjera, siç është decimetri. Nxënësit vizatojnë në fletore segmentin prej 10 cm dhe shkruajnë barazimin: $10\text{ cm} = 1\text{ dm}$. Pas kësaj, ata masin me decimetra objektet përreth ose pjesët e tyre: shiritat, spangot, cepat e tavolinave etj.

Shënim: Në këtë temë mësimi, nxënësit duhet të mësojnë që të përcaktojnë jo vetëm gjatësinë, por edhe lartësinë, gjerësinë dhe thellësinë. Rëndësi ka që, gjatë matjes, nxënësit ta ndërrojnë pozicionin e vizores dhe jo pozicionin e sendit.

Për zhvillimin e vlerësimit perceptues të gjatësisë së segmentit, është me dobi që nxënësit ta vlerësojnë fillimisht gjatësinë e segmentit me sy, ndërsa pastaj ta kontrollojnë rezultatit e matjes me vizore.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit mbledhin dhe zbresin madhësitë e shprehura me centimetra dhe me decimetra. Ata vënë re, se veprimet i kryejnë në mënyrë të ngjashme sikurse me numrat e zakonshëm.

Shënim: Duhet vetëm që pranë rezultatit të jetë gjithmonë e shënuar njësi matëse.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3**

Nxënësit përcaktojnë mbi bazën e figurës, se në ç'largësi ka fluturuar mollëkuqja.

Udhëzim: Largësia nga lulja e kaltër deri tek lulja e kuqe kërkon mbledhjen: $1 \text{ dm} + 3 \text{ dm} = 4 \text{ dm}$.

Njëlloj kërkohet largësia nga lulja vjollcë deri tek lulja portokalli: $3 \text{ dm} + 4 \text{ dm} = 7 \text{ dm}$

Në fund, përcaktojnë largësinë nga lulja e kaltër deri tek lulja portokalli: $1 \text{ dm} + 3 \text{ dm} + 4 \text{ dm} = 8 \text{ dm}$.

Veprimtaria 5:

Nxënësit zgjidhin ushtrimin më poshtë:

“Markoja ka ngatërruar emërtimin e njësive matëse për gjatësinë. Ndhimoheni Markon që t'i korrigojë gabimet.” (Në dërrasë të zezë janë vendosur figurat, në të cilat është paraqitur miza, druri dhe fletorja, ndërsa poshtë shkrimi, sipas radhës: 1 dm, 50 cm dhe 20 dm).

- Markoja ka shkruar se gjatësia e mizës është 1 dm. Cila është njësia e drejtë matëse? 1 cm)
- Lartësia e drurit është 50 cm. Korrigojeni gabimin (50 dm). Gjatësia e fletores është e barabartë me 20 dm. Ku është gabimi? (Duhet të shkruhet 20 cm.)

Veprimtaria 6:

Nxënësit masin gjatësinë e dërrasës së zezë, gjerësinë e klasës etj. në centimetra ose në decimetra në varësi të gjatësisë matëse.

Shënim: Pas kësaj veprimtarie, duhet të nxirret përfundimi, se njësitë e njohura matëse për matjen e gjatësisë; centimetrat e decimetrat, nuk janë të përshtatshëm të përdoren në rastet e tilla. Shfaqet nevoja e futjes së një njësie të re më të madhe matëse për matjen e gjatësisë. Është e natyrshme se duhet të formohet një njësi e tillë që ka dhjetë decimetra. Prandaj futet në përdorim nocioni metër si njësi matëse e gjatësisë. Nxënësit i tregohen realizimet e llojeve të ndryshme të metrit: metri i rrobaqepësit, metri i marangozit, metri i muratorit. Nxënësit nxjerrin përfundimin se, me matjen me metër, do të përftohet gjithmonë i njëjti rezultat, pavarësisht se kush mat dhe me ç'lloj metri mat. Kjo gjë mund të vërtetohet duke u matur me metër nga disa nxënës gjatësia e klasës; të gjithë do të përftojnë rezultate të barabarta.

Shënim: Metri është njësia matëse më e rëndësishme për gjatësinë. Ai është paraardhësi i familjes së madhe të njësive që mban emrin “Sistemi metrik”. Metri është futur në përdorim në fundin e shekullit XVIII në Francë. Më parë, siç e kemi thënë, ka pasur njësi të ndryshme matëse për gjatësinë; gishti, këmba, hapi etj.

Meqë metri ka dhjetë decimetra, ndërsa decimetri ka dhjetë centimetra, është e qartë se metri ka njëqind centimetra, d.m.th. $1 \text{ m} = 10 \text{ dm} = 100 \text{ cm}$.

Para dërrasës së zezë dalin 10 nxënës me shirita prej 1 dm dhe i bashkojnë ashtu, që të përftojnë metrin.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë mund të matni me metër?
- Sa centimetra ka 1 metër? ($1 \text{ m} = 100 \text{ cm}$)
- Sa decimetra ka 1 metër? ($1 \text{ m} = 10 \text{ dm}$)
- Si e shkruajnë njësinë matëse metër (*Me shkronjën e vogël m pa pikë pas saj.*)
- Shkruani me shkurtim në fletore 10 metra, 12 metra, 7 metra.

**Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4 e 5**

Nxënësit zgjidhin problemat, në të cilat gjatësitë janë të shprehura me metra.


Veprimtaria 8: „Vlerësimi“

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve duke ngritur kartonin, në të cilin janë shkruar fjalët: Po dhe Jo. Shembuj pyetjesh:

- A mund t'i hapësh krahët 2 metra?
- A janë dy vogëlushë nga klasa së bashku më të lartë se 4 metra (ose 2 metra)?
- A mund të kërcesh së largu më shumë se 5 metra?

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit shohin lëvizjen graduale të kërmillit në shtyllë dhe zgjidhin problemën.





30. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para; rastet $10 + 3$, $3 + 10$; $13 - 3$ dhe $13 - 10$;
- dinë t'i paraqitin numrat me dy shifra deri në 20 në formën e shumës së dhjetësheve dhe të shumës së njësheve;
- përdorin lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes për zgjidhjen e ushtrimeve.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit zgjidhin shembujt, në të cilët njëri mbledhës është numri dhjetë.

Shënim: Dinë të formojnë numrin prej dhjetësheve dhe prej disa njësheve. Dinë ta zbërthejnë numrin e dhënë në shumën e dhjetësheve dhe në shumën e njësheve.

Nxënësit e zhvillojnë punën me tri numra, prej të cilëve ndërtojnë në mënyrë të pavarur dy shembuj me mbledhje dhe dy shembuj me zbritje. Për shembull, në dërrasë të zeze janë shkruar numrat 6, 16 dhe 10, nxënësit shkruajnë shembujt:

$$6 + 10 = 16 \text{ dhe } 10 + 6 = 16;$$

$$16 - 6 = 10 \text{ dhe } 16 - 10 = 6.$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse dhe gjejnë vlerën e shprehjeve numerike.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1, 2 e 3

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur **ushtrimet nr. 1 e 2.**

Shënim: Në **detyrën nr. 3**, duhet të plotësohet tabela, e cila përbëhet prej tre rreshtave. Rreshti i parë dhe i tretë janë të plotësuar, kurse në rreshtin e tretë duhet të shkruhet numri së bashku me veprimin e njehsimit, në mënyrë të tillë që numri në rreshtin e parë të kolonës përkatëse dhe veprimi i njehsimit i shkruar me numrin si rezultat japin numrin në rreshtin e tretë të kolonës përkatëse.

Veprimtaria 4:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet që janë shkruar në dërrasë të zeze:

$$10 + 4 = \underline{\quad} \quad 10 + 9 = \underline{\quad} \quad \underline{\quad} + 6 = 16$$

$$\underline{\quad} - 4 = 10 \quad 19 - \underline{\quad} = 10 \quad \underline{\quad} - 6 = 10$$

$$14 - \underline{\quad} = 4 \quad 19 - \underline{\quad} = 9 \quad 16 - \underline{\quad} = 6$$

**Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4**

Nxënësit zgjidhin ushtrimin e dhënë duke i zhvilluar gradualisht shembujt me dy veprime njehsimi: fillimisht zbresin zbritësin e parë dhe si rezultat përftojnë numrin 10. Pastaj zbresin nga numri 10 zbritësin tjetër. E njëjta ecuri ndiqet edhe me mbledhjen: dy mbledhësit japin numrin 10 dhe pastaj shtojnë mbledhësin e tretë.

Shënim: Ky ushtrim shërben si përgatitje për punën e mëtejshme: për mbledhjen e numrave me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe. Në këtë veprim ideja kryesore është plotësimi deri në dhjetë.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin gradualisht zinxhirin në formë gjarpri dhe në fund shkruajnë rezultatin: 11.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit masin segmentin me ngjyrë jeshile dhe shkruajnë rezultatin e matjes në centimetra dhe në decimetra. Kërkojnë shumën e gjatësive të segmenteve dhe rezultatin e shkruajnë në centimetra dhe në decimetra. Në vazhdim të kësaj veprimtarie, nxënësit masin gjatësinë e fletores dhe rezultatin e matjes e shkruajnë në centimetra dhe në decimetra.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit zgjidhin në mënyrë pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 9: Kontroll i zotërimit të qëllimeve

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

1. Njehso:

$$10 + 9 = _ \quad 3 + 10 = _ \quad 10 + 6 = _$$

$$8 + 10 = _ \quad 10 + 2 = _ \quad 10 + 9 = _$$

2. Cili numër është:

a) për 3 më i madh se numri 10?

b) për 1 më i madh se numri 10?

3. Në oborr kanë qenë 10 vogëlushe dhe 6 vogëlushë. Sa fëmijë kanë qenë gjithsej në oborr?

4. Kur numrin 14 e zvogëlon me një numër të panjohur, do të përftosh 10. Gjej numrin e panjohur.

5. Markoja ka shpenzuar 10 euro nga 18 euro sa ka pasur gjithsej. Sa euro i kanë mbetur Markos?

6. Vesna ka 4 kordele të verdha dhe 6 kordele të kaltra. Nëna i dha edhe 2 kordele të kuqe. Sa kordele ka gjithsej Vesna?

7. Asimi ka pasur 14 rruaza. Ai humbi 4 rruaza, kurse vëllai i fali pastaj 5 rruaza. Sa rruaza ka tani Asimi?



31. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- zotërojnë mbledhjen ($12 + 3$) dhe zbritjen ($15 - 3$) mbi bazën e analogjisë brenda dhjetëshes së dytë;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para; rastet $12 + 3$, $3 + 12$; $15 - 3$.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit ilustrjnë mbledhjen e numrave 12 dhe 3 duke vënë fillimisht para vetes nga e ana e majta tufën me dhjetë shkopiinj dhe edhe dy shkopiinj, kurse në anën e djathtë tre shkopiinj. Ata bëjnë veprimin e mbledhjes me shkopiinj dhe arrijnë në përfundimin, se duhen mbledhur 3 njëshe dhe 2 njëshe, ndërsa pastaj duhet formuar numri prej 1 dhjetëshe dhe 5 njësheve, përkatësisht të mblidhen 10 njëshe dhe 5 njëshe.

Njësoj duken edhe rastet respektive me zbritje.

Ecuria e zgjidhjes së shembullit shkruhet në dërrasë të zezë dhe, paralelisht me këtë, nxënësit shkruajnë në fletoret e veta::

$$\begin{array}{ll} 12 + 3 = ? & 15 - 3 = ? \\ 2 + 3 = 5 & 5 - 3 = 2 \\ 10 + 5 = 15 & 10 + 2 = 12 \\ 12 + 3 = 15 & 15 - 3 = 12 \end{array}$$

Shënim: Më vonë, mbledhja bëhet pa ndihmën e shkopiinjve dhe pa shkrimin e detajuar. Shpjegimi mund të bëhet gojarisht.

Gjatë zgjidhjes së shembullit $7 + 12$ përdorim ndërrimin e vendeve të mbledhësve:

$$7 + 12 = 12 + 7 = 10 + 2 + 7 = 10 + 9 = 19.$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse dhe vënë re, se Maja mban në një dorë 10 tulipanë të kuq, kurse në dorën tjetër mban 5 zambakë të verdhë. Markoja i fali edhe 1 zambak. Buqeta me 10 tulipanë ka mbetur e pandryshuar, kurse numri i zambakëve është shtuar me 1. Kështu, Maja ka tani 6 zambakë. Domethënë, numri i përgjithshëm i luleve është $10 + 6 = 16$.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur shembujt dhe ushtrohen në mbledhjen e numrit me dy shifra dhe të numrit me një shifër.

Veprimtaria 4:

Nxënësit gjejnë mbledhësin e panjohur me plotësim:

**Veprimtaria 5:**

$$\begin{array}{cccc}
 10 + \square = 13 & 10 + \square = 14 & 11 + \square = 15 & 13 + \square = 17 \\
 12 + \square = 13 & 13 + \square = 14 & 10 + \square = 15 & 12 + \square = 17 \\
 13 + \square = 13 & 11 + \square = 14 & 14 + \square = 15 & 17 + \square = 17 \\
 11 + \square = 13 & 12 + \square = 14 & 13 + \square = 15 & 16 + \square = 17
 \end{array}$$

Nxënësit, në çdo grup të shprehjeve numerike të shkruara në dërrasë të zezë, fshijnë shprehjet numerike, vlera e të cilave dallohet nga numri i shkruar sipër grupit të dhënë.

18	19	16
$10 + 8$ $13 + 2$ $17 + 1$ $3 + 15$	$10 + 5$ $11 + 8$ $15 + 4$ $6 + 12$	$10 + 6$ $12 + 4$ $5 + 11$ $14 + 4$

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit shohin figurën dhe vënë re, se nga 17 lule, janë vyshkur dy, gjë që e shkruajnë: $17 - 2$. Ata vënë re, se në rreshtin e dytë janë 10 lule, kurse në rreshtin e parë janë 7 lule, prej të cilave dy janë të vyshkura. Kjo shkruhet si $10 + 7 - 2 = 15$.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur shembujt dhe ushtrohen në zbritjen e numrit me një shifër prej numrit me dy shifra.

Veprimtaria 8:

Nxënësit dalin me radhë dhe plotësojnë tabelat e vizatuara në dërrasë të zezë:

	-3		-2		-4		-5
14		17		15		15	
19		19		17		17	
16		16		19		19	
17		18		18		18	
15		15		14		16	

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit plotësojnë skemën.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin problemën. Ata fshijnë në figurë aq bredha, sa janë prerë dhe numërojnë sa bredha kanë mbetur. Në fund shkruajnë barazimin, i cili i përgjigjet këtij ushtrimi.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë tekstin dhe kuptojnë, se teksti i mungon pyetja që të jetë problemë. Shkruajnë pyetjen në vendin përkatës, ndërsa pastaj edhe shprehjen numerike dhe gjejnë vlerën e shprehjes numerike.

**Veprimtaria 12: Ushtrimi nr. 7**

Nxënësit zbukurojnë bredhin. Njehsojnë shprehjet numerike dhe, në varësi të vlerave të tyre, ngjyrosin zbukurimet në bredh.

Veprimtaria 13: Ushtrimi nr. 8

Nxënësit analizojnë figurën dhe vënë re, se numrin 15 mund ta përftojnë në mënyra të ndryshme me mbledhje, duke qenë gjithmonë njëri mbledhës 11. Nxënësit kërkojnë të gjitha mënyrat dhe plotësojnë katrorët bosh me numrat e duhur:

$$11 + 1 + 1 + 1 + 1 = 15;$$

$$11 + 2 + 1 + 1 = 15;$$


$$11 + 2 + 2 = 15;$$

$$11 + 3 + 1 = 15;$$

$$11 + 4 = 15.$$

Veprimtaria 14: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi

Në tabelë janë vizatuar tullumbacet, në të cilat janë shkruar shprehjet numerike dhe shkronjat.



Në tabelë janë vizatuar tabelat:


Nxënësit gjejnë vlerat e shprehjeve numerike dhe shkruajnë shkronjat në vendet e duhura në tabelë.

Zgjidhja: Nëse e zgjidhin saktë shprehjen numerike, nxënësit duhet të përftojnë fjalën PUSHIMET.

12	19	14	16	13	15	18

Veprimtaria 15:

Nxënësit plotësojnë skemën që është vizatuar në tabelë.





32. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- paraqitin mënyrën e zbritjes së numrave deri 20 ($18 - 12$, $20 - 16$) me ndihmën e materialit didaktik;
- ushtrojnë zbritjen brenda dy dhjetësheve të para; rastet $18 - 12$ dhe $20 - 16$;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para; rastet; $16 + 4$ e $20 - 4$;
- përdorin lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes për zgjidhjen e ushtrimeve.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit paraqitin mënyrën e zbritjes së numrave me dy shifra $18 - 12$ dhe $20 - 16$ me ndihmën e materialit didaktik. Tek shembujt e tillë, duhet që zbritësi të zërthehet në dhjetëshe dhe në njëshe. Pastaj, fillimisht zbrasin dhjetëshet, kurse në fund zbrasin njëshet.

$$\begin{array}{ll} 18 - 12 = ? & 20 - 16 = ? \\ 18 - 10 = 8 & 20 - 10 = 10 \\ 8 - 2 = 6 & 10 - 6 = 4 \\ 18 - 12 = 6 & 20 - 16 = 4 \end{array}$$

Mund të formulohen gojarisht rregullat përkatëse. Për shembull: që të zbritet prej numrit 18 numri 15, fillimisht duhet të zbritet 10 dhe pastaj edhe 5, prej numrit 18 zbritet 10 dhe përftohet 8, prej 8 zbritet 5 dhe përftohet 3. Domethënë, $18 - 15 = 3$.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit ushtrohen për mënyrën e zbritjes së numrit me dy shifra nga numri me dy shifra. Në kolonën e parë zërthejnë zbritësin në dhjetëshe dhe në njëshe. Pastaj bëjnë gradualisht zbritjen. Duke zhvilluar shembujt e kolonës së dytë, nxënësit thonë ecurinë dhe shkruajnë rezultatin.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

**Veprimtaria 4: Loja "Lotaria"**

Nxënësve u jepet një nga kartonët me shprehjet numerike:

$14 - 14 = \underline{\quad}$	$17 - 17 = \underline{\quad}$	$19 - 14 = \underline{\quad}$	$16 - 11 = \underline{\quad}$	$15 - 10 = \underline{\quad}$
$14 - 12 = \underline{\quad}$	$17 - 15 = \underline{\quad}$	$19 - 16 = \underline{\quad}$	$16 - 13 = \underline{\quad}$	$15 - 12 = \underline{\quad}$
$14 - 10 = \underline{\quad}$	$17 - 12 = \underline{\quad}$	$19 - 19 = \underline{\quad}$	$16 - 10 = \underline{\quad}$	$15 - 14 = \underline{\quad}$
$14 - 13 = \underline{\quad}$	$17 - 10 = \underline{\quad}$	$19 - 12 = \underline{\quad}$	$16 - 15 = \underline{\quad}$	$15 - 11 = \underline{\quad}$
$14 - 11 = \underline{\quad}$	$17 - 13 = \underline{\quad}$	$19 - 17 = \underline{\quad}$	$16 - 16 = \underline{\quad}$	$15 - 13 = \underline{\quad}$

Mësues-i/ja merr me hamendje një karton nga grumbulli dhe ua tregon nxënësve (kartonët me numrat nga 0 deri në 9 janë përzier dhe të kthyer mbrapsht). Nxënësit kërkojnë pastaj në kartonët e vet shprehjet numerike, vlera e të cilave është e barabartë me numrin në karton. Fitues shpallet nxënësi që e mbush i pari me përgjigje kartonin e vet.


Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit e kërkojnë zbritësin e panjohur "me gjetje".

Shembull: $17 - \square = 3$. Nxënësit vënë re, se i zbritshmi është numër me dy shifra që ka 1 dhjetëshe dhe 7 njëshe, kurse ndryshesa është numri 3. Domethënë, zbritësi është numri me dy shifra që ka 1 dhjetëshe dhe 4 njëshe, d.m.th. numri 14.

Veprimtaria 6:

Nxënësit, me ndihmën e materialit didaktik, njohin ecurinë e mbledhjes së numrit me dy shifra dhe të numrit me një shifër, shuma e të cilëve është e barabartë me 20.



Pastaj ilustrohet në dërrasë të zezë ecuria për zgjidhjen e shembujve të formës $16 + 4$:

$$\begin{array}{c} 16 + 4 = 10 + 6 + 4 = 10 + 10 = 20 \\ \swarrow \quad \searrow \quad \swarrow \quad \searrow \\ 10 \quad 6 \quad \quad 10 \end{array}$$

Duke shfrytëzuar lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes, nxënësit shkruajnë dy barazime me zbritje: $20 - 4 = 16$ dhe $20 - 16 = 4$.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit shkruajnë numrin 20 si shumën e numrit me dy shifra dhe të numrit me një shifër. Plotësojnë vendet boshe në rreth dhe shkruajnë shumat përkatëse.

Shënim: Pas kësaj veprimtarie, nxënësit, mbi bazën e shumave të shkruara dhe duke shfrytëzuar lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes, shkruajnë në fletore nga dy ndryshesa për çdo shumë.



Veprimtaria 8: Kontroll

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

1. Njehso:

$$13 + 7 = \underline{\quad} \quad 14 + 6 = \underline{\quad} \quad 11 + 9 = \underline{\quad}$$

$$15 + 5 = \underline{\quad} \quad 12 + 8 = \underline{\quad} \quad 17 + 3 = \underline{\quad}$$

2. Mbledhësi i parë është shuma e numrave 12 dhe 2, kurse mbledhësi i dytë është numri 6. Gjej shumën.

3. Në një klasë janë 11 vogëlushë dhe 9 vogëlushe. Sa nxënës janë në këtë klasë?

4. Lidh çdo dy numra, shuma e të cilëve është 20:

$$19 \quad 4 \quad 8 \quad 13 \quad 2$$

$$7 \quad 12 \quad 1 \quad 18 \quad 16$$

5. Shkruaj numrin që mungon:

$$20 - \underline{\quad} = 17; \quad 20 - \underline{\quad} = 11; \quad 20 - \underline{\quad} = 13;$$

$$20 - \underline{\quad} = 14; \quad 20 - \underline{\quad} = 18; \quad 20 - \underline{\quad} = 15.$$

6. Sanja ka pasur 20 euro. Me to ka blerë një libër 7 euro. Sa euro i kanë mbetur?

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit numërojnë zbukurimet e ngjyrave të ndryshme dhe rezultatet e veta i shkruajnë në tabelë.: të verdha janë 17, të kuqe janë 6, të kaltra 7 dhe ngjyrë rozë 12. Ata vënë re se zbukurime të verdha ka më shumë, kurse më pak ka zbukurime të kuqe. Për t'iu përgjigjur pyetjes, nxënësit shkruajnë barazimin: $17 - 12 = 5$.

Shënim: Nxënësve u jepet të zhvillojnë edhe disa ushtrime me këto numra. Duhet treguar kujdes, se mbledhja e numrave me një shifër, me kalimin mbi dhjetëshe, do të mësohet së shpejti.

$$10 + 7 = \underline{\quad}$$

$$17 - \underline{\quad} = 10$$

$$17 - \underline{\quad} = 7$$



33. MBLEDHJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsëritin përbërjen e numrit 10;
- formulojnë rregullën e mbledhjes së numrave me kalimin mbi dhjetëshe (mbledhja me plotësim deri në 10);
- mbledhin numrat me një shifër : $9+2, 8+3, 7+4, 6+5; 9+3, 8+4, 7+5, 6+6$;
- përvetësojnë algoritmin e mbledhjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- dinë përbërjen e numrit 11 dhe 12;
- përcaktojnë relacionet e caktuara: **“është më i madh se”** dhe **“është më i vogël se”** dhe përdorin shenjat e duhura.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit përsëritin përbërjen e numrit 10 dhe zhvillojnë gojarisht ushtrimet më poshtë:

1. Loja “Ketri dhe lajthitë”

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin për ketrin, i cili krijon rezervat me lajthi për dimrin e gjatë. Ai nuk i vë kurrë të gjitha lajthitë në të njëjtën strofull, por i vendos në dy vende. Ketri (nxënësit mund ta shohin ilustrimin e përgatitur tashmë) mbledh çdo ditë nga 10 lajthi (numri mund të ndryshojë).

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: “Nga sa lajthi mund të vendosë ketri në çdo strofull? Si mund t’i ndajë ketri lajthitë ditën e parë? Po ditën e dytë? Po ditën e tretë?” Nxënësit i shkruajnë të gjitha variantet e ndryshme.

2. “Plotëso deri tek dhjetëshja”

$$5 + _ = 10, \quad 2 + _ = 10, \quad 4 + _ = 10, \quad 7 + _ = 10, \quad 1 + _ = 10.$$

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur **ushtrimin nr. 2** në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 2:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet me dy veprime, në të cilët shuma e mbledhësit të parë dhe e mbledhësit të dytë është e barabartë me 10.

Udhëzim: Nxënësit udhëzohen që të vënë re dhe të qarkojnë së bashku mbledhësin e parë dhe mbledhësin e dytë, si edhe u shpjegohet, se duhet të plotësohet mbledhësi i parë deri në dhjetë, ndërsa pastaj të shtohet mbledhësi i tretë.

$$\begin{array}{cccc} \boxed{8+2}+6 = _ & 7+3+2 = _ & 1+9+6 = _ & 2+8+3 = _ \\ 5+5+9 = _ & 9+1+4 = _ & 3+7+5 = _ & 6+4+8 = _ \end{array}$$



Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse, në të cilën është paraqitur Markoja, sesi ka mbledhur shtatë gogla të kuqe dhe 5 gogla blu. Goglat blu Markoja i ka ndarë në dy grupe: 3 dhe 2. Tri gogla blu i ka mbledhur me 7 gogla të kuqe për të përfutur 10, ndërsa pastaj 2 të mbeturat ia ka shtuar numrit 10 dhe ka përfutur 12 gogla.

Nxënësit analizojnë ecurinë dhe u përgjigjen pyetjeve lidhur me shumën $7 + 5$:

- Sa njëshe mungojnë tek mbledhësi i parë deri tek dhjetëshja? (Nxënësit nxjerrin përfundimin se mungojnë 3 njëshe.)
- Ku mund t'i marrim këto njëshe? (Nxënësit vënë re, se këto njëshe mund t'i marrin nga mbledhësi i dytë.)
- Në çfarë mbledhësish mund ta zbërthejmë mbledhësin e dytë? (Nxënësit mund të japin si zgjidhje 3 dhe 2.)
- Kalojmë 3 tek mbledhësi i parë. Sa dhjetëshe kemi përfutur? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se është përfutur një dhjetëshe.)
- Sa njëshe kanë mbetur? (Nxënësit vënë re, se kanë mbetur 2 njëshe.)

Pra, me sa është e barabartë shuma? (Shënim: Përgjigja në këtë pyetje është 1 dh 2 nj ose 12.

Nxënësit analizojnë veprimet e kryera dhe formulojnë rregullën e mbledhjes me kalimin mbi dhjetëshe: Për të mbledhur numrat me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe, fillimisht duhet plotësuar deri në 10 mbledhësi i parë, pastaj të shtohen edhe njëshet e tjera.

Shënim: Rëndësi ka që vetë nxënësit ta shpjegojnë qartë thelbin e ecurisë se mbledhjes me plotësimin deri në 10.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit studiojnë skemën që paraqet mënyrën e mbledhjes së dy numrave me dy shifra me kalimin mbi dhjetëshe. Atyre u kujtohet, se është më e lehtë t'i shtohet një numër më i vogël një numri më të madh, sesa një numër më i madh t'i shtohet një numri më të vogël, respektivisht të përdorin ndërrimin e vendeve të mbledhësve për ta bërë më të lehtë mbledhjen. Nxënësit i zgjidhin shembujt sipas modelit.

Veprimtaria Veprimtaria 3

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Çfarë është vizatuar në figurë? (Nxënësit shohin figurën dhe nxjerrin përfundimin, se në të janë vizatuar nëntë peshq të vegjël të kuq, që notojnë nga e majta në të djathtë; përballë tyre notojnë dy peshq të vegjël ngjyrë portokalli.)
- Çfarë mund të njehsojmë? (Sa peshq notojnë gjithsej?)
- Ç'njehsim duhet të bëjmë për t'iu përgjigjur pyetjes së problemës? (Nxënësit përgjigjen, se është fjala për mbledhjen.)

Nxënësit shkruajnë shprehjen e duhur numerike, njehsojnë dhe në fund japin përgjigjen.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 4 e 5

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Shënim: Tek ushtrimi nr. 4 në kolonën e parë janë shumatat me dy mbledhës, ku mbledhësi i parë është më i vogël se mbledhësi i dytë. Nxënësve u tërhiqet vëmendja tek këto raste, u shpjegohet se deri tek dhjetëshja mund të plotësohet më lehtë numri më i madh, prandaj tek shembujt e tillë është më mirë t'u ndërrohet vendi mbledhësve: $2 + 9 = 9 + 2 = 11$.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë problemën dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është e njohur tek problema? Çfarë duhet të njehsohet?
- Ç'veprim duhet të kryhet për t'iu përgjigjur pyetjes së problemës?



Nxënësit shkruajnë në vijën poshtë problemës në Tekstin mësimor shprehjen numerike $8 + 4$ dhe gjejnë vlerën e saj. Në fund japin përgjigjen.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit përsëritin lëndën mësimore të mëparshme duke e plotësuar tabelën.

Udhëzim: Në rreshtin e mesëm të tabelës duhet të shkruhet numri së bashku me shenjën, në mënyrë që numri në rreshtin e parë të kolonës përkatëse dhe veprimi i shkruar me numrin si rezultat të japin numrin në rreshtin e tretë të kolonës përkatëse.

Veprimtaria 9: Loja "Ne jemi ndërtues"

Nxënësit kanë para vetes kubet. Detyrë e tyre është që në mënyrën më të shpejtë të ndërtojnë shumëkatëshin, d.m.th. katet me kubet që kanë në dispozicion, duke shfrytëzuar mbledhjen me kalimin mbi dhjetëshe. Atyre u bëhet e ditur se tani janë ndërtues dhe se firma e ndërtimit ka ofruar tashmë katet prej blloqeve të kombinimeve të bëra. Çdo bllok mund të ndahet nga njëri-tjetri, në mënyrë që ndërtimi të jetë më i lehtë dhe më i shpejtë.

Firma e ndërtimit ka ofruar kombinimet më poshtë të blloqeve për ndërtimin e shumëkatëshave:

$$9+2 \quad 8+3 \quad 7+4 \quad 6+5$$

Nxënësit marrin kombinimet e ofruara të blloqeve të simuluar në formën e kubeve dhe fillojnë ndërtimin e shumëkatëshit në mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë.

Shumëkatëshi i parë duhet të ketë 11 kate në kombinimin $9 + 2$. Nxënësit ndajnë nëntë dhe dy kube. Për të përfutur dhjetë katet e para, prej dy blloqeve të ofruara, marrin një bllok dhe përfutjnë dhjetë katet e para. Këtyre dhjetë kateve i shtojnë bllokun e mbetur dhe përfutjnë ndërtimin e shumëkatëshit të parë.

Shpjegojnë matematikisht, sesi e kanë ndërtuar më lehtë planetin:

$$9+2 = 9+1+1 = 10+1 = 11.$$

"Punët e ndërtimit" vazhdojnë, deri sa të përfundohen të gjitha kombinimet.

Veprimtaria 10: Mozaik matematikor

Nxënësit ndahen në katër grupe. Çdo grupi i jepen nga 15 kartonë, në të cilët janë shkruar numrat dhe shenjat matematikore $+$, $=$. Detyrë e tyre është t'i kombinojnë siç duhet kartonët prej "mozaiku" sipas modelit të mbledhjes me kalimin mbi dhjetëshe.

Grupi i parë: $9 + 3 = 9 + 1 + 2 = 10 + 2 = 12.$

Grupi i dytë: $8 + 4 = 8 + 2 + 2 = 10 + 2 = 12.$

Grupi i tretë: $7 + 5 = 7 + 3 + 2 = 10 + 2 = 12.$

Grupi i katërt: $6 + 6 = 6 + 4 + 2 = 10 + 2 = 12.$

Veprimtaria 11:

Nxënësit zgjidhin problemën: "Milloshi kishte 8 euro, ndërsa më pas gjyshja i dha edhe 3 euro. Sa euro ka gjithsej Milloshi?"

Sqarim: 8 eurove u shtohen edhe 2 euro, të cilat i kemi marrë prej 3 eurove dhe kështu bëhet plotësimi deri në 10, pastaj kësaj shume i shtohet 1 euro e mbetur. Shpjegimin në fjalë nxënësit e paraqitin pastaj me ndihmën e zhetonëve ose të një materiali tjetër didaktik.

Nxënësit veçojnë 8 zhetonë, ndërsa pastaj edhe 3 zhetonë. Ndajnë 3 zhetonët në dy bashkësi, prej të cilave njëra ka 2 zhetonë, kurse tjetra ka 1 zheton. Pastaj bashkojnë bashkësitë prej 8 dhe 2 zhetonëve dhe përfutjnë bashkësinë e 10 zhetonëve, kurse pastaj i shtojnë kësaj edhe 1 zheton të mbetur. Gjithsej janë 11 zhetonë:

$$8+3 = 8+2+1 = 10+1 = 11.$$

Në mënyrë të ngjashme zgjidhin: $9+2$, $7+4$, $6+5$, $9+3$, $8+4$, $7+5$, $6+6$.



34. ZBRITJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë algoritmin e zbritjes së numrit me një shifër nga numri me dy shifra, kur vlera e të zbritshmit zbritet fillimisht nga dhjetëshet;
- zbresin numrin me një shifër nga numri me dy shifra: $11 - \square$, $12 - \square$;
- njohin mënyrën e zbritjes, kur i zbritshmi zërthehet në mbledhësit, në mënyrë të tillë që një mbledhës është i barabartë me zbritësin;
- përdorin lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Në pjesën hyrëse, nxënësit përsëritin zbritjen brenda dhjetëshes së dytë, kur ndryshesa e dy numrave është e barabartë me 10. Shembuj:

$$19 - 9 = \underline{\quad} \quad 12 - 2 = \underline{\quad} \quad 13 - 3 = \underline{\quad} \quad 15 - 5 = \underline{\quad}$$

$$16 - 6 = \underline{\quad} \quad 17 - 7 = \underline{\quad} \quad 11 - 1 = \underline{\quad} \quad 14 - 4 = \underline{\quad}$$

Veprimtaria 2:

Nxënësit plotësojnë tabelën dhe u përgjigjen pyetjeve: "Si ndryshon i zbritshmi? Si ndryshon zbritësi: Si ndryshon ndryshesa?"

I zbritshmi	10	10	10	10	10	10	10	10	10
Zbritësi	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Ndryshesa									

Veprimtaria 3:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet me dy veprime, në të cilët ndryshesa e të zbritshmit dhe e zbritësit të parë është 10.

Udhëzim: Nxënësit vënë re dhe qarkojnë të zbritshmin dhe zbritësin e parë, pastaj u shpjegohet atyre, se fillimisht duhet të zbritet zbritësi i parë duke u përfutur kështu ndryshesa e barabartë me 10, ndërsa pastaj zbritet edhe zbritësi i dytë.

$$\boxed{12 - 2} - 6 = \underline{\quad} \quad 16 - 6 - 2 = \underline{\quad} \quad 19 - 9 - 3 = \underline{\quad}$$

$$14 - 4 - 5 = \underline{\quad} \quad 11 - 1 - 4 = \underline{\quad} \quad 17 - 7 - 7 = \underline{\quad}$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 4: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin paraqitjen grafike dhe skemën që paraqesin ecurinë e zbritjes së numrave me një shifër nga numrat me dy shifra. Tek mbledhja, mbledhësi i parë plotësohet deri në dhjetë, kurse tek zbritja, vlera e të zbritshmit zvogëlohet deri tek dhjetëshja.



Nxënësit analizojnë ecurinë dhe u përgjigjen pyetjeve lidhur me ndryshesën $12 - 3$:

- Sa njëshe ka i zbritshmi? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se i zbritshmi është 12 dhe se ka një dhjetëshe dhe 2 njëshe.)
- Si mund ta paraqitim zbritësin 3? (Shënim: $3 = 2 + 1$)
- Sa njëshe duhet të zbresim fillimisht? (Shënim: 2 njëshe.) Çfarë kemi përfutur? (Shënim: 10 njëshe.)
- Edhe sa njëshe kanë mbetur që të zbriten? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se duhet të zbritet edhe 1 njëshe.) Çfarë kemi përfutur? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se përgjigjja është $10 - 1 = 9$)

Nxënësit analizojnë veprimet e bëra dhe formulojnë rregullën e zbritjes së numrit me një shifër nga numri me dy shifra me kalimin mbi dhjetëshe: **Për të zbritur numrin me një shifër nga numri me dy shifra me kalimin mbi dhjetëshe, fillimisht duhet të zbriten nga i zbritshmi me dy shifra njëshet, ndërsa pastaj nga dhjetëshja të zbriten njëshet e tjera.**

Shënim: Rëndësi ka që nxënësit ta thonë vetë thelbin e ecurisë të zbritjes së numrave me një shifër nga numrat me dy shifra.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit vënë re lidhjen reciproke ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes dhe, mbi bazën e një barazimi me mbledhje, shkruajnë dy barazime me zbritje.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit masin gjatësinë e segmentit dhe rikujtojnë mënyrën e përdorimit të vizores: afrojnë vizoren pranë segmentit, puthitin fillimin e segmentit me zeron në vizore, gjejnë në vizore numrin që i përgjigjet skajit tjetër të segmentit, thonë dhe shkruajnë rezultatin e matjes. Pastaj gjejnë duke njehsuar gjatësinë e segmentit më të shkurtër: $12 \text{ cm} - 3 \text{ cm} = 9 \text{ cm}$. Vizatojnë segmentin me gjatësi 9 cm.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit njihen me mënyrën tjetër të zbritjes, kur i zbritshmi zërthehet në mbledhës, në mënyrë të tillë që një mbledhës është i barabartë me zbritësin. Ndërkohë, kjo mënyrë kërkon që nxënësit ta njohin mirë tabelën e mbledhjes së numrave me një shifër. Në orët e mëparshme të mësimin, nxënësit janë ushtruar në formimin e numrave 11 dhe 12, ndërsa tani i shfrytëzojnë njohuritë e veta për zgjidhjen e shembujve.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit lexojnë problemën dhe veçojnë atë që është e njohur dhe atë që duhet të njehsohet.

Shënim: Rëndësi ka që nxënësve t'u saktësohet nocioni dhe kuptimi gjuhësor i shprehjes numerike *edhe aq*.

Nxënësit ndeshen për herë të parë me problemën me dy veprime dhe kësaj i duhet kushtuar vëmendje e veçantë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është e njohur? (Nxënësit nxjerrin përfundimin nga teksti, se ketri ka 12 lajthi, se ka ngrënë 2, pastaj edhe 2.)
- Çfarë kërkohet? (Nxënësit nxjerrin përfundimin nga teksti se kërkohet përgjigjja për pyetjen: Sa lajthi kanë mbetur?)
- Ç'veprim përdorim? (Nxënësve u kujtohet, se përdoret veprimi i zbritjes.)
- Cila është shprehja numerike? (Nxënësit shkruajnë $12 - 2 - 2 = 10 - 2 = 8$.)



- Si mund ta zgjidhim ndryshe këtë problemë? (Nxënësit duhet të vënë re, se fillimisht duhet të gjejnë sesa lajthi ka ngrënë gjatë ditës ketri: $2 + 2 = 4$. Pas kësaj, nxënësit duhet të gjejnë sesa lajthi kanë mbetur: $12 - 4 = 8$.)

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Ushtrime për përforsim

Veprimtaria 11:

Nxënësit, duke u ndihmuar dhe me shpjegime, zgjidhin problemën.

Problema: Ivani, prej gjithsej 11 ushtrimeve, ka zgjidhur 5. Edhe sa ushtrime i kanë mbetur Ivanit për të zgjidhur?

Udhëzim: Nxënësve u shpjegohet, sesi mund të zgjidhet më lehtë kjo problemë. Ka rëndësi që nxënësve t'u shpjegohet ecuria. Kur prej 11 ushtrimeve zbritet 1, mbesin edhe 10 ushtrime. Kur prej kësaj zbriten edhe 4 ushtrimet e mbetura, mbeten edhe 6 ushtrime që nuk janë zgjidhur. Në dërrasë të zezë duhet të shkruhet barazimi: $11 - 5 = 11 - 1 - 4 = 10 - 4 = 6$. Nxënësit i paraqitin këto barazime me anë të zhetonëve, ose të një materiali tjetër didaktik.

Veprimtaria 12: Loja "Konduktori", lidhja ndërlëndore me lëndët mësimore Natyra dhe shoqëria dhe Gjuha shqipe dhe letërsia

Para dërrasës së zezë, në karriget e vendosura si ndenjëset në autobus, ulen 11 nxënës. Nxënësit e tjerë zgjidhin gjëegjëzën. Ai që e zgjidh i pari gjëegjëzën fiton rolin e konduktorit të autobusit.

Gjëegjëzë: "I lartë jam, katër rrota kam, udhëtari me mua fluturon, në çatinë time zogu nganjëherë follenë ndërton." (Autobusi)

Nxënësi konduktor hyn e del në autobus. Nxënësit udhëtarë janë ulur dhe udhëtimi nis.

Ata dëgjojnë rrëfimin që u tregon mësues-i/ja:

"Udhëtarët u nisen nga Podgorica, kryeqendra e shtetit tonë, për në Cetinjë. Cetinje është kryeqyteti i vjetër i shtetit të Malit të Zi. Në autobus janë gjithsej 11 udhëtarë. Arritën në Cetinjë, në qytetin që ka mjaft muze. Në Cetinjë dolën 7 udhëtarë."

Konduktorit i bëhet pyetja: "Sa udhëtarë e vazhduan udhëtimin?" Ai shpjegon: "Di që në autobus kanë qenë 11 udhëtarë dhe se në Cetinjë kanë dalë 7 udhëtarë. Më lehtë do ta gjej, sesa udhëtarë kanë mbetur duke zbritur fillimisht nga 11 udhëtarë 1 udhëtar dhe do të përftoj 10 udhëtarë, ndërsa ata 6 udhëtarët e mbetur nga 7 udhëtarët do t'i zbres prej 10 udhëtarëve dhe do të kuptoj se kanë mbetur 4 udhëtarë."

Pasi që shpjegon, sesi ka ardhur deri tek zgjidhja, konduktori shkruan barazimin duke përdorur zbritjen me kalimin mbi dhjetëshe: $11 - 7 = 11 - 1 - 6 = 10 - 6 = 4$.

Shënim: "Udhëtimi" vazhdon në drejtim të qyteteve të tjera të vendit tonë me shembuj të ndryshëm me zbritje me kalimin mbi dhjetëshe.

Shembull: Në autobus janë 11 udhëtarë që udhëtojnë për në Budvë, qytetin kryesor të turizmit tonë. Në stacionin e autobusit në Budvë dolën 5 udhëtarë. Sa udhëtarë mbetën në autobus?

Njehsojnë: $11 - 5 = 11 - 1 - 4 = 10 - 4 = 6$.

**Veprimtaria 13: lidhja ndërlëndore me lëndët mësimore Natyra dhe shoqëria dhe Kultura e artit figurativ**

Nxënësit ndahen në grupe. Kriteret për formimin e grupeve janë: kafshët shtëpiake; kafshët e egra, mjetet e transportit dhe sendet e higjienës personale. Nxënësit, në mënyrë figurative, paraqitin në pllakate boshe barazimin matematikor.

Grupi i parë: mendon rrëfimin për shprehjen e dhënë numerike $12 - 4$, e paraqet në mënyrë figurative dhe njehson. Nxënësit vizatojnë sipas dëshirës 12 kafshë shtëpiake që qëndrojnë në grup dhe katër kafshë shtëpiake që largohen nga ky grup. Pastaj e njehson ushtrimin e shkruar.

Grupi i dytë: paraqet në mënyrë figurative dhe njehson shprehjen numerike $12 - 5$, duke vizatuar kafshët e egra.

Grupi i tretë: paraqet në mënyrë figurative dhe njehson shprehjen numerike $12 - 6$ duke vizatuar mjetet e transportit.

Grupi i katërt: paraqet në mënyrë figurative dhe njehson shprehjen numerike $12 - 3$, duke vizatuar sendet e higjienës personale..

Veprimtaria 14:

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke lidhur me shigjetë shprehjen numerike me vlerën e saj.

$11 - 2$						$11 - 6$
$11 - 7$		8		5		$11 - 3$
$11 - 4$	7				4	$11 - 8$
$11 - 9$		2		3		$11 - 5$
$12 - 5$						$12 - 7$
$12 - 8$	6		9		1	$12 - 4$
$12 - 3$						$12 - 9$



35. MBLEDHJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE


QËLLIMET

Nxënësit:

- përcaktojnë përbërjen e numrave 11 dhe 12;
- mbledhin me ndihmën e segmentit numerik;
- mbledhin numrat me një shifër: $9 + 4$, $8 + 5$, $7 + 6$; $9 + 5$, $8 + 6$, $7 + 7$;
- përvetësojnë algoritmin në rastin e mbledhjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- dinë përbërjen e numrave 13 dhe 14.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Shkallët"



Në dërrasë të zezë janë vizatuar shkallët; e para me numrin 11 në majë dhe e dyta me numrin 12 në majë. Nga dy nxënës ndihmojnë njëri-tjetrin që të ngjiten në shkallë duke shkruar numrat me një shifër. Njëri nxënës shkruan një mbledhës në shkallaren e majtë, kurse nxënësi tjetër shkruan në shkallaren e dytë, djathtas, mbledhësin tjetër, në mënyrë që shuma të jetë numri i barabartë me numrin në majë të shkallëve.

Shënim: Në shkallët e para është paraqitur shembulli i plotësimit të shkallares.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit dëgjojnë dhe zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Maja po sistemon librat në etazhe. Ajo vendosi fillimisht njëri pranë tjetrit të gjithë librat me kapakë ngjyrë portokalli, ndërsa pastaj të gjithë librat ngjyrë vjollcë. Me kapakë ngjyrë portokalli janë 7 libra, kurse me kapakë ngjyrë vjollcë janë 6 libra. Sa libra vendosi gjithsej në etazhe Maja?

Për njehsimin e shprehjes numerike $7 + 6$ nxënësit mund të shfrytëzojnë njohuritë e veta për numërimin: $7 + 1 = 8$, $8 + 1 = 9$, $9 + 1 = 10$, $10 + 1 = 11$, $11 + 1 = 12$, $12 + 1 = 13$. Shtojnë nga një njëshe (i numërojnë me radhë librat në etazhe). Nxënësit mund të shfrytëzojnë edhe mënyrën e njohur të mbledhjes së numrave me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe me plotësim deri në 10. Kjo mënyrë është përshkruar në figurën ilustruese hyrëse.

**Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1**

Nxënësit zhvillojnë mënyrën e mbledhjes së numrave me një shifër me plotësim deri në dhjetëshe me ndihmën e segmentit numerik. Pas kësaj, zgjidhin shembujt sipas modelit.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit shohin figurën dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është vizatuar në figurë? (Nxënësit vënë re, se në figurë janë vizatuar 8 Burra prej bore me kapele të kuqe dhe 5 me kësulë të gjelbër.)
- Çfarë mund të njehsojmë? (Nxënësit duhet të vënë re, se mund të mësojmë, sesa Burra prej bore janë gjithsej.)
- Cilin veprim duhet të përdorim? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se duhet të përdoret veprimi i mbledhjes.)

Shembulli sesi mund të formulohet kjo problemë: "Dy ekipe fëmijësh kanë bërë Burra prej bore. Ekipi i kësulëkuqeve ka bërë 8 Burra prej bore, ndërsa ekipi i kësulëgjelbërve ka bërë 5 Burra prej bore. Sa Burra prej bore kanë bërë gjithsej nxënësit?"

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.


Zgjidhja: Nxënësit mund ta zgjidhin ushtrimin në dy mënyra:

Mënyra e parë:

1. Nxënësit masin dhe shkruajnë gjatësinë e çdo segmenti: 9 cm e 4 cm.
2. Njehsojnë shumën e gjatësive: $9\text{ cm} + 4\text{ cm} = 13\text{ cm}$
3. Vizatojnë segmentin me gjatësi 13 cm.

Mënyra e dytë:

1. Nxënësit masin dhe shkruajnë gjatësinë e çdo segmenti: 9 cm e 4 cm.
2. Vizatojnë gradualisht njërin pas tjetrit dy segmentet.
3. Përftojnë segmentin gjatësia e të cilit është e barabartë me shumën e gjatësive të dy segmenteve.

**Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 4**

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit i zgjidhin shembujt me dy veprime. Fillimisht bëjnë zbritjen e numrit me një shifër nga numri me dy shifra, ndërsa pastaj mbledhin dy numra me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin dhe analizojnë çdo shembull:

Që nga numri 8 të përftohet numri 6, duhet të zvogëlohet numri 12 për 6. Domethënë,
 $12 - 2 - 4 = 6$.

Që nga numri 11 të përftohet numri 6, duhet të zvogëlohet numri 11 për 5. Domethënë,
 $11 - 1 - 4 = 6$.

Që nga numri 16 të përftohet numri 13, duhet të zvogëlohet numri 16 për 3. Domethënë,
 $16 - 5 + 2 = 13$.



Që nga numri 19 të përftohet numri 13, duhet të zvogëlohet numri 19 për 6. Domethënë, $19 - 8 + 2 = 13$.

Që nga numri 15 të përftohet numri 12, duhet të zvogëlohet numri 15 për 3. Domethënë, $15 + 5 - 8 = 12$.

Që nga numri 12 të përftosh numrin 15 duhet të rritet numri 12 për 3. Domethënë, $12 - 2 + 5 = 15$.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit gjejnë mbledhësit e panjohur.

Ushtrime për përforsim

Veprimtaria 10: Puna në çifte

Detyrë e nxënësve është që, në çifte, të vënë re dhe të qarkojnë sa më shpejt barazimet që janë të sakta.

Ushtrimi: Asimi dhe Lluka kanë bërë garë në njehsim. Kush prej tyre ka më shumë zgjidhje të sakta?

ASIMI

$$8 + 4 = 11$$

$$7 + 5 = 12$$

$$7 + 4 = 11$$

$$9 + 4 = 13$$

$$8 + 6 = 13$$

$$6 + 6 = 12$$

$$9 + 2 = 11$$

LLUKA

$$8 + 5 = 12$$

$$6 + 5 = 11$$

$$7 + 6 = 13$$

$$9 + 5 = 14$$

$$8 + 3 = 11$$

$$7 + 7 = 14$$

$$9 + 3 = 12$$

Asimi ka ___ zgjidhje të sakta.

Lluka ka ___ zgjidhje të sakta.

Më shumë zgjidhje të sakta ka _____.

Veprimtaria 11:

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Kur grupet ta përfundojnë zgjidhjen e ushtrimeve, ata zgjedhin me short kapitenin e grupit. Ai ka për detyrë që të informojë në fund të punës

GRUPI I PARË

Shfrytëzo ndonjë nga numrat e dhënë dhe plotëso barazimin që të jetë i saktë:

a) 12, 3, 6, 5, 11

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 5 = 8 + 5 = 13.$$

b) 10, 6, 7, 12, 9

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 7 = 6 + 7 = 13.$$

c) 11, 5, 7, 2, 10

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 6 = 8 + 6 = 14.$$

GRUPI I DYTË

Shfrytëzo ndonjë nga numrat e dhënë dhe plotëso barazimin që të jetë i saktë:

a) 12, 3, 2, 5, 8

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 9 = 4 + 9 = 13.$$

b) 11, 6, 9, 2, 3

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 5 = 9 + 5 = 14.$$

c) 10, 5, 8, 4, 11

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} + 7 = 7 + 7 = 14.$$

Veprimtaria 12:

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Shkruaj shprehjen dhe përcakto vlerën e saj:

a) Selma është 8 vjeçe, ndërsa vëllai i saj është 6 vjet më i madh. Sa vjeç është vëllai i Selmës?

b) Në pjtancë ishin 9 lapsa të kuq dhe 5 lapsa blu. Sa lapsa ishin gjithsej në pjtancë?



36. ZBRITJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE

QËLLIMET




Nxënësit:

- zbresin numrin me një shifër nga numri me dy shifra: $13 - \square$, $14 - \square$;
- përvetësojnë algoritmin e zbritjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para në raste të ndryshme;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen e shpejtë.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Bëj një buqetë"

Nxënësit e çdo rreshti i plotësojnë petalet e luleve që janë vizatuar në dërrasë të zezë, në mënyrë të tillë që vlera e shprehjeve numerike të shkruara të jetë e barabartë me numrin në mesin të luleve:



Shënim: Tek lulja e parë është treguar një nga zgjidhjet e mundshme.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse, Ushtrimi nr. 1

Udhëzim dhe sqarim: Nxënësit mbledhin 7 gogla të verdha dhe 7 gogla jeshile, duke plotësuar fillimisht 7 gogla deri në 10. Për këtë arsye, goglave të verdha u shtohen 3 gogla jeshile dhe atëherë përftojme në rreshtin e parë 10 gogla. Nëse tani i shtojmë edhe 4 goglat e mbetura, përftojme gjithsej 14 gogla, d.m.th. në rreshtin e dytë vihen edhe 4 gogla.

Nxënësit zgjidhin shembujt me mbledhje në Tekstin mësimor.

Ndërsa tani, që prej 14 goglave të zbriten 7 gogla, duhet të fshihen fillimisht 4 goglat e rreshtit të dytë, pastaj të fshihen edhe 3 goglat e rreshtit të parë.

Nxënësit zgjidhin ushtrimet përkatëse me zbritje. Në vazhdim të kësaj veprimtarie, nxënësit zgjidhin **ushtrimin nr. 1** duke e komentuar.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike dhe e lidhin çdo zarf me kutinë postare, numri i së cilës është i barabartë me vlerën e shprehjes numerike në zarf.



Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shpjegojnë dy mënyrat e ndryshme të zbritjes së numrit me një shifër nga numri me dy shifra me kalimin mbi dhjetëshe:

$$\begin{array}{r} 13 - 8 = 5 \\ \begin{array}{r} 3 \\ 5 \end{array} \end{array} \qquad \begin{array}{r} 13 - 8 = 5 \\ \begin{array}{r} 8 \\ 5 \end{array} \end{array}$$

Sqarim: *Mënyra e parë:* Zbritësi paraqitet në formën e shumës, ku njëri mbledhës është i barabartë me numrin e njësheve të të zbritshmit me dy shifra. Pastaj, fillimisht zbresim njëshet për të përfutur numrin 10, kurse pastaj zbresim edhe njëshet e tjera.

Mënyra e dytë: Të zbritshmin e shkruajmë si shumën e dy mbledhësve, në ç' rast njëri mbledhës është i barabartë me zbritësin. Në këtë rast ndryshesa është e barabartë me mbledhësin e dytë.

Nxënësit kërkojnë në vendin e caktuar në dy mënyra vlerën e shprehjeve të dhëna numerike.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit kërkojnë vlerën e shprehjeve numerike me dy veprime njehsimi. Poshtë çdo shprehje numerike është grepi i peshkimit dhe, pas çdo njehsimi, nxënësit e lidhin grepin e peshkimit me peshkun, në të cilin është shkruar vlera përkatëse e shprehjes numerike.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit, duke u ndihmuar, zgjidhin problemën. Gjatë leximit, nxënësit veçojnë kushtin dhe pyetjen e problemës; shkurtimisht e shkruajnë ushtrimin:

Gjithsej – 14 shembuj;

Gabim – 6 shembuj.

Saktë – ? shembuj

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një pjesë të ushtrimeve të zhvilluara, shtrohet pyetja: me ç' veprim njehsimi do të përshkruhet kjo gjë tek ushtrimi që çon deri tek zgjidhja e problemës. Nxënësit e kuptojnë se bëhet fjalë për zbritjen. Ata shkruajnë shprehjen numerike $14 - 6$ në vendin e caktuar në Tekstin mësimor, gjejnë vlerën e shprehjes numerike dhe japin përgjigjen e problemës.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit gjejnë mbledhësin e panjohur me plotësim dhe duke i plotësuar shtëpitë. Zbritësi i panjohur gjendet me zbritje graduale.

Ushtrime kontrolli

Veprimtaria 8: Diktimi matematikor

Nxënësit shkruajnë shprehjet numerike dhe gjejnë vlerën e tyre.

1. Prej numrit 14 të zbritet numri 5.
2. Numrit 9 t'i shtohet numri 3.
3. Shumës së numrave 7 dhe 3 t'i shtohet numri 2.
4. Ndryshesës së numrave 12 dhe 2 t'i zbritet numri 3.
5. Shumës së numrave 8 dhe 2 t'i shtohet numri 3.
6. Ndryshesës së numrave 13 dhe 3 t'i zbritet numri 2.
7. Shumës së numrave 9 dhe 1 t'i shtohet numri 4.
8. Ndryshesës së numrave 14 dhe 4 t'i zbritet numri 1.



Veprimtaria 9:

Nxënësit zgjidhin ushtrimet e përgatitura në fletën e punës.

Ushtrimi nr. 1: Njehso gojarisht dhe ngjyros me të njëjtën ngjyrë ndryshesën dhe numrin në vargun që i përgjigjet vlerës së saktë të ndryshesës:

$$14 - 5 \quad 1, 6, 8, 4, 9$$

$$13 - 5 \quad 2, 5, 8, 7, 4$$

$$14 - 8 \quad 3, 7, 8, 6, 9$$

$$13 - 4 \quad 8, 7, 5, 3, 9$$

$$14 - 9 \quad 4, 8, 9, 7, 5$$

$$13 - 9 \quad 4, 7, 1, 5, 8$$

$$14 - 7 \quad 5, 6, 7, 8, 4$$

$$13 - 6 \quad 6, 7, 8, 9, 1$$

Ushtrimi nr. 2: Mendohu dhe përgjigju!

Maria ka në portofol 14 euro. Nëse blen çokolletën që kushton 5 euro, a do të ketë ajo të holla edhe për bonbonet që kushtojnë 7 euro?

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad} \quad \text{PO} \quad \text{JO}$$

Ushtrimi nr. 3: Ana kishte 7 euro. Edhe sa euro i duhen për të blerë kukullën që kushton 13 euro?



37. MBLEDHJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE

QËLLIMET

Nxënësit:

- mbledhin numrat me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe: $9+6$, $8+7$, $9+7$, $8+8$, $9+8$, $9+9$;
- përvetësojnë algoritmin e mbledhjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para në raste të ndryshme;
- shkruajnë relacionet midis numrave $<$, $>$, $=$) në zgjidhjen e ushtrimeve;
- ushtrojnë mbledhjen e shpejtë.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Stafeta"

Në dërrasën e zezë janë shkruar numrat. Nxënësit ndahen në dy ekipe. Të gjithë pjesëtarët e ekipit shkruajnë me radhë në dërrasën e zezë çiftet e numrave me një shifër, shumën e të cilëve është e barabartë me numrin e dhënë

14	13	12	11
9 5	9 4	9 3	9 2
8 6	8 5	8 4	8 3
7 7	7 6	7 5	7 4
6 8	6 7	6 6	6 5

Fitues është ekipi, nxënësit e të cilit i kanë shkruar siç duhet dhe më shpejt se nxënësit e tjerë të gjitha çiftet e numrave me një shifër.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse, Ushtrimi nr. 1

Nxënësve u rikujtohet edhe një herë mënyra e mbledhjes së numrave me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe dhe thonë çdo hap. Nxënësit e zgjidhin ushtrimin.

Shembuj: $9 + 7$

1. Mbledhësi i parë është 9. Atij deri tek numri 10 i mungon edhe 1 njëshe.
2. Për këtë arsye, mbledhësin e dytë 7 e paraqesim më formën e shumës 1 dhe 6.
3. I shtojmë numrit 9 fillimisht 1 njëshe për të përfutur 10 njëshe, ndërsa pastaj edhe 6 njëshet e mbetura. Përftojme 16.
4. Përgjigje: $9 + 7 = 16$.

Në vazhdim të kësaj veprimtarie, nxënësit zgjidhin **ushtrimin nr. 1**, duke e shpjeguar gojarisht dhe duke shkruar mënyrën e zgjidhjes në vendin e caktuar në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3**

Shënim: Nxënësit njihen me mënyrën e mbledhjes, e cila bazohet në zbatimin e barazimit: $9 = 10 - 1$. Kur i shtojmë një numri numrin 9, mund t'i shtojmë atij fillimisht numrin 10, ndërsa pastaj zbresim numrin 1.

Nxënësit e ushtrojnë këtë ecuri tek shembujt e ndryshëm.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit e zgjidhin problemin dhe mbi bazën e skemës shkruajnë barazimin: $7 + \square = 15$. Nxënësit gjejnë mbledhësin e panjohur me plotësim.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet në mënyrën më të lehtë.

Shënim: Kur kemi tre mbledhës, shumën e dy prej të cilëve është e barabartë me 10, është më mirë të mblidhen fillimisht këta dy mbledhës dhe pastaj të shtohet i treti.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit zgjidhin dy detyrat më poshtë:

1. Në pjatancë janë 9 mollë dhe 7 dardha. Sa fruta janë gjithsej në pjatancë?
2. Në pjatancë janë 16 fruta. Sa fruta kanë mbetur në pjatancë, pas ngrënies nga fëmijët të 10 frutave? ($16 - 10 = 6$)

Pas zgjidhjes organizohet diskutimi:

- A mund të thuhet, se kërkesa e dytë është vazhdim i kërkesës së parë? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se kërkesa e dytë është vazhdim i kërkesës së parë.)
- A mund t'i lidhim kërkesat në një kërkesë duke ruajtur radhën e veprimeve? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se këto dy kërkesa mund të lidhen.)
- Si do ta formulonit kërkesën e re?
- Si mund ta shkruajmë shprehjen numerike? (Nxënësit shkruajnë: $(9 + 7 - 10)$)
- Duke pasur parasysh, se kërkesa e re është krijuar me bashkimin e dy kërkesave të para, atë mund ta zgjidhim hap pas hapi:
1) $9 + 7 = 16$ fruta; 2) $16 - 10 = 6$ fruta.

Nxënësit lexojnë **ushtrimin nr. 4**, shkruajnë shprehjen numerike në vendin e caktuar, gjejnë vlerën e shprehjes numerike dhe i përgjigjen pyetjes së problemës.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Udhëzim: Nxënësit u ndihmojnë bletëve që t'i gjejnë shtëpitë e veta. Shumën e numrave në kovat e vockla me mjaltë që bartin bletët duhet të jetë e barabartë me numrin e shtëpisë. Duhet të lidhet me shigjetë bleat dhe shtëpia e saj.

Ushtrime për përforsim**Veprimtaria 9: "Unë di"**

Nxënësit i zgjidhin gojarisht ushtrimet dhe qarkojnë zgjidhjen e drejtë.

$9 + 6 \quad (10, 12, 15, 14)$

$8 + 7 \quad (13, 15, 12, 13)$

$9 + 7 \quad (15, 17, 18, 16)$

$8 + 8 \quad (12, 10, 16, 13)$

$9 + 8 \quad (14, 15, 12, 17)$

$9 + 9 \quad (20, 17, 18, 19)$

**Veprimtaria 10:**

Nxënësit e plotësojnë në mënyrë të pavarur tabelën.

Shënim: Shprehja numerike $A + 9$ tregon, se në rreshtin e dytë të çdo kolone numri përkatës i rreshtit të parë duhet të zmadhohet për 9.

A	6	7	5	8	4	9	2
$A + 9$							

Nga tabela shihet se, kur zmadhohet një prej mbledhësve, atëherë zmadhohet edhe shuma.

**Veprimtaria 11: “Fjala enigmë”, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore
Gjuhë shqipe dhe letërsi.**

Nxënësit shkruajnë numrin që mungon.

Udhëzim: Pranë çdo shprehjeje gjendet shkronja. Kur t’i shkruajnë numrat, nxënësit duhet t’i renditin nga numri më i vogël tek numri më i madh dhe t’i renditin shkronjat sipas këtij vargu numerik. Nëse i kanë zgjidhur siç duhet ushtrimet, ata do ta përftojnë fjalën enigmë. (SHIFRA)

$9 + \square = 18$	A
$\square + 9 = 14$	SH

$9 + \square = 15$	I
$8 + \square = 16$	R

$8 + \square = 15$	F
--------------------	----------



38. ZBRITJA ME KALIMIN MBI DHJETËSHE

QËLLIMET

Nxënësit:

- zbresin numrin me një shifër nga numri me dy shifra: $15 - \square$, $16 - \square$, $17 - \square$, $18 - \square$;
- përvetësojnë algoritmin e zbritjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dy dhjetësheve të para në raste të ndryshme;
- ushtrojnë mbledhjen e shpejtë.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit, të ndarë në tri grupe, zgjidhin ushtrimin (vargun):

$$\begin{array}{ccccccccc} (6) & + & (9) & - & (5) & + & (8) & = & (\quad) \\ (7) & + & (9) & - & (6) & + & (4) & = & (\quad) \\ (5) & + & (7) & - & (2) & + & (6) & = & (\quad) \end{array}$$

Teksti mësimor:

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse, Ushtrimi nr. 1

Nxënësve u kujtohet edhe një herë mënyra e zbritjes së numrit me një shifër nga numri me dy shifra me kalimin mbi dhjetëshe dhe thonë çdo hap të këtij veprimi të njehsimit:

Shembull: $17 - 9$

1. I zbritshmi është 17 dhe ka 7 njëshe.
2. Për këtë arsye, zbritësi 9 shkruhet si shuma e numrave 7 dhe 2.
3. Prej numrit 17 fillimisht zbresim 7 njëshe për të përfutur 10 njëshe, ndërsa pastaj prej numrit 10 zbresim 2 njëshet e tjera. Përftojme numrin 8.

Përgjigja: $17 - 9 = 8$.

Nxënësit, në vazhdim të kësaj veprimtarie, zhvillojnë sipas modelit **ushtrimin nr. 1** duke e komentuar gojarisht ecurinë e punës.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit gjejnë zbritësin e panjohur me plotësim dhe i plotësojnë shtëpitë. Zbritësi i panjohur gjendet me zbritje graduale.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3**

Nxënësit e zgjidhin problemën duke u ndihmuar. Gjatë leximit, ata veçojnë kërkesën dhe pyetjen e problemës; shkruajnë shkurtimisht problemën:

Kanë qenë – 18 m;

Kanë prerë – 9 m.

Kanë mbetur – ? m

Nxënësit e kuptojnë, se bëhet fjalë për zbritjen dhe shkruajnë shprehjen numerike $18 - 9$ në vendin e caktuar në Tekstin mësimor, gjejnë vlerën e shprehjes numerike dhe i përgjigjen pyetjes së problemës.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit plotësojnë tri tabelat.

Shënim: Mund të organizohet gara midis tri rreshtave: çdo rresht plotëson tabelën e vet.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjes numerike duke zbritur fillimisht zbritësin e parë, ndërsa pastaj zbresin edhe zbritësin e dytë.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit i zgjidhin shprehjet numerike sipas modelit. Ata vënë re, se në rastet e ushtrimeve me dy veprime njehsimi me zbritje, është më mirë të zbritet fillimisht zbritësi i dytë për të përfutur numrin 10, ndërsa pastaj të zbritet nga numri 10 zbritësi i parë. Kjo ecuri mundëson njehsimin e shpejtë më gojë të vlerës së shprehjes numerike.

Shënim: Nxënësve mund t'u propozohet që, në të njëjtën mënyrë, të zhvillojnë **ushtrimin nr. 5**.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7, lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi.

Nxënësit përsëritin mbledhjen dhe zbritjen me kalimin mbi dhjetëshe. Njehsojnë shprehjet numerike dhe i shkruajnë përgjigjet në katorrin e djathtë. Në anën e majtë të shprehjeve numerike gjenden shkronjat. Pas njehsimit, nxënësit e plotësojnë tabelën: në rreshtin e parë shkruajnë vlerën e shprehjeve numerike të njehsuara nga vlera më e vogël tek vlera më e madhe, kurse në rreshtin e dytë shkruajnë shkronjën përkatëse, e cila është e vendosur në anën e djathtë të shprehjes numerike dhe kështu përftojnë emërtimin e zogut: Thëllëza.

Ushtrime për përsëritje dhe përforsim**Veprimtaria 9:**

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke e lidhur me shigjetë shprehjen numerike me vlerën e saj.

14 - 5	8	5	4	15 - 8
15 - 9	7	2	3	16 - 9
14 - 8	6	9	1	15 - 7
15 - 6				17 - 8

Veprimtaria 10: Loja "Kush është më i shpejtë"

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet në vazhdim. Fitues është nxënësi që i zgjidh më shpejt, por edhe saktë të gjitha ushtrimet.



I ZBRITSHMI	ZBRITËSI	NDRYSHESA
17	9	
16	7	
17	8	
18	9	
16	8	
15	7	

Veprimtaria 11:

Këtë veprimtari nxënësit e zhvillojnë në çifte. Çdo çifti i jepet fletushka, në të cilën janë shkruar barazimet, por disa prej të cilave nuk janë të sakta. Nxënësit duhet t'i gjejnë barazimet e pasakta dhe t'i fshijnë me vizë.

$15 - 6 = 9$

$16 - 4 = 7$

$14 - 6 = 8$

$16 - 7 = 6$

$17 - 9 = 8$

$13 - 7 = 5$

$18 - 9 = 9$

$15 - 8 = 9$

$11 - 5 = 8$

Veprimtaria 12: Loja "Llogaritarët"

Nxënësve u thuhet, se sot do të jenë llogaritarë. Në Shtëpinë e madhe të mallrave për fëmijë po bëhet shitja me çmime të ulura. Janë shitur shumë lodra. Detyra e llogaritarëve të vegjël është që ta plotësojnë raportin e shitjes.

KUKULLA TË VOGLA

KUKULLA TË MESME

KUKULLA TË MËDHA

Kanë qenë 16

Kanë qenë 17

Kanë qenë 18

Janë shitur 5

Janë shitur 6

Janë shitur 9

Kanë mbetur _____

Kanë mbetur _____

Kanë mbetur _____

ANIJE

KAMIONË

VETURA GARASH

Kanë qenë 17

Kanë qenë 16

Kanë qenë 15

Janë shitur 9

Janë shitur 9

Janë shitur 8

Kanë mbetur _____

Kanë mbetur _____

Kanë mbetur _____

Veprimtaria 13: "Edhe kjo është matematikë"

Nxënësit zgjidhin problemën.

Problema: Në park janë 5 vogëlushe, 12 vogëlushë dhe 2 qenë. Nëntë vogëlushë shkuan në shtëpi. Sa **persona** kanë mbetur në park?

Shënim: Qeni nuk është person.



39. TABELA E MBLEDHJES SË NUMRAVE DERI NË 20

QËLLIMET

Nxënësit:

- përvetësojnë algoritmin e mbledhjes dhe të zbritjes me kalimin mbi dhjetëshe;
- gjejnë shumën dhe ndryshesën sipas tabelës së mbledhjes;
- përdorin lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor:

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse, tabela e mbledhjes

Nxënësit përdorin përvojën e vet, të cilën e kanë fituar gjatë plotësimit të tabelës trekëndëshe të mbledhjes dhe shpjegojnë se, në rreshta dhe në kolona, vlera e shumëve shtohet gradualisht me 1. Domethënë, mund të plotësohen të gjithë katrorët pa bërë njehsimin.

Mjafton të shkruhen në rreshta dhe në kolona të gjithë numrat me radhë.

Duke analizuar tabelën, nxënësit vënë re lidhjen midis komponentëve të mbledhjes dhe të zbritjes:

- nëse një mbledhës zmadhohet për një ose disa njëshe, atëherë edhe shuma zmadhohet për po kaq njëshe;
- nëse i zbritshmi zmadhohet për disa njëshe, atëherë ndryshesa zmadhohet për po kaq njëshe;
- nëse zbritësi zmadhohet për disa njëshe, atëherë edhe ndryshesa zmadhohet për po kaq njëshe.

Pas analizës së tabelës, nxënësit saktësojnë mënyrën e mbledhjes dhe të zbritjes së numrave me ndihmën e tabelës

Shënim: Faktikisht, nxënësit rikujtohen dhe e kalojnë në një fushë më të lartë numerike mënyrën e njohur të punës me tabelën trekëndëshe të mbledhjes. Rezultati i diskutimit mund të fiksohet në mënyrën më poshtë:

+	0	b	9
0			
a			
9			

$$a + b = c$$

$$b + a = c$$

$$c - a = b$$

$$c - b = a$$

**Algoritmi i gjetjes së shumës $a + b$ sipas tabelës**

1. Gjej shumën a dhe b në rreshtin e parë në kolonën e parë.
2. Gjej pikën e prerjes së rreshtit dhe të kolonës të a dhe b përkatëse.
3. Të thuhet numri c që gjendet në këtë pikë të prerjes.
4. Përgjigje: $a + b = c$.

Algoritmi i gjetjes së ndryshesës $c - a$ sipas tabelës

1. Gjej në tabelë katrorin me numrin c .
2. Të përzgjidhet rreshti që i përgjigjet numrit a .
3. Të thuhet numri b që është në majë të kolonës përkatëse.
4. Përgjigja: $c - a = b$.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me tabelën:

- Pse është ndarë tabela sipas ngjyrës në dy pjesë? (Nxënësit duhet të vënë re, se kjo është për arsye të vetisë së mbledhjes për ndërrimin e vendit të mbledhësve.)
- Cilët mbledhës japin shumën 15?, 16?, 17?
- Cilët numra mund t'i shkruajmë si shuma e dy mbledhësve të njëjtë? Ku gjenden në tabelë këto numra? (Nxënësit shkruajnë numrat 12, 14, 16 dhe 18 në formën e shumës së mbledhësve të barabartë.)

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit në pjesën e parë të ushtrimit kërkojnë ndryshesat në kolonën e parë dhe mbledhësin e panjohur në kolonën e dytë (mund të përdorin tabelën e mbledhjes).

Në pjesën e dytë të ushtrimit, në kolonën e parë kërkojnë zbritësin e panjohur, kurse në kolonën e dytë kërkojnë mbledhësin e panjohur. Nxënësit vënë re barazimet që tregojnë lidhjen midis mbledhjes dhe zbritjes dhe i lidhin ato me shigjetë.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit analizojnë shembujt në çdo kolonë.

Udhëzim: Në kolonën e parë janë paraqitur shumat, në ç'rast njëri mbledhës mbetet i pandryshuar. Kurse tjetri zmadhohet për 1. Për këtë arsye, çdo shumë në vazhdim do të jetë më e madhe për 1.

Në kolonën e dytë janë dhënë ndryshesat, në ç'rast i zbritshmi zmadhohet për 1, kurse zbritësi mbetet i pandryshuar. Domethënë, ndryshesa në çdo shembull në vazhdim do të jetë për 1 më e madhe prej së mëparshmes.

Në kolonën e tretë kemi shumat, tek të cilat për një zvogëlohet mbledhësi i parë, kurse për një zmadhohet mbledhësi i dytë, Domethënë, shuma në këto raste mbetet e pandryshuar dhe të gjithë shembujt kanë përgjigje të njëjta.

Në kolonën e katërt kemi ndryshesat, tek të cilat i zbritshmi është i njëjtë, kurse zbritësi zmadhohet për 1. Domethënë, ndryshesa do të zvogëlohet për një në çdo shembull pasardhës.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit kërkojnë mbledhësit e panjohur dhe plotësojnë skemën.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4, Loja "Peshkatari"

Nxënësit e lidhin çdo peshk me peshkatarin që ka numrin e barabartë me shumën tek peshku dhe e ngjyrosin me ngjyrën me të cilën është shkruar numri. Në fund, nxënësit përcaktojnë fituesit. Këto janë peshkatarët me numrat 11 dhe 12, për arsye se ata kanë peshkuar më shumë peshq; nga 4 peshq.

**Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5**

Nxënësit i zgjidhin shembujt me dy veprime njehsimi dhe i lidhin ato me përgjigjet.

Ushtrime për përsëritje**Veprimtaria 7:**

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke lidhur me shigjetë shprehjen numerike dhe vlerën e saj.

12 - 8	8	5	4	15 - 6
13 - 5	7	2	3	17 - 9
14 - 7	6	9	1	11 - 4
16 - 9				16 - 7

Veprimtaria 8: "Të njohim botën e kafshëve përmes matematikës", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Natyra dhe shoqëria

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

Ushtrimi nr. 1: "Unë jam kastori"

"Jam ndërtuesi më i mirë midis kafshëve. Njerëzit mbeten të mahnitur para kështjellave, kanaleve dhe pendave të mia. Çdo vit ndërtoj pa u lodhur nga pranvera deri në vjeshtë. Për këtë arsye, dimrin e kaloj i sigurt në shtëpinë plot ushqim."

Kam një problemë për ju:

Një ditë, ndërsa po ndërtoja pendën, grumbullova 15 degë, por lumi m'i mori 6 degë. Sa degë solla atë ditë në pendë?

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$$

Shkruaj barazimin që tregon lidhjen e mbledhjes dhe zbritjes së dhënë.

Ushtrimi nr. 2: "Unë jam foka"

Jetoj në grupe të mëdha në ujërat e qeta. Për nga natyra jam dashamirëse dhe kureshtare. Kur zbutem, atëherë jam e dashur për njeriun. Më pëlqen të luaj me top. Mund ta mbajë për një kohë të gjatë në majë të turirit. Neve na pëlqen shpesh që të rrestohemi në rreth dhe ta vërtitim topin në turinjtë tanë".

Kam një problemë për ju:

Në parkun zoologjik dielli tundoj një grup prej 16 fokash që të rrestoheshin në formë rrethi. Nëntë prej fokave luanin me topa. Sa foka nuk kishin top?

$$\underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$$

Shkruaj barazimin që tregon lidhjen e mbledhjes dhe zbritjes së dhënë.

Ushtrimi nr. 3: "Unë jam bretkosa"

"Jam e gëzuar dhe shkathët. Notoj, zhytem, por më mirë kërcëj. Kur mbrëmja është e qetë dhe e ngrohtë, ne bretkosat kemi koncertin tonë, duke lajmëruar gjendjen e mirë shpirtërore, sepse na pëlqen zhurma e madhe. Në vjeshtë futemi në rërë dhe flemë deri në pranverë."

Kam një problemë për ju:

$$16 - 7 \quad 17 - 8 \quad 15 - 9$$



Bëj nga dy shembuj me mbledhje, për çdonjë të zbritje:

$$7 + 6 \quad 9 + 5 \quad 6 + 4$$

Veprimtaria 9: Puna në çifte

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet e dhëna. Kur përfundojnë, i ndërrojnë fletoret dhe kontrollojnë rezultatet e njëri-tjetrit:

Ushtrimi nr.: Shkruaj nga 4 barazime me numrat e dhënë:

13	7	6	15	6	9	17	9	8	12	8	4
___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___	___ + ___ = ___
___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___
___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___	___ - ___ = ___

Veprimtaria 10: Loja "Unë jam numri, më paraqit me ndihmën e - dhe +"

Nxënësit me ndihmën e mbledhjes dhe të zbritjes së tre numrave, paraqesin numrin e dhënë në dy numra. Ata tregojnë kujdes që, në rastin e parë, fillimisht të jetë veprimi i njehsimit me mbledhje, kurse në rastin e dytë fillimisht të jetë veprimi i njehsimit me zbritje.

Ushtrime për përsëritje:

- Unë jam numri 9, më paraqit! (Shembull: $8 + 6 - 5$ dhe $12 - 6 + 3$.)
- Unë jam numri 8, më paraqit!
- Unë jam numri 5, më paraqit!



40. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsosin dhe zbatojnë mbledhjen dhe zbritjen në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 20;
- gjejnë numrin e panjohur me lojë didaktike të orientuar.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit gjejnë zbritësin e panjohur “me gjetje”, p.sh. $14 - \underline{\quad} = 11$: prej 14 duhet të zbritet 3 për të përfutur 11. Tek shembujt e tipit $14 - \underline{\quad} = 9$, zbritësi i panjohur kërkohet me zbritje graduale: nga numri 14 duhet të zbritet numri 4 për të përfutur numrin 10, ndërsa pastaj nga numri 10 duhet të zbritet numri 1 për të përfutur numrin 9. Domethënë, numri i kërkuar është $4 + 1 = 5$.

Shënim: Zgjidhja e ushtrimit mund të organizohet në formën e lojës “Thërrisni numrin e lënë”.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr.2

Nxënësit zbatojnë rregullën lidhur me plotësimin deri në 10.

$$9 + 4 = 9 + 1 + 3 = \underline{10} + 3 = 13;$$

$$8 + 3 = 8 + 2 + 1 = \underline{10} + 1 = 11;$$

$$12 - 3 = 12 - 2 - 1 = \underline{10} - 1 = 9;$$

$$7 + 4 = 7 + 3 + 1 = \underline{10} + 1 = 11;$$

$$18 - 9 = 18 - 8 - 1 = \underline{10} - 1 = 9;$$

$$11 - 4 = 11 - 1 - 3 = \underline{10} - 3 = 7.$$

Shembulli i fundit ka edhe zgjidhjet e tjera, që nuk janë të lidhura me plotësimin deri në 10: $11 - 4 = 11 - 2 - 2$ ose $11 - 4 = 11 - 3 - 1$.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3.

Nxënësit plotësojnë kornizat “interesante” duke shkruar numrat në vendet boshe, në mënyrë të tillë që shuma e numrave përgjatë çdo ane të kornizës të jetë e barabartë me numrin që është shkruar në qendër:

$$14 = 5 + 4 + \mathbf{5}, \quad 14 = 4 + 2 + \mathbf{8}, \quad 14 = 5 + 2 + \mathbf{7}; \quad 18 = 4 + 3 + \mathbf{11}, \quad 18 = 4 + 5 + \mathbf{9},$$

$$18 = 5 + 5 + \mathbf{8}, \quad 18 = 5 + 3 + \mathbf{10}; \quad 17 = 4 + 3 + \mathbf{10}, \quad 17 = 3 + 6 + \mathbf{8}, \quad 17 = 6 + 4 + \mathbf{7}.$$

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4


Nxënësit e zgjidhin gojarisht “zinxhirin”.

Shënim: Në rast vështirësie, nxënësit i shkruajnë shembujt në fletore dhe i zgjidhin gradualisht,

**Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 5**

Nxënësit plotësojnë rrethin në mënyrë që shuma e numrave të jetë e barabartë me numrin në qendër të rrethit. Ata vënë re, se numrat në rrethin e brendshëm zmadhohen, kurse në rrethin e jashtëm, zvogëlohen.

Organizohet gara në plotësimin e shembujve të ngjashëm me rrathë:

**Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6**

Udhëzim: Nxënësit janë njohur tashmë me mënyrën, sesi punon roboti mbledhës. Në fillim të makinës llogaritëse kemi rrethin blu, ku “kalojnë” numrat nga tabela, ndërsa pastaj “kalojnë” nëpër makinë në dalje; në rrethin e kuq përtohet numri i ri, të cilin nxënësit e shkruajnë në tabelë.

Për shembull: Numri i parë në tabelë është 5. Numri 5 arrin tek kushti i krahasimit me numrin 15. Meqë $5 < 15$, zbatohet përgjigja “po” dhe, në këtë rast, roboti mbledhës i shton numrit 5 numrin 4. Në rrethin e kuq, roboti mbledhës shkruan përgjigjen përfundimtare 9. Nxënësit e shkruajnë numrin në tabelë.

- $5 < 15$ – po, $5 + 4 = 9$. Përgjigjja: 9.
- $8 < 15$ – po, $8 + 4 = 12$. Përgjigjja: 12.
- $9 < 15$ – po, $9 + 4 = 13$. Përgjigjja: 13.
- $12 < 15$ – po, $12 + 4 = 16$. Përgjigjja: 16.
- $15 < 15$ – jo, $15 - 8 = 7$. Përgjigjja: 7.
- $17 < 15$ – jo, $17 - 8 = 9$. Përgjigjja: 9.
- $19 < 15$ – jo, $19 - 8 = 11$. Përgjigjja: 11.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit njehsojnë shprehjet numerike dhe i ngjyrosin ato me ngjyrat përkatëse.

Veprimtaria 8: Testi “Mbledhja dhe zbritja”

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet:

- Lidhni me shigjetë shprehjen numerike me vlerën e saj.

$6 + 6$	10	5	18	$7 + 7$
$18 - 9$	8	14	9	$12 - 6$
$8 + 8$	12	7	16	$9 + 9$
$14 - 7$	15	14	16	$16 - 8$

- Lidhni me shigjetë shprehjen numerike me vlerën e saj.

$9 + 2$	12	13	17	$9 + 8$
$9 + 7$	11	18	16	$8 + 3$
$9 + 3$	15	14	16	$8 + 7$
$7 + 4$	15	14	16	$9 + 6$



3. Lidhni me shigjetë shprehjen numerike me vlerën e saj.

$7 + 6$	11	14	12	$8 + 6$
$9 + 4$	16	18		$8 + 4$
$6 + 5$	15	13	17	$9 + 5$
$8 + 5$				$7 + 5$

Veprimtaria 9:

Shënim: Në këto ushtrime, nxënësit gjejnë numrin e panjohur.

Nxënësit zgjidhin ushtrimet më poshtë:

Ushtrimi nr. 1: Cili mbledhës mungon që shuma të jetë numri më i vogël me dy shifra:

$$7 + 2 + _ = _ \quad 6 + 2 + _ = _ \quad 8 + 1 + _ = _$$

Ushtrimi nr. 2: Plotëso: $13 - _ = 9$, $15 - _ = 6$, $16 - _ = 7$, $18 - _ = 9$.

Ushtrimi nr. 3: "Kush do të jetë i pari?"

Nxënësit zgjidhin problemat. Përgjigjen e jep nxënësi, i cili gjen i pari zgjidhjen.

1. Markoja kishte 9 lapsa. Ai bleu edhe disa, kështu që tani ka 15 lapsa. Sa lapsa ka blerë Markoja?
2. Masha bleu 7 trëndafila. Sa trëndafila i mungojnë Mashës që të ketë buqetën prej 13 trëndafilash?
3. Numrin e panjohur është zmadhuar për 9, kështu që është përftuar numri 18. Gjej numrin e panjohur.

Veprimtaria 10: "Kam mësuar", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi

Nxënësit njehsojnë vlerën e shprehjeve numerike dhe gjejnë fjalët enigmë.

Zgjidhja: Pranë çdo shprehjeje qëndron shkronja që është pjesë e fjalës që kërkohet. Nëse i zgjidhin siç duhet ushtrimet, nxënësit do të përftojnë fjalët KAM MËSUAR.

Zgjidhja e saktë e fjalëve të panjohura përftohet, kur vlerat e shprehjeve të dhëna numerike renditen nga më e madhja tek më e vogla. **Nxënësit duhet ta zbulojnë vetë këtë gjë.**

$$17 - 8 = R$$

$$7 + 7 = S$$

$$14 - 7 = A$$

$$12 - 4 = K$$

$$14 - 9 = M$$

$$9 + 3 = A$$

$$9 + 7 = \text{Ë}$$

$$6 + 7 = U$$

$$8 + 9 = M$$

8	7	5
K	A	M

17	16	14	13	12	9
M	Ë	S	U	A	R



41. USHTRIME ME MBLEDHJE DHE ME ZBRITJE

QËLLIMET

Nxënësit:

- zbatojnë mbledhjen dhe zbritjen në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 20;
- ushtrojnë mbledhjen dhe zbritjen brenda dhjetëshes së parë e të dytë.

Veprimtaritë e nxënësve

Shënim: Matematika bëhet më interesante dhe më tërheqëse, kur zbatohet në situatat e caktuara jetësore. Nxënësit i zbatojnë njohuritë e fituara gjatë blerjes në dyqan, gjatë numërimit të pikëve në gara etj. Në këtë temë mësimi janë përdorur shembuj të situatave nga jeta e përditshme, tek të cilat nxënësit mund t'i shfrytëzojnë njohuritë e fituara.

Veprimtaria 1: Loja "Shembulli i gjatë"

Çdo rreshti nxënësish i jepet letra, në të cilën është shkruar ushtrimi. Nxënësit kryejnë nga një veprim njehsimi dhe ia kalojnë letrën shokut pasues. Rreshti që kryen më shpejt dhe siç duhet ushtrimin, do të jetë rreshti fitues.

$$\boxed{7} + 3 \quad \boxed{} - 2 \quad \boxed{} + 7 \quad \boxed{} - 5 \quad \boxed{} + 4 \quad \boxed{} - 6 \quad \boxed{} + 5 \quad \boxed{}$$

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit studiojnë tabelën e qitjes të çdo pjesëmarrësi në lojë dhe plotësojnë tabelën. Pas njehsimit, sipas numrit të pikëve, përcaktojnë se kush ka qenë më i miri, d.m.th. kush ka fituar më shumë pikë dhe ka zënë vendin e parë, kush ka qenë i dyti e kështu më tej. Në fund u përgjigjen pyetjeve lidhur me tabelën.

Shënim: Pyetjet mund të zgjerohen:

1. Sa është ndryshesa në pikë midis atij që është klasifikuar i pari dhe atij që është klasifikuar i dyti?
2. Sa pikë ka fituar më shumë Milloshi se Markoja?
3. Cila vogëlushe ka pasur më shumë sukses?
4. Sa është ndryshesa në pikë midis të parit dhe të fundit në këtë lojë?

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit njehsojnë gjatësinë e rrugëve që janë vizatuar me ngjyra të ndryshme dhe i shkruajnë barazimet në vendet e caktuara. Gjatë njehsimit shfrytëzojnë lehtësitë në njehsim, d.m.th. gjejnë mbledhësit që japin shumën e barabartë me 10.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit luajnë lojën "Libraria". Në vitrinën e librarisë janë renditur sendet me emërtimin dhe me çmimin e tyre. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me blerjen dhe i shkruajnë njehsimet e veta në vendin e duhur.





Shënim: Lidhur me këtë ushtrim mund të zgjerohet numri i pyetjeve. Për shembull:

- Markoja ka 10 euro. A mund ta paguajë ai fletoren dhe fotoalbumin?
- Maja ka 5 euro. Çfarë mund të blejë ajo me këto të holla?
- Asimi ka 6 euro. Sa euro i mungojnë atij për të blerë librin?
- Sa do të jetë kusuri që do të marrë Milloshi, nëse me kartëmonedhën prej 5 eurosh paguan gërshtëret dhe dy gomat?
- Sa euro është më i shtrenjtë libri se fotoalbumi?
- Sa euro më të lira janë bojërat e ujit se lapsat me ngjyra?

Veprimtaria 5: Loja “Ndërtojmë shtëpinë”

Në dërrasë të zezë janë vizatuar dy shtëpi; në njëren janë shkruar numrat, kurse tjetra është njësoj, por pa numra.



Duhet të ndërtohet shtëpia. Nxënësve të çdo banke u jepen copat e letrave, në të cilat është shkruar një shprehje:

$$7 + 2 = _ (9)$$

$$11 - 8 = _ (3)$$

$$13 + 5 = _ (18)$$

$$14 + 5 = _ (19)$$

$$11 + 6 = _ (17)$$

$$1 + 7 = _ (8)$$

$$9 + 7 = _ (16)$$

$$10 - 5 = _ (5)$$

$$2 + 2 = _ (4)$$

$$3 + 4 = _ (7)$$

$$7 + 6 = _ (13)$$

$$11 + 9 = _ (20)$$

$$8 + 4 = _ (12)$$

$$15 - 9 = _ (6)$$

Çdo copë letre përfaqëson tullën që duhet të vihet në vendin e caktuar gjatë ndërtimit të shtëpisë, kurse një letër përfaqëson dritaren.

Nxënësit kërkojnë vlerat e shprehjeve numerike në letrat e veta dhe gjejnë në shtëpi tullën e vet (vlerën e shprehjes numerike). Nxënësit që i kanë gjetur vendin “tullës” së vet e shkruajnë dhe e zgjidhin shembullin në dërrasë të zezë, kurse nxënësit e tjerë punojnë në fletore. Në fund, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Cili veprim njehsimi shfaqet në shprehjen numerike, kur kemi ndërtuar murin e shtëpisë?
- Ç’mendon, pse të gjitha këto shprehje numerike janë me mbledhje? (Nxënësit duhet të vënë re, se “tullat” i kanë shtuar dhe se muri është bërë më i madh.)
- Si quhen komponentët e mbledhjes?
- Cili veprim njehsimi shfaqet në shprehjen numerike, kur jemi tek çatia? (Nxënësit vënë re, se fjala është për shprehjet numerike me zbritje.)
- Si quhen komponentët e zbritjes?



Veprimtaria 6: "Matematika me fjalë", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi.

Nxënësit lexojnë paraprakisht tekstin e përgatitur të vjershës "Mirësjellja në qarkullim"

MIRËSJELLJA NË QARKULLIM

Në repertorin e qarkullimit,
në mendje çdo nxënës të ketë:
rëndësi ka ecja në trotuar,
trotuari është parajsë për këmbësorët.

[Autori]

Nxënësit, pas leximit të tekstit të vjershës, zgjidhin ushtrimin:

Prej sa fjalësh përbëhet kjo vjershë? _____

Sa fjalë duhet të hiqen që të mbeten 14? _____

Veprimtaria 7: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi

Në dërrasë të zeze është shkruar fjala: MIRËSJELLJA. Nxënësit vënë re, se fjala përbëhet prej 10 shkronjash. Nxënësit, duke fshirë me vizë, formojnë prej kësaj fjalët e reja dhe zgjidhin shembujt përkatës me zbritje. Për shembull, me fshirjen e 6 shkronjave nxënësit përftojnë fjalën "SJELL":

~~MIRËSJELLJA~~ 10 - 6 = 4

Nxënësit mendojnë variantet e veta të fjalëve, fshijnë shkronjat e caktuara dhe formojnë shembuj të tjerë me zbritje: MIRË, SJELLJA, SMIRË, MIRA, MARS, ARSIM, RIMË.

Veprimtaria 8: "Unë jam pasues"

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Nxënësit ndahen në tri grupe. Çdo grupi i jepet fleta, në të cilën është dhënë numri i i parë (i fillimit) me të cilin fillohet njehsimi. Çdo nxënës pjesëtar i grupit kryen një hap të ushtrimit, pasi që çdo nxënës pasues shkruan nga një element. Nxënësi parë i grupit shkruan shenjën për veprimin e njehsimit të mbledhjes (+) dhe numrin (sipas përzgjedhjes) me të cilin do të kryhet veprimi i njehsimit. Nxënësi pasues e gjen shumën. Nxënësi i tretë i grupit shton shenjën për veprimin e njehsimit të zbritjes (-) dhe numrin me të cilin do të zbritet. Nxënësi pasues e gjen ndryshesën.

Shembull:

$$\boxed{9} \xrightarrow{+3} \boxed{12} \xrightarrow{-5} \boxed{}$$



42. USHTRIME ME PROBLEMA

QËLLIMET

Nxënësit:

- formojnë përfytyrimin mbi problemën dhe pjesët e saj logjike (kushti, pyetja, shprehja numerike, zgjidhja dhe përgjigjja);
- dinë të veçojnë pjesët logjike të problemës nga teksti i problemës;
- zgjidhin problemat me një e më dy njehsime brenda mbledhjes dhe zbritjes deri në 20, me anë të ndërtimit të shprehjes numerike;
- dinë të ndërtojnë problemën mbi bazën e njehsimit të dhënë;
- përforcojnë mbledhjen e zbritjen deri në 20.

Veprimtaritë e nxënësve

Shënim: Gjatë orëve të mëparshme të mësimin, me nxënësit është bërë përgatitja serioze për zgjidhjen e problemave me mbledhje dhe me zbritje: është sqaruar kuptimi i këtyre veprimeve dhe është vendosur raporti midis të tërës dhe pjesës. Termi “problemë” është futur në të folurin praktik. Nxënësit kanë ndërtuar problema të ndryshme sipas figurave, u kanë caktuar atyre shprehjet numerike dhe i kanë zgjidhur ato. Domethënë, nxënësit dinë tashmë të zgjidhin problemat e thjeshta me mbledhje dhe me zbritje. Në orën e mësimin saktësohen termat lidhur me nocionin problemë, formohen tek nxënësit aftësia e veçimit të problemës dhe të pjesëve të saj nga teksti i dhënë. Po ashtu, nxënësit mësojnë ta shkruajnë shkurt përmbajtjen e problemës me mbledhje dhe me zbritje me ndihmën e skemës.

Veprimtaria hyrëse:

Kjo është veprimtaria, me të cilën nxënësit përmes lojës së asociimit zbulojnë se çfarë do të mësojnë në të ardhmen në orët e matematikës. Përgjigjen do ta përftojnë duke zgjidhur asociimin.

GAZETË	PLUS	MINUS	MATEMATIKA
TITULL	MBLEDHËS	I ZBRITSHMI	REZULTATI
SHKRONJAT	MË SHUMË	ZBRITËSI	NJEHSIMI
FJALËT	SHUMA	NDRYSHESA	NUMRAT
TEKSTI	MBLEDHJA	ZBRITJA	USHTRIMET
PROBLEMAT			

Shënim: Para se të kalohet në zgjidhjen e problemave, nxënësve duhet t’u thuhet se fillimisht duhet ta lexojnë me vëmendje tekstin, ta dallojnë kërkesën që kërkohet, ta shkruajnë si duhet shprehjen numerike, të bëjnë njehsimin e saj dhe, sigurisht, t’i përgjigjen me shkrim pyetjes së bërë të problemës.



Teksti mësimor:

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figura ilustruese hyrëse dhe zgjidhin problemën logjike më poshtë: “Si quhen fëmijët peshkatarë, nëse shkopi i peshkimit i Markos është më i gjatë se shkopi i peshkimit i Asimit, por më i shkurtër se shkopi i peshkimit i Natashës”.

Pasi e kanë dëgjuar tekstin, nxënësit arrijnë në përfundimin, se Asimi ka shkopin më të shkurtër të peshkimit, kurse Natasha ka shkopin më të gjatë të peshkimit. Shkopi i peshkimit i Markos ka gjatësinë mesatare. Në figurë sqarojnë me shkronja të mëdha, se kush është secili. Në mes është Markoja, në anën e majtë, me shkopin më të gjatë të peshkimit, është Natasha, kurse në anën e djathtë, me shkopin më të vogël të peshkimit, peshkon Asimi.

Këta fëmijë do të jenë personazhet e kësaj teme mësimi, në të cilën nxënësit do të zgjidhin problemat dhe do t’i ndërtojnë po vetë në bazë të figurës.

Veprimtaria 2:

Nxënësit analizojnë dhe krahasojnë tekstin e ndonjë probleme me 3-4 tekste të ngjashme, për shembull:

1. Markoja ka zënë 7 peshq.
2. Markoja ka zënë 7 peshq, kurse Asimi ka zënë 6 peshq.
3. Markoja ka zënë 7 peshq, kurse Asimi ka zënë 6 peshq. Sa peshq kanë zënë së bashku Markoja dhe Asimi?
4. Sa janë më shumë mollë se dardha?

Gjatë diskutimit, nxënësit arrijnë në përfundimin, se me problemë mund ta quajmë vetëm tekstin e tretë dhe se ky tekst i problemës dallohet prej teksteve të tjera nga që përmban dy pjesë:

1. **kushti**; ajo që është e njohur (Markoja ka zënë 7 peshq, kurse Asimi ka zënë 6 peshq.)
2. **pyetja**; ajo që duhet të gjendet (Sa peshq kanë zënë së bashku Markoja dhe Asimi?)

Në vazhdim të kësaj veprimtarie, nxënësit vizatojnë peshqit, ndërtojnë shprehjen numerike të kësaj probleme $6 + 7$ dhe gjejnë vlerën e saj.

Udhëzim dhe sqarim: Barazimi i përfutur $6 + 7 = 13$ **quhet zgjidhja e problemës**, kurse vlera e shprehjes (13 peshq) është **përgjigja e problemës**. Pastaj, në bazë të figurës së vizatuar, nxënësit i shkruajnë të gjitha barazimet e mundshme: $6 + 7 = 13$, $7 + 6 = 13$, $13 - 7 = 6$, $13 - 6 = 7$. Për çdo barazim hartojnë problemën dhe thonë kushtin e pyetjen. Për shembull: Markoja dhe Asimi kanë zënë bashkë 13 peshq. Asimi ka zënë 6 peshq. Sa peshq ka zënë Markoja?

Veprimtaria 3:

Nxënësit zgjidhin gojarisht problemat duke treguar një nga skemat e mundshme që janë paraqitur në tabelë. Skema ndihmëse përfaqëson shkrimin e shkurtuar për gjetjen e shumës dhe për gjetjen e ndryshesës (mbetjeve).

Skema e parë	
Kanë qenë	<input type="checkbox"/>
_____ -	<input type="checkbox"/>
Gjithsej:	?

Skema e dytë	
Kanë qenë	<input type="checkbox"/>
_____ -	<input type="checkbox"/>
Mbetur:	?

Skema e tretë	
_____ -	<input type="checkbox"/>
_____ -	<input type="checkbox"/>
} ?	

1. Në tryezë janë 6 pjata. Nëna vuri edhe 5 pjata. Sa pjata janë tani gjithsej në tryezë?
2. Në bredhin e Vitit të Ri janë vendosur 5 gogla zbukurimi dhe 6 boça, ndërsa bonbone janë, aq sa ka gogla e boça së bashku. Sa bonbone janë në bredh?



3. Në oborrin e shkollës rriten 7 pisha dhe 6 lisa, kurse ahe janë, aq sa ka bredha dhe lisa së bashku. Sa ahe janë në oborrin e shkollës?
4. Asimi kishte 12 figura. Ai i fali shokut 3 figura. Sa figura i mbetën Asimit?
5. Në dyqanin e fruta-perimeve ishin 11 arka me domate. Gjatë ditës u shitën 5 arka me domate. Sa arka me domate kanë mbetur në dyqan?
6. Në vazo ishin 13 trëndafila. Prej tyre u vyshken 4 trëndafila. Sa trëndafila kanë mbetur në vazo?
7. Hana kishte 10 euro. Ajo bleu 4 euro bonbone prej çokollate. Sa euro i mbetën Hanës?
8. Në autobus ishin 17 pasagjerë. Në stacion dolën 9 pasagjerë. Sa pasagjerë e vazhduan udhëtimin?
9. Në kuti ishin 12 bonbone. Janë ngrënë 6 bonbone. Sa bonbone kanë mbetur në kuti?

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit ndjekin ecurinë e zgjidhjes së problemave:

- lexojnë mirë problemën dhe shohin se çfarë kërkohet në të?
- shkruajnë siç duhet shprehjen numerike;
- gjejnë vlerën e shprehjes numerike;
- i përgjigjen me shkrim pyetjes së bërë.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit ndërtojnë sipas figurës problemat, të cilat i përgjigjen shprehjeve numerike të dhëna.

Udhëzim: Fillimisht duhet gjetur vetia përkatëse, sipas së cilës është bërë klasifikimi. Në figurë shohim, se në akuarium notojnë 2 peshq të mëdhenj dhe 10 peshq të vegjël; 4 peshq janë të verdhë, kurse 8 peshq janë të kuq; 6 peshq notojnë majtas, kurse 6 peshq notojnë djathtas. Mbi bazën e shprehjeve numerike, nxënësit hartojnë dhe shkruajnë problemat në fletore, i zgjidhin ato dhe shkruajnë përgjigjet. Për shembull: problemat mund të jenë kështu:

- 1) $4 + 8$ Në akuarium notojnë 4 peshq të verdhë dhe 8 peshq të kuq. Sa peshq gjithsej janë në akuarium?

Nxënësve u jepet detyrë që të hartojnë problemën e anasjellë, në të cilën dihet, sesa peshq janë gjithsej. Për shembull:

- 2) $10 + 2$ Në akuarium notojnë 10 peshq të vegjël dhe 2 peshq të mëdhenj. Sa peshq gjithsej notojnë në akuarium?

- 3) $6 + 6$ Markoja i ka ushqyer peshqit dhe ka vënë re, se 6 peshq notojnë majtas, kurse 6 peshq notojnë djathtas. Sa peshq ka në akuarium Markoja?

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3, me dy njehsime

Nxënësit zgjidhin dy problemat më poshtë:

1. Vogëlushët kanë zënë 6 peshq të kuq dhe 5 peshq të verdhë. Sa peshq kanë zënë gjithsej vogëlushët? ($6 + 5 = 11$)
2. Vogëlushët kanë zënë 11 peshq dhe kanë kthyer pastaj në ujë 3 peshq. Sa peshq kanë mbetur tek vogëlushët? ($11 - 3 = 8$)

Pas zgjidhjeve organizohet diskutimi:

- A mund të thuhet, se problema e dytë është vazhdim i problemës së parë? (Nxënësit duhet të nxjerrin përfundimin, se përgjigja është pohuese.)
- A mund t'i lidhim këto dy problema në një problemë duke ruajtur radhën e veprimeve të njehsimit? (Nxënësit duhet të nxjerrin përfundimin, se këto dy problema mund të lidhen në një problemë.)



- Si do të ishte problema e re? (Shembull: vogëlushët kanë zënë 6 peshq të kuq dhe 5 peshq të verdhë, ndërsa pastaj kanë kthyer në ujë 3 peshq. Sa peshq kanë tani vogëlushët?)
- Si mund ta shkruajmë shprehjen numerike? ($6 + 5 - 3$)
- Duke pasur parasysh se problema është krijuar me bashkimin e dy problemave, atë mund ta zgjidhim hap pas hapi: 1) $6 + 5 = 11$ peshq; $11 - 3 = 8$ peshq

Pas kësaj veprimtarie hyrëse, e cila shpjegon strukturën e problemës me dy veprime njehsimi dhe mënyrat e zgjidhjes (ndërtimin e shprehjes numerike ose hap pas hapi), nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur **ushtrimin nr. 3** në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit lexojnë më vëmendje problemën, shpjegojnë përzgjedhjen e vet të veprimeve të njehsimit për zgjidhjen e problemës dhe ndërtojnë skemën:

$$\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle\triangle - \triangle\triangle\triangle\triangle\triangle - \triangle\triangle$$

Nxënësit shkruajnë shprehjen numerike në vendin e caktuar në Tekstin mësimor, njehsojnë dhe shkruajnë përgjigjen për pyetjen e problemës.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit ngulitin mbledhjen dhe zbritjen deri në 20.

Ushtrime për përforcim

Nxënësit zgjidhin problemat:

1. Sonja kishte 11 bonbone. Ajo i dha vëllait 6. Sa bonbone i kanë mbetur Sonjës?
2. Marta këputi 12 trëndafila dhe i çoi mësueses 7. Sa trëndafila i kanë mbetur Martës?
3. Velkoja kishte 14 lapsa me ngjyrë. Ai i fali motrës 8. Sa lapsa me ngjyrë i kanë mbetur Velkos?
4. Ivana zgjidhi në ditën e parë 8 problema, kurse ditën e dytë zgjidhi 7 problema. Sa problema zgjidhi gjithsej Ivana?
5. Ditën e kremtimit të ditëlindjes, dhoma ishte zbukuruar me 9 tullumbace. Nëna solli edhe 9 tullumbace të tjera. Sa tullumbace ka tani gjithsej në dhomë?
6. U kapën 12 flutura, ndërsa pastaj fluturuan 7. Sa flutura mbetën?
7. Fluturojnë 14 miza dhe krakëritin 7 bretkosa. Çdo bretkosë zuri nga një mizë. Sa miza mbetën?
8. Janë 13 vogëlushë, kurse kapuçja janë 6. Sa vogëlushë kanë mbetur kokëzbuluar?
9. Vishuni vogëlushëve këpucët sportive! Vogëlushë janë 6 dhe këpucë sportive 6. Edhe sa këpucë sportive u duhen këtyre vogëlushëve?
10. Harto një problemë për mollët në bazë të shprehjes numerike: $13 - 7$.
11. Harto problemën në bazë të shprehjes numerike në vazhdim dhe bëj njehsimin: $11 - 3 + 1$.



43. DITËT E JAVËS

QËLLIMET

Nxënësit:

- dinë ditët e javës dhe renditjen e tyre;
- zbatojnë njësitë matëse të kohës në jetën e përditshme;
- zgjidhin problemat;
- dinë t'i lexojnë të dhënat e thjeshta.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit thonë ditët e javës sipas radhës. Në çdo fletë kalendari shkruajnë shifrën që i përgjigjet vendit të saj në javë. Aty u përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Cilat shifra keni shkruar? (Udhëzim: Shifra 1 është në kalendarin e parë, kjo është dita e parë e javës - e hëna; në kalendarin e dytë është shifra 2, kjo është dita e dytë e javës - e marta e më tej.)
- Me cilën ditë fillon java dhe me cilën mbaron?
- Çfarë ndodh, kur mbaron një javë?
- Nëse sot është e hënë, cila ditë ka qenë dje?
- Nëse nesër do të jetë e mërkurë, cila ditë është sot?
- Nëse dje ka qenë e premte, cila ditë është sot?
- Cila ditë e javës është ndërmjet ditës së martë dhe ditës së enjte?

Veprimtaria 2: Loja e paraqitjes së javës

Nxënësit ndahen në grupe me nga shtatë nxënës.

1. Pjesëtarët e grupit merren vesh, se ç'ditë të javës do të përfaqësojë secili prej tyre. Çdo pjesëtar shkruan në karton emërtimin e ditës së vet dhe e var kartonin në kurriz. Me dhënien e sinjalit nga mësuesi, çdo grup vihet në rreth, në mënyrë të tillë që renditja e nxënësve t'i përgjigjet renditjes së ditëve të javës. Grupi që nuk e bën mirë këtë gjë, del nga loja.
2. Thuhet emërtimi i dy ditëve të javës, largësia midis të cilave është një ditë. Nga çdo grup ngrihen nxënësit që kanë në karton emërtimin e këtyre ditëve. Ndërmjet tyre qëndrojnë nxënësit me emërtimin e ditës përkatëse. Për çdo zgjidhje të saktë, grupi fiton një pikë.

Veprimtaria 3: Loja "Ditët e javës", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore të Edukimit fizik

Nxënësit ndahen në grupe me nga shtatë nxënës (nxënësit qëndrojnë pranë njëri-tjetrit) dhe secilit prej tyre i është caktuar emërtimi i një dite të javës. Mësues-i/ja thotë emërtimin e një dite, për shembull e mërkurë. Atëherë nxënësit që e kanë marrë këtë emër, vrapojnë rreth fëmijëve të grupit të vet dhe kthehen në vendin prej nga janë nisur. Fiton grupi, lojtari i të cilit arrin i pari në vendin e vet. Loja vazhdon me thënien e ditëve të tjera.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1**

Nxënësit lexojnë me vëmendje problemën dhe kuptojnë se, nëse Maja ka qenë tek gjyshja për vizitë të hënën, të martën dhe të mërkurën, kurse vëllai i saj ka qenë po për vizitë të mërkurën, të enjten dhe të premten, atëherë gjyshja ka pasur vizitorë nga dita e hënë deri ditën e premte, gjë që është gjithsej pesë ditë. Nxënësit e shkruajnë përgjigjen në vijën poshtë problemës.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit veçojnë nga numri i përgjithshëm i ditëve, numrin e plotë të javëve.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit lexojnë problemën dhe veçojnë atë që është e njohur dhe atë që kërkohet. Ata e dinë se dy javë bëjnë 14 ditë. Shkruajnë në vendin e caktuar barazimin $14 + 3$, njehsojnë dhe japin përgjigjen për pyetjen e problemës.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit lexojnë problemën dhe kuptojnë se, nëse trëndafili rritet çdo ditë me nga 1 cm, d.m.th. se ai për shtatë ditë do të rritet 7 cm. Pra, për të zgjidhur problemën duhet të njehsohet shprehja numerike $10 \text{ cm} + 7 \text{ cm}$. Nxënësit njehsojnë, shkruajnë në vendin e caktuar dhe japin përgjigjen.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit lexojnë problemën dhe saktësojnë, se ç'është e saktë: pushimi zgjat 2 javë ose 14 ditë. Tashmë kanë kaluar 5 ditë. Ata kërkojnë me zbritje se edhe sa ditë kanë mbetur. Shkruajnë shprehjen numerike $14 - 5$, njehsojnë dhe japin përgjigjen.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë problemën. Nëse Petri është nisur për në fshat ditën e enjte dhe është kthyer pas pesë ditësh, kjo do të thotë se ai ka qëndruar atje ditën e premte, ditën e shtunë, ditën e diel, ditën e hënë dhe ditën e martë. Domethënë, Petri është kthyer ditën e martë.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit studiojnë diagramin me shtylla që ka bërë Markoja. Në këtë diagram janë paraqitur me drejtkëndësha numri i spektatorëve të filmit sipas ditëve të javës dhe këtë numër nxënësit e shohin në shkallën në anën e djathtë të diagramit. Çdo drejtkëndësh ka ngjyrë tjetër lloj dhe i përgjigjet ditës së caktuar të javës (shpjegimin mund ta shohin poshtë diagramit).

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: Më pak spektatorë kanë qenë ditën e martë, kurse më shumë spektatorë kanë qenë ditën e diel. Për t'iu përgjigjur pyetjes, sesa spektatorë më shumë kanë qenë, nxënësit shohin në diagram ndryshesën ndërmjet dy drejtkëndëshave që përfaqësojnë numrin e spektatorëve për dy ditët në fjalë të javës. Gjithashtu, ata mund të lexojnë në diagram dhe të shkruajnë numrin e spektatorëve sipas ditëve dhe kërkojnë ndryshesën ndërmjet numrit më të madh dhe numrit më të vogël. Pyetjes sesa spektatorë e kanë parë gjithsej filmin ditën e hënë dhe ditën e martë, nxënësit lexojnë dhe shkruajnë numrin e spektatorëve nga diagrami dhe gjejnë shumën.

Veprimtaria 11: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Dituri natyre e shoqërie

Nxënësit dëgjojnë rrëfimin më poshtë dhe zgjidhin problemat e dhëna.

"Fëmijë, sot do të nisim në orën e mësimi të matematikës një udhëtim tepër të jashtëzakonshëm. Do të nisemi ditën e hënë dhe do të kthehemi ditën e diel. Gjatë këtij udhëtimi do të takojmë ditët e javës dhe do të zgjidhim problemat! Çdo ditë ka për ju nga një problemë. Udhëtim të mbarë!"



E HËNË

E hëna është dita së cilës vazhdimisht i hapet goja nga përgjumja akoma e gjumit të së dielës.

Detyrë për ju:

- Ngjyros me ngjyrë të kuqe fjalën që është përgjigje e saktë:

Dita e dytë e javës është: dita e mërkurë, dita e premte, dita e martë.

Dita e pestë e javës është: dita e shtunë, dita e premte, dita e hënë.

Dita e shtatë e javës është: dita e premte, dita e enjte, dita e diel.

E MARTË

E marta është dita që zgjohet me nxit, ajo është e vyer dhe vrapon pas punës!

Detyrë për ju:

- Lidh me vijë ditën me numrat përkatës (sipas radhës) të javës:

E hënë 7

E martë 5

E mërkurë 6

E enjte 2

E premte 1

E shtunë 3

E diel 4

E MËRKURË

E mërkura gjithmonë drejt qëndron, ajo ditët e tjera tashmë numëron!

Detyrë për ju:

- Gjej "paraardhësin" dhe "pasardhësin" e ditës:

_____, së martë, _____

_____, së shtunë, _____

_____, së premte, _____

_____, së enjte, _____

E ENJTE

Oho, e enjtja bën zhurmë, gjithmonë bërtet

Detyrë për ju:

- Është e enjte: Maja është tek shoqja e vet. Ka ardhur tek ajo pardje. Në ç' ditë ka ardhur dhe tash sa ditë është e ftuar Maja?
 - Sa ditë janë ndërmjet dy të enjteve?

E PREMTE

Të premten tmerrsisht nxitohet, gjithkush në shtëpi kthehet.

Detyrë për ju:

- Pata duhet të fluturojë mbi shtatë male dhe mbi shtatë dete. Për çdo mal dhe për çdo det i duhet nga një ditë fluturimi. Për sa ditë do t'i kalojë shtatë malet dhe shtatë detet pata?

**E SHTUNË**

Është e lodhur, ngadalë përgatitet që të kotet me qetësi.

Detyrë për ju:

6. Ivani është tash shtatë ditë tek gjyshja në fshat. Pas gjashtë ditësh do të vijnë prindërit për vizitë dhe do ta kthejnë në shtëpi. Sa ditë do të jetë tek gjyshja Ivani?

E DIEL

E diela është ditë e trishtë, ajo derdh lotët, sepse nuk është pak më e gjatë!

Detyrë për ju:

7. Kanë filluar pushimet shkollore. Nevena dhe Milica kanë planifikuar të shkojnë në qendrën e njohur për rrëshqitje me ski në Bjellasicë. Ato u nisën ditën e martë, ndërsa do të kthehen pas tetë ditësh. Cila ditë do të jetë, kur do të kthehen në shtëp?

Shënim: Dita kur janë nisur për në qendrën e rrëshqitjes me ski nuk llogaritet.

Veprimtaria 12:

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën.

Problema: Nina ka qenë për ski 2 javë dhe 3 ditë. Katarina ka qenë për ski 1 javë e 5 ditë. Sa ditë ka qenë për ski Nina dhe sa ditë Katarina? Qarko përgjigjen e saktë.

Nina ka qenë për ski

Katarina ka qenë për ski

12 ditë

15 ditë

17 ditë

19 ditë

12 ditë

16 ditë



44. TRUPAT GJEOMETRIKË

QËLLIMET

Nxënësit:

- krahasojnë sendet sipas formës;
- formojnë përfytyrimin fillestar për paralelepipedin e konin;
- njohin, dallojnë dhe emërtojnë trupat kryesorë gjeometrikë në mjedisin përreth (sfera, cilindri, kubi, koni dhe paralelepiedi);
- dallojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis kubit e paralelepipedit;
- vizatojnë dhe ngjyrosin sendet e të njëjtës formë.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit vënë re sipërfaqet e rrafshëta e të lakuara tek sendet në mjedisin përreth dhe në klasë; sipërfaqja e rrafshët e murit, e bankës, e dërrasës së zezë, sipërfaqja e lakuar e abazhurit, e drurit etj.

Nxënësit përsëritin njohuritë (përfytyrimet) e veta për sferën dhe për cilindrin dhe njohin formën e re: konin.

Nxënësve u jepet modeli i konit për ta prekur dhe nxjerrin përfundimin, se ky trup përbëhet nga sipërfaqja e rrafshët dhe nga sipërfaqja e lakuar, se ka majën dhe se mund të rrokulliset (por jo aq mirë si sfera ose si cilindri). Nxënësit kalojnë pastaj në gjetjen e sendeve në formë koni në mjedisin përreth. Ata thonë sendet në formë koni (shembuj: ostja e akullores, kapuçi zbukurues për ditëlindje, fisheku etj.) dhe vizatojnë disa prej këtyre sendeve.

Veprimtaria 2:

Nxënësit shohin kuti të ndryshme në formë kubi dhe paralelepiedi. Me vrojtim dhe me prekje, nxënësit duhet të arrijnë në përfundimin se kutitë përbëhen vetëm nga disa sipërfaqe të rrafshëta, por se ndërmjet tyre ekzistojnë disa ndryshime.

Nxënësit sistemojnë sende në formë kubi dhe në formë paralelepiedi për të vënë re më mirë ndryshimin midis tyre. Ata shohin sende në formë kubi e paralelepiedi (sënduku, zaret, rafti, tavolina etj.) dhe vizatojnë disa prej këtyre sendeve.

Më pas vazhdon loja: Kush do të përmendë më shumë sende në formë kubi dhe në formë paralelepiedi në klasë.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin se shumë sende në mjedisin përreth kanë formën e trupave gjeometrikë: kubit, paralelepipedit, sferës, cilindrit dhe konit. Në figurën ilustruese hyrëse janë paraqitur sendet e ndryshme, ndërsa nxënësit lidhin me vijë trupin gjeometrik me sendin përkatës në figurën ilustruese.

Veprimtaria 4: "Trasta magjike"

Në një trastë jo të tejdukshme gjenden sendet në formën e të gjithë trupave gjeometrikë: kubi; kutie në formë paralelepiedi, sferë, cilindri dhe koni. Nxënësit, një nga një, i nxjerrin sendet nga trasta dhe i përshkruajnë ato: ç'formë ka sendi, si i ka sipërfaqet, i emërtojnë sendet dhe thonë nga një send të së njëjtës formë.



Në fund të lojës, të gjitha sendet nga trasta ekspozohen në tavolinë. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Ç'gjë është e përbashkët tek të gjitha sendet? **Shënim:** Nxënësit duhet të vënë re se të gjitha këto janë figura hapësinore dhe se ato mund t'i fshehim midis shuplakave si figura të rrafshëta.
- Ç'gjë është e përbashkët tek kubi dhe tek paralelepiedi? **Shënim:** Nxënësit duhet të vënë re, se përbëhen vetëm nga sipërfaqet e rrafshëta, si edhe se kanë nga 6 faqe, 12 brinjë dhe 8 kulme.
- Në ç'gjë ndryshojnë kubi dhe paralelepiedi? **Shënim:** Nxënësit duhet të vënë re, se tek kubi të gjitha faqet janë të barabarta, kurse tek paralelepiedi ato nuk janë të barabarta.
- Ç'gjë është e përbashkët tek cilindri dhe tek koni? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se të përbashkët kanë atë, se tek cilindri dhe tek koni baza është rrethi.)
- Në ç'gjë ndryshojnë cilindri dhe koni? (Nxënësit shohin, se koni ka majë, ndërsa cilindri nuk ka majë. Cilindri ka dy baza, kurse koni ka vetëm një bazë.)
- Cili prej këtyre trupave rrokulliset më mirë: cilindri apo koni? Nxënësit nxjerrin përfundimin, se cilindri rrokulliset më mirë. **Shënim:** Në përkthimin nga greqishtja e vjetër fjala cilindër do të thotë rrokullisës).
- Në ç'grupe mund t'i ndajmë të gjitha këto për të cilët kemi mësuar? **Shënim:** Ndarja ka të bëjë me trupat që përbëhen nga sipërfaqe të rrafshëta; kubi dhe paralelepiedi dhe trupat që kanë sipërfaqe të lakuara; sfera, cilindri e koni.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit mësojnë të vizatojnë cilindrin, sferën e konin dhe njihen me mënyrat e paraqitjes së trupave në një fletë letre. Në **ushtrimin nr. 1**, tri figurat e para janë vizatuar me vija të trasha dhe shërbejnë për vrojtimin e sferës, të cilindrit dhe të konit. Figurat e tjera janë vizatuar me vija të zbehta dhe nxënësit duhet t'i trashin ato me laps.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit kërkojnë trupat e paraqitur të së njëjtës formë dhe i ngjyrosin ato, ashtu siç është treguar: kubin me ngjyrë blu, paralelepipedin me ngjyrë të verdhë, cilindrin me ngjyrë të kuqe, konin me ngjyrë jeshile.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shohin figurën dhe kërkojnë trupat gjeometrikë, i numërojnë ato dhe i shkruajnë të plota fjalitë: ka 6 sfera, 1 kub, 5 paralelepiede, 3 kone (kapuçi i klounit është në formë koni). Hunda e klounit duket si sferë, kurse në njërin dorë klouni mban paralelepipedin, cilindrin, konin dhe kubin.

Veprimtaria 8: Loja "Ku e kam vendin"

Shënim: Që të organizohet kjo lojë, nevojitet një kuti e madhe dhe pesë kuti të vogla. Në kutinë e madhe gjenden sende të ngjyrave, të madhësive dhe të formave të ndryshme gjeometrike. Katër kuti të vogla shërbejnë për klasifikimin e sendeve. Në secilën prej kutive të vogla gjendet nga një figurë (sfera, kubi, cilindri, paralelepiedi, koni), me qëllim që nxënësit të dinë se ku duhet t'i vendosin sendet. Si mjet klasifikimi mund të shërbejnë lodrat e ndryshme në formë sferë, kubi, cilindri, paralelepiedi dhe koni, si edhe sendet e ndryshme (lapsi, osteja e akullores, hinka, kutia e shkrepeve, kubet e lodrave, kutitë e konservave, topat e vegjël ...

Në këtë lojë marrin pjesë të gjithë nxënësit e klasës.

Fëmijët vijnë një nga një tek kutia e madhe dhe, pa shikuar, marrin një send, e prekin atë dhe mbi bazën e prekjës nxjerrin përfundimin se ç'formë ka ai. Thonë formën që ka dhe e vendosin në kutinë që është shënuar për sendet e kësaj forme. Në kohën që një nxënës e nxjerr sendin, nxënësit e tjerë këndojnë këngën "Ku e kam vendin". Nxënësi që gabon duhet ta kthejë prapë sendin në kutinë e madhe. Loja zgjat gjithnjë, deri sa të gjithë nxënësit të marrin pjesë në këtë lojë.



45. TRUPAT DHE FIGURAT GJEOMETRIKE

QËLLIMET

Nxënësit:

- dallojnë dhe emërtojnë figurat gjeometrike: katrorin, drejtkëndëshin, rrethin, trekëndëshin.
- dallojnë dhe emërtojnë trupat kryesorë gjeometrikë në mjedisin përreth (sfera, cilindri, kubi, koni dhe paralelepipedin);
- vizatojnë sendet e të njëjtës formë.

Veprimtaritë e nxënësve

Shënim: Rekomandojmë punën në grupe, në mënyrë që nxënësit të luajnë me sendet dhe me modelet e formave të përmendura gjeometrike, t'i dallojnë karakteristikat e tyre dhe t'i krahasojnë ata.

Mjetet e mësimit: modele prej druri të paralelepipedit e konit, kuba lodrash, sfera të madhësive të ndryshme, modele cilindri e koni, sende të këtyre formave të formave të ndryshme dhe prej materialeve të ndryshme.

Veprimtaria 1:

Nxënësit i krahasojnë fillimisht sendet për nga forma e tyre. Çdo grupi i jepën disa sende të ndryshme me detyrë që t'i ndajnë ato në grupe sipas formës që kanë. Këto mund të jenë rruazat, zaret, kubet lodrave, lapsat, kutitë

Më pas mund të kërkojnë dhe t'i emërtojnë sendet në mjedisin përreth që kanë po të njëjtën formë. Fitues është grupi që ka gjetur me shumë shembuj.

Veprimtaria 2:

Nxënësit vizatojnë katrorin me ndihmën e shabllonit ose të kubit. Nxënësve u jepën shabllonet e përgatitura ose u ndahen kubet dhe shpjegohet mënyra e punës. Nëse u janë dhënë shabllonet, duhet t'i ngjeshin ato fort me njërin dorë, kurse me dorën tjetër ta heqin vijën me laps. Nëse u janë dhënë kubet, vizatojnë në të njëjtën mënyrë; e mbështetin njërin anë të modelit të kubit në letër dhe pastaj heqin vijën me laps përgjatë skajeve. Në të njëjtën mënyrë, nxënësit vizatojnë figurën gjeometrike të drejtkëndëshit me ndihmën e modelit të paralelepipedit.

Çdo çifti nxënësish i jepet letra në formë katrori, e cila paloset përgjatë diagonales (atyre duhet t'u tregohet, sesi bëhet kjo gjë, sepse nxënësit nuk e njohin nocionin diagonalja). Nxënësit duhet ta presin pastaj letrën me gërrshërë përgjatë vijës së përfutur me palosje. Në këtë mënyrë do të përfutur dy trekëndësha dhe çdo nxënës e ngjit njërin prej trekëndëshave në fletore.

Për vizatimin e rrethit, nxënësve u jepën monedhat metalike ose kopsat, të cilat ata i vendosin në fletën e letrës dhe, duke e mbajtur me dorë monedhën metalike ose kopsën, vizatojnë me laps përreth tyre. Si model për vizatim mund të shërbejë cilindri dhe koni, ose ndonjë send tjetër që e ka bazën në formë rrethi.

Prej aplikimeve të prera, nxënësit bëjnë figura të ndryshme (për shembull: anijen kozmike, robotët etj.). Kur ta bëjnë këtë gjë, në çdo figurë të përfutur, duhet që çdonjërin figurë gjeometrike ta ngjyrosin me tjetër lloj ngjyre.



Veprimtaria 3: Loja "Kujdes"

Nxënësve u tregohen katër figura gjeometrike; secila me nga 3 sekonda. Nxënësit i vizatojnë pastaj këto figura ashtu siç i kanë mbajtur mend (renditja, forma, ngjyra).

Teksti mësimor

Veprimtaria 4: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse dhe kërkojnë figurat dhe trupat gjeometrikë të përmendur, të cilët janë ndarë në tri grupe: figurat e rrafshëta (trekëndëshi, rrethi, katrori, drejtkëndëshi; trupat që përbëhen nga sipërfaqet e rrafshëta (kubi, paralelepipedit) dhe trupat që kanë sipërfaqe të lakuara (cilindri, sfera dhe koni). Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Prej cilave figura është bërë kukulla lodruese? (Nxënësit shohin, se qafa, hunda, kapela dhe shkopi kanë formën e cilindrit. Koka ka formën e sferës, kurse trupi ka formën e paralelepipedit.) Ç'gjë tjetër ka formën e cilindrit? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se formën e cilindrit kanë: pishtari, topi, trumbeta e vockël tek zogu i vogël.)
- Çfarë ka formën e sferës? (Nxënësit shohin, se është fjala për: topin, për tullumbacet, për kokat (e zogut, maces, tigrin dhe kukullës lodruese), për fluskat që lëshon zogu i vogël, për hundën e klounit dhe për majën e kapelës të cilën e zbukuron sfera.
- Çfarë ka formën e paralelepipedit? (Nxënësit shohin, se këto janë trupi i kukullës lodruese, gramafoni dha kafazi i zogut të vogël.)
- Çfarë ka formën e konit? (Nxënësit shohin, se kapela e klounit ka formën e konit.)
- Cilat figura gjeometrike mund t'i shohim në figurën ilustruese? (Nxënësit duhet të dallojnë format e ndryshme. Formën e rrethit kanë: pllaka e gramafonit, kapaku i konservës, spaletat tek kukulla lodruese, rrotat e topit, të kuqët në faqet e klounit dhe hallka. Formën e trekëndëshit kanë: kravata e klounit dhe rozetat në kapelën e klounit. Faqet e paralelepipedit janë drejtkëndësha, kurse faqet e katrorit janë katrorë.)

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit e vazhdojnë vizatimin, ashtu siç është filluar dhe vënë re karakteristikat e kubit dhe të paralelepipedit:

- Kubi përbëhet nga 6 faqe. Faqet e kubit janë katrorë dhe të gjitha janë të barabarta.
- Paralelepipedit përbëhet nga 6 faqe. Faqet e paralelepipedit janë drejtkëndësha (6) ose drejtkëndësha (4) dhe katrorë 2.

Veprimtaria 6: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit vizatojnë disa sende, të cilët kanë në përbërje të vet formën e kubit, të paralelepipedit, të cilindrit, të sferës dhe të konit.

Shënim: Vizatimi më i mirë duhet të veçohet dhe të vihet në stendën e klasës.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit shohin kukullën prej druri dhe dallojnë format që kanë pjesët e saj. Numërojnë se çfarë është dashur për ta ndërtuar kukullën, shohin figurën në të cilën janë paraqitur hollësisht të gjitha pjesët e kukullës dhe qarkojnë shkronjën e shkruar në këtë figurë.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 9:

Shënim: Mësuesi duhet t'i përgatisë modelet e trupave gjeometrikë ose modelet e sendeve të ndryshme që kanë karakteristikat e trupave gjeometrikë.

Nxënësit vënë re, se disa sende mund të rrokullisën (sepse janë të rrumbullakët), kurse disa



të rrëshqasin (sepse kanë sipërfaqe të rrafshët). Nxënësit shohin sipërfaqet e rrafshëta dhe u përgjigjen pyetjeve, se ç'formë kanë sipërfaqet e modeleve të veçanta (drejtkëndëshe, katrore, rrethore ...). Mbi bazën e përgjigjeve të dhëna, nxënësit shohin formën rrethore, drejtkëndëshe, katrore dhe trekëndëshe.

Nxënësit krahasojnë blloqet logjike të së njëjtës ngjyrë, por të formave të ndryshme dhe nxjerrin përfundimin, se në ç'gjë ndryshojnë ato.

Veprimtaria 10: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit bëjnë stampa prej patate dhe prej karote. Stampat janë në formë rrethi, drejtkëndëshi, katrori dhe trekëndëshi. Sipërfaqet e stampave i ngjyrosin me ngjyra të ndryshme dhe stampojnë pastaj me to në një fletë vizatimi.

Nxënësit tregojnë:

- rrethin e kuq;
- drejtkëndëshin e verdhë;
- katrorin jeshil;
- trekëndëshin blu.

Veprimtaria 11: Puna në çifte

Nxënësit mendojnë një varg figurash gjeometrike, por në mënyrë të tillë që të mund dallohet rregulla e vargëzimit, me ndihmën e blloqeve logjike të formuara me figura në formë katrorësh, rrethesh, trekëndëshash dhe drejtkëndëshash. Shembull: rrethi, trekëndëshi, rrethi, trekëndëshi...

Veprimtaria 12: Loja "Treni lara-lara"

Në këtë veprimtari marrin pjesë nxënësit e të gjithë klasës. Të gjithë kanë blloqet logjike të formave dhe të ngjyrave të ndryshme. Fillimi i trenit është vendosur në dyshtemenë e klasës, për shkak të hapësirës që nevojitet për lojën. Shembull: katrori, trekëndëshi, rrethi, drejtkëndëshi.

Nxënësi i parë del, e sheh rregullën dhe vazhdon ta zgjerojë trenin. Nxënësit dalin kështu një nga një duke e plotësuar trenin sipas rregullës. Nxënësve u theksohet, se çdo bllok në vazhdim duhet të jetë me ngjyrë tjetërsoj nga blloku i mëparshëm.



46. DHJETËSHET DHE NJËSHET

QËLLIMET


Nxënësit:

- përvetësojnë nocionin numër me dy shifra (shuma e dhjetësheve dhe e njësheve);
- kuptojnë strukturën e numrave deri në 100;
- dinë vlerën e vendit të shifrës në numër;
- dinë se shifra e parë majtas tek numri me dy shifra përfaqëson numrin e dhjetësheve, kurse shifra e dytë përfaqëson numrin e njësheve;
- dinë se cilës dhjetëshe i përket çdo numër deri në 100.

Veprimtaritë e nxënësve

Shënim: Shkrimi i numrave me dy shifra ndërtohet mbi bazën e vlerës së vendit të shifrës në numër. Për këtë arsye, ka rëndësi që nxënësit të kuptojnë, se po e njëjta shifër, mund të ketë kuptime të ndryshme në shkrimin e numrave dhe kjo në varësi të vendit që ajo shifër zë në këtë shkrim. Për shembull, shifra 3 mund të shënojë 3 njëshe, nëse gjendet në vendin e parë nga ana e djathtë dhe 3 dhjetëshe, nëse është në vendin e dytë nga ana e djathtë. Në rast mungese të njësheve në vendin e parë nga ana e djathtë, tek numrat me dy shifra shkruhet 0.

Në fillim të mësimin të numrave nga 21 deri në 100 është shumë i dobishëm edhe përdorimi mjeteve ndihmëse vizuale, midis të cilave rol të veçantë luan loja me numëratore me gogla. Gjithashtu mund të përdoret ndihma vizuale në formën e shiritave me hapësirën për numra, të cilët janë dhënë në materialin didaktik së bashku me Tekstin mësimor.



Nxënësit demonstronjë numrat në ndonjë prej mjeteve ndihmëse vizuale dhe u përgjigjen pyetjeve: Sa dhjetëshe ka numri? Sa njëshe ka?

Veprimtaria 1:

Nxënësit përsëritin dhjetëshet e qindëshes së parë dhe renditjen e tyre në vargun e numrave deri në 100. I renditin dhjetëshet dhe numrat nga fillimi dhe nga fundi. Pas kësaj, nxënësit zhvillojnë në grupe shembujt, tek të cilët duhet të vihet shenja + ose -, në mënyrë të tillë që të përftohen barazimet e sakta:

$70 \bigcirc 20 = 90$

$50 \bigcirc 30 = 80$

$70 \bigcirc 40 = 30$

$50 \bigcirc 10 = 40$

$50 \bigcirc 30 = 20$

$40 \bigcirc 40 = 80$

$40 \bigcirc 60 = 100$

$60 \bigcirc 20 = 40$

$30 \bigcirc 40 = 70$

**Veprimtaria 2:**

Nxënësit vënë pikat në letër për një kohë prej 30 - 40 sekondash. Pastaj përpiqen të kuptojnë, sesi munden lehtë dhe pa gabime të numërojnë, se sa pika ka vënë secili prej tyre në letër. Nxënësve u rikujtohet se si paraqitet sasia e madhe e sendeve me ndihmën e njësisë më të madhe të numërimit: me ndihmën e dhjetësheve; natyrisht që kjo gjë nuk kërkon edhe përdorimin e njësheve. Nxënësit numërojnë grupet me nga 10 pikë dhe me ndihmën e vijave të lakuara të mbyllura i paraqitin këto grupe. Pastaj i bëjnë të ditura rezultatet (p.sh. 5 dhjetëshe dhe 8 njëshe. Nxënësit i shkruajnë rezultatet e numërimeve të tyre, për shembull, 5 dh 8 nj.

Shënim: Ushtrim i dobishëm për nxënësit mund të jetë, për shembull, numërimi i kokrrave të vërteta të fasules.

Udhëzim: Nxënësit vlerësojnë fillimisht me të parë, sesa kokrra fasule mund të gjenden në kavanozin prej gjysmë litri. Pastaj i zbrazin kokrrat e fasules në banka, ndërsa nxënësit duhet t'i numërojnë ato: i grupojnë me nga dhjetë. (Është interesante se kokrrat e fasules janë përdorur si mjet numërimi nga inkasit, popull i lashtë i Amerikës së Jugut; kokrrat me ngjyrë të fasules shënonin nga pesë njëshe, kurse kokrrat e bardha të fasules shënonin njëshet.)

Nxënësit e kuptojnë, sesa e papërshtatshme është të shkruhen numrat e shprehur me dhjetëshe dhe me njëshe me anën e shkronjave "dh" e "nj"; ky është një shkrim tepër i gjatë. Numrat mund t'i shkruajmë më shkurt; heqim shkronjat "dh" e "nj", kurse shifrat i afrojmë. Përftojme numrin me dy shifra, tek i cili shifra majtas tregon numrin e dhjetësheve, kurse shifra djathtas tregon numrin e njësheve. Gjatë leximit, duke filluar nga dhjetëshja e tretë, thonë fillimisht numrin e shprehur me shifrën e parë dhe me shkronjën "dh", ndërsa pastaj numrin e shprehur me shifrën e dytë. Për shembull, ... nj ... dh. Kjo është tridhjetë e shtatë.

Dhjetëshet	Njëshet
3	4

Veprimtaria 3:

Para nxënësve është mjeti ndihmës vizual, me të cilin është paraqitur numri 34 me anën e 34 shkopinjve. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve më poshtë: Cilin numër do të shkruajmë poshtë bashkësisë së shkopinjve? Sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka ky numër? Me ndihmën e cilëve numra do ta shkruajmë numrin 34? Nxënësit shohin se në vendin e dhjetësheve gjendet numri 3, kurse në vendin e njësheve gjendet numri 4. Pas kësaj zhvillohet puna e ngjashme me numrat e tjerë.

Veprimtaria 4:

Para nxënësve është tabela:

dh	nj

Në tabelën e paraqitur, nxënësit shkruajnë numrat: 52, 25, 67, 74, 82, 96.

Nxënësit nxjerrin përfundimin, se shifra 5 gjendet në vendin e dhjetësheve, kurse shifra 2 në vendin e njësheve, përkatësisht vënë re vlerën e vendit të shifrës tek numri me dy shifra

Veprimtaria 5: Loja "Gara e numrave me dy shifra", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik

Tri grupe me nga 10 nxënës vihen në kolonë për një. Largësia midis kolonave është 2 - 3 metra. Nxënësit në kolona mbajnë në gjoks numrat me dy shifra. Kolona e parë numrat nga 51 deri 60, kolona e dytë numrat nga 61 deri në 70 dhe kolona e tretë numrat nga 71 deri në 80. Mësuesi qëndron para kolonës dhe tregon kartonët, në të cilët janë shkruar numrat 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. Nëse, për shembull, tregon kartonin me numër 5, të gjithë nxënësit që kanë në gjoks numrin me dy shifra, tek i cili në vendin e njësheve gjendet shifra 5, vrapojnë rreth kolonës së



tyre dhe kthehen në vendin e vet. Pikën e fiton kolona, pjesëtari i së cilës është kthyer i pari në vendin e vet. Loja përsëritet, deri sa të marrin pjesë në vrapim të gjithë nxënësit e kolonës, natyrisht me radhë. Fituese është kolona që grumbullon më shumë pikë.

Teksti mësimor

Veprimtaria 6: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shkruajnë numrat e pashkruar në karrige. Kur t'i plotësojnë të gjitha karriget me numra, nxënësit shënojnë veçmas numrin e parë dhe të fundit të çdo dhjetësheje, për të dalluar më mirë numrat me të cilët fillojnë dhe me të cilët mbarojnë dhjetëshet. Ata u përgjigjen kërkesave më poshtë:

- Thoni të gjithë numrat e dhjetësheve të dytë, të dhjetësheve të katërt dhe të dhjetësheve të nëntë.
- Thoni dhe shkruani numrin më të madh dhe numrin më të vogël të dhjetësheve të gjashtë.
- Thoni të gjithë numrat me dy shifra, tek të cilët shifra 4 gjendet në vendin e njësheve.
- Thoni të gjithë numrat me dy shifra, tek të cilët shifra 3 gjendet në vendin e dhjetësheve.
- Shkruani të gjithë numrat me dy shifra, tek të cilët numri i dhjetësheve është për 3 më i vogël se numri i njësheve. (Nëse numri i dhjetësheve është për 3 më i vogël se numri i njësheve, atëherë është më mirë të fillohet nga numri, tek i cili është më i madh numri njësheve: 69, 58, 47, 36, 25, 14.)
- Shkruani të gjithë numrat me dy shifra, tek të cilët numri i dhjetësheve është për 2 më i madh se numri i njësheve. (Nëse numri i dhjetësheve është më i madh se numri i njësheve, atëherë është më mirë të fillohet nga shifra më e madhe e dhjetësheve: 97, 86, 75, 64, 53, 42, 31, 20.)

Veprimtaria 7:

Në dërrasë të zezë mbërthehen 10 zarfe, në të cilët janë shkruar numrat rendorë të dhjetësheve të qindësheve të parë. Çdo nxënësi i jepet në një copë letre një numër. Mësuesi thotë numrin e një dhjetësheje, ndërsa nxënësi që ka numrin, i cili i përket kësaj dhjetësheje duhet të vijë shpejt dhe ta futë letrën e vet në zarfin e duhur. Në fund, nxënësit kontrollojnë, nëse numrat në zarfe i përkasin dhjetësheve të duhur.

Veprimtaria 8: Ushtrimet 1, 2 e 3

Nxënësit janë njohur tashmë me numëratoren me gogla, mjetin me dy shifra në të cilën janë vënë goglat. Shifra e parë përfaqëson dhjetëshet, kurse shifra e dytë përfaqëson njëshet. Në **ushtrimin nr. 1**, nxënësit shkruajnë dhe lexojnë numrat që janë paraqitur në numëratoren me gogla.

Në **ushtrimin nr. 2**, nxënësit shkruajnë numrat që duhen.

Në **ushtrimin nr. 3**, nxënësit shkruajnë numrat me dy shifra.

Veprimtaria 9: Loja dhe ushtrimi nr. 4

Loja: Çdo nxënës ka një shifër prej 0 deri në 9. Me dhënien e sinjalit ata formojnë çiftet. Shifra e nxënësit të parë në çift përfaqëson dhjetëshen, kurse shifra e nxënësit të dytë përfaqëson njëshet. Nxënësit thonë numrin që kanë marrë. Pas kësaj nxënësit i ndërrojnë vendet (domethënë edhe numrat i ndërrojnë vendet) dhe thonë numrin që kanë marrë me ndërrimin e shifrave.

Udhëzim: Organizohet diskutimi lidhur me disa raste. Për shembull:

- Cila shifër ka vlerën më të madhe? (Nxënësit e dinë, se kjo është shifra 9.)
- Nëse vogëlushja me numrin 1 qëndron pranë vogëlushit me numrin 9 në anën e tij të djathtë, cili numër do të përftohet?



- Cila shifër përfaqëson tani vlerën më të madhe? (Nxënësit nxjerrin përfundimin, se vlerën më të madhe e ka numri 1, sepse gjendet në vendin e dhjetësheve dhe vlen 10 njëshe, kurse shifra 9 është në vendin e njësheve dhe vlen 9 njëshe.)
- Nëse një nxënës në çift ka numrin 0, cilët numra përftohen? (Zeroja në vendin e njësheve dhe çfarëdo lloj shifre tjetër në vendin e dhjetësheve përfaqësojnë numrin me dy shifra; domethënë numrin me disa dhjetëshe. Por, në rastin e ndërrimit të vendeve, përftohet numri me një shifër. Zeroja në vendin e parë zakonisht nuk shkruhet, por edhe nëse shkruhet, ajo nuk ndryshon vlerën e numrit pranë të cilit është shkruar majtas).

Pas lojës nxënësit zgjidhin **ushtrimin nr. 4**.

Veprimtaria 10: Ushtrimet nr. 5 e 6

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit shkojnë në kinema dhe duhet t'i gjejnë vendet e veta. Nxënësit duhet ta shkruajnë rreshtin (numrin e dhjetësheve) dhe vendin (numrin e njësheve): $24 =$ rreshti i dytë, vendi i katërt etj. Pas kësaj, në skemën e sallës gjendet rreshti dhe vendi përkatës.



47. SHKRIMI DHE LEXIMI I NUMRAVE DERI NË 100

QËLLIMET

Nxënësit:

- kuptojnë strukturën e numrave me dy shifra, p.sh. $35 = 3$ dh 5 nj;
- lexojnë dhe shkruajnë numrat deri në 100;
- përvetësojnë thënien dhe shkrimin siç duhet të numrave me dy shifra.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Enigma", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi.

Përmbajtja e lojës: Mësues-i/ja lexon gjëgjëzën "Të rreh, por nuk e sheh". Nxënësit duhet ta ndërrojnë numrin e tabelës së parë me dhjetëshe dhe njëshe dhe me këtë të gjejnë në tabelën e dytë shkronjën: numri i dhjetësheve përcakton rreshtin, kurse numri i njësheve përcakton kolonën, në pikën e prerjes të rreshtit e të kolonës gjendet shkronja e kërkuar. Nxënësit shkruajnë shkronjë pas shkronje dhe japin përgjigjen: ERA

98	76	38

	5 nj	6 nj	8 nj
3 dh	Nj	D	A
7 dh	T	R	M
9 dh	R	I	E

Veprimtaria 2:

Shënim: Nxënësit përsëritin shkrimin e dhjetësheve të qindëseshes së parë, për shembull; 2 dh = njëzet etj.

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Shënim: Nxënësit i johin mirë numrat e dhjetëseshes së parë, përbërjen dhe mënyrën e thënies së tyre. Ndërkohë, nxënësit ndeshen tani për herë të parë me shkrimin e këtyre numrave me shkronja.

Rëndësi ka që vëmendja e nxënësve të drejtohet në kuptimin e parimit të numrave me dy shifra, sepse ekziston ndryshimi në shkrimin dhe në leximin e numrave nga dhjetë deri në njëzet. Tek numrat e dhjetëseshes së dytë (11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19) gjatë leximit thuhet fillimisht njëshet: **njëmbëdhjetë**, **dymbëdhjetë**, **trembëdhjetë**, **katërmëdhjetë**, **pesëmbëdhjetë**, **gjashtëmbëdhjetë**, **shtatëmbëdhjetë**, **tetëmbëdhjetë**, **nëntëmbëdhjetë**, kurse gjatë shkrimit me shifra, fillimisht shkruhen dhjetëshet.

Nxënësit vënë re dhe përvetësojnë, mënyrën e shkrimit dhe të leximit të numrave të tjerë me dy shifra, gjë që mund të paraqitet me ndihmën e skemës:



$$= 3 \text{ dh } 5 \text{ nj} = 35$$

tridhjetë e pesë

**Veprimtaria 4:**


Nxënësit lexojnë numrat e shkruar në dërrasë të zezë:

71 dhe 17 61 dhe 16 81 dhe 18 51 dhe 15
91 dhe 19 41 dhe 14 21 dhe 12 31 dhe 13

Nxënësit vënë re ndryshimin në emërtimin e numrave që kanë shifrën e dhjetësheve 1 nga emërtimi i numrave të tjerë me dy shifra.

Veprimtaria 5:

Nxënësve u tregohen numrat më ndihmën e mjeteve mësimore vizuale dhe i shkruajnë numrat me shifra dhe me fjalë. Për shembull:



4 dh 6 nj ose 46, shkruajmë: *dyzet e gjashtë*

Pas paraqitjes, nxënësit plotësojnë çdo herë skemën:

__ dh __ nj ose __, shkruajmë: _____

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit, duke u mbështetur në strukturën e numrave me dy shifra, ushtrohen në shkrimin e numrave të qindëshes së parë me shifra dhe me fjalë.

Shënim: Duhet të tregohet kujdes në shkrimin ndaras, për shembull: tetëdhjetë e tetë.

**Veprimtaria 7: Loja "Gjej shkronjat", lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore
Gjuhë shqipe dhe letërsi**

Nxënësit ndahen në katër grupe. Çdo grupi i jepet kartoni me shkronja (8kartonë - 8 shkronja). Nxënësit duhet të formulojnë fjalën, në të cilën do të përdoren të gjitha shkronjat (shembuj: dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, trembëdhjetë). Fitues është grupi që e zgjidh këtë më parë.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin fjalëkryqin. Pas plotësimit siç duhet të fjalëkryqit, nxënësit mund të lexojnë vertikalisht QINDËSHJA E PARË.

Veprimtaria 9: Loja "Kush do të arrijë më shpejt tek numri me dy shifra?"

Para nxënësve janë dy kanistra. Në njërin kanistër janë dhjetëshet, kurse në kanistrën tjetër janë njëshet. Nxënësit marrin një nga një numrat (me zgjedhje të rastësishme) nga njëra dhe nga tjetra kanistër, e thonë numrin që kanë marrë dhe shkruajnë atë. Vijnë tek numri me dy shifra: për shembull, $20 + 5$ është njëzet e pesë, përkatësisht shkruajnë numrin 25.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit, me ndihmën e shifrave të ofruara, formojnë dhe shkruajnë numrat me dy shifra, me kusht që shifrat të mos përsëriten (mendojmë se janë dhënë tre kartonë me numrat 2, 5, 7, ndërsa nxënësit i përsëritin vetëm ato).

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 4: Loja "Numrat e arratisur?"

Nxënësve u thuhet: "Në tabelat e paraqitura çdo numër jeton në shtëpinë e vet: Po mund të vini re, se disa shtëpi janë boshe, për arsye se disa numra kanë ikur. Cilët numra janë këto? Nxënësit duhet të mendojnë dhe t'i kthejmë "të arratisurit" në shtëpitë e veta.



Nxënësit kërkojnë rregullën e renditjes së numrave në tabela dhe i plotësojnë numrat e kapërcyer. Fitues i kësaj loje është nxënësi që i plotëson siç duhet të gjitha “shtëpitë”.

Zgjidhja: Në tabelën e parë në çdo rresht shifra e dhjetësheve është e barabartë, ndërsa në kolonë është e barabartë shifra e njësheve. Për këtë arsye, nxënësit shkruajnë në rreshtin e parë numrat 30 dhe 32, në rreshtin e dytë shkruajnë numrat 54 dhe 52, kurse në rreshtin e tretë shkruajnë numrat 81 dhe 87.

Në tabelën e dytë, është e kundërta, në rreshta mbetet e njëjtë shifra e njësheve, kurse në kolonë mbetet e njëjtë shifra e dhjetësheve. Domethënë, në rreshtin e parë nxënësit shkruajnë numrat 65 dhe 75, në rreshtin e dytë shkruajnë numrat 48 dhe 78 dhe 98, kurse në rreshtin e tretë shkruajnë numrat 49, 69 dhe 19.

Shënim: Nxënësit ndeshen praktikisht me të gjitha tipat e ushtrimeve të mëparshme, por kërkohet një nivel më i lartë i përgatitjes logjike të nxënësve.

Veprimtaria 12: Loja: Unë jam “PO”, kurse unë jam “JO”!

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet.

Udhëzim: Nxënësit kanë kartonët, në të cilët shkruan PO dhe JO. Kur mësuesi tregon një nga ushtrimet, ata ngrenë lart kartonët me përgjigjet PO ose JO. Përgjigjet nxënësi që e çon i pari kartonin.

Çfarë është e saktë dhe çfarë është e pasaktë? Pas përgjigjes shkruhet fjala PO ose JO si përgjigje e saktë.

$$3 \text{ Dh dhe } 4 \text{ Nj} = 34$$

$$3 \text{ Dh dhe } 2 \text{ Nj} = 23$$

$$4 \text{ Dh dhe } 6 \text{ Nj} = 46$$

$$6 \text{ Dh dhe } 5 \text{ Nj} = 56$$

$$8 \text{ Dh dhe } 5 \text{ Nj} = 85$$

$$5 \text{ Dh dhe } 1 \text{ Nj} = 15$$

Veprimtaria 13: Puna në stacione

Nxënësit zgjidhin ushtrimet.

Udhëzim: Nxënësit e të gjithë klasës ndahen në katër grupe. Të gjitha grupet kalojnë nëpër të gjitha stacionet, duke i zgjidhur ushtrimet në çdo stacion. Puna fillon me këngën që zgjedh mësues-i/ja, kurse puna në stacione përfundon, kur mësues-i/ja e ndërpret këngën. Grupet atëherë i ndërrojnë vendet dhe nisen për në stacionin e dytë. Një ecuri e tillë përsëritet gjithnjë, deri sa të arrihet në stacionin e fundit. Pas kësaj, vijon biseda për ushtrimet.

Stacioni i parë

- Shkruaj me shifra numrat:

tridhjetë e tetë ____ gjashtëdhjetë e tre ____

pesëdhjetë e pesë ____ tetëdhjetë e nëntë ____

Stacioni i dytë

- Shkruaj me shifra të gjithë numrat:

e dhjetëseshes së 4^{-të}: 31, _____

e dhjetëseshes së 6^{-të}: _____, 54, _____

e dhjetëseshes së 8^{-të}: _____

Stacioni i tretë

- Shkruaj se cilës dhjetëshe i përkasin numrat e dhënë:

53: _____ 67: _____

87: _____ 34: _____



Stacioni i katërt

4. Me ndihmën e shifrave 2, 5 dhe 8, shkruaj të gjithë numrat me dy shifra duke përdorur të njëjtën shifër në secilin numër vetëm një herë. Sa numra të tillë janë?

Veprimtaria 14:

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Ata i shkruajnë të gjithë numrat me dy shifra, në shkrimin e të cilëve përdoret shifra 1. U përgjigjen pyetjeve:

- Sa numra të tillë ka?
- Sa numra ka, tek të cilët me shifrën 1 është shkruar dhjetëshja?
- Sa numra të tillë ka, të cilëve me shifrën 1 u janë shkruar njëshet?



48. NUMRAT DERI NË 100

QËLLIMET

Nxënësit:

- numërojnë, shkruajnë dhe lexojnë numrat deri 100;
- shkruajnë dhe thonë siç duhet numrat;
- dinë renditjen e numrave deri në 100.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin vargun me gogla, në të cilin janë shkruar numrat deri në 100 dhe shkruajnë numrat që janë lënë pa shkruar. Numërojnë deri në 100 në mënyra të ndryshme: nga numri 35 deri tek numri 47; nga numri 72 deri tek numri 88; mbarë dhe mbrapsht. Nxënësit vënë re paraardhësit dhe pasardhësit e numrave të caktuar dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Thoni dhjetëshet me dy shifra të qindëshes së parë (10, 20, 30, 40, 50, 60, 70, 80, 90). Sa ka prej tyre? (9)
- Sa numra me dy shifra ka, që përfundojnë me shifrën 1? (Numra me numrin e fiksuar të njësheve ka aq, sa dhjetëshe të ndryshme me dy shifra mund të shkruajmë; nëntë.)
- Për sa është më i madh numri 11 nga numri 1? (Për 10) Për sa është më i madh numri 31 nga numri 21?
- Thoni dhe shkruani: a) numrin më të madh me dy shifra; b) numrin më të vogël me dy shifra; c) numrat me dy shifra që shkruhen me ndihmën e shifrave 8 dhe 2 (28, 22, 82, 88); numrat më të vegjël se 42, por më të mëdhenj se 33.
- Sa numra me dy shifra ka, që janë më të mëdhenj se 25, por që përfundojnë me shifrën 5? Cilët numra janë këto? (35, 45, 55, 65, 75, 85, 95. Ata janë 7.)

Veprimtaria 2: Loja "Kush e tregon më shpejt numrin?"

Në dërrasë të zezë janë varur dy tabela, në të cilët janë shkruar numrat me renditje të lirë. Për shembull: nga numri 61 deri tek numri 90 (nga numri 31 deri tek numri 60 etj.) Pjesëmarrësit në lojë duhet të emërtojnë dhe të tregojnë sipas radhës në tabelë të gjithë numrat nga numri 61 deri tek numri 90. Kush e bën më shpejt këtë gjë, ai është fituesi. Mund të organizohet gara midis dy ekipeve që kanë një numër të barabartë nxënësish në përbërje.

Pamja e përafërt e tabelave:

41	51	31	34	44
59	60	58	57	42
43	53	55	35	56
32	52	46	36	54
45	33	37	39	48
38	50	40	49	47

90	75	71	63	66
67	82	86	68	76
87	61	73	89	81
74	88	65	77	84
80	69	78	62	70
64	83	72	79	85



Veprimtaria 3: Ushtrimet 1 dhe 2

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 4:

Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Në ç'gjë janë të ngjashëm dhe në ç'ndryshojnë numrat e çdo çifti që janë shkruar në dërrasë të zezë?

12 dhe 15	52 dhe 25	42 dhe 62
13 dhe 14	37 dhe 73	57 dhe 79

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit analizojnë çdo bashkësi të numrave, veçojnë një karakteristikë, të cilën e ka shumica e numrave në këtë bashkësi., kërkojnë në bashkësi numrin që nuk e ka këtë bashkësi dhe e fshijnë atë.

Zgjidhja: Në bashkësinë e parë, numri që nuk i takon grupit është numri 25, si numri i vetëm me dy shifra në bashkësinë e numrave të tjerë me një shifër.

Në bashkësinë e dytë, numri që nuk i takon grupit është numri 9, si numri i vetëm me një shifër në bashkësinë e numrave të tjerë me dy shifra.

Në bashkësinë e tretë, numri që nuk i takon grupit është numri 45, sepse të gjithë numrat e tjerë kanë numrin e dhjetësheve të barabartë me 3.

Në bashkësinë e katërt, numri që nuk i takon grupit është numri 21, sepse të gjithë numrat e tjerë janë numra me disa dhjetëshe.

Në bashkësinë e pestë, numri që nuk i takon grupit është numri 50, sepse të gjithë numrat e tjerë kanë 5 njëshe (mbarojnë me shifrën 5).

Në bashkësinë e gjashtë, numri që nuk i takon grupit është numri 35, sepse të gjithë numrat e tjerë kanë numrin e barabartë të dhjetësheve e të njësheve (janë të shkruar me të njëjtat shifra.)

Në bashkësinë e shtatë, numri që nuk i takon grupit është numri 34, sepse të gjithë numrat e tjerë kanë shifrën e dhjetësheve 4.

Në bashkësinë e tetë, numri që nuk i takon grupit është numri 15, sepse të gjithë numrat e tjerë kanë numrin e njëjtë të njësheve 2.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike, gjejnë rezultatin në rreshtin e parë të tabelës dhe shkruajnë në rreshtin e dytë të kolonës përkatëse shkronjën që është shkruar pranë shprehjes numerike. Në fund mund të lexojnë fjalën NUMRAT.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Në tabelë janë shkruar me një renditje të lirë dhe në madhësi të ndryshme numrat nga 1 deri në 51. Nxënësit i gjejnë dhe i emërtojnë numrat sipas radhës, duke i regjistruar ata në tabelë.

Ushtrime kontrolli

Veprimtaria 8:

Nxënësit përforcojnë njohuritë për vargun e numrave.

Shënim: Për përforcimin e njohurive për vargun e numrave mund të shfrytëzohen situatat e ndryshme nga jeta e përditshme. Për shembull:

- Në çdo kat janë nga 4 apartamente banimi. Numri i njërit prej apartamenteve të banimit është 38. Ç'numra të tjerë të apartamenteve të banimit mund të jenë në këtë kat (shkruhen disa variante)?



49. PARAARDHËSI DHE PASARDHËSI I NJË NUMRI ME DY SHIFRA

QËLLIMET

Nxënësit:

- gjejnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrit të dhënë;
- dallojnë neutralitetin e zeros si mbledhës dhe si zbritës në shembujt konkretë;
- dinë t'i krahasojnë numrat duke shfrytëzuar njohuritë për numërimin; 34 është më pak se 35, për arsye se gjatë numërimit 34 vjen para 35;
- dinë të mbledhin dhe të zbresin numrat mbi bazën e njohjes së vargut numerik: $89 + 1$, $90 - 1$.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Luajmë paraardhësin dhe pasardhësin! - lidhja ndërlëndore me lëndët mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi, Natyra dhe shoqëria dhe Kultura muzikore

Shënim: Kjo veprimtari mund t'u shërbejë nxënësve për të përsëritur njohuritë për nocionin "pason" dhe "paraprin", para se të kalohet tek nocionet paraardhës dhe pasardhës i numrit me dy shifra.

Shkruaj "paraardhësin" dhe "pasardhësin"

ME SHKRONJA:

___, G, ___
___, A, ___
___, K, ___
___, O, ___

ME STINËT E VITIT:

___, VERA, ___
___, DIMRI, ___
___, VJESHTA, ___
___, PRANVERA, ___

ME DITËT E JAVËS:

___, E MARTË, ___
___, E PREMTE, ___
___, E MËRKURË, ___
___, E SHTUNË, ___

ME NOTA:

___, Re, ___
___, Fa, ___
___, Si, ___
___, Mi, ___

ME PJESËT E DITËS:

___, MËNGJESI, ___
___, NATA, ___
___, PASDITE, ___

ME KOHË:

___, SOT, ___
___, DJE, ___
___, NESËR, ___

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit plotësojnë me numra dritaret e vagonëve të trenit. Numri i trenit është shënuar në lokomotivë. Tek treni i parë, numri i vagonit të parë është pasardhësi i numrit të trenit.



Pas kësaj veprimtarie, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

1. Si gjendet pasardhësi i një numri të dhënë? (Nxënësve duhet t'u sqarohet, se me mbledhjen e njëshit gjendet pasardhësi i këtij numri.)

Në trenin e dytë, vagoni i parë ka numrin që i paraprin numrit të dhënë.

2. Si gjendet paraardhësi i një numri të dhënë? (Nxënësve duhet t'u sqarohet, se me zbritjen e njëshit gjendet paraardhësi i këtij numri.)

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimin, tek i cili duhet të gjendet paraardhësi dhe pasardhësi i numrit të dhënë.

Veprimtaria 4: Puna në çifte

Nxënësit i japin njëri-tjetrit me zgjedhje me nga gjashtë numra me dy shifra: Këta numra i renditin sipas madhësisë dhe secilin prej tyre e plotësojnë me pasardhësin e tij.

Shembull: 34, 73, 56, 67, 28, 43

28, 29 34, 35 43, 44 56, 57 67, 68 73, 74

Veprimtaria 5:

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Plotëso:

32, ____, 34 34, ____ ____, 55

45, ____, 47 67, ____ ____, 99

Veprimtaria 6: Loja "Gjeni numrat fqinjë",

lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Edukimi fizik

Udhëzim: Për lojën duhet topi ose dy topa; topi i madh dhe topi i vogël (ose topa të ngjyrave të ndryshme).

Mësues-i/ja ia hedh topin herë njërit, herë tjetrit nxënës-lojtar, ndërsa këta e kthejnë topin dhe i përgjigjen pyetjes së mësues-it/es.

Kur mësues-i/ja e hedh topin ai/ajo thotë ndonjë numër, për shembull, njëzet e shtatë, kurse lojtari duhet të thotë paraardhësin dhe pasardhësin e këtij numri (26 dhe 28).

Shënim: Detyrimisht duhet të thonë me parë paraardhësin dhe pastaj pasardhësin.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike që janë të shkruara në papiruse dhe rezultatet i renditin nga më i vogli tek më i madhi. Poshtë përgjigjes shkruajnë shkronjat dhe përftojnë tipin e anijes luftarake.

0	21	37	44	50	65	98
F	R	E	G	A	T	A

Shënim: Nxënësve u rikujtohet roli i numrit 0 gjatë mbledhjes dhe zbritjes dhe ata e kuptojnë se 0 është ndryshesa e dy numrave të barabartë.

Për ta drejtuar mirë anijen duhet të dihet mirë që të njehsohet. Në velat e anijes janë shkruar shprehjet numerike dhe nxënësit gjejnë vlerën e tyre duke shfrytëzuar njohuritë e veta për vargun numerik deri në 100.

**Veprimtaria 8: Ushtrimet nr. 3 e 4**

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit i ngulitin njohuritë për vargun numerik dhe i lidhin numrat (pikat) nga 21 deri në 58. Ata përftojnë figurën e robotit mbledhës, me të cilin janë njohur tashmë qysh më parë. Nxënësit e krahasojnë çdo numër të tabelës me numrin 61, duke shfrytëzuar njohuritë për numërimin dhe, në varësi të asaj, nëse numri është më i madh apo më i vogël se 61, mbledhin ose zbresin njëshin. Me fjalë të tjera, për numrat që janë më të vegjël se 61 gjejnë pasardhësin, kurse për numrat që janë më të mëdhenj se 61 gjejnë paraardhësin.

Veprimtaria 10: Loja “Kush i përket secilës dhjetëshe?”

Udhëzim: Pesë nxënësve u jepet fletushka, në të cilën janë shkruar: dhjetëshja e 4-t, dhjetëshja e 5-të, dhjetëshja e 6-të dhe dhjetëshja e 10-të. Ata dalin para dërrasës së zezë dhe e ngrenë lart fletushkën që të shihet. Nxënësve të tjerë u ndahen fletushkat me numrat që u përkasin këtyre dhjetësheve. Më dhënien e sinjalit nga mësues-i/ja, çdo nxënës duhet ta “gjejë” dhjetëshen e vet dhe të vendoset pas saj. Duke iu përgjigjur pyetjeve, nxënësit përsëritin gjithçka për numrat.

Këto janë disa nga pyetjet që mund të bëhen:

- Sa “numra” ka në dhjetëshen tënde? Shkruaji ata në dërrasë të zezë.
- I sati je ti në radhë në kolonë? Shkruaje këtë në dërrasë të zezë.
- Si e quajmë këtë numër?
- Cili numër është në fletushkën tënde? Cili numër duhet të jetë para këtij numri dhe cili numër duhet të jetë pas?
- Ç’janë këto numra për numrin që ti mban në dorë?
- Tre nxënës thonë numrat e vet. Cili prej këtyre numrave është më i madh?
- Ç’shenja përdorim për t’i krahasuar numrat? Shkruajmë shenjat në dërrasë të zezë.



50. KRAHASIMI I NUMRAVE DERI NË 100

QËLLIMET

Nxënësit:

- renditin sipas madhësisë numrat natyrorë deri në 100.
- shkruajnë relacionet midis numrave ($<$, $>$, $=$) gjatë zgjidhjes së ushtrimeve;
- krahasojnë numrat deri në 100;
- dinë t'i lexojnë të dhënat e thjeshta.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Shënim: Kjo veprimtari mund të përdoret si hyrje për krahasimin e numrave deri në 100.

Një nxënës i numëron nxënësit e klasës dhe përcakton numrin e tyre. Nxënësi tjetër numëron çantat e nxënësve dhe përcakton numrin e tyre. Nxënësit e vënë re, se numri i nxënësve dhe numri çantave të tyre është i barabartë.

Nxënësi në vazhdim përcakton me numërim numrin e bankave në klasë. (Shembull: 16 banka.). Nxënësit vërejnë se banka ka më pak, se sa ka nxënës. Në dërrasë të zezë shkruhet $16 < 25$, d.m.th. se banka ka më pak, sesa ka nxënës. Pastaj shkruhet $25 > 16$ d.m.th. se nxënës ka më shumë, sesa ka banka.

Në vazhdim thuhet edhe shembuj të tjerë nga mjedisi përreth, çfarë ka më shumë, çfarë ka më pak dhe çfarë ka në numër të njëjtë.

Veprimtaria 2:

Nxënësit përsëritin njohuritë e veta për vargun numerik në segmentin numerik. Saktësojnë nocionin e dhjetëshes paraardhëse dhe të dhjetëshes pasardhëse, të numrit paraardhës dhe të numrit pasardhës.

0 < 10 < 20 < 30 < 40 < 50 < 60 < 70 < 80 < 90 < 100

60 < 61 < 62 < 63 < 64 < 65 < 66 < 67 < 68 < 69 < 70

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Katër shoqe: Jovana, Ana, Hana dhe Sanja kanë veshur fustanet, në të cilat janë shkruar numrat me dy shifra. Mbi bazën e thënieve të vogëlusheve, nxënësit gjejnë secilën prej tyre në figurë dhe pranë secilës vogëlushe shkruajnë emrin e saj.

- Unë quhem Ana. Numri në fustanin tim gjendet ndërmjet numrave 80 dhe 82.
- Në fustanin tim është shkruar numri, numri i dhjetësheve të të cilit është për 4 më i madh se numri i njësheve. Unë jam Sanja.
- Quhem Jovana. Numri në fustanin tim është më i madhi ndër numrat që janë shkruar në fustanet e shoqeve të mia.
- Ndërsa numri im është më i vogli. Unë jam Hana.



Nxënësit e kanë përvetësuar tashmë faktin, se shifra e parë tregon numrin e dhjetësheve, kurse shifra e dytë tregon numrin e njësheve. Kjo gjë ka rëndësi të madhe në krahasimin e numrave.

Nxënësit kalojnë nga krahasimi i numrave me një shifër tek krahasimi i numrave me dy shifra:

$$\begin{array}{ccc} 6 < 8 & 7 > 1 & 6 > 3 \\ 6 \text{ Dh} < 8 \text{ Dh} & 8 \text{ Dh} = 8 \text{ Dh} & 6 \text{ Dh} > 3 \text{ Dh} \\ 62 < 87 & 87 > 81 & 62 > 32 \end{array}$$

Nxënësit arrijnë në përfundimin:

1. Krahasimi i numrave me dy shifra fillon nga dhjetëshet.
2. Më i madh (më i vogël) është ai numër, i cili ka më shumë (më pak) dhjetëshe.
3. Nëse numri i dhjetësheve është i barabartë, atëherë krahasojmë njëshet.
4. Më i madh (më i vogël) është ai numër, i cila ka më shumë (më pak) njëshe.

Nxënësit vënë re, se më i madh është numri që ka më shumë dhjetëshe ndërsa, nëse dy numra kanë numrin e barabartë të dhjetësheve, atëherë më i madh është numri që ka numrin më të madh të njësheve.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësve u kujtohet fillimisht krahasimi i numrave me një shifër, i dhjetësheve dhe i numrave me dy shifra.

Shënim: Gjatë krahasimit të numrave me dy shifra, nxënësit mbështeten në përbërjen e numrave nga dhjetëshet dhe nga njëshet: 16 d.m.th. këto janë 1 dhjetëshe dhe 6 njëshe, 60 - 6 dhjetëshe, 1 dh < 6 dh, domethënë 16 < 60. Meqë emërtimet e këtyre numrave janë të ngjashme (shumë nxënës nuk bëjnë dallimin e tyre as me të dëgjuar), duhet të zhvillohen shpesh ushtrimet gojore për krahasimin e numrave të dhjetësheve së dytë dhe të numrave me disa dhjetëshe (13 dhe 30, 15 dhe 50 etj.).

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit e zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit i shfrytëzojnë njohuritë e veta për krahasimin e numrave me dy shifra dhe në vend të yjzave shkruajnë numrat e duhur:

$$\begin{array}{cccc} 61 > 6\underline{0} & 89 < \underline{9}0 & 96 < \underline{9}8 & 27 > \underline{2}0 \\ \underline{7}2 = \underline{7}2 & \underline{4}9 > 48 & \underline{3}0 = \underline{3}0 & 18 < \underline{1}9 \end{array}$$

Tek shembulli $27 > 2^*$ në vend të yjzës mund të jenë shifrat:

0, 1, 2, 3, 4, 5, 6.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit, prej shifrave të shkruara në drurë, formojnë dhe shkruajnë numrat më të vegjël dhe më të mëdhenj me dy shifra. Ata vënë re, se në rastin e numrit më të vogël, në vendin e dhjetësheve duhet të vihet shifra më e vogël, kurse në vendin e njësheve, gjithashtu, duhet të zgjidhet shifra më e vogël prej shifrave të mbetura. Për shkrimin e numrit më të madh në vendin e dhjetësheve duhet të vihet shifra më e madhe prej shifrave të ofruara, kurse në vendin e njësheve duhet të shkruhet shifra më e madhe prej shifrave të mbetura.

Nxënësit i renditin numrat e përfutur nga më i vogli deri tek më i madhi.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit i zhvillojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit studiojnë diagramin dhe u përgjigjen pyetjeve.



Shënim: Nxënësve u shpjegohet, se më e moshuar ka kuptimin *ka më shumë vjet*; më i ri (më e re) ka kuptimin *ka më pak vjet*.

Ushtrime për përforsim:

Veprimtaria 10:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet e përgatitur paraprakisht në fletën e punës.

1. Shkruaj të gjitha numrat që gjenden ndërmjet 34 dhe 43.
2. Shkruaj të gjitha numrat ndërmjet 68 dhe 76.
3. Shkruaj të gjitha numrat ndërmjet 86 dhe 98.
4. Plotëso vargun:

48 _____ 53 _____

59 _____ 64 _____

91 _____ 87 _____

84 _____ 78 _____

Veprimtaria 11:

Më short nxirren 14 nxënës. Ata ndahen në dy grupe me nga 7 nxënës. Çdo nxënësi i jepet nga një numër. Nxënësve të grupit të parë u jepen numrat: 47, 26, 39, 18, 67, 83, 95. Nxënësve të grupit të dytë u jepen numrat: 66, 29, 80, 54, 73, 20, 37. Nxënësit e grupit të parë, sa më parë që të mundën, formojnë rreshtin nga numri më i vogël deri tek numri më i madh, kurse nxënësit e grupit të dytë formojnë rreshtin nga numri më i madh deri tek numri më i vogël. Grupi që zhvillon më shpejt dhe siç duhet ushtrimin, është fitues. Vijon e njëjta lojë me nxënës të tjerë.

Veprimtaria 12: "Ne jemi numra dhe shenja"

Udhëzim: Kjo veprimtari realizohet me 3 kolona me nga 5 nxënës. Kolonat mund të formohen sipas kriterëve të ndryshme.

Nxënësit e kolonës së parë dhe të kolonës së tretë thonë një nga një qindëshen e parë, ndërsa nxënësit e kolonës së dytë thonë shenjën e krahasimit që duhet të jetë midis këtyre dy numrave.

Shembull: Nxënësi i grupit të parë thotë numrin 54, nxënësi i grupit të tretë thotë numrin 64, ndërsa nxënësi i grupit të dytë duhet të thotë shenjën që duhet të vihet midis këtyre dy numrave (<, >, =).

Loja vazhdon deri sa të gjithë nxënësit e grupit të parë dhe të tretë i thonë të gjithë numrat që janë zgjedhur, ndërsa nxënësit e grupit të dytë ta thonë shenjën që duhet të vihet midis tyre.

Veprimtaria 13:

Nxënësit zhvillojnë diktimin e matematikës.

- 1) Shkruaj të gjithë numrat që janë:
 - a) me të mëdhenj se 26 dhe më të vegjël se 33
 - b) me të vegjël se 47 dhe më të mëdhenj se 38;
- 2) Gjej paraardhësin e numrit:
____, 45 ____ , 68 ____ , 99
- 3) Gjej pasardhësin e numrit:
33, ____ 55, ____ 78, ____
- 4) Fshij numrat:
Më të vegjël se 64 Me të mëdhenj se 55
70, 62, 89, 46, 77, 32, 97 53, 72, 99, 24, 39, 68, 22



51. MBLEDHJA DHE ZBRITJA

QËLLIMET

Nxënësit:

- paraqitin numrin me dy shifra si shuma e numrit me disa dhjetëshe dhe e numrit me një shifër;
- formojnë numrin prej dhjetësheve dhe prej njësheve;
- dinë të mbledhin dhe të zbresin mbi bazën e sistemit numerik me dhjetëshe;
- njohin strukturën e numrave me dy shifra;
- kuptojnë, se kur prej numrit me dy shifra zbresim njëshet, mbeten numrat me disa dhjetëshe;
- kuptojnë se, kur prej numrit me dy shifra zbresim numrat me disa dhjetëshe, mbeten njëshet.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Lotaria"

Udhëzim: Loja organizohet në çifte ose frontale. Për këtë lojë nevojiten fletushkat me një lloj ngjyre me numrat nga 0 deri në 9 dhe fletushkat me një lloj tjetër ngjyre me numrat që tregojnë dhjetëshet (10, 20, ..., 90) (fletushkat janë në materialin didaktik). Fletushkat janë të përziera dhe vendosen në dy turra me numra të kthyer në drejtim të tavolinës. Nxënësit nuk i shohin numrat e shkruar.

Një nxënës merr fletushkën e dhjetësheve, kurse një nxënës tjetër merr fletushkën e njësheve: la tregojnë klasës dhe thonë numrin.

Shënim: Është mirë që nxënësit ta përshkruajnë menjëherë numrin. Për shembull: numri 37 ka tri dhjetëshe dhe 7 njëshe. Shkruajnë: $37 = 30 + 7$, $37 - 7 = 30$, $37 - 30 = 7$.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin lojën "Lotaria" tek figura ilustruese hyrëse. Markoja merr fletushkën me numrin e dhjetësheve, kurse Maja merr fletushkën me numrin e njësheve dhe formojnë numrin me dy shifra. Barazimet që mund t'i shkruajmë janë të paraqitura në pllakat. Nxënësit plotësojnë pastaj tri fletushkat me shprehjet numerike dhe shpjegojnë, se çfarë tregon çdo shprehje numerike. Për shembull, $30 + 7$ është shkrimi i numrit me dy shifra 37 me anë të mbledhjes së dhjetësheve e të njësheve. $37 - 7$ tregon zbritjen nga numri me dy shifra të të gjitha njësheve të tij, ndërsa $37 - 30$ tregon zbritjen nga numri të të gjitha dhjetësheve.

Veprimtaria 3:

Nxënësit lexojnë numrat: 39, 50, 66, 7. Thonë numrin e dhjetësheve dhe numrin e njësheve, shkruajnë çdo numër në formën e shumës së dhjetësheve dhe të njësheve. Prej çdo numri zbresin dhjetëshen dhe kërkojnë vlerën e shprehjes numerike; pastaj, nga po i njëjti numër, zbresin njëshet e tij dhe kërkojnë vlerën e shprehjeve numerike.



Shënim: Numri 50 ka 5 dhjetëshe dhe 0 njëshe dhe e shkruajnë atë në formën e shumës si $50 + 0$. Numri 7 ka 0 dhjetëshe dhe 7 njëshe dhe e shkruajnë atë në formën e shumës si $0 + 7$.

$$39 - 30 = 9$$

$$39 - 9 = 30$$

$$50 - 50 = 0$$

$$50 - 0 = 50$$

$$66 - 60 = 6$$

$$66 - 6 = 60$$

$$7 - 0 = 7$$

$$7 - 7 = 0$$

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësve u kujtohet, sesi mund ta shkruajnë numrin me dy shifra në formën e shumës së dhjetësheve dhe të njësheve. Nxënësve duhet t'u tërhiqet vëmendja, se mbledhësi i parë në këtë shumë është dhjetëshja, kurse mbledhësi i dytë është numri me një shifër.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit shkruajnë numrin me dy shifra si shumën e dhjetësheve dhe të njësheve. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të dinë të kalojnë nga shkrimi i shkurtër me dhjetëshe i numrit drejt shkrimit të shumës së dhjetësheve e të njësheve dhe anasjelltas në shkrimin e shkurtër të numrit. Për shembull, nga shuma $50 + 8$ mund të kalojmë në shkrimin e shkurtër: 58.

Veprimtaria 6: Loja "Ç'është kjo?"

Në këtë lojë, nxënësit do të marrin përgjigje për pyetjen: "Çfarë mund të bjerë në ujë dhe të mos laget?"

Nxënësit zëvendësojnë çdo numër nga tabela e parë me shumën e dhjetësheve dhe të njësheve. Pastaj në tabelën e dytë, sipas atyre mbledhësve, në pikën e prerjes së rreshtit dhe të kolonës, gjejnë shkronjën. Formojnë fjalën dhe lexojnë përgjigjen për pyetjen: HIJA.

27	87	54	24

	4	5	7
80	S	L	I
50	J	K	M
20	A	O	H

Shënim: Mund të organizohet edhe loja e kundërt. Shembull: fjalën e shkruar nxënësit duhet ta shifrojnë me ndihmën e numrave me dy shifra. Për shembull, LOJA. Nxënësit e gjejnë shkronjën në tabelën e dytë. Në kolonën e parë dhe në rreshtin e dytë gjenden mbledhësit dhe kërkojnë shumën. Përftojnë numrin me dy shifra. Kështu fjalën LOJA e shifrojmë 85, 25, 54, 24.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit krahasojnë në mënyrë të pavarur vlerat e shprehjeve numerike.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit e lexojnë problemën, veçojnë nga teksti atë që është e njohur dhe atë që duhet të gjejnë. Shkruajnë shprehjen numerike dhe gjejnë vlerën e tij. Shkruajnë përgjigjen për pyetjen e problemës.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit plotësojnë tabelën, në të cilën gjejnë mbledhësin e panjohur me plotësim ose kërkojnë shumën.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë problemën, shkruajnë shprehjen numerike $26 - 6 + 4$, njehsojnë dhe i përgjigjen pyetjes së problemës.



9. Krahaso:

$<, >, =$

$50 \bigcirc 5 \text{ dh}$

$37 \bigcirc 3 \text{ dh } 7 \text{ nj}$

$68 \bigcirc 58$

$29 \bigcirc 27$

$84 \bigcirc 82$

$49 \bigcirc 51$

10. Shkruaj numrat më të mëdhenj dhe më të vegjël me dy shifra, tek të cilët numri i dhjetësheve dhe i njësheve është i barabartë. _____

Veprimtaria 15:

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Plotëso:

$62 = 60 + \square$

$60 = 68 - \square$

$98 = \square + 8$

$5 = 45 - \square$

$37 = 30 + \square$

$50 = 55 - \square$

$85 = \square + 5$

$8 = 58 - \square$

$76 = 70 + \square$

$80 = 84 - \square$

$34 = \square + 4$

$9 = 99 - \square$

Veprimtaria 16:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet dhe i shkruajnë përgjigjet sipas radhës.

1. Numrin 40 zmadhoje për 6.
2. Cili numër është për 3 më i madh se numri 60?
3. Numrit 40 shtoji numrin 8.
4. Cili numër është për 6 më i vogël se numri 66?
5. Numrin 77 zvogëloje për 7.
6. Mbledhësi i parë është 50, kurse i dyti është 9. Gjej shumën.
7. Në etazhe kanë qenë 39 libra. Nxënësit shpërndanë 30 libra për të lexuar. Sa libra kanë mbetur në etazhe?

Përgjigjet janë: 46, 63, 48, 60, 70, 59, 9.

Në tabelën që është vizatuar në dërrasë të zezë, nxënësit gjejnë shkronjën që i përgjigjet numrit.

9	48	70	60	46	63	59
T	SH	M	I	P	U	E

Duke i renditur shkronjat, nxënësit përftojnë fjalën PUSHIMET.

Veprimtaria 17:

Nxënësit hartojnë problema për zogjtë mbi bazën e shprehjeve numerike më poshtë:

$50 + 7; 67 - 7; 44 - 40.$

Veprimtaria 18:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën:

Stërgjyshi i Markos është 99 vjeç, kurse stërgjyshja e tij është 9 vjet më e vogël. Sa vjeçe është stërgjyshja e Markos? Sa vjeç ka qenë stërgjyshi i Markos para 90 vitesh?



52. MBLEDHJA DHE ZBRITJA

QËLLIMET

Nxënësit:

- mbledhin numrat me dy shifra dhe me një shifër pa kalimin mbi dhjetëshe;
- kuptojnë formën e dhënë të mbledhjes si mbledhje, bashkim të njësheve (shuma e njësheve është më e vogël se 10);
- zbresin numrin me një shifër nga numri me dy shifra, kur shifra e njësheve e të zbritshmit është më e madhe se zbritësi.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja “Makina llogaritëse”.

Nxënësve u lexohen shprehjet numerike, ndërsa nxënësit njehsojnë me ndihmën e kartonëve me numra.

$$23 - 3 + 40 + 8 + 10 - 70 - 6 + 30$$

$$7 + 9 - 10 - 2 + 80 - 4 - 20 + 5 - 60$$

$$13 - 8 + 50 - 5 - 40 - 7 + 60 - 3 + 7$$

Shënim: Nxënësit përdorin kartonët me numra të dhjetësheve dhe të njësheve që janë dhënë në materialin didaktik të Tekstit mësimor. Për të treguar numrin me dy shifra, ata marrin dy kartonë: një me numër me disa dhjetëshe dhe një me karton me numër me një shifër. Me mbulimin me kartonin me një shifër të zeros tek numri me disa dhjetëshe, nxënësit përftojnë numrin e kërkuar me dy shifra.

Veprimtaria 2:

Në dërrasë të zezë janë shkruar shprehjet numerike: $32 + 3$, $45 + 2$, $51 + 7$ etj. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: “Në ç’gjë janë të ngjashme shprehjet e dhëna numerike?” (**Shënim:** Nxënësit duhet të kuptojnë, se numrit me dy shifra i shtohen numrat me një shifër.) “Kush prej nxënësve mund të gjejë vlerën e të gjitha shprehjeve numerike?”

Shënim: Në këtë mënyrë shtrohet problemi metodik: të mësohen nxënësit, sesi të mbledhin numrat me dy shifra dhe numrat me një shifër.

Në vazhdim, nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke përdorur mjetin ndihmës vizual.

Ushtrim: Zmadhoje numrin 42 për 1 (për 2, për 3).

Nxënësit shohin, se cila shifër ndryshon tek numri 42. Ata i përgjigjen pyetjes: “Cilët numra të tjerë mund t’i shtojmë numrit 42, që të ndryshojë shifra që tregon njëshet, por që të mos ndryshojë shifra që tregon dhjetëshet?” Nxënësit shkruajnë barazimet:

$$42 + 1 = 43$$

$$42 + 3 = 45$$


$$42 + 5 = 47$$

$$42 + 7 = 49$$

$$42 + 2 = 44$$

$$42 + 4 = 46$$

$$42 + 6 = 48$$





Nxënësit arrijnë në përfundimin, se numrit 42 mund t'i shtojmë 7 numra me një shifër, që në shkrimin e tij të ndryshojë vetëm shifra e njësheve.

Shënim: Mund të paraqitet edhe në mjetin ndihmës vizual edhe rasti $42 + 8$, që nxënësit të binden, se rezultati do të jetë i njëjtë me 5 dhjetëshe.

Nxënësit nxjerrin përgjithësimin e mënyrës së mbledhjes së numrit me dy shifra me numrin me një shifër; **në raste të tilla njëshet duhen mbledhur me njëshe, kurse dhjetëshet duhen mbledhur me dhjetëshe.**

Teksti mësimor

Veprimtaria 3: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit shohin, sesi xhaxhi Mile, i cili shet mollë në tregun e fruta-perimeve, e rregullon banakun e vet. Çdo arkë zë 10 mollë. Mollët e kuqe kanë mbushur 4 arka. Prej mollëve jeshile janë shitur disa prej tyre dhe tani duhet të paketohen mollët e tjera. E ka të lehtë xhaxhi Mileja, që të tregojë kujdes për sasinë e mollëve, sepse ai di të njehsojë lehtë dhe shpejt.

Nxënësit shpjegojnë mënyrën e mbledhjes mbi bazën e figurës ilustruese. Në mënyrë të pavarur, kërkojnë vlerën e shprehjeve numerike që janë të shkruara pas figurës ilustruese hyrëse.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit i zhvillojnë ushtrimet në çifte. I zgjidhin ushtrimet, i shkëmbejnë tekstet mësimore, dhe ia kontrollojnë njëri-tjetrit rezultatet e punës. Gabimet e bëra diskutohen para gjithë klasës.

Shënim: Kontrolli i rezultateve të punës i mundëson mësues-it/es për të nxjerrë përfundimin, nëse nxënësit e kanë kuptuar mënyrën e mbledhjes.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën.

Veprimtaria 6:

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet në fletore:


1. Mbledhësi i parë është numri 41, kurse mbledhësi i dytë është numri 6. Gjej shumën.
2. Numrin më të madh të dhjetëshes së gjashtë zmadhoje për 8.
3. Cili numër: a) është për 7 më i madh se numri 92; b) është për 4 më i madh se numri 44?
4. Milloshi ka bërë 34 aeroplanë prej letre, kurse Dragani ka bërë 5 më shumë. Sa aeroplanë prej letre ka bërë Dragani?

Veprimtaria 7:

Nxënësit e zhvillojnë ushtrimin duke përdorur mjetin ndihmës vizual.

Ushtrim: Zvogëloje numrin 58 për 1 (për 2, për 3, për 6.).

Nxënësit shohin, se cila shifër ndryshon tek shkrimi i të zbritshmit, shkruajnë barazimin dhe vënë re ngjashmëritë (tek i zbritshmi nuk ndryshon shifra që tregon dhjetëshet). Mendojnë, se cilët numra të tjerë mund të zbriten nga numri 58, por të ndryshohet vetëm shifra që tregon njëshet.



$$58 - 1 = 57$$

$$58 - 3 = 55$$

$$58 - 5 = 53$$

$$58 - 7 = 51$$

$$58 - 2 = 56$$

$$58 - 4 = 54$$

$$58 - 6 = 52$$

$$58 - 8 = 50$$

**Veprimtaria 8: Figura ilustruese hyrëse**

Nxënësit vënë re mënyrën e zbritjes në figurën e dytë ilustruese në Tekstin mësimor. Xhaxhi Mirkoja ka fërguar 4 vezë. Ai e di, sesa vezë i kanë mbetur, sepse i ka marrë ato nga kutia që ka qenë e filluar tashmë. Nuk ka nevojë, t'i numërojë kutitë që janë plot.

Nxënësit shpjegojnë mënyrën e zbritjes mbi bazën e figurës ilustruese. Në mënyrë të pavarur, kërkojnë vlerën e shprehjeve numerike që janë të shkruara pas figurës ilustruese hyrëse.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjes numerike të shkruar në kamion dhe e lidhin kamionin me garazhin, në të cilën është shkruar vlera e shprehjes numerike.

Veprimtaria 11: Punë në Fletën e punës

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet.

1. I zbritshmi është numri 78, kurse zbritësi është numri 6. Gjej ndryshesën.
2. Numrin më të madh me dy shifra zvogëloje për 8.
3. Cili numër: a) është për 7 më i vogël se numri 79; b) është për 4 më i vogël se numri 56?
4. Nikolla ka shënuar 28 kosha, kurse Gjorgji ka shënuar 6 kosha më pak. Sa kosha ka shënuar Gjorgji?

Veprimtaria 12:

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Shkruaj numrin:

1. që është për 5 më i madh se numri 72, 63, 83, 42, 50: , , , , .
2. që është për 4 më i vogël se numri 96, 35, 47, 66, 78: , , , , .

Veprimtaria 13:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. Në një dyqan lulesh janë 31 trëndafila, kurse në dyqanin tjetër të luleve janë 5 trëndafila më shumë. Sa trëndafila janë në dyqanin e dytë?
2. Asimi ka blerë 46 tullumbace për shoqen e vet Aleksandra, por era ia mori 2 tullumbace. Sa tullumbace i dhuroi Aleksandrës Asimi?
3. Në tren ishin 89 pasagjerë. Në stacionin e parë dolën 5 pasagjerë dhe nuk hyri asnjë pasagjer tjetër. Sa pasagjerë e vazhduan udhëtimin me tren?
4. Nëse numrit të panjohur i shtohet numri 7, përftohet numri 59. Gjej numrin e panjohur.
5. Gjej ndryshesën, nëse i zbritshmi është numri 56, kurse zbritësi është numri 4.



53. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET

Nxënësit:

- ushtrojnë mënyrën e mbledhjes e të zbritjes së numrit me dy shifra dhe të numrit me një shifër pa kalimin mbi dhjetëshe;
- dinë të gjejnë mbledhësin e panjohur dhe zbritësin e panjohur;
- zgjidhin problemat me një e me dy veprime njehsimi me ndihmën e ndërtimit të shprehjes numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Ushtrimi 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Nxënësit kanë çantën plot me shembuj, tek të cilët gjejnë mbledhësin e panjohur. Mësuesi shkruan në dërrasë të zezë barazimin e parë nga trasta dhe tërheq vëmendjen tek veprimi i mbledhjes. Nxënësit nënvizojnë shifrën e dhjetësheve tek mbledhësi dhe tek shumta: $22 + _ = 29$. . Ata shohin se shifra e dhjetësheve nuk ka ndryshuar, por ka ndryshuar vetëm shifra e njësheve. Domethënë, mbledhësi dytë që mungon është numër me një shifër. (Që të përftohet numri 9, numrit 2 i duhet shtuar numri 7.)

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur shembujt e çantës së madhe dhe në mënyrë të ngjashme gjejnë zbritësin e panjohur.

Shënim: Në rast vështirësie, përdoret mjeti ndihmës vizual.

Veprimtaria 2: Ushtrimi 2

Nxënësit zgjidhin ushtrimet.

Udhëzim: Nxënësit shpjegojnë me radhë ecurinë e arsytimit gjatë krahasimit të shprehjeve numerike dhe të numrave të veçantë. Ata mund të krahasojnë në dy mënyra:

- gjejnë vlerën e shprehjeve numerike dhe krahaso rezultatet;
- vënë re rregullën: çdo çift i shprehjeve numerike ka numra të barabartë.

Për shembull, krahasojnë dy shprehje numerike: $6 + 72$ dhe $82 + 6$. Shohin, se të dyja shprehjet numerike përfaqësojnë shumatat që kanë të njëjtë njërin mbledhës. Këto numra mund t'i krahasojnë edhe pa njehsimin e drejtpërdrejtë, me ndihmën e krahasimit vetëm të mbledhësit të dytë. Duke pasur parasysh se numri 72 është më i vogël se numri 82, do të thotë $6 + 72 < 82 + 6$. Gjatë krahasimit, për shembull, shprehja numerike $33 + 5$ dha $39 - 1$, nxënësit gjejnë vlerën e shprehjes së parë numerike - 38, pastaj të shprehjes së dytë numerike - 38 dhe në fund krahasojnë rezultatet: $38 = 38$.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin problemën.




Udhëzim: Nxënësit krahasojnë gjatësinë e kërcimeve të vogëlusheve. Gjatësia e kërcimit të Mirkos dhe e kërcimit të Asimit është shprehur në centimetra, kurse kërcimi i Ivanit është shprehur me decimetra. Nxënësve u kujtohet, se 1 dm përfaqëson 10 cm. Kur kemi 9 dm, duhet të mbliidhen dhjetë dhjetëshe centimetra, gjë që është e barabartë me 90 cm. Tani, kur të gjitha gjatësitë e kërcimeve janë të shprehura me të njëjtën njësi matëse, nxënësit i krahasojnë numrat me dy shifra. Pastaj shkruajnë për çdo vogëlush vendin që ka zënë në garën e kërcimit.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4

Shënim: Zgjidhja e problemës me mbledhje dhe me zbritje kthehet në faktin se duhet të gjejmë, a kërkojmë pjesën apo të tërën, në mënyrë që të kuptojmë se për ç'operacion bëhet fjalë. Që nxënësit ta kuptojnë më mirë këtë gjë, fillimisht përdoren ilustrimet me sende të situatës, të cilat më pas zëvendësohen nga ilustrimet me skema ose me figura. Por, nëse bëhet fjalë për numra të mëdhenj, atëherë nuk është e përshtatshme të bëhen figurat, do të duhej të vizatoheshin shumë sende. Në rastet e tilla paraqitjen vizuale të përmbajtjes së problemës mund ta arrijmë me ndihmën e segmentit numerik. Nëse e zëvendësojmë sasinë e tërë të një gjëje me të gjithë segmentin, atëherë pjesët e segmentit përfaqësojnë komponentët prej të cilëve përbëhet kjo sasi e kësaj gjëje. Për skemë mund të merret segmenti i çfarëdo gjatësie. Rëndësi ka vetëm të paraqiten saktë pjesët prej të cilave përbëhet e tëra. Përdorimi i një formë të tillë të shkurtër të problemës u mundëson nxënësve zgjidhjen e shpejtë dhe të lehtë të saj.

Nxënësit vizatojnë në fletore segmentin dhe e ndajnë atë në pjesë. Veçojnë në skemë kushtin dhe pyetjen e problemës.




Udhëzim: Gjithë segmenti tregon, sesa kuleçë janë pjekur gjithsej. Një pjesë e segmentit tregon, sesa kuleçë janë ngrënë, kurse pjesa tjetër tregon, sesa kuleçë kanë mbetur. Shenja e pyetjes tregon, se çfarë kërkohet. Nga skema shihet se në problemë kërkohet pjesa e së tërës, gjë që përftohet me zbritje.

Nxënësit shkruajnë në vendin e caktuar në Tekstin mësimor zgjidhjen e problemës dhe japin përgjigjen.

Veprimtaria 5:

Nxënësit konfirmojnë zgjidhje e problemës me përdorimin e segmentit duke dëgjuar problemat në vazhdim dhe duke i zgjidhur ato me mbushjen e skemës së vizatuar në dërrasë të zezë.



1. Për zbukurimin e klasës nxënësit kanë fryrë 37 tullumbace. Kur i kanë varur, 7 tullumbace janë shpuar. Sa tullumbace kanë mbetur?

Nxënësit e plotësojnë skemën dhe e kuptojnë se e panjohur është një pjesë e së tërës, gjë që kërkohet me zbritje. Ata shkruajnë shprehjen numerike $37 - 7$ dhe njehsojnë.

2. Për zbukurimin e klasës nxënësit kanë fryrë 37 tullumbace. Pasi që janë shpuar disa tullumbace, kanë mbetur 30 tullumbace. Sa tullumbace janë shpuar?

Nxënësit e plotësojnë skemën dhe e kuptojnë, se e panjohur është një pjesë e së tërës, gjë që kërkohet me zbritje nga e tëra të pjesës tjetër. Ata shkruajnë shprehjen numerike $37 - 30$ dhe njehsojnë.

3. Pasi që janë shpuar 7 tullumbace, kanë mbetur edhe 30. Sa tullumbace kanë qenë në fillim?

Nxënësit e plotësojnë skemën dhe e kuptojnë se duhet të gjendet e tëra dhe për këtë përdoret mbledhja. Ata shkruajnë shprehjen numerike $30 + 7$ dhe njehsojnë.

**Veprimtaria 6:**

Nxënësit shohin me vëmendje shembujt që janë shkruar në dërrasë të zezë dhe i zgjidhin ato me gojë. Ata përpiqen ta kuptojnë rregullën, sipas së cilës janë ndërtuar shembujt dhe shkruajnë edhe disa shembuj të ngjashëm.

$$19 - 10 + 9 = \underline{\quad}$$

$$28 - 20 + 9 = \underline{\quad}$$

$$37 - 30 + 9 = \underline{\quad}$$

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin ushtrimet e dhëna.

Udhëzim: Nxënësit krahasojnë shembujt në kolonën e parë dhe vënë re, se ato janë shprehje numerike me dy veprime njehsime, tek të cilët i pari është shuma me mbledhës të njëjtë, ndërsa pastaj nga kjo shumë zbritet njëshi. Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve të dhëna numerike dhe shkruajnë shembullin e ngjashëm si vijon: $6 + 6 - 1 = 11$.

Në kolonën e dytë janë shprehjet numerike me dy veprime njehsimi, tek të cilët, së pari, nga i zbritshmi zbriten të gjitha njëshet, ndërsa pastaj shtohen njëshet e barabarta me numrin e dhjetësheve të të zbritshmit. Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike në kolonën e dytë dhe shkruajnë shembullin e ngjashëm si vijon: $46 - 6 + 4 = 44$. Ata vënë re, se përgjigjet janë numrat me dy shifra, tek të cilët numri i dhjetësheve dhe i njësheve është i barabartë.

Në kolonën e dytë janë shprehjet numerike me dy veprime njehsime, tek të cilët fillimisht mbledhin numrat me disa dhjetëshe dhe numrin me një shifër, i cili është i barabartë me numrin e dhjetësheve tek mbledhësi i parë, ndërsa pastaj zbresin njëshin. Nxënësit gjejnë vlerën e shprehjeve numerike në kolonën e tretë dhe shkruajnë shembullin e ngjashëm si vijon: $60 + 6 - 1 = 65$.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë me vëmendje problemën. Pastaj e ritregojnë atë me fjalët e veta dhe veçojnë kushtin dhe pyetjen e saj, domethënë bëjnë analizën e saj fillestare. Nxënësit dallojnë në përmbajtjen e problemës fjalët kyçe, të cilat kushtëzojnë zgjedhjen e veprimit të njehsimit (fluturuan, u pakësuan, zbritje; u ulën, u shtuan, mbledhje). Shkruajnë shprehjen numerike $48 - 4 + 5$, njehsojnë dhe i përgjigjen pyetjes së problemës.

Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën.

Veprimtaria 10: Ushtrimi nr. 8

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur shembujt. Nxënësit kontrollojnë pastaj në çifte rezultatet dhe analizojnë gabimet.

Veprimtaria 11: Ushtrimi nr. 9

Nxënësit lexojnë dhe zgjidhin problemën logjike që zhvillon mendjemprehtësinë.

Zgjidhja: Nxënësit e kuptojnë nga teksti se Ana ka 4 zambakë dhe 3 tulipanë. Domethënë, buqeta e parë me lule është e Anës dhe shkruajnë emrin e saj pranë buqetës 1. Hana ka katër zambakë, domethënë buqeta e saj është numër 3. Buqeta numër 2, me tre tulipanë, i përket Sanjës.

Ushtrime për përforcim**Veprimtaria 12:**

Nxënësit e zhvillojnë këtë veprimtari në çifte. Çdo çift ka kubin e zarit. Ushtrimin e zgjidh nxënësi, që fiton numrin më të madh të shortit. Çdo ushtrim në vazhdim zgjidhet sipas të njëjtit parim. Në fund bëhet kontrolli i përbashkët i ushtrimeve.



Njehsoni:

- a) $47 + 1 = 40 + \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$ $78 - 6 = 70 + \underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$
 $76 + 3 = 70 + \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$ $66 - 4 = 60 + \underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$
 $81 + 7 = 80 + \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$ $97 - 6 = 90 + \underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$
 $54 + 5 = 50 + \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$ $57 - 5 = 50 + \underline{\quad} - \underline{\quad} = \underline{\quad}$
- b) $32 + 4 = \underline{\quad}$ $43 + 5 = \underline{\quad}$ $19 - 6 = \underline{\quad}$ $38 - 6 = \underline{\quad}$
 $73 + 4 = \underline{\quad}$ $51 + 6 = \underline{\quad}$ $99 - 3 = \underline{\quad}$ $29 - 7 = \underline{\quad}$

Veprimtaria 13: Puna në grupe

Veprimtaria ka karakterin e garës, ndërsa fiton grupi që i plotëson më shpejt dhe saktë tabelat. Kriterin për ndarjen në grupe e cakton mësues-i/ja. Grupeve u jepet fletushka, në të cilën janë katër tabela. Nxënësit i plotësojnë tabelat duke treguar kujdes për atë që kërkohet prej tyre.

Plotëso tabelën:

A	B	A + B
65	4	
2	37	
7	42	
73	6	

A	B	A - B
85	3	
39	8	
78	6	
99	5	

A	B	C	A + B + C
40	4	5	
2	50	4	
72	3	3	
52	4	2	

A	B	C	A - B - C
59	3	2	
87	4	1	
99	5	3	
46	2	2	

Veprimtaria 14:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat dhe ushtrimin.

1. Në njërin kopsht fëmijësh janë 42 vogëlushë, kurse në kopshtin tjetër 6 më shumë. Sa vogëlushë janë në kopshtin e dytë?
2. Cili numër i duhet shtuar numrit 91 që të përftohet numri 99?
3. Davidi duhet të lexojë 39 faqe libri. Ditën e parë lexoi 4 faqe libri, kurse ditën e dytë lexoi 3 faqe. Edhe sa faqe libri duhet të lexojë Davidi?
4. Gjej ndryshesën, nëse i zbritshmi është 66, kurse zbritësi 5.



54. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE ME DY SHIFRA

QËLLIMET

Nxënësit:

- mbledhin dy numra me dy shifra, prej të cilëve njëri është numër me disa dhjetëshe;
- përforcojnë mbledhjen e zbritjen e numrit me dy shifra dhe me një shifër pa kalimin mbi dhjetëshe.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor:

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit e zhvillojnë ushtrimin duke shfrytëzuar mjetin ndihmës vizual dhe vënë re, se cili numër ndryshon.

Ushtrim: Zmadhoje numrin 36 për një dhjetëshe, për dy dhjetëshe, për tri dhjetëshe.

Udhëzim: Nxënësit shohin, se cila shifër ndryshon tek numri .36. Ata vënë re, se duke i shtuar dhjetëshet numrit 36 nuk ndryshon shifra e njësheve tek shumën; ajo mbetet gjithnjë 6. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: "Cilat janë gjithë dhjetëshet që mund t'ia shtojmë numrit 36, në mënyrë që shumën të jetë një numër me dy shifra?" Ata shkruajnë barazimet:

$$\begin{array}{lll} 36 + 10 = 46 & 36 + 30 = 66 & 36 + 50 = 86 \\ 36 + 20 = 56 & 36 + 40 = 76 & 36 + 60 = 96 \end{array}$$

Dhjetëshet	Njëshet

Nxënësit arrijnë në përfundimin, se numrit 36 mund t'i shtojmë 6 numra me disa dhjetëshe, dhe në këtë rast në shkrimin e tij ka ndryshuar vetëm shifra e numrit të dhjetësheve.

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse në Tekstin mësimor dhe shpjegojnë mënyrën e mbledhjes së numrave 36 dhe 20.

Nxënësit përgjithësojnë mënyrën e mbledhjes së numrit me dy shifra dhe të numrit me disa dhjetëshe: **duhet të mblidhen dhjetëshet, ndërsa të lihet e pandryshuar shifra e njësheve e numrit me dy shifra.**

Shënim: Rëndësi ka që nxënësit të arrijnë në mënyrë të pavarur tek përfundimi për mënyrën e mbledhjes së numrave me dy shifra dhe të dhjetësheve.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet në dërrasë të zezë dhe shpjegojnë mënyrën e zgjidhjes.

Udhëzim: Ngulitet algoritmi i mbledhjes së numrit me dy shifra dhe i dhjetësheve.

Për shembull: $53 + 40 = \underline{\quad}$

Shumën e numrave 53 dhe 40.

- Njëshet mblidhen me njëshe; d.m.th. dallohet shifra e njësheve 3.
- Shkruhet rezultati në vendin e dytë djathtas; d.m.th. shkruhet 3 si shifra e shumës së njësheve.
- Dhjetëshet mblidhen me dhjetëshe, d.m.th. mblidhet $5 + 4$.



- Shkruhet rezultati në vendin e parë majtas; d.m.th. shkruhet 9 si shifra e shumës së dhjetësheve.
- Shuma e numrave 53 dhe 40 është e barabartë me 93.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin.

Shënim: Nxënësit kuptojnë, se numrat me dy shifra me të mëdhenj se 17, që përfundojnë me shifrën 7, përftohen vetëm me ndryshimin e shifrës së dhjetësheve tek numri me dy shifra. Me shtimin gradual të dhjetësheve dhe me plotësimin e rathëve, nxënësit përftojnë të gjithë numrat me dy shifra që kanë karakteristikën e përmendur.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin dhe analizojnë mënyrën e mbledhjes së dhjetësheve. Ata kuptojnë, se mbledhja, për shembull, e numrit tridhjetë është analoge me mbledhjen graduale të tri dhjetësheve.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin ushtrimet dhe i ndihmojnë futbollistit për t'i ngjitur shkallët.

Zgjidhja: Nxënësit vënë re parimin e lëvizjes në shkallë: vlera e shprehjes numerike në shkallën e parë është e barabartë me mbledhësin e parë të shprehjes numerike në shkallën e dytë, kurse vlera e shprehjes numerike në shkallën e dytë është e barabartë me të zbritshmin në shkallën e dytë etj.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet, d.m.th. i analizojnë shprehjet numerike, përgjithësojnë rregullën sipas së cilës janë ndërtuar dhe shkruajnë tri çifte të reja të shprehjeve numerike. Disa çifte të shprehjeve numerike shkruhen pastaj në dërrasë të zezë dhe zhvillohet diskutimi.

Udhëzim: Mbledhësi i parë është numër me dy shifra dhe ai është i përbashkët për çiftin e dhënë të shprehjeve numerike. Në shprehjen e parë numerike të çiftit, numri me dy shifra zmadhohet me numrin me një shifër, kurse në shprehjen e dytë numerike, numri me dy shifra zmadhohet me numrin e njëjtë të dhjetësheve.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit dëgjojnë gjëegjëzën: "Unë ruaj thesarin, kurse njerëzit me ruajnë mua" (Çelësi). Më tej, ata zgjidhin vlerën e shprehjeve numerike që janë shkruar në dryna, kërkojnë çelësin e duhur dhe lidhin me shigjeta.

Ushtrime për përforsim

Veprimtaria 9: Gjej rezultatin!

Nxënësit ndahen në dy grupe. Kriteri për ndarjen në grupe është *mbledhja* dhe *rezultati*. Kur formohen grupet, nxënësve të grupit të parë u jepen kartonët me shprehjet numerike me mbledhje, kurse nxënësve të grupit të dytë u jepen kartonët me rezultatet e mbledhjes.

Nxënësit e grupit të parë ngrenë lart me radhë kartonët, kurse nga grupi i dytë kartonin e ngre lart vetëm nxënësi, tek i cili është rezultati i mbledhjes. Numri i kartonëve duhet t'i përgjigjet numrit të nxënësve në grup. Shembuj të kartonëve:

MBLEDHJA	REZULTATI
$50 + 23$	73
$18 + 30$	48
$44 + 20$	64
$63 + 30$	93
$36 + 40$	76

**Veprimtaria 10: Puna në grup**

Nxënësit i zgjidhin ushtrimet.

Plotëso barazimin që të jetë i saktë:

$$41 + \underline{\quad} = 61 \quad \underline{\quad} + 27 = 97$$

$$\underline{\quad} + 64 = 84 \quad 68 + \underline{\quad} = 88$$

$$55 + \underline{\quad} = 95 \quad 35 + \underline{\quad} = 65$$

Veprimtaria 11: Shkruaj numrin!

Nxënësit duhet të shkruajnë numrin që është:

- a) për 23 më i madh se 20 (30, 50, 60, 40, 70);
- b) për 30 më i madh se 43 (65, 48, 59, 27, 32).

Veprimtaria 12:

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. Një libër ka 64 faqe, kurse libri tjetër ka 30 faqe më shumë. Sa faqe ka libri i dytë?
2. Katja kishte 36 figura. Tamara i dha edhe 20 figura për ta plotësuar albumin. Sa figura i duheshin gjithsej Tamarës që ta kishte të plotë albumin?
3. Nëse numrit të panjohur i shtojmë numrin 44, përftohet numri 74. Gjej numrin e panjohur.
4. Sasha doli i nëntëmbëdhjeti në krosin e shkollës, kurse Dejani ishte njëzet vende prapa tij. Në cilin vend doli Dejani?



55. ZBRITJA E NUMRAVE ME DY SHIFRA

QËLLIMET

Nxënësit:

- zbresin dy numra me dy shifra, prej të cilëve zbritësi është numri me disa dhjetëshe;
- përforcojnë mbledhjen dhe zbritjen e numrit me dy shifra dhe me një shifër pa kalimin mbi dhjetëshe;
- zgjidhin problemat me një dhe me dy veprime njehsimi me ndihmën e ndërtimit të shprehjes numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Figura ilustruese hyrëse

Nxënësit e zgjidhin ushtrimin duke përdorur mjetet ndihmëse vizuale dhe shohin, se cila shifër ndryshon.

Ushtrimi: Të zvogëlohet numri 63 për një dhjetëshe, për dy dhjetëshe, për tri dhjetëshe.

Udhëzim: Nxënësit shohin, se cila shifër nuk ndryshon tek numri 63. Ata vënë re, se me zbritjen e numrit me disa dhjetëshe nga numri 63, nuk ndryshon shifra e njësheve. Kështu shifra e ndryshesës së njësheve është gjithnjë 3. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: "Cilat dhjetëshe të tjera me disa numra mund t'i zbrësim nga numri 63?" Ata shkruajnë barazimet:

$$63 - 10 = 53$$


$$63 - 30 = 33$$

$$63 - 50 = 13$$

$$63 - 20 = 43$$

$$63 - 40 = 23$$

$$63 - 60 = 3$$



Nxënësit vënë re ngjashmëritë tek këto barazime; zbritësi është numri me disa dhjetëshe, kurse i zbritshmi është numri 63; në shkrimin e rezultatit nuk ndryshon shifra që tregon njëshet, por ndryshon vetëm shifra që tregon dhjetëshet.

Nxënësit përgjithësojnë mënyrën e zbritjes së numrit me disa dhjetëshe nga numri me disa shifra: **duhet të zbriten dhjetëshet, ndërsa të lihet e pandryshuar shifra e njësheve e numrit me dy shifra; e të zbritshmit.**

Shënim: Rëndësi ka që nxënësit të arrijnë në mënyrë të pavarur tek përfundimi për mënyrën e zbritjes të numrit me disa dhjetëshe nga numri me dy shifra.

Nxënësit shohin figurën ilustruese hyrëse në Tekstin mësimor dhe shpjegojnë mënyrën e zbritjes së numrave 36 dhe 20.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin shembujt në dërrasë të zezë dhe shpjegojnë mënyrën e zbritjes.

Udhëzim: Ngulitet algoritmi i zbritjes së numrit me disa dhjetëshe nga numri me dy shifra.



Për shembull: $91 - 60 = \underline{\quad}$

- Ndryshesa e numrave 91 dhe 60.
- Nga shifra e njësheve e të zbritshmit zbritet shifra e njësheve të zbritësit, d.m.th. dallohet shifra e njësheve 1.
- Shkruhet rezultati në vendin e dytë djathtas, d.m.th. shifra e ndryshesës e njësheve është numri 1.
- Nga shifra e dhjetësheve e të zbritshmit zbritet shifra e dhjetësheve e zbritësit, d.m.th. gjendet ndryshesa 9 - 6.

Shkruhet rezultati në vendin e dytë majtas, d.m.th. 3 shkruhet si shifra e ndryshesës e dhjetësheve. Ndryshesa e numrave 91 dhe 60 është e barabartë me 31.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Zgjidhja: Nxënësit kuptojnë, se numrat me dy shifra me të vegjël se 93, që mbarojnë me shifrën 3, përftohen vetëm me ndryshimin e shifrës së dhjetësheve tek numri me dy shifra. Me zbritjen graduale të dhjetësheve dhe me plotësimin e r Rathëve, nxënësit përftojnë të gjithë numrat me dy shifra që kanë karakteristikën e shënuar.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Nxënësit analizojnë mënyrën e zbritjes së dhjetësheve dhe kuptojnë se zbritja, për shembull, e numrit pesëdhjetë është analoge me mënyrën e zbritjes së pesë dhjetësheve.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit krahasojnë shprehjet numerike duke përdorur rregullat që vënë re:

- shprehjet numerike që kanë zbritës të barabartë;
- shprehjet numerike që kanë të zbritshmit e barabartë.

Shënim: Rëndësi ka që të analizohet çdo shembull. Nxënësit kuptojnë më vështirë dhe përvetësojnë më ngadalë ndryshimet e të zbritshmit dhe të zbritësit: pse, kur zmadhojmë të zbritshmin, ndryshesa zmadhohet, ndërsa kur zmadhojmë zbritësin, ndryshesa zvogëlohet? Në situatat e tilla është më mirë të përdoren shembuj nga jeta e përditshme: "Keni 17 bonbone. A do t'u mbeten më shumë bonbone, nëse dikush u merr 3 bonbone, apo nëse dikush u merr 5 bonbone?"

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin, d.m.th. i analizojnë shprehjet numerike, përgjithësojnë rregullën sipas së cilës janë formuar shprehjet numerike dhe shkruajnë tri çifte të reja të shprehjeve numerike. Disa çifte të shprehjeve numerike shkruhen pastaj në dërrasë të zezë dhe zhvillohet diskutimi.

Shënim: I zbritshmi është numri me dy shifra. Ai është i njëjtë në çdo çift të dhënë të shprehjeve numerike. Në shprehjen e parë numerike prej numrit me dy shifra zbritet numri më një shifër, kurse në shprehjen e dytë numerike prej numrit me dy shifra, zbritet numri i njëjtë i dhjetësheve.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit lexojnë me vëmendje problemën. Ata shpjegojnë veprimin që kanë zgjedhur për zgjidhjen e problemës, shkruajnë shprehjen numerike në vendin e caktuar në Tekstin mësimor, njehsojnë dhe i përgjigjen pyetjes.

**Veprimtaria 9: Ushtrimi nr. 8**

Nxënësit njehsojnë shprehjet numerike me dy veprime njehsimi dhe shkruajnë rezultatin në katrorin e djathtë. Në anën e majtë të shprehjes numerike gjendet shkronja. Pas njehsimit, nxënësit e plotësojnë tabelën: në rreshtin e parë shkruajnë vlerat e shprehjeve numerike të njehsuara nga më e vogla deri tek më e madhja, kurse në rreshtin e dytë shkruajnë shkronjën e duhur në anën e djathtë të shprehjes numerike dhe përftojnë kështu fjalën PORTIER.

23	29	30	33	44	49	
P	O	R	T	I	E	R

Ushtrime për përforcim**Veprimtaria 10:**

Nxënësit zgjidhin në çifte në mënyrë të alternuar ushtrimet.

Gjej ndryshesën:

$$84 - 20 = 64 - 40 = \quad 53 - 30 = \quad 73 - 50 =$$

$$68 - 20 = 57 - 40 = \quad 95 - 60 = \quad 49 - 30 =$$

Veprimtaria 11:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Shkruaj $>$, $<$ ose $=$:

$$67 - 20 \quad \underline{\quad} \quad 67 - 30 \quad 54 - 30 \quad \underline{\quad} \quad 43 - 20$$

$$98 - 70 \quad \underline{\quad} \quad 58 - 30 \quad 86 - 60 \quad \underline{\quad} \quad 46 - 20$$

Veprimtaria 12:

Nxënësit hartojnë problemat mbi bazën e shprehjeve të dhëna numerike dhe gjejnë vlerën e shprehjeve numerike:

- $47 - 30$,
- $69 - 50$,
- $78 - 40$.

Veprimtaria 13:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

- Masha kishte 55 euro. Ajo shpenzoi 20 euro. Sa euro i kanë mbetur Mashës?
- Fermeri grumbulloi 99 vezë. Gjatë transportimit atij iu thyen 60 vezë. Sa vezë solli fermeri?
- Në pako janë 98 shumësia. U harxhuan 40 shumësia. Sa shumësia kanë mbetur në pako?
- Dy vëllezër duhet të ndajnë 69 euro. Njëri vëlla mori 20 euro. Sa euro mori vëllai tjetër?



56. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE

QËLLIMET


Nxënësit:

- mbledhin dhe zbresin në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 100;
- krahasojnë dhe shkruajnë relacionet ndërmjet shprehjeve numerike $>$, $<$ ose $=$;
- zgjidhin problemat me dy veprime njehsimi me ndihmën e ndërtimit të shprehjes numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1: Loja "Rreshti i kujt është më i shpejtë?"

Nxënësit e çdo rreshti, një nga një, dalin në dërrasë të zezë, kërkojnë vlerën e shprehjeve numerike dhe shkruajnë përgjigjen në "zinxhirin e mbledhjes dhe të zbritjes":



Fitues është rreshti, që e njehson i pari siç duhet "zinxhirin".

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Ushtrimet nr. 1 e 2

Nxënësit kërkojnë në mënyrë të pavarur vlerën e shprehjeve numerike me mbledhje dhe me zbritje.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit shpjegojnë me radhë ecurinë e arsyetimit gjatë krahasimit të shprehjeve numerike.

Udhëzim: Në kolonën e parë, nxënësit krahasojnë shprehjet numerike me zbritje, në ç'rast çdo çift i shprehjeve numerike e ka të barabartë zbritësin ose e ka të barabartë të zbritshmin. Në këto raste, shprehjet numerike mund të krahasohen pa bërë njehsimin. Në rastin, kur shprehjet numerike e kanë të barabartë të zbritshmin (përkatesisht, nëse e zvogëlojmë të zbritshmin me ndonjë numër), mjafton që të krahasohen vetëm të zbritshmit. Në rastin, kur shprehjet numerike e kanë të barabartë të zbritshmin, më e madhe do të jetë ajo shprehje numerike, tek e cila është më i vogël zbritësi.

Në kolonën e dytë janë shembujt me mbledhje. Çdo çift i shprehjeve numerike e ka të barabartë një mbledhës. Domethënë, nxënësit i krahasojnë mbledhësit e dytë.

**Veprimtaria 4:**

Nxënësit i zgjidhin problemat në grupe:

1. Në etazhe janë 25 libra. Nxënësit morën në mëngjes 4 libra, kurse në mbrëmje vendosën në etazhe 7 libra. Sa libra gjenden tani në etazhe?
2. Gjatë pushimeve shkollore, Markoja bëri 36 fotografi. Ai i fali 6 fotografi gjyshes, kurse një fotografi ia dha shokut të vet. Sa fotografi i kanë mbetur Markos?

Nxënësit e çdo grupi tregojnë pastaj, se çfarë e kanë të njohur ata nga teksti i shkruar dhe konfirmojnë se kjo gjë është kushti i problemave. Veçojnë nga problema atë që kërkohet dhe dallojnë fjalët që ndikojnë në zgjedhjen e veprimit të njehsimit që duhet të kryhet (morën – zbritja, vendosën – mbledhja, fali – zbritja). Nxënësit ndërtojnë shprehjen numerike që përfaqëson zgjidhjen e problemës, kurse vlera e shprehjes numerike është përgjigja për pyetjen e problemës.

Veprimtaria 5: Ushtrimet nr. 4 e 5

Nxënësit i zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat. Mund të organizohet puna me grupe.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë problemën dhe shohin figurën që u ndihmon për ta kuptuar kushtin e problemës.

Udhëzim: Nga kushti se në katin e parë janë 15 banues më shumë sesa në katin përdhes, nxënësit e kuptojnë, se në katin e parë janë 20 banues dhe edhe 15 banues. Domethënë, numri i banuesve në katin e parë kërkohet me mbledhje: $20 + 15 = 35$ banues. Nga kushti se në katin e dytë jetojnë 5 banues më pak sesa në katin parë, nxënësit e kuptojnë, se në katin e dytë jetojnë $35 - 5$ banues, gjë që e shkruajnë: $35 - 5 = 30$ banues. Për t'iu përgjigjur pyetjes së problemës, nxënësit mbledhin numrin e banuesve të çdo kati: $20 + 35 + 30 = 85$ banues. Domethënë, përgjigja është: Në godinën e banimit të Asimit jetojnë 85 banues.

Ushtrime për përforcim:**Veprimtaria 7: Puna e pavarur e nxënësve “Katrori magjik”**

Nxënësve u jepen fletët e punës paraprakisht të përgatitura, në të cilët janë vizatuar dy katrorë. Në mesin e çdo katrori gjendet numri dhe përreth këtij numri 8 numra të vendosur si numrat në orën e dorës. Çdo numër përgjatë cepave të katrorit duhet të zmadhohet ose të zvogëlohet, në mënyrë që të jetë i barabartë me numrin në mes. Nxënësit e gjejnë, se cilët janë këto numra.

Katrori i parë: në mes është numri 48, përreth tij janë numrat 88, 28, 18, 40, 58, 49, 46, 8.

Katrori i dytë: në mes është numri 84, përreth tij janë numrat 60, 24, 86, 80, 10, 88, 4, 64.

Shembull:

Katrori: në mes është numri 27, përreth tij janë numrat 57, 29, 7, 17, 87, 22, 20, 37.

Njehsimi:

Në mesin e katrorit është numri 27. Kjo do të thotë, se prej numrave të ofruar, ndërsa këta janë 57, 29, 7, 17, 87, 22, 20, 37, duhet të përftojnë me mbledhjen ose me zbritjen e numrit të caktuar, numrin 27.

$$57 - 30 = 27$$

$$29 - 2 = 27$$

$$7 + 20 = 27$$

$$17 + 10 = 27$$

$$87 - 60 = 27$$

$$22 + 5 = 27$$

$$20 + 7 = 27$$

$$37 - 10 = 27$$

57	29	7
37	27	17
20	22	87

**Veprimtaria 8: Loja “Banka e shumave dhe e ndryshesave”**

Të gjithë nxënësve u jepet nga një fletushkë boshe. Ata duhet të shkruajnë gjashtë shprehje numerike, tri me mbledhje dhe tri me zbritje në bashkësinë e numrave natyrorë deri në 100. Ushtrimet vetëm i shkruajnë, por nuk i zgjidhin. Ushtrimet, kështu të shkruara, i futin në kuti, d.m.th. “në bankën e shumave e të ndryshesave”. Fletët përzihen. Nxënësit pastaj, një nga një, nxjerrin me zgjedhje të rastësishme nga një fletushkë me shprehje numerike me mbledhje dhe me zbritje, të cilën ata duhet ta zgjidhin. Pason puna e nxënësve dhe kontrolli i zgjidhjeve.

**Veprimtaria 9: “Shkrimtarët e matematikës”,
lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi**

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

Problemat:

1. Ndërto problemën “Rrëfimi për Kësulëkuqen” mbi bazën e shprehjes numerike: $29 - 5$.

Shembull: “Ishte një herë një vogëlushe që mbante kësulën e kuqe. Ajo quhej Kësulëkuqe. Nëna e dërgoi që të vizitonte gjyshen e sëmurë. Ajo e porositi që të mos ndalej askund. Kësulëkuqja mbante kanistrën me 29 pasta. Duke shëtitur nëpër pyll, filloi të këpuste lule. Ajo u lodh. U ul që të pushonte, hëngri 5 pasta dhe vazhdoi rrugën për tek gjyshja. Sa pasta i solli gjyshes Kësulëkuqja?”

Nxënësit e zgjidhin problemën dhe japin përgjigjen.

2. Ndërto problemën “Rrëfimi për Ivicën dhe Maricën” mbi bazën e shprehjes numerike:

$$32 + 7.$$

Shembull: “Shumë kohë më parë jetonte një zdrukthëtar me fëmijë dhe me njerken e tyre. Ishin shumë të varfër dhe shpesh nuk kishin se çfarë të hanin, kështu që njerka i mbushi mendjen burrit që t’i çonte fëmijët në pyll dhe t’i linte atje. Ivica dhe Marica vendosën të grumbullonin guralecë për ta shënuar rrugën, që të mund të ktheheshin në shtëpi. Ata grumbulluan 32 guralecë të bardhë dhe 7 guralecë ngjyrë gri. Sa guralecë kishin gjithsej dy fëmijët.”

Nxënësit e zgjidhin problemën dhe japin përgjigjen.

3. Ndërto problemën “Rrëfimi për Rosakun e shëmtuar” mbi bazën e shprehjes numerike:

$$15 + 4 - 7.$$

Shembull: “Rosa çeli një rosak të pazakontë. Ishte i shëmtuar dhe të gjithë e tallnin. Rosaku kërkonte dashurinë dhe e gjeti në liqen. Në liqen pa fytyrën e vet. Ishte kjo një mjellmë shumë e bukur. Rreth tij u mblohdën 15 mjellma, ndërsa pastaj erdhën edhe 4 mjellma të tjera. Ata u mrekulluan me bukurinë e tij. Prej këtyre mjellmave, 7 shkuan që t’i bënë ditur mjellmave të tjera lajmin e bukur për shokun e ri. Sa mjellma mbetën që ta shikonin “rosakun e shëmtuar”.

Nxënësit e zgjidhin problemën dhe japin përgjigjen.



57. MONEDHAT: 50 DHE 100 EURO

QËLLIMET

Nxënësit:

- njohin kartëmonedhat prej 50 dhe 100 euro;
- njohin vlerën dhe relacionet e monedhave;
- këmbëjnë monedhat në mënyra të ndryshme;
- dallojnë vlerën e monedhave;
- bëjnë njehsime me monedha.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Nxënësit njohin kartëmonedhat prej 50 dhe 100 eurosh, i shohin ato dhe i vlerësojnë.

Shënim: Për realizimin e këtij qëllimi mund të organizohen lojëra të ndryshme, p.sh., "Blerësit dhe shitësit" (njehsimi brenda qindësesh së parë). Duhet të shkruhen çmimet e sendeve të veçanta. Nxënësve u ndahen modele të monedhave dhe organizohet loja, në të cilën nxënësit do të jenë shitës ose blerës. "Blerësit" duhet ta paguajnë sendin me monedha të ndryshme, kurse detyrë e "shitësve" është ta kthejnë siç duhet kusurin.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Ushtrimet nr. 1 e 2

Nxënësit zhvillojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet dhe në të njëjtën kohë ushtrohen të bëjnë mbledhjen brenda qindësesh së parë.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit kthejnë në të imta në disa mënyra me monedha të ndryshme kartëmonedhën prej 100 eurosh.

Veprimtaria 4:

Nxënësit, mbi bazën e tabelës, ndërtojnë shprehjen numerike dhe njehsojnë.

Kanë qenë	I ka dhënë nëna	Ka shpenzuar	Kanë mbetur
40 euro	20 euro	30 euro	
25 euro	3 euro	8 euro	
10 euro	5 euro	7 euro	

Veprimtaria 5: Ushtrimet nr. 4, 5 e 6

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

**Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 7.**

Nxënësit shkëmbejnë kartëmonedhën prej 50 eurosh në disa mënyra. Në Tekstin mësimor janë paraqitur grafikisht kartëmonedhat dhe nxënësit shkruajnë në to vlerën. Në vendin e caktuar vizatojnë edhe ndonjë mënyrë tjetër të mundshme:

$$10 + 10 + 10 + 10 + 5 + 5 = 10 + 10 + 10 + 5 + 5 + 5 + 5 \text{ etj.}$$

Ushtrime për përforsim**Veprimtaria 7:**

Nxënësit zhvillojnë ushtrimet në fletore:

1. Tri kartëmonedha prej 10 eurosh dhe dy monedha metalike prej 2 eurosh bëjnë ___ euro.
Tri kartëmonedha prej 20 eurosh dhe një kartëmonedhë prej 5 eurosh bëjnë ___ euro.
Kartëmonedha prej 10, 20 dhe 50 eurosh dhe tri monedha metalike prej 1 euro bëjnë ___ euro.
2. Kam 50 euro. Babai më dha edhe 20 euro, ndërsa motra më dha dy kartëmonedha prej 5 eurosh. Sa euro kam tani?
3. Ana bleu fustanin për 50 euro, këpucët për 30 euro dhe shaminë për 5 euro. Sa euro shpenzoi Ana?
4. Branka i pagoi çizmet 60 euro, ndërsa pantollonat 20 euro më pak. Sa euro shpenzoi Branka?

Veprimtaria 8:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Njehso:

$$\begin{array}{ll} 50 \text{ e} + 20 \text{ e} + 10 \text{ e} + 20 \text{ e} = ___ \text{ e} & 20 \text{ e} + 20 \text{ e} + 5 \text{ e} = ___ \text{ e} \\ 80 \text{ e} + 20 \text{ e} = ___ \text{ e} & 50 \text{ e} + 50 \text{ e} = ___ \text{ e} \\ 20 \text{ e} + 20 \text{ e} + 20 \text{ e} + 20 \text{ e} = ___ \text{ e} & 10 \text{ e} + 10 \text{ e} + 10 \text{ e} + 10 \text{ e} + 10 \text{ e} = ___ \text{ e} \end{array}$$

Veprimtaria 9: Puna në grup

Një nga nxënësit e çiftit zgjidh ushtrimin nr. 1, kurse nxënësi tjetër zgjidh ushtrimin nr. 2. Pas kësaj bëjnë kontrollin e përbashkët të ushtrimeve të zgjidhura.

1. Krahaso vlerën e monedhave duke vënë re shenjat: >, <, =:
 $10 \text{ e} ___ 20 \text{ e} ___ 50 \text{ e} \quad 5 \text{ e} ___ 10 \text{ e} ___ 20 \text{ e} \quad 100 \text{ e} ___ 50 \text{ e} ___ 10 \text{ e}$
2. Krahaso vlerën e monedhave duke vënë re shenjat: >, <, =:
 $10 \text{ e} + 20 \text{ e} ___ 30 \text{ e} \quad 50 \text{ e} + 5 \text{ e} ___ 60 \text{ e} \quad 20 \text{ e} + 20 \text{ e} + 5 \text{ e} ___ 100 \text{ e}$

Veprimtaria 10:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. A) Sa dhe cilat monedha duhet të marrësh me vete në dyqan për të blerë këpucët sportive që kushtojnë 40 euro? (shkruaj dy variante)
- B) Sa dhe cilat monedha do të marrësh si kusur, nëse në dyqan për këpucët sportive ke dhënë monedhat:
a) 50 e kusuri: _____
b) 100 e kusuri: _____

Shënim: Ushtrimi ka disa zgjidhje.



2. Sa euro e ka paguar Ivani dhuratën e blerë, nëse tek arka ka lënë një kartëmonedhë prej 50 eurosh, dy kartëmonedha nga 10 euro dhe tri kartëmonedha prej 5 eurosh?
Ivani ka paguar: _____
3. Svetllana e bleu kukullën 70 euro. Në portofol kishte një kartëmonedhë prej 50 eurosh dhe dy kartëmonedha prej 20 eurosh. Sa euro i kanë mbetur Svetllanës?
Svetllanës i kanë mbetur: _____
4. Veprimi i llogarisë i nënës nga supermarketi përmbante: mish 20 euro, fruta 10 euro, ëmbëlsira 5 euro, gazeta e revista 5 euro. Nëna ka pasur kartëmonedhën prej 100 eurosh. Shitësi i ktheu dy kartëmonedha. Cilat kartëmonedha i ktheu shitësi nënës?
5. Milena do ta kthejë në të imta kartëmonedhën prej 50 eurosh. Ç' monedha mund të marrë Milena?

Veprimtaria 11: ZGJUARSI

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. Dushani ka 30 euro, kurse Maja ka 10 më shumë se Dushani. Maja bleu me të hollat e veta 20 euro kukullën. Sa të holla i mbetën Majës?
2. ÇMIMET: libri 10 euro, çokollata e madhe 5 euro, topi i futbollit 20 euro.
 - a) Sanja bleu një libër dhe tri çokollata. Sa euro pagoi për to Sanja?
 - b) Filipi bleu një top futbollit, një çokollatë dhe dy libra. Sa pagoi për të gjitha këto Filipi?
 - c) Andria bleu tre libra dhe katër çokollata. Sa euro pagoi për to Andria?
3. Me shprehjen numerike $55 e + 5 e$, ndërtoje dhe zgjidhe problemën.
4. A mund të blihet malli që kushton:
25 euro, me katër kartëmonedha _____
45 euro, me pesë kartëmonedha _____
70 euro, me dy kartëmonedha _____



58. USHTRIME ME MBLEDHJE DHE ZBRITJE

QËLLIMET

Nxënësit:

- zbatojnë njohuritë e fituara për mbledhjen dhe për zbritjen brenda qindëshes së parë;
- njehsojnë me monedha metalike dhe me kartëmonedha;
- zgjidhin problemat me një e me dy veprime njehsimi duke ndërtuar shprehjet numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor


Veprimtaria 1: Ushtrimet nr. 1 e 2

Nxënësit tregojnë situatat e ndryshme nga jeta e përditshme, në të cilat ata kanë përdorur njohuritë nga matematika (blerje, shkëmbim figurash a fotografish, numërim bonbonesh etj.). Pas kësaj zgjidhin **problemat nr. 1 e 2** në Tekstin mësimor.

Veprimtaria 2:

Nxënësve u kujtohet, sesi i kanë krahasuar numrat në klasën e parë: kanë bërë çiftet. Shohin figurën e vizatuar në dërrasë të zeze dhe u përgjigjen pyetjeve: "Çfarë ka më shumë në figurë: trekëndësha apo rrathë? Sa trekëndësha janë më shumë se rrathë? Sa rrathë janë më shumë se trekëndësha?"

Nxënësit bëjnë çiftet dhe shohin, se pa çift kanë mbetur dy trekëndësha. Domethënë, numri i trekëndëshave është për 2 më i madh se numri i rrathëve, respektivisht se numri i rrathëve është për 2 më i vogël se numri i trekëndëshave. Domethënë, numri 3 është për 2 më i vogël se numri 5, kurse numri 5 është për 2 më i madh se numri 3.



Nxënësit e kuptojnë, se kur kanë numra të mëdhenj, atëherë mënyra e krahasimit me bërjen e çifteve nuk është e përshtatshme dhe nxjerrin përfundimin, se **kur duhet të gjendet se për sa është më i madh një numër nga një numër tjetër, respektivisht më i vogël se një numër tjetër, atëherë duhet nga numri më i madh të zbritet numri më i vogël.**

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit lexojnë problemat dhe u përgjigjen pyetjeve të problemës.

Udhëzim: Pyetja e parë ka të bëjë me numrin e përgjithshëm të ndeshjeve. Nxënësit duhet të kuptojnë, se numri i përgjithshëm i ndeshjeve të luajtura përbëhet nga shuma e ndeshjeve të përfunduara me fitore, me barazim dhe me humbje. Ata ndërtojnë shprehjen numerike, njehsojnë dhe japin përgjigjen.

Pyetja e dytë ka të bëjë me krahasimin. Nxënësit e kuptojnë, se më shumë ndeshje kanë përfunduar me fitore (12) sesa me humbje (4). Për t'iu përgjigjur pyetjes, sa më shumë ndeshje kanë përfunduar me fitore, duhet të zbritet nga numri më i madh numri më i vogël, përkatësisht $12 - 4 = 8$. Domethënë, 8 ndeshje më shumë kanë përfunduar me fitore nga ato që kanë përfunduar me humbje.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4**

Nxënësit luajnë lojën "Dyqani".

Udhëzim: Në vitrinën e dyqanit "Gjithçka për sportin" janë ekspozuar sendet me çmimet e shënuara. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra lidhur me blerjen dhe shkruajnë njehsimet e veta në vendin e caktuar për këtë gjë.

Shënim: Nxënësve u shpjegohet, se kur thuhet se një artikull është më i lirë sesa një artikull tjetër, kjo gjë do të thotë, se artikulli i parë kushton më pak sesa artikulli i dytë. Kur thuhet, se një artikull është më i shtrenjtë sesa një artikull tjetër, kjo gjë do të thotë, se ky artikull i parë e ka çmimin më të lartë sesa artikulli i dytë.

Pyetja e problemës: "Nëse reketi i tenisit është bërë 5 euro më e lirë, sa euro kushton tani reketi i tenisit?"

Nxënësit e kuptojnë, se çmimi i reketit të tenisit është ulur për 5 euro dhe shkruajnë shprehjen numerike:

$$16 - 5 = 11 \text{ eypa.}$$

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat me dy veprime njehsimi me anë të ndërtimit të shprehjeve numerike.

Veprimtaria 6:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. Sinisha ka kursyer 16 euro. Gjyshja i dha edhe 20 euro. Sa të holla ka tani Sinisha? Sa të holla i kanë mbetur Sinishës, nëse prej këtyre të hollave ka shpenzuar për ëmbëlsira 6 euro?
2. Lidia ka pasur në portofol 55 euro. Ajo bleu lodrat për 30 euro, ndërsa po atë ditë babai i dha edhe 4 euro. Sa euro ka tani Lidia?
3. Në pemishte ishin 29 drufrutorë. Shtatë drufrutorë të vjetër u prenë, kurse u mbollën 5 fidanë të rinj. Sa drufrutorë ka tani në pemishte?
4. Cilin numër do të përfutosh, nëse numrin 49 e zvogëlon për 7, ndërsa pastaj e zmadhon për 6?
5. Në tri kuti janë 48 rruaza. Në kutinë e parë janë 10 rruaza, kurse në kutinë e dytë janë 20 rruaza. Sa rruaza janë në kutinë e tretë?



59. USHTRIME ME PROBLEMA

QËLLIMET

Nxënësit:

- përsëritin përfytyrimin për problemën dhe pjesët e saj logjike (kushti, pyetja, shprehja numerike, zgjidhja dhe përgjigjja);
- dinë të veçojnë pjesët logjike të problemës nga teksti i saj;
- zgjidhin problemat me një dhe me dy veprime njehsimi në kuadër të mbledhjes dhe të zbritjes deri në 100 duke e ndërtuar shprehjen numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria 1:

Shënim: Gjatë zgjidhjes së problemave, shumica e nxënësve kanë vështirësi në zgjidhjen e veprimeve të njehsimit sipas përmbajtjes së problemës, përkatësisht ta kthejnë problemën në "gjuhën e matematikës".

Nxënësit dëgjojnë problemat dhe i përgjigjen pyetjes, se cilin veprim njehsimi do të përdorin (mbledhjen ose zbritjen) për zgjidhjen e problemës.


1. Dihet se sa libra gjenden në njërin etazhe dhe sa në etazhenë tjetër. Duhet të gjendet se sa libra janë gjithsej në të dyja etazhetë.
2. Dihet se sa libra gjenden në njërin etazhe dhe në etazhenë tjetër. Duhet të gjendet, sesa libra janë me shumë në njërin etazhe sesa në etazhenë tjetër.
3. Dihet, se sa libra kanë qenë në etazhe dhe sa libra kanë marrë nxënësit nga etazheja. Duhet të gjendet se sa libra kanë mbetur në etazhe.
4. Dihet, se sa libra janë në etazhenë e parë dhe dihet se në etazhenë e dytë ka disa libra më shumë sesa në etazhenë e parë. Duhet të gjendet, se sa libra janë në etazhenë e dytë.

Teksti mësimor

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 1


Nxënësit i zgjidhin problemat në dërrasë të zezë, pastaj krahasojnë kushtet, pyetjet, zgjidhjet dhe përgjigjet. Për secilën problemë kërkojnë në tekst fjalën që tregon zgjedhjen e veprimit të njehsimit për zgjidhjen e problemave.

Shënim: Zgjidhja e problemave mund të bëhet sipas rreshtave, duke i shkruar zgjidhjet e të gjitha problemave në dërrasë të zezë:




Problema e parë

Kanë mbledhur - 30 banane
 Kanë ngrënë - 20 banane
 Kanë mbetur - ? banane




Problema e dytë

Kanë mbledhur - 30 banane
 Kanë ngrënë - ? banane
 Kanë mbetur - 10 banane



Problema e tretë

Kanë mbledhur - ? banane
 Kanë ngrënë - 20 banane
 Kanë mbetur - 10 banane





Pas zgjidhjes së këtyre tri problemave, mësues-i/ja bën përmbledhjen e punës së kryer dhe shkruan në dërrasë të zeze:

30	20	?	30	?	10	?	20	10
----	----	---	----	---	----	---	----	----

Nxënësit krahasojnë. Nxënësve u bëhet e ditur, se këto problema janë reciprokisht të kundërta: njëra prej këtyre objekteve, sipas radhës, bëhet pyetja e problemës, kurse dy të tjerat bëhen kushti i saj.

Veprimtaria 3: Ushtrimet nr. 2, 3, 4 e 5

Nxënësit zgjidhin problemat.

Udhëzim: Nxënësit lexojnë me vëmendje problemat dhe ndjekin mënyrën e zgjidhjes së problemave:

- shohin se çfarë është dhënë dhe çfarë kërkohet nga problema;
- kuptojnë idenë e fjalëve e të fjalëve të përbëra, tek të cilat duhet të mbështetemi gjatë zgjedhjes së veprimit të njehsimit;
- shkruajnë shprehjen numerike që duhet;
- gjejnë vlerën e shprehjes numerike;
- i përgjigjen me shkrim pyetjes që është bërë.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 6

Shënim: Nxënësve u shpjegohet se “më i ri” do të thotë “ka më pak vite”, kurse “më i moshuar” do të thotë “ka më shumë vite”.

Nxënësit lexojnë problemën dhe krahasojnë vitet e gjyshërve të vogëlushëve.

Zgjidhja: Gjyshi i Dushanit ka më pak vite, domethënë ai është më i ri.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit lexojnë problemën dhe kuptojnë se thënia “paralelja e dytë ka 6 nxënës më pak sesa paralelja e parë”, do të thotë “në paralelen e dytë ka $26 - 6$ nxënës”. Në problemë kërkohet numri i përgjithshëm i nxënësve në të dyja paralelet, prandaj nxënësit shkruajnë shprehjen numerike $26 - 6 + 26$. Bëjnë njehsimin dhe shkruajnë përgjigjen.

Veprimtaria 6:

Nxënësit zgjidhin problemat.

1. Në oborr janë 30 pula dhe 5 pata. Sa shpendë janë gjithsej në oborr?
2. Në ndeshje kanë qenë 96 tifozë të një ekipi dhe 6 më pak tifozë të ekipit tjetër. Sa tifozë të ekipit tjetër kanë qenë?
3. Pavli duhet të bëjë 60 balona. Ai bëri 40 balona. Edhe sa balona duhet të bëjë Pavli?
4. Aleks i ka 40 vetura të vogla. Kur i dhuroi vëllait disa prej tyre, atij i mbetën 20 vetura të vogla. Sa vetura të vogla i dha Aleks vëllait?
5. Marija ka në akuariumin e vet 25 peshq të mëdhenj dhe 4 peshq të vegjël. Sa peshq gjithsej ka në akuarium Marija?
6. Vanja dhe Novaku morën si dhuratë kutinë me bonbone prej çokollate. Vanja hëngri 25 bonbone, kurse Novaku hëngri 10 bonbone më shumë. Pas kësaj kutia mbeti bosh. Sa bonbone ka ngrënë Novaku? Sa bonbone prej çokollate kanë qenë gjithsej në kuti?
7. Aleks është 15 vjeç, kurse vëllai i tij ka 5 vite më shumë. Sa vjeç është vëllai i Aleksit? Sa vjeç ka qenë Aleks para dhjetë vitesh, ndërsa sa vjeç ka qenë atëherë vëllai i tij?



60. USHTRIME ME PROBLEMA

QËLLIMET

Nxënësit:

- zgjidhin problemat me një dhe me dy veprime njehsimi në kuadër të mbledhjes dhe të zbritjes deri në 100 duke ndërtuar shprehjet numerike;
- dinë të ndërtojnë problemën mbi bazën e shprehjes së dhënë numerike.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit lexojnë problemën dhe kërkojnë shprehjen numerike që përfaqëson zgjidhjen e problemës. Pastaj lidhin me shigjetë shkronjën para tekstit të problemës dhe shprehjen numerike përkatëse.

Udhëzim: Problema B mund të zgjidhet në dy mënyra:

1. Fillimisht gjendet se sa pasagjerë kanë hyrë, ndërsa pastaj zbritet numri i pasagjerëve që kanë dalë. Shprehja numerike mund të jetë: $7 + 5 - 4$
2. Dihet se kanë dalë 4 gra nga gjithsej 5 që kanë qenë në autobus, kurse numri i meshkujve ka mbetur i pandryshuar. Domethënë, fillimisht mund të gjendet, sesa gra kanë mbetur në autobus, ndërsa pastaj të shtohet numri i meshkujve që gjenden në autobus. Domethënë, shprehja numerike për zgjidhjen e kësaj probleme mund të jetë: $5 - 4 + 7$.

Shënim: U propozohet nxënësve që të shkruajnë edhe një shprehje numerike për **problemën A**.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit përfytyrojnë dhe shkruajnë problemën sipas figurës dhe shprehjes së dhënë numerike.

Shënim: Klasa mund të ndahet në dy grupe dhe çdo grup ta formulojë problemën duke e shkruar shkurtimisht vetë:

Grupi i parë

Kanë qenë – 42 dele
Kanë ikur – 20 dele
Kanë mbetur – ? dele

Grupi i dytë

Kanë qenë – 42 dele
Kanë ikur – ? dele
Kanë mbetur – 20 dele

Problema nr. 1. Në vathë kanë qenë 42 dele. Kanë ikur nga vatha 20 dele. Sa dele kanë mbetur në vathë?

Problema nr. 2. Në vathë kanë qenë 42 dele. Pasi që kanë ikur nga vathi disa dele, në vathë kanë mbetur 20 dele. Sa dele kanë ikur nga vathi?

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin problemën.



Shënim: Nxënësit duhet ta kuptojnë, se numri 23 gjendet në vargun numerik para numrit 25, domethënë se edhe ditëlindja e Markos vjen para pushimeve shkollore.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4

Nxënësit zgjidhin problemën.

Udhëzim: Nxënësit krahasojnë vitet e moshës së gjyshes dhe të gjyshit dhe nxjerrin përfundimin, se gjyshi është më i moshuar, përkatësisht se ka më shumë vite. Me fjalë të tjera, gjyshja është me moshë më të re, d.m.th. ka më pak vite. Për të gjetur sesa vite është më i moshuar gjyshi nga gjyshja, nxënësit kërkojnë ndryshesën ndërmjet numrit më të madh dhe numrit më të vogël: $67 - 60 = 7$. Përgjigjja: gjyshi është 7 vite më i moshuar.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit lexojnë dhe zgjidhin problemën.

Shënim: Nxënësit mbi bazën e tekstit të lexuar nxjerrin përfundimin, se i biri ka 30 vite më pak nga babai, gjë që shkruhet me shprehjen numerike $37 - 30$. Ata njehsojnë dhe japin përgjigjen: $37 - 30 = 7$. I biri është 7 vjeç.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit lexojnë dhe zgjidhin problemën.

Shënim: Nxënësit lexojnë problemën dhe kuptojnë, se ka $24 - 4$ peshq të vegjël. Ata njehsojnë dhe i përgjigjen pyetjes së parë: $24 - 4 = 20$. Për të gjetur numrin e breshkave, duhet të gjendet shuma e numrit të kanarinave dhe e peshqve të vegjël: $24 + 20 = 44$.

Veprimtaria 7:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

- Luani i mblodhi kafshët e egra dhe u vuri detyrë: xhirafa ka për të ngrënë 46 gjethe, kurse panda ka për të ngrënë 20 më shumë sesa xhirafa. Sa gjethe ka për të ngrënë panda?
Elefanti thotë: 70
Tigri thotë: 56
Rinoceronti thotë: 66
Qarko përgjigjen e saktë dhe shkruaj veprimin e njehsimit.
- Majmuni varet në drurin që ka 18 banane. Disa banane janë jeshile, kurse 9 janë të verdha. Sa banane janë jeshile?
- Ivani zhvilloi detyrën e shtëpisë që kishte 36 shkronja të vogla dhe 20 shkronja të mëdha. Sa shkronja ka shkruar gjithsej Ivani?
- Ana duhet të zgjidhë 38 ushtrime. Dje ka zgjidhur 6 ushtrime, kurse sot 2. Edhe sa ushtrime duhet të zgjidhë Ana?
- Babai i Danijelës është 47 vjeç, kurse nëna e saj është 5 vjet më e vogël. Sa vjeçe është nëna e Danijelës?
- Pylltarët mbollën 60 fidanë pisha dhe 9 fidanë mëshstekne. Sa fidanë mbollën gjithsej pylltarët?
- Hana është 6 vjeçe. Ajo është 30 vite më re se babai i saj. Sa vjeçe është babai i Hanës?
- Shitësi i kanakarëve shtëpiakë ka 39 kanarina. Ai shiti 3 çifte kanarinash. Sa kanarina i kanë mbetur shitësit të kanakarëve shtëpiakë?
- Stripi ka 18 faqe. Nëse sot ke lexuar 9 faqet e fundit të stripit, prej cilës faqe e ke filluar leximin e stripit?
- Punëtorët hapën një ditë 30 m kanal, kurse ditën e dytë hapën 7 m më shumë. Sa metra hapën ditën e dytë dhe sa metra në të dyja ditët së bashku?



61. ÇFARË KEMI MËSUAR NË KLASËN E DYTË?

QËLLIMET

Nxënësit:

- kërkojnë rrugën deri tek sendi duke bërë shpjegimin;
- vënë re dhe dallojnë sendet sipas madhësisë;
- vënë re relacionet midis sendeve, ndaj sendeve;
- njohin, dallojnë dhe emërtojnë drejt format e vijave;
- mbledhin dhe zbresin të njëjtat njësi matëse;
- sistemojnë sendet sipas karakteristikës së dhënë.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Udhëzim: Nxënësit vizatojnë rrugën që është shënuar në skemë dhe gjejnë shtëpinë në të cilën jeton vogëlushja.

Veprimtaria 2: Ushtrimi nr. 2

Nxënësit shohin figurën, në të cilën janë paraqitur shufrat me të njëjtën lartësi me gogla të vargëzuara të madhësive të ndryshme dhe i përgjigjen pyetjes së bërë.

Udhëzim: Goglat rozë janë më të vogla sesa goglat blu, gjë që do të thotë se shufra zë më shumë gogla rozë sesa gogla blu. Nxënësit mund të binden për këtë gjë, nëse i numërojnë goglat rozë dhe goglat blu.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit zgjidhin ushtrimin.

Shënim: Me këtë ushtrim nxënësit ngulitin relacionet hapësinore.

Udhëzim: Çdo nxënës ka në bankë modelin e luleve dhe e kthen këtë model, ashtu siç i duhet atij. Nxënësit dëgjojnë rrëfimin: "Në pyll ka mjaft lule. Ndërmjet tyre ka shumë lule të ngjashme, por kjo gjë dallohet me vështirësi, nga që çdo lule është e kthyer në anën e vet." Nxënësit shohin lulen e parë dhe u përgjigjen pyetjeve:

- Ç'ngjyrë kanë petalet që qarkojnë petalin e kuq nga ana e majtë dhe nga ana e djathtë? Po ato që qarkojnë petalin e verdhë?
- Thoni me radhë të gjitha ngjyrat e petaleve duke filluar nga e verdha?

Shënim: Propozojmë që mësuesi, të vizatojë në dërrasë të zezë një nga kahet (për shembull, kahun e lëvizjes së akrepave të sahatit).

Nxënësit analizojnë pozicionet e reja të luleve dhe i ngjyrosin petalet duke respektuar radhën e ngjyrave.

**Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4**

Nxënësit vënë re renditjen e figurave në zinxhir dhe kërkojnë vazhdimin.

Zgjidhja: : Zinxhiri është këputur dhe duhet gjetur vazhdimi i tij. Vazhdimi i zinxhirit është tek numri 2.

Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 5

Nxënësit zgjidhin ushtrimin duke i gjetur lulet sipas adresës: në vendin e parë është shkruar shkronja që përfaqëson kolonën, kurse në vendin e dytë është numri që përfaqëson rreshtin.

Udhëzim: Në vendin ku pritet kolona dhe rreshti përkatës, nxënësit gjejnë dhe ngjyrosin lulen me ngjyrën, me të cilën është drejtkëndëshi me adresën e asaj lule.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit emërtojnë vijat.

Shënim: Nxënësve u rikujtohen të gjitha format e vijave që kanë njohur në klasën e dytë. Këto janë: vijat e lakuara, të cilat mund të jenë të hapura (1) dhe të mbyllura (2); vija të drejta (3) dhe pjesa e vijës së drejtë, që quhet segment (4); rrethi (5), për të cilin mund të thuhet, se është vijë e lakuar e mbyllur; vija e thyer (6) që është e hapur; trekëndëshi (7), të cilin mund ta konsiderojmë edhe si vijë të thyer të mbyllur.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit zgjidhin problemën.

Udhëzim: Nxënësit përsëritin njësitë matëse që kanë njohur në klasën e dytë. Pastaj zgjidhin problemën me dy veprime njehsimi.

Veprimtaria 8: Ushtrimi nr. 8

Nxënësit zgjidhin ushtrimin logjik.

Udhëzim: Nxënësit kuptojnë se, nëse Maja nuk e ka vizatuar as rrethin, as katrorin, domethënë se ajo ka zgjedhur trekëndëshin. Ata vizatojnë trekëndëshin në hapësirën e Majës.

Asimi nuk e ka vizatuar katrorin, ndërsa trekëndëshin e ka vizatuar tashmë Maja. Domethënë, Asimi ka vizatuar rrethin. Ka mbetur edhe një figurë; katrori, të cilin e ka vizatuar Markoja. Nxënësit vizatojnë figurën përkatëse në hapësirën pranë emrit të fëmijëve.

Veprimtaria 9: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Çdo nxënës ka fletën e punës paraprakisht të përgatitur, e cila është e ndarë në katrorë. Ata duhet të vizatojnë në fletë zogun e pulës dhe pulën, duke treguar kujdes që të jenë larg njëri-tjetrit (të gjenden në dy skajet e ndryshme të fletës). Detyrë e nxënësve është, që ta shënojnë me shigjetë rrugën për t'i ndihmuar zogut të pulës, i cili ka humbur rrugën për të ardhur tek pula. Në fund vizatojnë skemën me shigjeta, e cila tregon rrugën me të cilën zogu i pulës ka gjetur pulën.

Shembull:

				Pula
Zogu i pulës				

Veprimtaria 10: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit zgjidhin ushtrimet.

1. Vizato një vizatim, ku do të përdorësh vijën e drejtë, vijën e lakuar dhe vijën e thyer.



2. Vizato katër lepurushë dhe qarko të dytin dhe të katërtin me vija të mbyllura, kurse të parin e të tretin me vija të hapura.

Cilët lepurushë mund të ikin në strofkën e vet pa e kapërcyer vijën?

Çfarë duhet bërë, që lepurushi i parë dhe i tretë të mos mund të ikin?

Çfarë duhet bërë, që lepurushi i dytë dhe i katërt të mund të ikin?

Veprimtaria 11:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat.

1. Masha dhe babai i saj e masin gjatësinë e dhomës me këmbë. Masha ka matur gjatësinë prej 13 këmbësh. Mendohu! A ka matur babai i Mashës më shumë apo më pak këmbë sesa Masha?

Qarko:

Më shumë Më pak

Pse? _____

2. Shiriti i Tanjës është 10 dm i gjatë, kurse shiriti i Sonjës është 25 më i gjatë. Sa është i gjatë shiriti i Sonjës dhe sa janë të gjatë të dy shiritat së bashku?

Veprimtaria 12: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Vizato arushin prej figurash gjeometrike: kokën dhe veshët vizatoji prej rrrathësh, trupin vizatoje prej katrori, këmbët vizatoji prej drejtkëndëshash, kravatën vizatoje prej drejtkëndëshash dhe katrorësh dhe ngjyrose atë:

Trekëndëshat - me ngjyrë të kuqe;

rrathët - me ngjyrë të verdhë;

drejtkëndëshat - me ngjyrë jeshile;

katrorët - me ngjyrë blu.

Veprimtaria 13: lidhja ndërlëndore me lëndën mësimore Kultura e artit figurativ

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur ushtrimin.

Ushtrimi: Vizato gjerdanin prej katër pjesësh duke përdorur figurat gjeometrike dhe duke treguar kujdes që çdo pjesë e gjerdanit të ketë renditjen e njëjtë të figurave.

Veprimtaria 14: "Detyrë me të gjetur"

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Nxënësit shohin figurën, në të cilën janë vizatuar tre automobila nga prapa. Automobilat janë renditur me këtë renditje:

i 1⁻ⁱ është automobili jeshil;

i 2^{-ti} është automobili blu;

i 3^{-ti} është automobili i kuq

Pyetje: A është parkuar automobili i kuq majtas automobilit blu?

Veprimtaria 15:

Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemën.

Nxënësit vizatojnë figurën e dy shumëkatëshave të së njëjtës lartësi, 15 cm, por të ndërtuar prej blloqesh të madhësive të ndryshme. Nxënësit duhet të vënë re se, megjithëse shumëkatëshat janë të së njëjtës lartësi, ata nuk kanë numrin e njëjtë të blloqeve, sepse blloqet janë të përmasave të ndryshme. Blloqet e shumëkatëshit të parë janë me përmasa 3 cm, kurse blloqet e shumëkatëshit të dytë janë me përmasa 5 cm. Nxënësit nxjerrin përfundimin, se më shumë janë blloqe me përmasat 3 cm.



62. ÇFARË KEMI MËSUAR NË KLASËN E DYTË?

QËLLIMET

Nxënësit:

- mbledhin dhe zbresin deri në 100;
- ndërrojnë vendin e mbledhësve dhe vënë re karakteristikat e përgjithshme;
- shohin lidhjen reciproke midis mbledhjes dhe zbritjes;
- dinë të zgjidhin problemat duke ndërtuar shprehjet numerike;
- përvetësojnë gjuhën e matematikës;
- njohin terminologjinë;
- gjejnë numrin e panjohur me lojë didaktike të orientuar.

Veprimtaritë e nxënësve

Teksti mësimor

Veprimtaria 1: Ushtrimi nr. 1

Nxënësit zgjidhin ushtrimet e dhëna.

Shënim: Me këto ushtrime nxënësit përsëritin mbledhjen e dy numrave me një shifër dhe vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhësve.

Veprimtaria 2: Loja “Formo barazimet”

Në dërrasë të zezë janë vizatuar tre rrrathë me numra. Nxënësit formojnë me këto numra nga dy barazime me mbledhje dhe nga dy barazime me zbritje.



Pas kësaj loje, nxënësit zhvillojnë **ushtrimin nr. 2** në tekstin mësimor.

Veprimtaria 3: Ushtrimi nr. 3

Nxënësit gjejnë në mënyrë të pavarur vlerën e shprehjeve numerike.

Veprimtaria 4: Ushtrimi nr. 4.

Nxënësit zgjidhin problemën, e cila ka pesë pyetje dhe pesë përgjigje. Ata vënë re, se përgjigjet e mëparshme mundësojnë përgjigjen më të shpejtë të pyetjeve në vazhdim.

Shënim: Pas përgjigjes ndaj të gjitha pyetjeve, është mirë që të sqarohet, a është e mundur përgjigja për pyetjen e fundit, pa iu përgjigjur pyetjes së parë. Nxënësit duhet të kuptojnë, se në rast të formulimit të problemës vetëm me pyetjen e fundit, do të duhej të përcaktohej fillimisht, sesa problema ka zgjidhur Markoja, ndërsa pastaj të kërkohej numri i përgjithshëm i problemave që kanë zgjidhur vogëlushët, d.m.th. në këtë rast do të duhej të zgjidhej problema me dy kërkesa.

**Veprimtaria 5: Ushtrimi nr. 5**

Nxënësit zgjidhin ushtrimin, me të cilin ata përsëritin mbledhjen e numrave me një shifër me kalimin mbi dhjetëshe dhe zbritjen e numrave me një shifër prej numrave me dy shifra të dhjetëshes së dytë me kalimin mbi dhjetëshe.

Veprimtaria 6: Ushtrimi nr. 6

Nxënësit shkruajnë shprehjet numerike, d.m.th. përkthejnë fjalinë në gjuhën e matematikës duke përdorur shenjat përkatëse.

Veprimtaria 7: Ushtrimi nr. 7

Nxënësit zgjidhin ushtrimet.

Udhëzim: Nxënësit kanë tri kolona me shembuj, në të cilat ata gjejnë mbledhësin e panjohur. Në dërrasën e zezë shkruhet barazimi i parë nga kolona e parë dhe tërhiqet vëmendja për veprimin e mbledhjes. Nxënësit nënvizojnë shifrën e dhjetësheve tek mbledhësi dhe tek shuma: $40 + \square = 45$. Ata vënë re, se shifra e dhjetësheve nuk ka ndryshuar, por ka ndryshuar vetëm shifra e njësheve. Domethënë, mbledhësi i dytë që mungon është numri me dy shifra. Në kolonën e dytë është e njëjta situatë.

Në dërrasën e zezë shkruhet barazimi i parë nga kolona e tretë dhe tërhiqet vëmendja për veprimin e mbledhjes. Nxënësit nënvizojnë shifrën e njësheve tek mbledhësi dhe tek shuma: $28 + \square = 48$. Ata vënë re, se shifra e njësheve nuk ka ndryshuar, por ka ndryshuar vetëm shifra e dhjetësheve. Domethënë, mbledhësi i dytë që mungon është numri me disa dhjetëshe.

Veprimtaria 8:

Shënim: Të gjitha veprimtaritë janë parashikuar për punën e pavarur të nxënësve. Mësues-i/ja mund t'i japë ato në formën e fletëve të punës, si sistematizim i lëndës së mësuar në klasën e dytë.

a) Gjej shumën në dy mënyra, nëse mbledhësit janë:

5 dhe 8, 6 dhe 7; 8 dhe 6, 7 dhe 4.

b) Jankoja dhe Petri i varin punimet figurative në stendë. Jankoja ka varur 8 punime, kurse Petri ka varur 6 punime. Sa punime kanë varur gjithsej Jankoja dhe Petri?

Veprimtaria 9:

Me ndihmën e numrave 8, 6 dhe 2 shkruaj:

a) dy barazime me mbledhje,

b) dy barazime me zbritje.

Veprimtaria 10:

1. Biblioteka e Dushanit përbëhet nga 48 enciklopedi. Në etazhe janë 6 enciklopedi. Sa enciklopedi mungojnë?

2. Shkruaj numrin që mungon:

$$44 + \underline{\quad} = 48 \qquad \underline{\quad} + 6 = 36$$

$$56 + \underline{\quad} = 59 \qquad \underline{\quad} + 8 = 48$$

$$42 + \underline{\quad} = 46 \qquad \underline{\quad} + 9 = 99$$

$$33 + \underline{\quad} = 37 \qquad \underline{\quad} + 7 = 77$$

**Veprimtaria 11:**

1. Në vagonin e parë janë 9 pasagjerë, në vagonin e dytë janë 6 pasagjerë më shumë sesa në të parin, kurse në vagonin e tretë janë 8 pasagjerë më shumë sesa në të dytin.
Sa pasagjerë janë në vagonin e dytë? _____
Sa pasagjerë janë në vagonin e tretë? _____
2. Jasmina ka këputur 14 trëndafila të dielën dhe 6 trëndafila të hënën. Sa trëndafila kanë qenë në lulishte, nëse në të kanë mbetur edhe 20 trëndafila?
3. Prej shumës së numrave 40 dhe 20 zbrit 9.
4. Ndryshesës së numrave 80 dhe 30 shtoji numrin 8.

Veprimtaria 12:

Gjej vlerën e shprehjeve numerike:

$$62 + 5 + 2 = \qquad 9 + 8 - 10 =$$

$$73 + 4 + 2 = \qquad 8 + 6 - 7 =$$

$$80 - 60 + 7 = \qquad 17 - 9 - 4 =$$

$$90 - 10 + 6 = \qquad 16 - 7 - 7 =$$




FLETA E PUNËS NUMËR 1


1. Ngjyros vazon e djathtë me ngjyrë jeshile.




2. Ngjyros me ngjyrë të verdhë sferën që është majtas sferës ngjyrë gri.




3. Majtas librit vizato lapsin. Djathtas librit vizato gomën fshirëse.



4. Ngjyros me ngjyrë të kuqe topin që është para kubit, me ngjyrë jeshile topin pas kubit dhe me të verdhë, topin mbi kub.





5. Ngjyros me ngjyrë të kaltër balonat që fëmijët mbajnë në dorën e djathtë dhe me ngjyrë të kuqe balonat që fëmijët mbajnë në dorën e majtë.







FLETA E PUNËS NUMËR 2

1. Ndiq shigjetat për ta sjellë qengjin tek nëna e tij.






2. Shëno me shigjeta rrugën e arushit.






FLETA E PUNËS NUMËR 3

1. Shëno pikat e prerjes:



2. Shëno pikat e prerjes dhe shkruaj të gjitha segmentet:



Pikat: _____

Segmentet: _____

3. Pikat e dhëna lidhi me vija të drejta. Shkruaj segmentet.

A •



• M

• K

• T

Segmentet: _____


4. Sa segmente sheh në çdo figurë?




5. Kjo është vija _____.

Ajo përbëhet nga _____.

Segmentin më të shkurtër përforcoje me ngjyrë të kuqe, kurse segmentin më të gjatë përforcoje me ngjyrë blu.



6. Përfundoje vijën e mbyllur, në mënyrë që rrethi të jetë jashtë vijës, trekëndëshi të jetë në vijë, kurse katrori të jetë brenda vijës.





FLETA E PUNËS NUMËR 4

1. Vër shenjën + ose - , në mënyrë të tillë që barazimet e përfutuara të jenë të sakta.

$3 \bigcirc 4 = 7$

$9 \bigcirc 5 \bigcirc 2 = 6$

$8 \bigcirc 4 = 4$

$3 \bigcirc 2 \bigcirc 3 = 8$

$3 \bigcirc 3 = 6$

$9 \bigcirc 1 \bigcirc 2 = 6$

$9 \bigcirc 5 = 4$

$5 \bigcirc 2 \bigcirc 3 = 6$

$8 \bigcirc 3 = 5$

$5 \bigcirc 1 \bigcirc 5 = 9$

2. Krahaso.

$8 \bigcirc 5$

$5 - 4 \bigcirc 3$

$6 - 4 \bigcirc 4 + 2$

$5 \bigcirc 9$

$6 + 3 \bigcirc 8$

$8 + 1 \bigcirc 5 + 4$

$3 \bigcirc 2$

$8 - 5 \bigcirc 3$

$7 + 2 \bigcirc 6 - 2$

>

<

=

3. Njehso.

$6 + 4 = \underline{\quad}$

$10 - 2 = \underline{\quad}$

$5 - 4 = \underline{\quad}$

$5 + 3 = \underline{\quad}$

$8 - 2 = \underline{\quad}$

$9 - 3 = \underline{\quad}$

$6 - 3 = \underline{\quad}$

$10 - 1 = \underline{\quad}$

4. Shkruaj shumën e numrave dhe njehso.

$3 \text{ dhe } 6: \underline{\quad\quad\quad} \quad 4 \text{ dhe } 5: \underline{\quad\quad\quad} \quad 1 \text{ dhe } 9: \underline{\quad\quad\quad}$

$4 \text{ dhe } 2: \underline{\quad\quad\quad} \quad 6 \text{ dhe } 3: \underline{\quad\quad\quad} \quad 3 \text{ dhe } 7: \underline{\quad\quad\quad}$

5. Kam menduar një numër. Nëse këtij numri i shtoj numrin 5, do të përftoj numrin 9. Cilin numër e kam menduar?

_____ . Kam menduar numrin _____.

6. Plotëso.

$6 + \underline{\quad} = 8$

$\underline{\quad} + \underline{\quad} = 10$

$\underline{\quad} + 4 = 8$

$7 + \underline{\quad} = 9$

$\underline{\quad} + \underline{\quad} = 6$

$\underline{\quad} + 3 = 7$

$4 + \underline{\quad} = 7$

$\underline{\quad} + \underline{\quad} = 8$

$\underline{\quad} + 2 = 6$

7. Gjej në dy mënyra shumën, nëse mbledhësit janë:

$5 \text{ dhe } 3: \underline{\quad\quad\quad}; \underline{\quad\quad\quad}$

$4 \text{ dhe } 5: \underline{\quad\quad\quad}; \underline{\quad\quad\quad}$

$1 \text{ dhe } 7: \underline{\quad\quad\quad}; \underline{\quad\quad\quad}$



8. Ndërro vendet e mbledhësve dhe bëj njehsimin:

$$8 + 1 = _ + _ = _$$

$$1 + 9 = _ + _ = _$$

$$6 + 4 = _ + _ = _$$

9. Gjej ndryshesën e numrave:

$$8 \text{ dhe } 3: _ ; \quad 5 \text{ dhe } 3: _ ;$$

$$3 \text{ dhe } 2: _ ; \quad 10 \text{ dhe } 8: _ .$$

10. Plotëso vendet boshe.

$$9 - _ = 6 \quad 5 = _ - 4 \quad 9 - 5 = _$$

$$7 - _ = 2 \quad 6 = _ - 3 \quad 7 - 4 = _$$

$$6 - _ = 4 \quad 7 = _ - 2 \quad 8 - 5 = _$$

11. Me ndihmën e numrave 4, 6 dhe 2 shkruaj:

a) dy barazime me mbledhje: _____ ; _____ .

b) dy barazime me zbritje: _____ ; _____ .

12. Plotëso.


$$2 + 3 = _ \quad 5 + 2 = _ \quad 8 + 1 = _$$

$$_ - 3 = _ \quad _ - 2 = _ \quad _ - 1 = _$$



FLETA E PUNËS NUMËR 5

1. Shumat dhe ndryshesat lidhi me vendin përkatës në segmentin numerik.




2. Krahaso.

6 ○ 4	14 ○ 12
12 ○ 18	11 ○ 15
15 ○ 20	19 ○ 17

3. Trego në segmentin numerik lidhjen midis mbledhjes dhe zbritjes:

nëse $5 + 4 = 9$, atëherë $9 - 4 = 5$.



4. Njehso.

$5 - 1 = \underline{\quad}$	$6 - 1 = \underline{\quad}$	$12 - 1 = \underline{\quad}$
$5 + 1 = \underline{\quad}$	$19 + 1 = \underline{\quad}$	$0 + 4 = \underline{\quad}$

5. Plotëso.

$3 + 0 = \underline{\quad}$	$6 + \underline{\quad} = 7$	$2 - \underline{\quad} = 0$
$4 + \underline{\quad} = 4$	$\underline{\quad} - 1 = 0$	$3 - \underline{\quad} = 0$

6. Krahaso.

9 ○ 0	6 - 5 ○ 4 - 3	0 + 0 ○ 3 + 3
0 ○ 8 - 8	0 - 0 ○ 9 - 8	4 + 0 ○ 5 - 1



7. Pavlit i dhanë 10 euro. Ai i bleu ëmbëlsirat 5 euro dhe figurat 2 euro. Sa është kusuri që mori Pavli?

8. Mina kishte 5 euro. Gjyshja i dha edhe 4 euro. Vëllai i kërkoi 3 euro. Sa të holla i kanë mbetur Minës?

9. Jankoja e bleu librin për 5 euro dhe ia pagoi shitësit me tri monedha metalike. Cilat janë këto monedha metalike. Vizatoji ato.

10. Njehso.

$8 + 2 = \underline{\quad}$ $10 - 2 = \underline{\quad}$ $2 + 8 = \underline{\quad}$ $4 + 6 = \underline{\quad}$

$10 - 8 = \underline{\quad}$ $6 + 4 = \underline{\quad}$ $10 - 4 = \underline{\quad}$ $10 - 6 = \underline{\quad}$

11. Shkruaj shenjën e duhur + ose -.

$5 \bigcirc 3 = 8$ $8 \bigcirc 2 = 6$ $10 \bigcirc 0 = 10$

$9 \bigcirc 1 = 8$ $4 \bigcirc 4 = 0$ $4 \bigcirc 5 = 9$

12. Formulo problemën mbi bazën e shprehjes numerike dhe bëj njehsimin.

a) $7 + 2$

b) $9 - 6$



FLETA E PUNËS NUMËR 6

1. Sa numra me një shifër janë?

Qarko përgjigjen:

dhjetë dymbëdhjetë nëntë

2. Përgjigju:

Cili është numri më i vogël me një shifër? _____

Cili është numri më i madh me një shifër? _____

Cili është numri më i vogël me dy shifra? _____

Cili është numri më i madh me dy shifra? _____

3. Shkruaj, për sa është më i madh numri më i vogël me dy shifra nga numri më i madh me një shifër.

4. Vendos shenjën $<$, $>$ ose $=$.

5 nj 2 dh 20 26 nj 7 dh 70 nj

5 dh 40 7 dh 45 nj 50 nj 50 dh

5. Njehso.

2 dh + 4 dh = ____ 8 dh - 3 dh = ____ ____ + 2 dh = 9 dh 3 dh + 5 dh = ____

6. Njehso.

20 + 10 = ____ 40 + 20 = ____ 70 + 10 = ____ 80 + 20 = ____ 30 + 40 = ____

7. Krahaso.

10 + 40 30 20 + 50 80 80 - 20 60

50 - 10 30 80 - 20 - 40 20 30 + 60 - 30 40

8. Nga shuma e numrave 60 dhe 20 zbrit numrin më të madh të dhjetëshes së katërt.



9. Shkruaj njësitë matëse të gjatësisë që ke mësuar.

10. Njehso.

$5 \text{ dm} - 3 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

$40 \text{ dm} + 10 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

$7 \text{ dm} + 2 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

$30 \text{ dm} + 50 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

$9 \text{ dm} - 6 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

$90 \text{ dm} - 40 \text{ dm} = \underline{\quad} \text{ dm}$

11. Sa është e gjatë kukulla e Minës, nëse ajo është 4 dm më e shkurtër sesa kukulla e Majës, lartësia e së cilës është 8 dm?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

12. Gjatësia e fushës sportive të basketbollit është 17 m, kurse gjatësia e fushës sportive të futbollit është 3 m më e gjatë. Gjej gjatësinë e përgjithshme të të dyja fushave sportive.

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____



FLETA E PUNËS NUMËR 7

1. Gjej vlerën e shprehjeve numerike.

$13 - 10 = \underline{\quad}$ $15 - 10 = \underline{\quad}$ $16 - 10 = \underline{\quad}$

$10 + 6 = \underline{\quad}$ $10 + 4 = \underline{\quad}$ $10 + 3 = \underline{\quad}$

2. Lidhi shprehjet numerike me rezultatet përkatëse.

$4 + 1$

$5 + 1$

$17 - 10$

$18 - 10$

$15 - 5$

$16 - 10$

$5 + 2$

$9 + 1$

$8 - 3$

$9 - 3$

$8 - 1$

$12 - 2$

 10 7 6 5

3. Shkruaj shenjën + ose -, në mënyrë të tillë që barazimet të jenë të sakta:

$12 \bigcirc 2 = 14$

$13 \bigcirc 3 = 10$

$13 \bigcirc 3 = 10$

$15 \bigcirc 10 = 5$

$18 \bigcirc 10 = 8$

$14 \bigcirc 2 = 16$

4. Njehso.

$14 - 4 - 6 = \underline{\quad}$

$9 + 1 + 5 = \underline{\quad}$

$11 - 1 - 7 = \underline{\quad}$

$6 + 4 + 2 = \underline{\quad}$

$18 - 8 - 2 = \underline{\quad}$

$3 + 7 + 5 = \underline{\quad}$

5. Njehso.

$17 + 2 = \underline{\quad}$

$17 - 5 = \underline{\quad}$

$18 + 1 = \underline{\quad}$

$8 - 7 = \underline{\quad}$

$15 + 3 = \underline{\quad}$

$15 - 4 = \underline{\quad}$

$14 + 5 = \underline{\quad}$

$16 - 5 = \underline{\quad}$

6. Lena poqi 18 kuleçë. Vëllai i saj hëngri 5 kuleçë. Sa kuleçë kanë mbetur?



7. Tomashi bëri 15 aeroplanë prej letre. Ai humbi 4 prej tyre. Sa aeroplanë i mbetën Tomashit?

8. Lidhi shprehjet numerike me vlerat e tyre.

12

14 - 3

16 - 4

12 + 1

11

19 - 8

18 - 7

13

17 - 5

11 + 1

9. Njehso.

$$17 - 12 = 17 - 10 - 2 = \underline{\quad} - 2 = \underline{\quad}$$

$$19 - 17 = 19 - 10 - 7 = \underline{\quad} - 7 = \underline{\quad}$$

$$16 - 13 = 16 - 10 - 6 = \underline{\quad} - 6 = \underline{\quad}$$

$$15 - 14 = 15 - 10 - 5 = \underline{\quad} - 5 = \underline{\quad}$$

10. Cili numër duhet të zbritet nga numri 16, që të përftohet numri 2?

11. Markoja kishte 18 figura. Vëllai i mori disa prej tyre. Markos i mbetën 5 figura. Sa figura i mori Markos vëllai?

12. Gjej zbritësin e panjohur.

$$18 - \underline{\quad} = 6$$

$$13 - \underline{\quad} = 3$$

$$14 - \underline{\quad} = 3$$

$$19 - \underline{\quad} = 4$$

$$17 - \underline{\quad} = 5$$

$$12 - \underline{\quad} = 1$$



FLETA E PUNËS NUMËR 8

1. Njehso.

$5 + 6 = \underline{\quad}$

$4 + 3 + 3 = \underline{\quad}$

$8 + 4 = \underline{\quad}$

$2 + 5 + 4 = \underline{\quad}$

$9 + 5 = \underline{\quad}$

$8 + 1 + 5 = \underline{\quad}$

$6 + 6 = \underline{\quad}$

$3 + 3 + 6 = \underline{\quad}$

2. Ollga kishte 8 kordele për flokë. Tezja i dha edhe 2 kordele të tjera. Sa kordele ka tani Ollga?

3. Njehso.

$11 - 6 = \underline{\quad}$

$12 - 7 = \underline{\quad}$

$11 - 5 = \underline{\quad}$

$12 - 8 = \underline{\quad}$

$11 - 7 = \underline{\quad}$

$12 - 9 = \underline{\quad}$

4. Vanja lexoi ditën e parë 12 faqe të librit, kurse ditën e dytë lexoi edhe 8 faqe të tjera. Sa faqe të librit lexoi gjithsej Vanja?

5. Njehso.

$8 + 3 = \underline{\quad}$

$11 - 4 + 8 = \underline{\quad}$

$9 + 4 = \underline{\quad}$

$12 - 7 + 9 = \underline{\quad}$

$7 + 7 = \underline{\quad}$

$10 - 2 + 6 = \underline{\quad}$

$6 + 8 = \underline{\quad}$

$12 - 9 + 8 = \underline{\quad}$

6. Dushani këputi 9 mollë, kurse Markoja këputi 6 mollë. Sa mollë këputën gjithsej Dushani dhe Markoja?

7. Njehso.

$13 - 7 = \underline{\quad}$

$13 - 6 + 7 = \underline{\quad}$

$14 - 5 = \underline{\quad}$

$11 - 4 + 5 = \underline{\quad}$

$13 - 8 = \underline{\quad}$

$12 - 8 + 8 = \underline{\quad}$

$14 - 7 = \underline{\quad}$

$14 - 8 + 8 = \underline{\quad}$



8. Në çatinë e godinës së banimit janë 14 pëllumba. Fluturuan 7 prej tyre. Sa pëllumba mbetën në çati?

9. Njehso.

$9 + 4 = \underline{\quad}$ $4 + 8 + 7 = \underline{\quad}$

$9 + 6 = \underline{\quad}$ $6 + 7 + 4 = \underline{\quad}$

$9 + 7 = \underline{\quad}$ $2 + 6 + 9 = \underline{\quad}$

$8 + 7 = \underline{\quad}$ $5 + 3 + 7 = \underline{\quad}$

$8 + 9 = \underline{\quad}$ $9 + 4 + 2 = \underline{\quad}$

10. Në kopshtin e fëmijëve janë 8 vogëlushë dhe 7 vogëlushe. Në shtëpi shkuan dhjetë prej fëmijëve. Sa fëmijë mbetën që të prisnin prindërit?

11. Njehso.

$15 - 7 = \underline{\quad}$ $12 - 8 - 3 = \underline{\quad}$

$15 - 6 = \underline{\quad}$ $16 - 7 - 4 = \underline{\quad}$

$16 - 9 = \underline{\quad}$ $15 - 8 - 5 = \underline{\quad}$

$16 - 7 = \underline{\quad}$ $18 - 9 - 5 = \underline{\quad}$

$17 - 9 = \underline{\quad}$ $17 - 8 - 8 = \underline{\quad}$

$17 - 8 = \underline{\quad}$ $16 - 8 - 6 = \underline{\quad}$

$18 - 9 = \underline{\quad}$ $15 - 9 - 3 = \underline{\quad}$

12. Mamaja bleu 17 m pëlhurë. Ajo shpenzoi për perde 8 m pëlhurë. Sa metra pëlhurë i mbetën mamasë?



FLETA E PUNËS NUMËR 9

1. Plotëso atë që mungon.

Meqë $14 - 8 = 6$, atëherë edhe $6 + \underline{\quad} = 14$.

Meqë $5 - 7 = 8$, atëherë edhe $\underline{\quad} + 7 = \underline{\quad}$.

Meqë $16 - 9 = 7$, atëherë edhe $7 + \underline{\quad} = 16$.

Meqë $13 - 5 = 8$, atëherë edhe $\underline{\quad} + \underline{\quad} = 13$.

2. Nenadi kishte 14 lapsa me ngjyrë. Ai i dha borxh shokut 7 lapsa me ngjyrë. Sa lapsa më ngjyrë i mbetën Nenadit?

Shoku ia ktheu pas disa ditësh lapsat me ngjyrë. Trego me shprehje numerike, sesa lapsa me ngjyrë ka tani Nenadi.

3. Trego lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes me ndihmën e numrave:

$14, 8, 6$

$13, 9, 4$

$15, 6, 9$

4. Gjej zbritësin e panjohur.

$13 - \underline{\quad} = 7$

$15 - \underline{\quad} = 12$

$17 - \underline{\quad} = 14$

$16 - \underline{\quad} = 8$

$18 - \underline{\quad} = 12$

$19 - \underline{\quad} = 7$

5. Dragani kishte 17 rruaza. Kur i dha shokut disa rruaza, atij i mbetën 9 rruaza. Sa rruaza i dha shokut?

6. Shkruaj numri që mungon.

$8 + 6 = 8 + 2 + \underline{\quad}$

$13 - 4 = 13 - \underline{\quad} - 1$

$7 + 6 = 7 + \underline{\quad} + 3$

$18 - 9 = 18 - \underline{\quad} - 1$

7. Njehso.

$12 - 8 + 5 = \underline{\quad}$

$9 - 4 + 12 = \underline{\quad}$

$13 - 8 + 6 = \underline{\quad}$

$8 - 6 + 8 = \underline{\quad}$

$14 - 9 + 6 = \underline{\quad}$

$16 - 9 + 7 = \underline{\quad}$

$10 - 4 + 7 = \underline{\quad}$

$18 - 7 + 5 = \underline{\quad}$



8. Vladimiri kishte gjithsej në kuti 17 zhetonë blu dhe të kuq. Ai nxori nga kutia të gjithë 8 zhetonët e kuq dhe shtoi në kuti 6 zhetonë blu. Atij i mbetën tani në kuti vetëm zhetonët blu. Sa zhetonë janë në kuti?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

9. Në një fermë fshati janë 8 lopë dhe 7 dele. Sa kafshë shtëpiake janë gjithsej në këtë fermë fshati?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

10. Danijela këputi 9 mollë. Ajo këputi më vonë edhe 8 mollë të tjera. Motrës i dha 5 mollë. Sa mollë i kanë mbetur Danielës?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

11. Pushimi shkollor i pranverës zgjat dy javë. Markoja ka 9 ditë që është tek gjyshja. Edhe sa ditë i kanë mbetur Markos për të shkuar në shkollë?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

12. Maja është nisur për në bregdet ditën e premte. Ajo ka planifikuar, që të qëndrojë atje katër ditë. Cilën ditë të javës do të kthehet në shtëpi Maja?



FLETA E PUNËS NUMËR 10

1. Plotëso.

$67 = 60 + 7$

$39 = 10 + 10 + 10 + 9$

$43 = \underline{\quad} + \underline{\quad} \quad 55 = \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad}$

$98 = \underline{\quad} + \underline{\quad} \quad 48 = \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad}$

$74 = \underline{\quad} + \underline{\quad} \quad 27 = \underline{\quad} + \underline{\quad} + \underline{\quad}$

2. Cilës dhjetëshe i përkasin numrat e dhënë?

56 _____

74 _____

43 _____

82 _____

3. Shkruaj si shumë.

$$\begin{array}{l} 2 \text{ dh } 7 \text{ nj} \\ \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad} \end{array}$$

$$\begin{array}{l} 5 \text{ dh } 4 \text{ nj} \\ \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad} \end{array}$$

$$\begin{array}{l} 8 \text{ dh } 9 \text{ nj} \\ \underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad} \end{array}$$

4. Shkruaj me shifra numrat:

pesëdhjetë e gjashtë _____ shtatëdhjetë e shtatë _____ tetëdhjetë e dy _____

5. Shkruaj numrin që:

pason numrin 65: _____; është paraardhësi i numrit 58: _____; që përmban 8 dh dhe 3 nj: _____

6. Shkruaj me fjalë numrat:

86 _____

71 _____

66 _____

42 _____

7. Renditi numrat 56, 89, 33, 48, 22, 90, 61 nga më i vogli deri tek më i madhi.



8. Cilët numra me dy shifra mund të shkruash me ndihmën e shifrave:

2 dhe 7 _____

6 dhe 8 _____

9 dhe 1 _____

5, 4 dhe 0 _____

8, 4 dhe 3 _____

9. Shkruaj të gjithë numrat me dy shifra, të cilat kanë në vendin e njësheve shifrën 8.

10. Gjej cili është:

paraardhësi i numrit 47 _____ pasardhësi i numrit 35 _____

paraardhësi i numrit 89 _____ pasardhësi i numrit 55 _____

11. Shkruaj numrin paraardhës dhe pasardhës të numrave.

____ 21 ____ 98 ____ ____ 56 ____

____ 77 ____ ____ 87 ____ ____ 61 ____

12. Qarko me ngjyrë blu pasardhësit e numrit 45, kurse me ngjyrë jeshile paraardhësit e numrave.

$44 < 45 < 46$ $46 > 45 > 44$

13. Shkruaj shenjën $<$, $>$ ose $=$.

$37 \bigcirc 45$ $65 \bigcirc 77$ $98 \bigcirc 99$

$65 \bigcirc 65$ $33 \bigcirc 21$ $26 \bigcirc 63$

14. Krahaso numrat 56, 78, 90, 43, 21, 88, 16, 62 nga më i madhi deri tek më i vogli:

Tani krahaso:

numrin e tretë dhe numrin e parë _____

numrin e dytë dhe numrin e katërt _____

numrin e pestë dhe numrin e gjashtë _____

numrin e tetë dhe numrin e shtatë _____



FLETA E PUNËS NUMËR 11

1. Njehso.

$20 + 6 = \underline{\quad}$ $70 + 7 = \underline{\quad}$ $30 + 3 = \underline{\quad}$

$26 - 6 = \underline{\quad}$ $77 - 7 = \underline{\quad}$ $80 + 6 = \underline{\quad}$

$26 - 20 = \underline{\quad}$ $77 - 70 = \underline{\quad}$ $60 + 7 = \underline{\quad}$

2. Krahaso.

$56 \bigcirc 50 + 5$ $45 - 5 \bigcirc 40 + 5$

$78 \bigcirc 55 - 5$ $60 + 10 \bigcirc 75 - 5$

$65 \bigcirc 60 + 5$ $50 + 2 \bigcirc 50 + 0$

3. Mbledhësi i dytë është 5, kurse mbledhësi i parë është 40. Gjej shumën.

4. Vanja kishte 60 euro. Gjyshja i dha 5 euro. Ka shpenzuar 60 euro. Sa euro i kanë mbetur Vanjës?

5. Njehso.

$38 + 1 = \underline{\quad}$ $83 + 4 = \underline{\quad}$ $96 - 3 = \underline{\quad}$ $77 - 4 = \underline{\quad}$

$45 + 3 = \underline{\quad}$ $44 + 5 = \underline{\quad}$ $28 - 5 = \underline{\quad}$ $59 - 8 = \underline{\quad}$

$52 + 4 = \underline{\quad}$ $33 + 5 = \underline{\quad}$ $88 - 7 = \underline{\quad}$ $53 - 3 = \underline{\quad}$

$66 + 3 = \underline{\quad}$ $82 + 7 = \underline{\quad}$ $39 - 6 = \underline{\quad}$ $35 - 4 = \underline{\quad}$

6. Në një kopsht perimesh janë mbjellë 34 lehe me lakër dhe 5 lehe me qepë. Sa lehe me lakra dhe me qepë ka gjithsej në kopshtin e perimeve?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

7. Në etazhenë e bibliotekës ishin 88 libra. Nxënësit morën 7 libra. Sa libra kanë mbetur në etazhenë e bibliotekës?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____



8. Shkruaj numrin që është:

për 6 më i madh se numri 32 _____

për 3 më i madh se numri 55 _____

për 6 më i madh se numri 72 _____

për 4 më i vogël se numri 68 _____

për 7 më i vogël se numri 89 _____

për 5 më i vogël se numri 98 _____

9. Markoja banon në shumëkatëshin që ka 22 kate. Mina banon në shumëkatëshin që ka 6 kate më shumë, kurse Jovana banon në shumëkatëshin që ka 5 kate më pak sesa shumëkatëshi i Minës. Sa kate ka shumëkatëshi i Minës dhe sa kate ka shumëkatëshi i Jovanës?

Shumëkatëshi i Minës: _____

Shumëkatëshi i Jovanës: _____

10. Gjej vlerën e shprehjeve numerike.

$70 + 15 = \underline{\quad\quad}$ $43 - 30 = \underline{\quad\quad}$

$18 + 50 = \underline{\quad\quad}$ $77 - 40 = \underline{\quad\quad}$

$60 + 25 = \underline{\quad\quad}$ $99 - 50 = \underline{\quad\quad}$

$56 + 30 = \underline{\quad\quad}$ $47 - 20 = \underline{\quad\quad}$

11. Krahaso.

$43 + 20 \bigcirc 30 + 13$ $53 - 20 \bigcirc 83 - 50$

$18 + 60 \bigcirc 14 + 50$ $65 - 30 \bigcirc 77 - 30$

$53 + 40 \bigcirc 70 + 22$ $78 - 40 \bigcirc 87 - 70$

$73 + 10 \bigcirc 80 + 14$ $89 - 60 \bigcirc 69 - 30$

12. Një autobus ka 56 ndenjëse, kurse tjetri ka 20 ndenjëse. Sa pasagjerë mund të transportojnë njëherësh të dy autobusët?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

13. Në të dyja anët e një godine duhet të mbillen 99 fidanë. Në njërin anë janë mbjellë tashmë 20 fidanë, ndërsa në tjetrën 10 fidanë. Edhe sa fidanë të tjerë duhet të mbillen?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____



- 14.** Në një stacion ishin tre trena mallrash. Trena e parë kishte 63 vagonë, trena e dytë kishte 10 vagonë më pak se e para, kurse trena e tretë kishte 20 vagonë më shumë se e dytë. Sa vagonë ka trena e tretë?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

- 15.** Një klasë ka 27 nxënës, kurse klasa tjetër ka 3 nxënës më shumë. Sa nxënës ka klasa e dytë dhe sa nxënës kanë gjithsej të dyja klasat?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____



FLETA E PUNËS NUMËR 12

1. Sonja kishte 100 euro. Ajo bleu këpucët. Sa i pagoi këpucët Sonja, nëse shitësja i ktheu kusurin prej 40 eurosh?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

2. Markoja dhe Jovani i kursejnë të hollat për të blerë topin e futbollit prej lëkure. Markoja ka kursyer 20 euro, kurse Jovani ka kursyer 10 euro më shumë se Markoja. Çmimi i topit të futbollit prej lëkure është 60 euro. Edhe sa të holla u duhen atyre, që të mund të blejnë topin e futbollit?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

3. Petri ka 80 euro në kartëmonedha. Shkruaj katër variantet e kartëmonedhave që mund të ketë Petri, por që shuma e tyre të jetë 80 euro.

4. Llana kishte 50 figura. Jovana i dha asaj edhe 15 figura të tjera. Llana i dhuroi Sarës 30 figura. Sa figura i mbetën Llanës?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

5. Ndryshesës së numrave 70 dhe 20 shtoji numrin 25.

6. Dy vëllezër kanë së bashku 25 vjet. Sa vjeç është vëllai i parë, nëse e di se vëllai i dytë është 10 vjeç?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

7. Në livadh janë 70 dele. Nga livadhi ikën 20 dele dhe erdhën edhe 25 dele të tjera. Sa dele janë tani në livadh?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____



8. Nikolla mblodhi 20 stripe, kurse Ivoja mblodhi 15 stripe. Llazari mblodhi 40 stripe më shumë sesa Nikolla dhe Ivoja së bashku. Sa stripe ka mbledhur Llazari?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

9. Në album janë 95 fotografi. Mamaja nxori nga albumi 30 fotografi, kurse shtoi 20 të reja. Sa fotografi janë tani në album?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

10. Jovani bëri 45 aeroplanë prej letre, kurse Gjorgji bëri 20 aeroplanë më pak. Filipi bëri 10 aeroplanë më shumë sesa Gjorgji. Sa aeroplanë prej letre bëri Filipi?

Zgjidhja: _____

Përgjigjja: _____

